REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

RAPORT

MBI GJENDJEN E SISTEMIT GJYQËSOR

DHE MBI

VEPRIMTARINË E

KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

VITI 2025

Ky Raport u përgatit nga Grupi i Punës i ngritur për këtë qëllim me Urdhrin e Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 22, datë 05.02.2026 “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e projekt-raportit mbi gjendjen e sistemit gjyqësor për vitin 2025”, i ndryshuar.

Raporti u shqyrtua dhe u miratua nga Komisioni i Përhershëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor për Planifikimin Strategjik, Administrimin dhe Buxhetin, i drejtuar nga Kryetari i Këshillit z. Ilir Rusi dhe anëtarët e tij znj. Yllka Rupa dhe z. Ridvan Hado.

Në përfundim raporti u miratua në mbledhjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor me vendimin nr. 230, datë 29.04.2026.

SHKURTIME

RSH	Republika e Shqipërisë
KLGJ	Këshilli i Lartë Gjyqësor
ILD	Inspektori i Lartë i Drejtësisë
KLP	Këshilli i Lartë i Prokurorisë
ILDKPKI	Inspektori i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave
MD	Ministria e Drejtësisë
MF	Ministria e Financave
MPJ	Ministria për Punët e Jashtme dhe Evropën
CEPEJ	Komisioni Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë
CCJE	Këshilli Konsultativ i Gjyqtarëve Evropian
KPK	Komisioni i Pavarur i Kualifikimit
KPA	Kolegji i Posaçëm i Apelimit
KPSAB	Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit
KZHK	Komisioni i Zhvillimit të Karrierës
KVEVP	Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale
KD	Komisioni Disiplinor
GJL	Gjykata e Lartë
GJPAKKO	Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar
GJPSHIKKO	Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar
QTI	Qendra e Teknologjisë së Informacionit
SHM	Shkolla e Magjistraturës

PËRMBAJTJA

MESAZHI I KRYETARIT TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR 4
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE 6
1. VEPRIMTARIA E KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR 8
1.1 Kuadri ligjor i brendshëm dhe ndërkombëtar 9
1.2 Mbledhjet plenare 10
1.3 Përmbledhje e veprimtarisë së komisioneve të Këshillit 10
1.4 Komisionet e përhershme 11
1.5 Komisionet e përkohshme 19
2. NIVELI I ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE GJATË VITIT 2025 TË REZOLUTËS SË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PËR VITIN 2024 22
3. UDHËRRËFYESI PËR EFIKASITETIN E PUSHTETIT GJYQËSOR NË SHQIPËRI 2025-2027 29
4. MENAXHIMI DHE ZHVILLIMI I BURIMEVE NJERËZORE 50
4.1 Burimet njerëzore të Këshillit të Lartë Gjyqësor 50
4.2 Burimet njerëzore në gjykatat e të tre nivele 52
5. VEPRIMTARIA BUXHETORE DHE FINANCIARE 56
6. DIGJITALIZIMI 68
6.1 Qendra e Teknologjisë së Informacionit 68
6.2 Përmirësimet në infrastrukturën teknologjike ekzistuese 72
7. STRATEGJIA KOMBËTARE E ULJES SË NUMRIT TË ÇËSHTJEVE TË PRAPAMBETURA NË GJYKATA 77
8. ANALIZA MBI SITUATËN E GJYKATAVE 80
8.1 GJYKATA E LARTË E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË 82
8.2 GJYKATA E POSAÇME E APELIT PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR 93
8.3 GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR 101
8.4 GJYKATA E APELIT TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM 109
8.5 GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT 122
8.6 GJYKATAT ADMINISTRATIVE TË SHKALLËS SË PARË 134
8.7 GJYKATAT E SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM 147
9. BASHKËPUNIMI NDËRINSTITUCIONAL DHE TRANSPARENCA 163
9.1 Bashkëpunimi i Brendshëm 163
9.2 Bashkëpunimi me grupet e interesit 164
9.3 Bashkëpunimi me Gjykatat 164
9.4 Aktivitete dhe marrëdhënie ndërkombëtare 165
9.5 Bashkëpunimi në kuadër të procesit të negociatave për anëtarësim në BE 166
9.6 Transparenca dhe marrëdhëniet me publikun 166
10. KONKLUZIONE DHE ANGAZHIME 168

MESAZHI I KRYETARIT TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

I nderuar z. Kryetar i Kuvendit,
Të nderuar deputetë,

Kam kënaqësinë të paraqes Raportin Vjetor për vitin 2025 mbi gjendjen e sistemit gjyqësor dhe veprimtarinë e Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Viti 2025 shënon një hap të rëndësishëm përpara për sistemin gjyqësor, duke reflektuar kalimin nga faza e stabilizimit drejt një reformimi më aktiv, me rezultate konkrete në shërbim të qytetarëve. Gjatë këtij viti, Këshilli zhvilloi 69 mbledhje, dhe miratoi 882 vendime, duke forcuar efektivitetin dhe funksionalitetin e veprimtarisë së tij.

Një ndër arritjet më të rëndësishme është frenimi i rritjes së çështjeve të prapambetura dhe fillimi i uljes së tyre. Gjykata e Lartë shënoi një reduktim të ndjeshëm të *backlog*-ut, ndërsa gjykatat e shkallës së parë përmirësuan treguesit e trajtimit të çështjeve, duke ndikuar pozitivisht në uljen e stokut.

Në të njëjtën kohë, është bërë përparim i dukshëm në procesin e digjitalizimit, përmes arkivimit elektronik të dokumentacionit dhe nisjes së ndërtimit të sistemit Juronix, duke kontribuar në rritjen e transparencës dhe aksesit të qytetarëve në shërbimet gjyqësore.

Gjatë vitit 2025 është vënë theksi gjithashtu në forcimin e kapaciteteve njerëzore, përmes emërimeve të reja, programeve të trajnimit dhe përmirësimit të standardeve profesionale në sistem.

Megjithatë, sfidat mbeten të pranishme. Numri i vakancave vijon të jetë i konsiderueshëm dhe ndikon në kapacitetin e gjykatave, veçanërisht në nivel apeli.

Në vijim synohet vijimi i reformave, reduktimi i mëtejshëm i çështjeve të prapambetura, plotësimi gradual i vakancave dhe thellimi i digjitalizimit të shërbimeve gjyqësore.

Në këtë kuadër, mbështetja e Kuvendit mbetet thelbësore, si në aspektin ligjor, në atë financiar dhe infrastrukturor për të garantuar vijueshmërinë dhe qëndrueshmërinë e reformave.

Ne besojmë se përmes një bashkëpunimi konstruktiv institucional mund të vijojmë ndërtimin e një sistemi drejtësie më efikas, transparent dhe të orientuar drejt qytetarit.

Sistemi gjyqësor sot ndodhet në një fazë të re zhvillimi dhe ka krijuar baza të qëndrueshme për përmirësim të mëtejshëm. Qëllimi ynë është forcimi i besimit të publikut dhe për të garantuar drejtësi cilësore dhe në kohë.

Drejtësia shqiptare sot përfaqëson një sistem që synon të balancojë cilësinë me kohën, duke respektuar qytetarin dhe duke iu përgjigjur sfidave me standarde bashkëkohore.

Jemi të ndërgjegjshëm se reformat kërkojnë vazhdimësi, përkushtim dhe përmirësim të pandërprerë. Megjithatë, mbetemi të bindur në progresin e arritur dhe në potencialin për zhvillime të mëtejshme.

Falënderimet dhe mirënjohja për këtë punë të çmuar u takojnë anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, magjistratëve, gjyqtarëve, nëpunësve civilë gjyqësorë, administrativ, etj.

Drejtësia e vërtetë nuk matet vetëm me cilësinë e vendimeve, por edhe me kohën në të cilën ajo vihet në dispozicion të qytetarëve. Në këtë drejtim, sistemi gjyqësor shqiptar po konsolidon kapacitetet për të garantuar njëkohësisht cilësi dhe kohë.

Me respekt,
Prof. Asoc. Dr. Ilir Rusi
Kryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Viti 2025 përfaqëson një etapë të rëndësishme në vijimësinë e përpjekjeve për konsolidimin, modernizimin dhe rritjen e efikasitetit të sistemit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë. Veprimtaria e Këshillit të Lartë Gjyqësor gjatë këtij viti është karakterizuar nga një intensitet i shtuar institucional, i reflektuar në një volum të konsiderueshëm vendimmarrjesh, si dhe në ndërmarrjen e nismave me karakter strukturor dhe strategjik, të orientuara drejt përmirësimit të qëndrueshëm të funksionimit të sistemit.

Në drejtim të reformave, miratimi i dokumenteve strategjike dhe ngritja e mekanizmave përkatës monitorues dëshmojnë një qasje të konsoliduar drejt rritjes së efiçencës dhe forcimit të qeverisjes gjyqësore. Këto zhvillime kanë kontribuar në krijimin e një kuadri më të qartë orientues për institucionet e sistemit, duke mundësuar një ndjekje më të strukturuar të objektivave afatmesme dhe afatgjata.

Forcimi i kapaciteteve njerëzore ka mbetur një ndër prioritetet kryesore. Gjatë vitit raportues janë ndërmarrë hapa të rëndësishëm në drejtim të emërimit të magjistratëve të rinj, zhvillimit të karrierës së gjyqtarëve dhe përmirësimit të mekanizmave të vlerësimit profesional dhe etik. Njëkohësisht, janë aplikuar masa për optimizimin e shpërndarjes së burimeve njerëzore ndërmjet gjykatave, me qëllim adresimin e pabarazive në ngarkesë. Megjithatë, prania e një numri të konsiderueshëm vakancash vijon të përbëjë një sfidë strukturore, me ndikim të drejtpërdrejtë në performancën dhe kohëzgjatjen e proceseve gjyqësore.

Paralelisht, janë shënuar përparime të rëndësishme në drejtim të transformimit digjital të sistemit gjyqësor. Digjitalizimi i proceseve, zhvillimi i infrastrukturës teknologjike dhe fillimi i implementimit të sistemeve të integruara të menaxhimit të çështjeve përfaqësojnë hapa konkretë drejt rritjes së transparencës, efikasitetit dhe sigurisë së të dhënave. Gjithashtu, miratimi i standardeve të reja procedurale dhe operacionale ka kontribuar në unifikimin e praktikave dhe përmirësimin e cilësisë së vendimmarrjes gjyqësore.

Në aspektin e performancës, evidentohet një tendencë përgjithësisht pozitive në disa nivele të sistemit gjyqësor, veçanërisht në drejtim të reduktimit të çështjeve të prapambetura dhe përmirësimit të normave të likuidimit. Gjykata e Lartë dhe gjykatat e shkallës së parë kanë shënuar progres të dukshëm në këtë drejtim, ndërsa në nivel apeli vërehen zhvillime drejt stabilizimit, megjithëse sfidat mbeten të pranishme, sidomos në trajtimin e çështjeve civile dhe në kushtet e kapaciteteve të kufizuara.

Drejtësia e specializuar ka vijuar të ruajë standarde të larta efikasiteti dhe profesionalizmi, duke garantuar trajtim në kohë dhe me cilësi të çështjeve me ndjeshmëri të lartë. Në të njëjtën kohë, është forcuar më tej angazhimi institucional ndaj transparencës dhe llogaridhënies,

përmes përmirësimit të komunikimit publik dhe rritjes së aksesit në informacion, si dhe përmes intensifikimit të bashkëpunimit ndërinstitucional dhe me partnerët ndërkombëtarë në funksion të procesit të integrimit evropian.

Në planin financiar, menaxhimi i kujdesshëm i burimeve buxhetore dhe rritja e investimeve, veçanërisht në infrastrukturë dhe teknologji, kanë krijuar premisa më të favorshme për zhvillimin e mëtejshëm të sistemit. Këto investime synojnë përmirësimin e kushteve të punës dhe rritjen e kapaciteteve operacionale të gjykatave.

Pavarësisht progresit të arritur, sfidat që lidhen me nivelin e vakancave, raportin gjyqtar/popullsi, volumin e çështjeve të prapambetura dhe kohëzgjatjen e proceseve gjyqësore kërkojnë vëmendje të vazhdueshme dhe masa të qëndrueshme adresuese. Në këtë kuadër, prioritetet strategjike për periudhën 2026–2028 përqendrohen në plotësimin progresiv të vakancave, konsolidimin e transformimit digjital, zbatimin efektiv të mekanizmave për uljen e *backlog*-ut, si dhe në forcimin e mëtejshëm të kapaciteteve institucionale dhe teknologjike.

Në përfundim, viti 2025 shënon një hap të rëndësishëm në drejtim të kalimit nga faza e stabilizimit drejt një faze më të avancuar të përmirësimit të qëndrueshëm të efikasitetit dhe cilësisë së drejtësisë. Arritjet e evidentuara, të kombinuara me angazhimin e vazhdueshëm institucional, krijojnë baza solide për ndërtimin e një sistemi gjyqësor të besueshëm, transparent dhe në përputhje me standardet më të mira evropiane.

1. VEPRIMTARIA E KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

Këshilli i Lartë Gjyqësor është një organ i pavarur kushtetues, i ngritur në përputhje me nenin 147 të Kushtetutës. Kjo dispozitë kushtetuese sanksionon se Këshilli i Lartë Gjyqësor siguron pavarësinë, përgjegjshmërinë dhe mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë.

Këshilli përbëhet nga 11 anëtarë, të cilët ushtrojnë detyrën me kohë të plotë për një mandat 5-vjeçar, pa të drejtë rizgjedhjeje të njëpasnjëshme. Prej tyre, 6 janë anëtarë gjyqtarë, të zgjedhur nga Konferenca Gjyqësore Kombëtare, që përfaqësojnë të gjitha nivelet e pushtetit gjyqësor. Ndërsa 5 janë anëtarë jogjyqtarë, të zgjedhur nga Kuvendi i Shqipërisë, që përfaqësojnë profesionet e lira. Kryetari i Këshillit zgjidhet nga radhët e anëtarëve jogjyqtarë.

Përbërja aktuale e institucionit paraqitet si më poshtë:

KRYETARI	
Z. ILIR RUSI	Jurist i spikatur, përzgjedhur nga trupa e pedagogëve Mandat 5-vjeçar (2022-2027)
ZËVENDËSKRYETARI	
Znj. Yllka Rupa	Juriste e spikatur, përzgjedhur nga trupa e pedagogëve Mandat 5-vjeçar (2022-2027)
ANETARËT GJYQTARË	
Znj. Emona Muçi	Përfaqësuese e Gjykatave të Apelit Mandat 5-vjeçar (2023-2028)
Znj. Gentiana Muçaj	Përfaqësuese e Gjykatave të Shkallës së Parë Mandat 5-vjeçar (2023-2028)
Znj. Irena Plaku	Përfaqësuese e Gjykatave të Shkallës së Parë Mandat 5-vjeçar (2021-2026)
Z. Klodian Kurushi	Përfaqësues i Gjykatës së Lartë Mandat 5-vjeçar (2021-2026)
Z. Markelian Koça	Përfaqësues i Gjykatave të Shkallës së Parë Mandat 5-vjeçar (2023-2028)
Z. Ridvan Hado	Përfaqësues i Gjykatave të Apelit Mandat 5-vjeçar (2021-2026)
ANËTARËT JOGJYQTARË	
Z. Albens Tabaku	Jurist i spikatur, përzgjedhur nga radhët e avokatëve Mandat 5-vjeçar (2024-2029)
Z. Bledar Bajri	Jurist i spikatur, përzgjedhur nga radhët e avokatëve Mandat 5-vjeçar (2024-2029)
Znj. Violanda Theodori	Juriste e spikatur, përzgjedhur nga shoqëria civile Mandat 5-vjeçar (2024-2029)

1.1 Kuadri ligjor i brendshëm dhe ndërkombëtar

Sistemi i drejtësisë në Republikën e Shqipërisë qeveriset bazuar në parimet e pavarësisë, paanshmërisë, profesionalizmit, integritetit, llogaridhënies, transparencës dhe efiçencës. Këto parime janë të mishëruara në paketën e Reformës në Drejtësi, e cila synoi adresimin në mënyrë sistematike të praktikave kompromentuese, si pandëshkueshmëria, mungesa e transparencës, ndikimi politik dhe korrupsioni në sistemin e drejtësisë.

Në këtë kuadër, ligjet më të rëndësishme të kësaj pakete, të cilat rregullojnë organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor, si dhe të vetë sistemit gjyqësor, janë:

- Ligji nr.8417, datë 21.10.1998 "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar;
- Ligji nr.115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar (referuar në raport si Ligji për Qeverisjen);
- Ligji nr.98/2016 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar (referuar si Ligji për Organizimin);
- Ligji nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve", i ndryshuar (referuar si Ligji për Statusin);
- Ligji nr.95/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar";
- Ligji nr.84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" (referuar si Ligji për Vetting-un);
- Ligji nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", i ndryshuar.

Krahas kuadrit të brendshëm ligjor, veprimtaria e gjyqësorit mbështetet edhe në një korpus të gjerë normash dhe standardesh ndërkombëtare, të cilat përbëjnë një referencë thelbësore për garantimin e një sistemi drejtësie të pavarur dhe funksional. Në këtë kuadër përfshihen instrumente themelore, si Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, si dhe Karta Evropiane për Statusin e Gjyqtarëve. Gjithashtu, rëndësi të veçantë kanë parimet themelore të Organizatës së Kombeve të Bashkuara mbi pavarësinë e gjyqësorit, udhëzimet për sundimin e ligjit, si dhe Parimet Bangalore të Kodit Etik të Gjyqtarëve.

Një rol të spikatur në këtë korpus standardesh ndërkombëtare zë edhe jurisprudenca e zhvilluar nga gjykatat evropiane, veçanërisht nga Gjykata Evropiane e Drejtësisë dhe Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Kjo pasurohet më tej nga opinionet dhe rekomandimet e institucioneve kyçe, si Komisioni i Venecias, Komisioni Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë, Këshilli Konsultativ i Gjyqtarëve Evropianë dhe Rrjeti Evropian i Këshillave për Gjyqësorin.

Këto standarde dhe parime ndërkombëtare kanë shërbyer si udhërrëfyes i rëndësishëm në hartimin dhe zbatimin e paketës së Reformës në Drejtësi, duke dëshmuar për

përputhshmërinë e kuadrit të brendshëm ligjor me parimet, standardet dhe praktikat më të mira ndërkombëtare në fushën e gjyqësorit.

1.2 Mbledhjet plenare

Në përmbushje të detyrave të tij kushtetuese e ligjore gjatë vitit 2025, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka realizuar 69 mbledhje plenare dhe ka marrë 882 vendimmarrje me fokus garantimin e funksionalitetit të sistemit gjyqësor.

Nga këto, 861 vendime janë propozuar nga komisionet e përhershme, 3 nga komisionet e përkohshme pranë KLGJ-së, 1 nga Këshilltari i Etikës,[1] 14 nga grupe të ndryshme pune që kanë ushtruar veprimtarinë gjatë vitit 2025, 2 nga anëtarë të Këshillit, ndërsa 1 vendim është i klasifikuar. Sa i përket kategorizimit sipas përcaktimit ligjor, rezulton se 15 janë akte nënligjore, 646 akte individuale, 157 akte kolektive dhe 64 akte rregullash të brendshme.

1.3 Përmbledhje e veprimtarisë së komisioneve të Këshillit

Referuar parashikimeve ligjore në fuqi, Këshilli i Lartë Gjyqësor ushtron veprimtarinë e tij përmes katër Komisioneve të Përhershme:

1. Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit;
2. Komisioni Disiplinor;
3. Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale;
4. Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Në vitin 2025, puna intensive e komisioneve ka rezultuar në një numër të konsiderueshëm aktesh nënligjore. Këto akte kanë pasur për qëllim përmirësimin e rregullimit, mbarëvajtjes dhe menaxhimit të sistemit gjyqësor, si dhe zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve, siç tregohet më poshtë:

	Komisionet e Përhershme	**Nr. i akteve propozuara**
1	Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit	110
2	Komisioni Disiplinor	21
3	Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale	106
4	Komisioni i Zhvillimit të Karrierës	624[2]

[1] Miratimi i Raportit Vjetor 2025

[2] Dy prej vendimeve të miratuara janë bashkëpropozim i Komisionit të Vlerësimit Etik dhe Profesional dhe Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, konkretisht: Vendimi nr. 117, datë 27.02.2025, "Për shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandim në Këshillin e Lartë Gjyqësor, kohëzgjatjen, kriteret dhe procedurën e komandimit" dhe Vendimi nr. 428, datë 16.07.2025, "Për hapjen e procedurës dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandim në Këshillin e Lartë Gjyqësor". Vendimi nr. 779, datë 31.10.2025, i Këshillit të Lartë Gjyqësor, "Për miratimin e rregullave për kriteret dhe procedurën e emërimit në pozicionin e kryetarit të gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë", botuar në Fletoren Zyrtare nr. 211, datë 13.11.2025, është hartuar nga Grupi i Punës i ngritur me Urdhrin nr. 124, datë

5	Akte të Komisioneve të Përhershme	861
6	Akte të tjera[3]	21
Akte totale të miratuara nga KLGJ (2025)[4]		882

Duke qenë se, në respektim të detyrimit ligjor,[5] veprimtaria e komisioneve të përhershme pasqyrohet në raportet e tyre vjetore që janë publike në faqen zyrtare të Këshillit (https://klgj.al/raporte-te-komisioneve-te-perhereshme/), në këtë kapitull do të ofrojmë një përmbledhje të gjetjeve kryesore të tyre.

1.4 Komisionet e përhershme

KOMISIONI I PLANIFIKIMIT STRATEGJIK, ADMINISTRIMIT DHE BUXHETIT

Gjatë vitit 2025, Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit ka realizuar 38 mbledhje, në të cilat janë marrë 110 vendime,[6] 80 prej të cilave në fushat përkatëse të veprimtarisë:

- 14 në fushën e planifikimit strategjik;
- 50 në fushën e administrimit dhe efiçencës; si dhe
- 16 vendime në fushën e programimit dhe menaxhimit financiar dhe buxhetor.

I udhëhequr nga parimet e profesionalizimit, integritetit dhe paanshmërisë, Komisioni ka vijuar punën për të garantuar përmbushjen e përgjegjësive ligjore, por njëkohësisht ka dëshmuar edhe fleksibilitet përmes reagimit në kohën e duhur dhe me mjetet e nevojshme ndaj problematikave të evidentuara në sistemin gjyqësor. Veprimtaria e KPSAB-së është pashmangshmërisht e ndërlidhur me veprimtarinë dhe funksionin e komisioneve të tjera të Këshillit, qofshin këto komisionet e përhershme, apo edhe ato të përkohshme. Ky ndërveprim evidentohet sidomos në funksion të ndërtimit të një administrate civile gjyqësore profesionale dhe rritjes së profesionalizimit dhe integritetit të saj në raport me publikun.

Disa prej arritjeve më të spikatura të këtij Komisioni janë si më poshtë vijon:

- 110 akte dhe vendime të përgatitura dhe miratuara që mbështesin vazhdimin e reformave të sistemit gjyqësor.

15.09.2025, në përbërje të të cilit kanë qenë anëtarët e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës. Ky vendim përfshihet në aktet e Komisionit, pasi bën pjesë në fushën e veprimtarisë së tij.

[3] Përfshihen aktet e miratuara nga Komisionet e Përkohshme, Këshilltarit të Etikës, Komisioni Ad Hoc për Efikasitetin në Shqipëri, si dhe nga Grupet e Punës.

[4] Përfshihen edhe aktet e miratimit të procesverbaleve të mbledhjes plenare

[5] Pika 16, e nenit 62 të Ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë".

[6] 28 vendime të Komisionit i referohen miratimit të procesverbaleve të mbledhjeve plenare dhe 2 akte të tjera të cilat kanë të bëjnë me caktimin e ditëve të pushimit për sistemin gjyqësor

- Miratimi i akteve me fokus nëpunësin civil gjyqësor, me qëllim rritjen e përgjegjshmërisë dhe kapaciteteve profesionale të administratës gjyqësore.
- Vijimi i procedurave për kualifikimin për ndjekjen e programit të formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës të 10 ndihmësve ligjorë; finalizimi, përmes caktimit në pozicion, i 6 ndihmësve ligjorë në njësitë e shërbimit ligjor pranë gjykatave të apelit, pas kalimit me sukses të procesit të rivlerësimit kalimtar, si dhe pranimit në shërbimin civil gjyqësor i 9 ndihmësve ligjorë.
- Realizimi i 87.5% të buxhetit për sistemin gjyqësor, duke reaguar me fleksibilitet ndaj ndryshimeve ligjore dhe administrative dhe duke siguruar fonde për riorganizimin dhe pagat.
- Fillimi i punës mbi zhvillimin e sistemit të ri të menaxhimit të çështjeve gjyqësore Juronix.
- Evidentimi i proceseve të punës në gjykata që do të përfshihen në procesin e automatizimit dhe digjitalizimit.
- Vijimi i procesit të digjitalizimit të vendimeve gjyqësore dhe përmirësimi i platformës së menaxhimit të tyre. Garantimi i aksesit për të gjithë gjyqtarët dhe punonjësit e administratës gjyqësore. Në total, janë digjitalizuar 12,937,316 fletë.
- Implementimi i standardeve që garantojnë sigurinë kibernetike të infrastrukturave digjitale të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe gjykatave, në përputhje me ligjin për sigurinë kibernetike dhe rekomandimet e Agjencisë Kombëtare të Sigurisë Kibernetike.
- Rritja e kapaciteteve të burimeve njerëzore në fushën e sigurisë kibernetike, duke zhvilluar trajnime për stafin IT dhe nëpunësit e administratës.
- Përgatitja e një plani afatgjatë lidhur me veprimtarinë e teknologjisë së informacionit në Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe gjykatat, me qëllim qendërzimin e shërbimeve dhe menaxhimin e infrastrukturave.

KOMISIONI I ZHVILLIMIT TË KARRIERËS

Gjatë vitit raportues, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës është fokusuar në zbatimin e të gjithë mekanizmave ligjorë me qëllim zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve, si dhe garantimin e një sistemi gjyqësor të pavarur, të paanshëm dhe me integritet të lartë. Vendimmarrjet e hartuara kanë qenë kryesisht të lidhura me proceset e përzgjedhjes/emërimit, promovimit, transferimit apo mbarimit të statusit të gjyqtarëve, duke zbatuar në mënyrë rigoroze kriteret ligjore e objektive të vendosura, dhe duke garantuar të drejtat e gjyqtarëve në proces.

Gjatë vitit 2025, KZHK-ja i ka propozuar Këshillit të Lartë Gjyqësor gjithsej 624 projektvendime, nga të cilat:

- 1 akt nënligjor me karakter normativ, në zbatim të nenit 52 të ligjit nr. 96/2016, për miratimin e rregullave që përcaktojnë procedurat e ngritjes në detyrë dhe kriteret për emërimin në pozicionet drejtuese të gjykatave të shkallës së parë dhe të dytë;

- 126 vendime në kuadër të procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe në Gjykatën Administrative të Apelit;
- 1 vendim në kuadër të procedurës së përcaktimit të numrit të kandidatëve për gjyqtarë dhe ndihmës ligjorë që do të pranohen në programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2024-2025;
- 2 vendime në kuadër të procedurave të mbarimit të statusit të magjistratit (për shkak pensioni);
- 18 vendime në kuadër të procedurave të komandimit të gjyqtarëve;
- 25 vendime në kuadër të procedurave të skemës së delegimit të ngritur pranë Këshillit sipas nenit 45 të Ligjit për Statusin;
- 288 vendime në kuadër të procedurave të transferimit të përkohshëm dhe të përhershëm të gjyqtarëve sipas neneve 42,43,46 të Ligjit për Statusin;
- 129 vendime në kuadër të procedurave të emërimit të magjistratëve;
- 16 vendime në kuadër të procedurave të verifikimit të kushteve dhe kritereve të kandidimit për në formimin fillestar, profili gjyqtar, për në Shkollën e Magjistraturës.
- 14 vendime në kuadër të procedurave të caktimit të gjyqtarëve në çështje gjyqësore të veçanta, në gjykata të tjera të ndryshme nga ato ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme, nga të cilat janë trajtuar 23 kërkesa për caktim gjyqtari dhe në përgjigje të tyre janë caktuar 31 gjyqtarë për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të ndryshme, nga ajo ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme.
- 4 vendime në kuadër të procedurave të tjera të lidhura me statusin dhe karrierën gjyqësore.

Fokus të veçantë, KZHK-ja i ka kushtuar edhe ndjekjes së procesit të plotësimit të vendeve vakante në gjykata përmes skemës së delegimit, transferimit të gjyqtarëve, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, si dhe ka shqyrtuar kërkesat e paraqitura nga drejtuesit e gjykatave në lidhje me caktimin e gjyqtarëve të ndryshëm për shqyrtimin e çështjeve të veçanta. Kjo veprimtari garanton jo vetëm mbarëvajtjen e sistemit gjyqësor por njëkohësisht përmbush detyrimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor për të siguruar ofrimin e shërbimeve gjyqësore për publikun. Gjithashtu, Komisioni është investuar edhe në draftimin e rregullores për emërimin e kryetarëve në gjykata, për të cilën është në pritje të miratimit të ndryshimeve ligjore, përcjellë në Kuvend.

KOMISIONI DISIPLINOR

Gjatë vitit 2025, Komisioni Disiplinor ka kaluar për shqyrtim në mbledhje plenare 3 procedura disiplinore të filluara rishtazi gjatë këtij viti, si dhe ka vënë në lëvizje 8 procedura të mbartura nga vitet e mëparshme. Këshilli i Lartë Gjyqësor ka proceduar me dhënien e vendimeve përfundimtare ose jopërfundimtare për procedurat e shqyrtuara. Ndërkohë, një

prej procedimeve disiplinore të kaluar për shqyrtim në mbledhje plenare është mbartur si procedurë administrative, për të vijuar shqyrtimi gjatë vitit 2026. Konkretisht:

▪ Procedimi disiplinor nr. 1/2025

Është vendosur dhënia e masës disiplinore *"Vërejtje publike"* ndaj magjistratit A.Xh. Gjatë shqyrtimit, Këshilli gjeti të bazuara përfundimet e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, duke vlerësuar se janë konsumuar elementet e shkeljes disiplinore që lidhen me sjelljen joetike, të parashikuara në nenin 101, pika 1, shkronja "a" dhe nenin 102, pika 2, shkronja "dh" të Ligjit për Statusin.[7]

▪ Procedimi disiplinor nr. 2/2025

Është vendosur rrëzimi i kërkesës për dhënien e masës disiplinore *"Vërejtje publike"* ndaj magjistratit A.P. Këshilli vlerësoi se vonesa në dorëzimin e tre vendimeve gjyqësore të arsyetuara nuk përmbush kriteret shteruese të parashikuara në nenet 101 dhe 102, pika 2, shkronja "d" të Ligjit për Statusin për t'u kualifikuar si shkelje disiplinore. Megjithatë, këto rrethana do të merren në konsideratë në kuadër të vlerësimit etik dhe profesional të magjistratit.[8]

▪ Procedimi disiplinor nr. 6/2024

Është vendosur dhënia e masës disiplinore *"Pezullimi nga detyra me të drejtën për të marrë pagën minimale sipas vendimit të Këshillit të Ministrave, për një periudhë 6-mujore"* ndaj magjistrates A.Ll. Nga verifikimi i fakteve rezultoi se moscaktimi i seancave gjyqësore për një numër të konsiderueshëm çështjesh të caktuara me short gjatë periudhës 2019–2023, të cilat nuk janë shqyrtuar brenda afateve ligjore ose standardeve minimale kohore, ka sjellë vonesa të dukshme dhe të përsëritura në ecurinë e proceseve gjyqësore. Gjithashtu, janë konstatuar vonesa në arsyetimin e një numri të madh vendimesh. Këshilli arriti në përfundimin se këto veprime nuk mund të trajtohen thjesht si elemente të vlerësimit etik dhe profesional, pasi respektimi i afateve të gjykimit dhe i afateve për arsyetimin e vendimeve është thelbësor për garantimin e së drejtës së palëve për ankimin efektiv, për marrjen e formës së prerë të vendimit dhe për ekzekutimin e tij në kohë. U gjetën të bazuara konkluzionet e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë se janë konsumuar elementet e shkeljes disiplinore të parashikuara në nenin 102, pika 1, shkronja "d" të Ligjit për Statusin, që lidhen me vonesa të përsëritura dhe zvarritje të pajustifikuara të veprimeve procedurale. Në përcaktimin e masës disiplinore u morën në konsideratë në mënyrë kumulative kriteret e nenit 110 të Ligjit për Statusin, duke vlerësuar ekzistencën e një shkeljeje shumë të rëndë, por pa e konsideruar magjistraten të papërshtatshme për ushtrimin e funksionit.[9]

[7] Vendimi i KLGJ-së nr.190, datë 02.04.2025
[8] Vendimi KLGJ-së nr. 307, datë 04.06.2025
[9] Vendimi i KLGJ-së nr. 189, datë 02.04.2025

▪ **Procedimi disiplinor nr. 2/2022**[10]

Është vendosur dhënia e masës disiplinore *"Vërejtje publike"* ndaj magjistratit B.Sh. Këshilli gjeti të bazuara konkluzionet e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, pasi magjistrati, në ushtrimin e funksionit të zëvendëskryetarit të gjykatës, ka konsumuar elementet e shkeljes disiplinore të parashikuara në nenin 102, pika 1, shkronjat "g" dhe "gj" të Ligjit për Statusin, duke shkelur në mënyrë të përsëritur dispozitat ligjore dhe nënligjore që rregullojnë organizimin dhe funksionimin e gjykatës, si dhe duke mos zbatuar, pa shkaqe të justifikuara, vendimin nr. 307, datë 13.07.2021 të Këshillit.[11]

Ndërkohë, për 6 procedurat disiplinore që më parë ishin pezulluar dhe u rikthyen për shqyrtim gjatë vitit 2025, Këshilli ka vendosur shfuqizimin e vendimeve të pezullimit, duke u bazuar në rënien e shkakut, dhe ka vijuar trajtimin e çështjeve në themel. Pas shqyrtimit të akteve të këtyre procedurave, Këshilli ka vendosur mbi secilën çështje, duke përfshirë ato që përfunduan pa një vendim përfundimtar për shkak të humbjes së statusit të magjistratit.

▪ **Procedimi disiplinor nr. 3/2024**

Është filluar ndaj magjistratit H.S., me propozim të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për masën disiplinore *"Shkarkim nga detyra"*. Ndërkohë, në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit me vendimin nr. 742, datë 13.03.2024 vendosi shkarkimin nga detyra të magjistratit. Për këtë arsye, Këshilli i Lartë Gjyqësor pezulloi procedimin disiplinor deri në marrjen formë të prerë të vendimit. Pas lënies në fuqi të vendimit të shkarkimit nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit me vendimin nr. 79, datë 04.11.2025, Këshilli vendosi përfundimin e procedimit disiplinor pa një vendim përfundimtar, pasi subjekti nuk gëzonte më statusin e magjistratit dhe procedimi kishte mbetur pa objekt.[12]

▪ **Procedimi disiplinor nr. 1/2021**

Është filluar ndaj magjistratit E.S., me propozim të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për masën disiplinore *"Shkarkim nga detyra"*. Ndërkohë, në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit me vendimin nr. 378, datë 30.04.2021 vendosi shkarkimin nga detyra të magjistratit. Për këtë arsye, Këshilli i Lartë Gjyqësor pezulloi procedimin disiplinor deri në marrjen formë të prerë të këtij vendimi. Pas lënies në fuqi të vendimit nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit, Këshilli shfuqizoi vendimin e pezullimit dhe

[10] Këshilli me vendimin nr. 436, datë 25.10.2022 ka vendosur: *"1. Pezullimin e procedimit disiplinor të filluar ndaj magjistratit B.Sh., gjyqtar i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë *, deri në marrjen formë të prerë të vendimit nr. 541, datë 15.6.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. 2. Kundër këtij vendimi, ligji nuk lejon ankim...."*. Me vendimin nr. 151, datë 12.03.2025, pas rënies së shkakut të pezullimit, ka vendosur: *"1. Shfuqizimin e vendimit nr. 436, datë 25.10.2022 të Këshillit për "Pezullimin e procedimit disiplinor të filluar ndaj magjistratit B.Sh., me funksion gjyqtar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë *. 2. Vijimin e shqyrtimit të procedimit disiplinor të filluar ndaj magjistratit dhe caktimin e seancës dëgjimore..."*

[11] Vendimi i KLGJ-së nr. 228, datë 23.04.2025

[12] Vendimi i KLGJ-së nr. 805, datë 26.11.2025

vendosi vijimin e shqyrtimit. Megjithatë, duke qenë se subjekti nuk gëzonte më statusin e magjistratit, Këshilli vendosi përfundimin e procedimit disiplinor pa një vendim përfundimtar.[13]

▪ **Procedimi disiplinor nr. 7/2021**

Është filluar ndaj magjistratëve P.A. dhe N.T., me propozim të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për masën disiplinore *"Ulje e përkohshme e pagës deri në 40% për një periudhë jo më të gjatë se një vit"*. Ndërkohë, në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka vendosur shkarkimin nga detyra të të dy magjistratëve, vendime të cilat janë lënë në fuqi nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit. Për këtë arsye, Këshilli i Lartë Gjyqësor fillimisht pezulloi procedimin disiplinor dhe, pas rënies së shkakut të pezullimit, vendosi shfuqizimin e pezullimit dhe vijimin e shqyrtimit. Megjithatë, duke qenë se të dy subjektet nuk gëzonin më statusin e magjistratit, Këshilli vendosi përfundimin e procedimit disiplinor pa një vendim përfundimtar.[14]

▪ **Procedimi disiplinor nr. 3/2023**

Është filluar ndaj magjistratëve B.M. dhe R.A., me propozim të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për masat disiplinore *"Ulje e përkohshme e pagës"* (ndaj B.M.) dhe *"Vërejtje publike"* (ndaj R.A.). Ndërkohë, në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka vendosur shkarkimin nga detyra të të dy magjistratëve, vendime të cilat janë lënë në fuqi nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit. Për këtë arsye, Këshilli i Lartë Gjyqësor fillimisht pezulloi procedimin disiplinor dhe, pas rënies së shkakut të pezullimit, vendosi shfuqizimin e tij dhe vijimin e shqyrtimit. Megjithatë, duke qenë se subjektet nuk gëzonin më statusin e magjistratit, është vendosur përfundimi i procedimit disiplinor pa një vendim përfundimtar.[15]

▪ **Procedimi disiplinor nr. 4/2023**

Është filluar ndaj magjistratit K.Dh., me propozim të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për masën disiplinore *"Shkarkim nga detyra"*. Ndërkohë, në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit me vendimin nr. 428, datë 29.07.2021 ka vendosur shkarkimin nga detyra të magjistratit, vendim i cili është lënë në fuqi nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit me vendimin nr. 2, datë 16.01.2025. Për këtë arsye, Këshilli i Lartë Gjyqësor fillimisht pezulloi procedimin disiplinor deri në marrjen formë të prerë të vendimit të rivlerësimit dhe, pas rënies së shkakut të pezullimit, vendosi shfuqizimin e pezullimit dhe vijimin e shqyrtimit. Megjithatë, duke qenë se subjekti nuk gëzonte më statusin e magjistratit, u vendos përfundimi i procedimit disiplinor pa një vendim përfundimtar.[16]

▪ **Procedimi disiplinor i vitit 2017**

[13] Vendimi i KLGJ-së nr. 3, datë 15.01.2025
[14] Vendimi i KLGJ-së nr.4, datë 15.01.2025
[15] Vendimi i KLGJ-së nr. 150, datë 12.03.2025
[16] Vendimi i KLGJ-së nr. 93, datë 19.02.2025.

Është filluar ndaj magjistratit Zh.P., me propozim të ish-Kryetarit të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë për masën disiplinore *"Shkarkim nga detyra"*. Në vijim, Këshilli i Lartë Gjyqësor, me vendimin nr. 209, datë 10.04.2025, deklaroi mbarimin e statusit të magjistratit për Zh.P. për shkak të mbushjes së moshës së pensionit të pleqërisë, vendim i formës së prerë. Për rrjedhojë, duke qenë se subjekti nuk e gëzon më statusin e magjistratit, Këshilli vendosi ndërprerjen e procedimit disiplinor pa një vendim përfundimtar.[17]

Komisioni Disiplinor, krahas shqyrtimit të procedimeve disiplinore, ka vlerësuar dhe forcuar bashkëpunimin ndërinstitucional me Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, përmes tryezave të përbashkëta dhe aktiviteteve me fokus rolin e inspektimeve në garantimin e funksionimit të pavarur dhe efikas të sistemit të drejtësisë, sipas standardeve evropiane.

Gjatë vitit 2025, anëtarët e Komisionit morën pjesë në takimin ndërinstitucional mbi "Inspektimet tematike", në Konferencën Rajonale të organizuar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë me mbështetjen e OSBE Prezenca në Shqipëri, si dhe në një vizitë studimore pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor të Francës, në kuadër të projektit EU4Justice.

Sa i përket inspektimeve tematike, nuk ka pasur kërkesa specifike nga Këshilli, pasi ato janë ndërmarrë me iniciativë nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë. Komisioni ka administruar rregullisht praktikat e përcjella prej tij, në zbatim të Ligjit për Statusin.

KOMISIONI I VLERËSIMIT TË ETIKËS DHE VEPRIMTARISË PROFESIONALE

Gjatë vitit 2025, Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale ka organizuar dhe zhvilluar veprimtarinë e tij me qëllim përmbushjen e funksioneve të përcaktuara, duke u fokusuar në këto drejtime kryesore:

- Hartimin, shqyrtimin dhe paraqitjen për miratim të akteve nënligjore me karakter normativ, që lidhen me fushën e veprimtarisë së KVEVP-së, si edhe realizimin e veprimtarive të tjera në bashkëpunim me komisionet e tjera të përhershme dhe të përkohshme të Këshillit;
- Shqyrtimin e kërkesave të paraqitura nga gjyqtarët pranë Këshillit për çështje që janë në fushën e veprimtarisë së KVEVP-së, si dhe përcjelljen e tyre për vendimmarrje;
- Administrimin dhe trajtimin e vazhdueshëm të dokumentacionit dhe praktikave të kaluara pranë Komisionit;
- Fillimin dhe zhvillimin e procedurave periodike 3-vjeçare dhe 5–vjeçare për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarëve, sipas programeve të vlerësimit për vitin 2025, si dhe realizimin e vlerësimit të përshpejtuar të detyruar në rastet e konkurrimit për ngritje në detyrë.

[17] Vendimi i KLGJ-së nr. 341, datë 25.06.2025.

Në total, Komisioni ka realizuar 45 mbledhje të cilat janë materializuar në 106[18] vendimmarrje ose trajtim të praktikave duke adresuar zgjidhjen e tyre, përkatësisht si më poshtë vijon:

- 1 akt nënligjor me karakter normativ, në zbatim të nenit 9 të ligjit nr. 96/2016, për miratimin e rregullave që përcaktojnë mënyrën e ushtrimit të veprimtarive jashtë funksionit nga gjyqtarët, duke rregulluar në mënyrë të plotë fushën e zbatimit, kushtet dhe procedurat për paraqitjen e kërkesave, dokumentacionin përkatës, shqyrtimin dhe vendimmarrjen, si edhe vlerësimin e veprimtarive të paguara jashtë funksionit;[19]
- 2 akte për miratimin e programeve periodike të vlerësimit 3-vjeçar dhe 5-vjeçar, ku janë përfshirë në total 96 gjyqtarë;[20]
- 71 akte të lidhura me procedurat e vlerësimit etik dhe profesional, konkretisht: 6 akte për nisjen dhe zhvillimin e procedurave të vlerësimit për 103 gjyqtarë; 2 akte administrative për miratimin e listës së gjyqtarëve që kanë ose mund të kenë dy vlerësime, një vlerësim, si dhe të gjyqtarëve që nuk kanë dhe nuk mund të kenë asnjë vlerësim, për qëllime të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm në Durrës, Gjirokastër dhe në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë; 59 akte për miratimin e raporteve të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve, në kuadër të të cilave janë vlerësuar 50 gjyqtarë, nga të cilët 9 janë vlerësuar me dy vlerësime etike dhe profesionale, si dhe 4 akte për përfundimin, pa vendim përfundimtar, të procedurave të vlerësimit të filluara;[21]
- 23 akte administrative individuale për trajtimin e kërkesave të gjyqtarëve ose të veprimtarive të tjera;
- 9 akte administrative në kuadër të bashkëpunimit me Shkollën e Magjistraturës, në funksion të realizimit të Programit të Trajnimit Fillestar.

KVEVP-ja ka marrë të gjitha masat e nevojshme për përfundimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve të përfshirë në program, duke i dhënë përparësi procesit të vlerësimit të kandidatëve të kualifikuar për ngritje në detyrë dhe për lëvizje paralele në Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, Elbasan, Durrës dhe

[18] Duke përfshirë edhe vendimin për miratimin e "Raportit vjetor i veprimtarisë së komisionit të vlerësimit të etikës dhe veprimtarisë profesionale për vitin 2024".

[19] Vendimi nr. 795, datë 18.11.2025, i Këshillit të Lartë Gjyqësor, "Për ushtrimin e veprimtarisë jashtë funksionit", botuar në Fletoren Zyrtare nr. 224, datë 03.12.2025, është hartuar nga Grupi i Punës i ngritur me urdhrin nr. 68, datë 24.04.2025; megjithatë, ai përfshihet në aktet e Komisionit për shkak se bën pjesë në fushën e veprimtarisë së tij.

[20] Në këtë program janë përfshirë 94 gjyqtarë, sipas vendimit nr. 812, datë 04.12.2025, me të cilin është miratuar programi i vlerësimeve periodike 3-vjeçare dhe 5-vjeçare. Gjithashtu, me vendimin nr. 813, datë 04.12.2025, Këshilli ka miratuar programin e vlerësimit për gjyqtarët e komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor, duke përfshirë në program 2 gjyqtarë. Lista përfshin detyrimisht ata gjyqtarë të komanduar, të cilëve u ka përfunduar ose u përfundon periudha e komandimit gjatë vitit përkatës.

[21] Nga të cilat: *i)* për 1 gjyqtar, procedura e vlerësimit ka përfunduar për shkak të mosushtrimit të funksionit gjatë periudhës së përcaktuar nga ligji për vlerësim; dhe *ii)* për 3 gjyqtarë, procedura e vlerësimit ka përfunduar për shkak të humbjes së statusit të magjistratit.

Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, kjo në kushtet kur finalizimi i këtyre proceseve ndikon edhe në krijimin e pozicioneve të lira të përhershme për kandidatët për magjistratë.

Duhet theksuar se qëllimi i vlerësimit është nxitja e gjyqtarëve në drejtim të rritjes profesionale, përmirësimit të cilësisë së punës dhe aftësive menaxheriale, respektimit të etikës dhe rritjes së angazhimit profesional. Duke iu referuar të dhënave të analizuara dhe vlerësuara në raport me kriteret e vlerësimit,[22] gjyqtarëve të vlerësuar u është rekomanduar që të vazhdojnë të mbajnë në konsideratë angazhimin e tyre në aktivitete për trajnimin e gjyqtarëve, pjesëmarrjen në veprimtari ndërinstitucionale, si dhe në fushën e publikimeve ligjore dhe akademike, me qëllim ndarjen e përvojës profesionale dhe dhënien e kontributit të tyre për përmirësimin e sistemit gjyqësor. Gjithashtu, të menaxhojnë punën dhe kohën në mënyrë efektive, duke i dhënë prioritet shqyrtimit të çështjeve me afate ligjore dhe respektimit të standardeve kohore, për të rritur efiçencën dhe rendimentin në përfundimin e çështjeve.

Rëndësi e veçantë i është kushtuar nxitjes së gjyqtarëve për të marrë pjesë në programet e trajnimit vazhdues, me qëllim jo vetëm shkëmbimin e njohurive e unifikimin e qëndrimeve në çështje të njëjta, por edhe përmirësimin e vazhdueshëm të etikës dhe aftësisë së tyre profesionale. Megjithëse përgjegjësitë e gjyqtarit ndryshojnë midis juridiksioneve dhe roleve specifike, gjyqtari në çdo nivel dhe në çdo detyrë duhet të ketë aftësi të mira organizative në mënyrë që të jetë produktiv. Në këtë aspekt është rekomanduar që gjyqtarët të bëjnë përpjekje maksimale në menaxhimin efektiv të kohës, si në planifikimin e seancave gjyqësore, ashtu edhe në veprimet procedurale jashtë tyre, pa krijuar pengesa në ecurinë e gjykimit të çështjeve në trupa gjykues.

KVEVP-ja vlerëson se, në kohëzgjatjen e procedurave të vlerësimit të papërfunduara ende, kanë ndikuar edhe një sërë faktorësh që lidhen kryesisht me plotësimin me vonesë të dosjeve të vlerësimit nga gjykatat, sidomos në lidhje me ofrimin e të dhënave të sakta statistikore, si dhe kohëzgjatja e trajtimit të ankesave të paraqitura ndaj gjyqtarëve gjatë periudhës së vlerësimit pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për sa kohë që rezultatet e këtij procesi, sipas ligjit, konsiderohen burim vlerësimi.

1.5 Komisionet e përkohshme

Në referim të parashikimeve ligjore të Ligjit për Qeverisjen e Pushtetit Gjyqësor, krahas komisioneve të përhershme, pranë Këshillit ushtrojnë veprimtarinë edhe komisionet e përkohshme. Këto struktura të posaçme kanë në fokus trajtimin e çështjeve të veçanta të

[22]Neni 93, pika 5, shkronja "ç", të ligjit nr.96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

sistemit gjyqësor, të cilat nuk mbulohen nga veprimtaria e komisioneve të përhershme. Komisionet e Përkohshme, të cilat kanë vijuar funksionimin edhe gjatë vitit 2025, janë:

1. Komisioni i Përkohshëm për verifikimin e plotësimit të kritereve ligjore të pranimit në provimin e pranimit në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2025-2026, të kandidatëve për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë;
2. Komisioni i Përkohshëm për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankesës ose pushimin e hetimit ndaj një gjyqtari;
3. Komisioni i Përkohshëm për Mbrojtjen e Gjyqtarëve, të Familjes dhe të Pasurisë së tyre;
4. Komisioni i Përkohshëm për verifikimin e kushteve dhe dokumentacionit që duhet të plotësojë magjistrati (gjyqtar) për të përfituar kredi për banim.
5. Komisioni Ad Hoc i monitorimit të zbatimit të Udhërrëfyesit për Efikasitetin e Pushtetit Gjyqësor në Shqipëri 2025-2027.

Komisioni i Përkohshëm për verifikimin e plotësimit të kritereve ligjore të pranimit në provimin e pranimit në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2025-2026, të kandidatëve për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë

Në janar të vitit 2025,[23] Këshilli i Lartë Gjyqësor, në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës, vendosi caktimin dhe publikimin e numrit maksimal të kandidatëve magjistratë, profili gjyqtar dhe ndihmës ligjorë,[24] që do të pranohen në programin e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2025-2026. Për këtë arsye, u ngrit Komisioni i Përkohshëm për Verifikimin e Plotësimit të Kritereve të Kandidatëve për Këshilltarë dhe Ndihmës Ligjorë,[25] i cili ka verifikuar gjithsej 101 kandidatë për ndihmës ligjorë. Në përfundim të procesit të verifikimit, Komisioni arriti në përcaktimin e listës emërore me:

- 98 kandidatë për ndihmës ligjorë, që plotësojnë kriteret;
- 3 kandidatë që nuk i plotësojnë kriteret.

Gjithashtu, ky Komision, bazuar në nenin 30, pika 4 të Ligjit për Statusin, ka vijuar sigurimin e komenteve dhe sugjerimeve lidhur me rezultatet e vlerësimit paraprak nga Shkolla e Magjistraturës për aplikantët që kanë kandiduar për magjistratë, profili gjyqtar. Konkretisht, Komisioni, pas verifikimit të 334 dosjeve të aplikantëve për magjistratë, profili gjyqtar, ka dhënë sugjerimet dhe kundërshtimet përkatëse për 32 kandidatë.

Komisioni i Përkohshëm për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankesës ose pushimin e hetimit ndaj një gjyqtari

[23] Vendimi nr. 26, datë 29.01.2025 "Për numrin e kandidatëve që do të pranohen në formimin fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës për vitin akademik 2025-2026".
[24] Për vitin akademik 2024-2025 nuk janë përcaktuar kuota për këshilltarë ligjorë.
[25] Vendimi nr. 26, datë 29.01.2025 "Për ngritjen dhe përbërjen e Komisionit të Përkohshëm për Verifikimin e Kandidatëve për në Provimin e Formimit Fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për Kancelar dhe/ose për Ndihmës Ligjor për vitin akademik 2025-2026" i KLGJ-së.

Në Këshill janë administruar gjithsej 97 ankime kundër vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, nga të cilat 6 janë mbartur nga viti 2024, ndërsa 91 janë regjistruar gjatë vitit raportues. Në këtë kuadër, Komisioni ka zhvilluar 14 mbledhje, duke trajtuar dhe vendosur për 77 ankime:

- për 72 ankesa, refuzim si të pabazuara me vendim të Komisionit;
- për 2 ankesa, pushim i ankimit;
- për 1 ankesë, mospranim i ankimit me vendim të relatorit;
- për 2 ankesa, dërgim për kompetencë te organi kompetent.

Ndërkohë, 20 ankesa janë mbartur për t'u trajtuar në vitin pasardhës nga Komisioni i ri.

Komisioni i Përkohshëm për Mbrojtjen e Gjyqtarëve, të Familjes dhe të Pasurisë së tyre[26]

Në mbështetje të kuadrit ligjor e nënligjor në fuqi,[27] gjatë ushtrimit të funksionit ose për shkak të tij, magjistrati dhe familja e tij gëzojnë të drejtën për mbrojtje të veçantë nga shteti për jetën, shëndetin dhe pasurinë e tyre. Për këtë qëllim, pranë Këshillit vijon funksionimi Komisioni i Përkohshëm për Mbrojtjen e Gjyqtarëve, Familjes dhe Pasurisë së tyre. Ky komision është një strukturë kolegjiale e përbërë nga përfaqësues të institucioneve të ndryshme shtetërore dhe kryesohet nga anëtari që përfaqëson Këshillin e Lartë Gjyqësor.[28]

Gjatë vitit 2025, pranë këtij Komisioni janë paraqitur dhe marrë në shqyrtim gjithsej 4 kërkesa për mbrojtje nga gjyqtarë në detyrë apo të pezulluar nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, të gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Shkodër dhe Fier, për të cilat është vendosur:

- për 1 rast, pranimi i kërkesës dhe marrja e masës për mbrojtje të veçantë të gjyqtarit;
- për 3 raste, zgjatja e afatit të masës, për shkak të të dhënave të tjera të besueshme se rreziku ka vijuar të ekzistojë edhe pas përfundimit të këtij afati.

Komisioni i Përkohshëm për verifikimin e kushteve dhe dokumentacionit që duhet të plotësojë magjistrati (gjyqtar) për të përfituar kredi për banim

Në mbështetje të nenit 17 të ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe akteve nënligjore në fuqi, pranë Këshillit ka

[26] Sipas vendimit Nr. 564, datë 31.09.2019 "Për kriteret dhe procedurat për mbrojtjen e veçantë të magjistratit gjatë ushtrimit të funksionit ose për shkak të tij", të Këshillit të Ministrave

[27] Neni 20 i ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, VKM nr. 564, datë 31.07.2019 "Për kriteret dhe procedurat për mbrojtjen e veçantë të magjistratit gjatë ushtrimit të funksionit ose për shkak të tij", i ndryshuar

[28] Në përbërje të tij janë përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Brendshme, Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë, Kryetari i Gjykatës pranë së cilës ushtron detyrën magjistrati dhe një anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor

vijuar funksionimin Komisioni i Përkohshëm për verifikimin e kushteve dhe dokumentacionit që duhet të plotësojë magjistrati (gjyqtar) për të përfituar kredi për banim, si dhe miratimin e listës së magjistratëve (gjyqtarë) përfitues nga skema e subvencionimit të interesave të kredisë. Gjatë vitit raportues 2025, ky komision ka vendosur konstatimin e plotësimit të kushteve, kritereve dhe dokumentacionit që duhet të plotësojë magjistrati (gjyqtar) për të përfituar kredi për banim të financuar nga shteti, si dhe miratimin e listës me 2 magjistratë përfitues nga skema e subvencionimit të interesave të kredisë.[29]

Komisioni Ad Hoc i Monitorimit të Zbatimit të Udhërrëfyesit për Efikasitetin e Pushtetit Gjyqësor në Shqipëri 2025-2027

Këshilli i Lartë Gjyqësor në përmbushje të kompetencave kushtetuese dhe detyrimeve që burojnë nga procesi i integrimit evropian ka miratuar Udhërrëfyesin për Efikasitetin e Pushtetit Gjyqësor për Shqipërinë duke marrë si pikënisje fushat kryesore të identifikuara tashmë si përparësi në Agjendën e Reformës së BE-së.[30] Për secilin synim janë përcaktuar objektiva dhe aktivitete konkrete për t'u kryer për arritjen e këtyre objektivave. Udhërrëfyesi përfshin gjithashtu mekanizma për monitorimin e zbatimit të tij dhe në këtë kuptim, me vendimin nr. 441, datë 23.07.2025 është miratuar Rregullorja për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Komisionit Ad Hoc për monitorimin e zbatimit të Udhërrëfyesit për Efikasitetin e Pushtetit Gjyqësor në Shqipëri 2025–2027.

Komisioni Ad Hoc ka zhvilluar gjithsej 12 mbledhje, në të cilat ka koordinuar dhe mbledhur të dhëna periodike, informacione statistikore dhe përditësime nga strukturat përgjegjëse të Këshillit. Ky komision ka ofruar mbështetje dhe zgjidhje në kuadër të përmirësimit të zbatimit të këtij dokumenti strategjik. Në Udhërrëfyes përfshihen edhe raportime tremujore monitorimi përpara mbledhjes plenare të Këshillit. Në këtë drejtim, Këshilli miratoi raportin e parë tremujor të monitorimit,[31] i cili pasqyron progresin, arritjet dhe sfidat e evidentuara përgjatë periudhës së zbatimit të Udhërrëfyesit. Ndjekja dhe monitorimi i zbatimit të objektivave të këtij dokumenti strategjik është një ndër angazhimet prioritare të Këshillit në këtë dyvjeçar.

2. NIVELI I ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE GJATË VITIT 2025 TË REZOLUTËS SË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PËR VITIN 2024

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë edhe për vitin 2024 ka përcjellë një tërësi rekomandimesh për adresim nga ana e Këshillit gjatë vitit pasardhës.[32] Këshilli, përmes komunikimit zyrtar,[33] ka raportuar në lidhje me masat përkatëse të ndërmarra në adresim të

[29] Vendimet nr. 1, datë 20.02.2025 dhe nr. 2, datë 09.07.2025 të Komisionit të Përkohshëm
[30] Miratuar me vendimin nr. 407, datë 15.07.2025
[31] Miratuar me vendimin nr. 55, datë 11.02.2026
[32] Miratuar nga Kuvendi Republikë së Shqipërisë më datë 30.10.2025.
[33] Shkresa nr. 6109/3, datë 31.12.2025.

çdo rekomandimi të rezolutës, në respektim të afateve të përcaktuara nga Kuvendi. Në mënyrë të përmbledhur paraqitet niveli i zbatimit të rekomandimeve:

Në lidhje me Rekomandimin nr. 1 **"Të bëjë një analizë mbi gjetjet dhe rekomandimet e BE-së (Raport progresi dhe *raporti "Rule of Law")* dhe angazhimeve të marra në kuadrin e procesit të negociatave. Përfundimet e kësaj analize t'ia bëjë të njohur Kuvendit brenda muajit dhjetor 2025",** Këshilli ka informuar Kuvendin mbi angazhimet e ndërmarra prej tij në përmbushjen e detyrimeve institucionale në kuadër të integrimit në Bashkimin Evropian. Në bazë të analizës mbi gjetjet dhe rekomandimet e paraqitura në "Rule of Law Report 2025" dhe "Progress Report 2025", Këshilli është angazhuar në adresimin e secilës prej tyre, bazuar në katër fushat kryesore: pavarësia dhe paanësia, cilësia e drejtësisë, llogaridhënia dhe efikasiteti.

Sa i përket Rekomandimit nr. 2 **"Të përmirësojë mekanizmat e mbledhjes dhe analizës së të dhënave statistikore mbi funksionimin e gjykatave, për të siguruar transparencë, krahasueshmëri dhe raportim të standardizuar sipas udhëzimeve të CEPEJ-it",** rezulton se me urdhrin nr. 148, datë 21.10.2025 të Kryetarit të Këshillit është ngritur grupi i punës për hartimin e udhëzuesit për statistikat gjyqësore. Grupi i punës ka në fokus të veprimtarisë së tij harmonizimin dhe standardizimin e statistikave gjyqësore, duke përfshirë mbajtjen e tyre sipas llojeve të veçanta të çështjeve. Përditësimi i metodologjisë së mbledhjes së të dhënave të unifikuara përfshin integrimin e statistikave relative dhe moduleve të raportimit në sistemin e ri në përputhje me metodologjinë dhe standardet e CEPEJ-it. Në veprimtarinë e tij, grupi i punës asistohet nga ekspertë të Këshillit të Evropës.

Lidhur me Rekomandimin nr. 3 **"Të intensifikojë monitorimin e zbatimit të planit të reduktimit të çështjeve të prapambetura *(backlog),* duke përcaktuar objektiva të matshëm për çdo gjykatë dhe duke raportuar periodikisht mbi progresin e arritur",** Këshilli ka vijuar monitorimin periodik të gjykatave mbi zbatimin e planit të reduktimit të *backlog-ut* në baza tremujore. Gjithashtu, është përgatitur raporti përmbledhës për katër gjykatat e përfshira dhe të ngarkuara për zbatimin e dokumentit strategjik, në funksion të raportimit periodik të progresit të arritur nga gjykatat. Në kuadër të detyrimeve të tij ligjore dhe strategjike, Këshilli vijon të realizojë monitorimin e plotë, të vazhdueshëm dhe efektiv të zbatimit të këtij dokumenti strategjik, me qëllim përfundimtar uljen e stokut të dosjeve gjyqësore dhe rritjen e besimit të publikut në sistemin gjyqësor.

Sa i takon Rekomandimit nr. 4 "**Të përmirësojë procesin e vlerësimit të performancës së gjyqtarëve, në mënyrë që të garantojë objektivitet, transparencë dhe lidhje të qartë ndërmjet vlerësimit dhe avancimit në karrierë",** Këshilli ka vijuar vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarëve sipas akteve nënligjore në fuqi që plotësojnë skemën e vlerësimit, bazuar në kritere të qarta, objektive dhe meritokratike, të cilat janë të përafruara me standardet e CEPEJ-it, me fokus efiçencën dhe cilësinë e drejtësisë. Në këtë kuadër, Këshilli ka ndërmarrë masat e nevojshme për përfundimin e procedurës së vlerësimit etik dhe

profesional të gjyqtarëve të përfshirë në programin vjetor të vlerësimeve, në zbatim të kuadrit ligjor e nënligjor përkatës. Vlerësimet për efekt të gradimit apo vlerësimet e përshpejtuara të detyruara për vitin 2025 janë 7 në total, nga të cilat 4 janë vlerësime gradimi, të filluara në vitet 2023 dhe 2024, dhe 3 janë vlerësime të përshpejtuara, të filluara në vitet 2022 dhe 2023. Për rrjedhojë, këto nuk kanë pasur një vëmendje të veçantë nga komisioni, në kushtet kur rivlerësimi kalimtar është në përfundim dhe vlerësimet për ngritje në detyrë apo lëvizje paralele janë kryer sipas programeve periodike të vlerësimit. Për vitin 2025, Këshilli ka miratuar 59 vlerësime për 50 gjyqtarë, ndërkohë që nga fillimi i këtij procesi në vitin 2021 janë miratuar në total 249 vlerësime për 154 gjyqtarë. Gjithashtu, Këshilli ka ndërmarrë masa konkrete për shtimin e numrit të nëpunësve përgjegjës për vlerësimin, me qëllim përshpejtimin e procesit të vlerësimeve.

Në lidhje me Rekomandimin nr. 5 **"Të forcojë masat për rritjen e integritetit gjyqësor, duke përfshirë programe trajnimi mbi etikën, konfliktin e interesit dhe komunikimin publik",** referuar kuadrit ligjor në fuqi, Shkolla e Magjistraturës, në bashkëpunim me Këshillin e Lartë Gjyqësor, harton dhe organizon programin e formimit të vazhdueshëm të gjyqtarëve, i cili ka efekte të drejtpërdrejta në rritjen e efiçencës së sistemit gjyqësor dhe përmirësimit të kapaciteteve të gjyqtarëve. Programet e trajnimit mbi etikën, konfliktin e interesit dhe komunikimin publik janë pjesë integrale e këtij programi dhe për çdo vit akademik ofrohen sesione të dedikuara trajnimi në këto fusha. Ndërsa, në kuadër të rritjes së kapaciteteve të administratës gjyqësore, Këshilli, që prej vitit 2024, ka miratuar Planin Strategjik 2024-2025 për trajnimin fillestar dhe vazhdues të nëpunësve civilë gjyqësorë dhe Rregulloren për formimin profesional të nëpunësve civilë gjyqësorë. Një tjetër masë e ndërmarrë nga Këshilli lidhet me miratimin e moduleve sipas fushave përkatëse, të cilat janë krijuar për të mbështetur nëpunësit civilë gjyqësorë në zhvillimin e njohurive dhe aftësive për funksionimin efikas të gjykatave, si dhe me qëllim përfitimin e kompetencave profesionale, administrative dhe etike që garantojnë ushtrimin e përgjegjësive me profesionalizëm, paanshmëri dhe integritet në sistemin gjyqësor. Temat me fokus komunikimin efektiv dhe etikën janë të përfshira në këto module.

Sa i përket Rekomandimit nr. 6 "**Të sigurojë ndarjen e balancuar të ngarkesës së punës ndërmjet gjykatave dhe gjyqtarëve, në mënyrë që të garantohet efikasiteti dhe barazia në trajtimin e çështjeve",** Këshilli i Lartë Gjyqësor, në funksion të garantimit të ndarjes së balancuar të ngarkesës së punës ndërmjet gjykatave dhe gjyqtarëve ka miratuar vendimin nr. 554, datë 29.12.2022 "Për ndarjen me short të çështjeve gjyqësore" dhe vendimin nr. 724, datë 07.12.2023 "Për rindarjen me short të çështjeve gjyqësore", i ndryshuar me vendimin nr. 867, datë 23.12.2025. Kryetari i gjykatës merr masa për organizimin e ndarjes së çështjeve gjyqësore nëpërmjet shortit elektronik, ndërsa vendimi dhe raporti i shortimit publikohet në faqen zyrtare të internetit të gjykatës. Kancelarit të gjykatës i atribuohet një rol mbikëqyrës në procesin e shortimit, i cili, në përfundim, nënshkruan kalimin e praktikës së regjistrimit të çështjes. Çështjet gjyqësore u ndahen në mënyrë të barabartë gjyqtarëve, sipas organizimit të brendshëm të gjykatës. Referuar vendimeve të mësipërme, barazia në

ndarjen e çështjeve nënkupton ndarjen në numër të barabartë mes gjyqtarëve të seksionit përkatës të çështjeve të regjistruara për short, pavarësisht nga ngarkesa individuale e çdo gjyqtari në momentin e hedhjes së shortit. Rindarja e çështjeve gjyqësore me short realizohet mbi bazën e parimit të procesit të rregullt ligjor, transparencës, informimit, kontrollit, mbikëqyrjes, gjurmueshmërisë, barazisë së shpërndarjes, efiçencës dhe objektivitetit. Ajo realizohet me qëllim që ngarkesa e punës për gjyqtarët e caktuar rishtazi në një seksion të jetë e balancuar dhe të përfshijë çështje me të njëjtën vjetërsi, sipas kohës së regjistrimit dhe të kategorive të ndryshme. Rindarja e çështjeve gjyqësore me short është një proces që zhvillohet nën kujdesin e kryetarit të gjykatës.

Në lidhje me Rekomandimin nr. 7, "**Të përmirësojë bashkëpunimin ndërinstitucional me Shkollën e Magjistraturës dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë për të harmonizuar proceset e emërimit, trajnimit dhe vlerësimit të magjistratëve"**, gjatë vitit 2025 Këshilli ka pasur një bashkëpunim dhe gatishmëri të vazhdueshme për koordinim ndërinstitucional me Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe Shkollën e Magjistraturës. Ky bashkëpunim është materializuar përmes shkëmbimit të informacioneve, harmonizimit të praktikave, bashkërendimit në fushat me interes të përbashkët institucional dhe përfshirjes aktive të secilit institucion në proceset e emërimit, trajnimit dhe vlerësimit të magjistratëve. Konkretisht, me vendimin nr. 410, datë 16.07.2025 është miratuar Rregullorja "Për mbledhjet e përbashkëta dhe bashkëpunimin ndërinstitucional ndërmjet Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë". Ndër të tjera, në këtë akt parashikohen bashkërendimi dhe përafrimi në interpretimin dhe zbatimin e dispozitave ligjore, shkëmbimi i jurisprudencës dhe praktikave institucionale, si dhe harmonizimi i procedurave dhe politikave në çështjet që lidhen me zhvillimin e karrierës, vlerësimin, transferimin dhe disiplinën e magjistratëve. Gjithashtu, gjatë vitit 2025, këshillat kanë intensifikuar takimet e përbashkëta duke zhvilluar 3 të tilla. Në këtë drejtim, evidentojmë se ky intensifikim përbën një rritje të rëndësishme të bashkëpunimit institucional, duke i konsideruar këto takime si forume për adresimin e çështjeve me rëndësi.

Në lidhje me Rekomandimin nr. 8 **"Të rrisë transparencën në procesin e komandimeve dhe emërimeve të përkohshme, duke siguruar respektimin e parimit të meritokracisë dhe shmangien e praktikave arbitrare"**, për të garantuar transparencën në funksionimin dhe proceset vendimmarrëse të Këshillit, veçanërisht në fushat që ndikojnë në karrierën gjyqësore si emërimet, ngritjet në detyrë, transferimet, vlerësimet dhe disiplinën, si dhe në performancën më të gjerë institucionale të tij, Këshilli ka miratuar me vendimin nr.770, datë 22.10.2025, rregulloren "Për transparencën dhe përmirësimin e procesit vendimmarrës në Këshillin e Lartë Gjyqësor". Përpara miratimit të kësaj rregulloreje, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vijuar të shpallë dhe publikojë në faqen zyrtare vendet vakante në sistemin gjyqësor. Në të njëjtën mënyrë janë bërë publike edhe pozicionet pranë institucioneve të sistemit të drejtësisë për komandimin e magjistratëve dhe për transferimet e përkohshme me pëlqim. Vendimet e Këshillit për shpalljen e vendeve vakante për komandim, lëvizje paralele ose ngritje në detyrë publikohen pa vonesë në faqen zyrtare. Në funksion të transparencës,

Këshilli publikon njoftime për kandidatët e interesuar, në të cilat përcaktohen kriteret ligjore të pranueshmërisë, si edhe çdo kusht specifik i vendosur me vendim të tij. Njoftimet bëhen si në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor, ashtu edhe në adresat elektronike të magjistratëve, dhe procedura shoqërohet me publikimin e listës së kandidatëve të paraqitur.

Në lidhje me Rekomandimin nr. 9 **"Të intensifikojë masat për përmirësimin e infrastrukturës së gjykatave dhe kushteve të punës së gjyqtarëve, dhe veçanërisht sigurinë në të gjithë gjykatat e vendit, duke përmirësuar bashkëpunimin ndërinstitucional me Kuvendin dhe institucionet e ekzekutivit përmes Ministrisë së Drejtësisë"** kemi bërë me dije se Këshilli i Lartë Gjyqësor, që nga krijimi i tij, gjatë çdo viti buxhetor, ka paraqitur nevojat e domosdoshme në infrastrukturën ndërtimore, për sistemin gjyqësor, duke i bërë pjesë të dokumenteve të programit buxhetor afatmesëm. Kjo nevojë u bë emergjente me përfundimin e riorganizimit të rretheve gjyqësore dhe të kompetencave tokësore të gjykatave. Nevojat emergjente për godina të reja kanë lindur, pasi në godinat ekzistuese ku gjykatat ushtrojnë aktivitetin e tyre nuk kanë sipërfaqe të nevojshme pune, nuk plotësojnë standardet e organizimit të brendshëm funksional dhe standardet e sigurisë, si dhe nuk ofrojnë mundësi për zgjerimin e ndërtesave ekzistuese të gjykatave.

Për Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, projekti i investimit është mbështetur nga hapi i parë i hartimit të detyrës së projektimit. Ky dokument është përgatitur gjatë vitit 2024, në bashkëpunim me përfaqësues të KLGJ-së, përfaqësues të institucioneve përfituese (prokurorive përkatëse), si dhe specialistë të Bashkisë Tiranë. Detyra e projektimit ka trajtuar nevojat për sipërfaqe pune për të dy gjykatat e Tiranës, duke parashikuar grupimin e tyre në një ndërtesë të përbashkët. Detajet e mëtejshme të projekteve të investimit për këto institucione do të zhvillohen pas miratimit të sheshit të ndërtimit, pasi zgjidhja urbanistike dhe arkitekturore e objekteve të reja do të varet nga karakteristikat e sheshit.

Për sa më sipër, Këshilli i Lartë Gjyqësor i është drejtuar Ministrisë së Drejtësisë, Këshillit të Ministrave dhe bashkive respektive, me qëllim vendosjen në dispozicion të shesheve të ndërtimit të godinave të reja për Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, Gjykatën Administrative të Apelit, si dhe gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm në Tiranë, Berat, Durrës, Fier, Kukës dhe Lezhë.

Për sa i përket sigurisë së gjykatave, gjatë përgatitjes së dokumentit PBA 2026-2028 janë programuar fonde buxhetore për vitin 2026 për projektin e sigurisë në gjykata në shumën 223,200 mijë lekë, i cili ka për qëllim pajisjen e gjykatave me mjete teknologjike që mundësojnë monitorimin e çështjeve të sigurisë në gjykata. Ky projekt synon pajisjen e gjykatave me mjete dhe sisteme teknologjike bashkëkohore, të standardizuara, që mundësojnë monitorimin dhe administrimin e çështjeve të sigurisë në ambientet gjyqësore. Projekti është konceptuar si projekt pilot, i cili do të zbatohet fillimisht në 10 gjykata gjatë

dy viteve të para buxhetore, duke mundësuar testimin, vlerësimin dhe më pas shtrirjen e tij në nivel kombëtar.

Në kuadër të përmirësimit të sigurisë në gjykata, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka ndërmarrë disa hapa, si dërgimi i pyetësorit institucional të shpërndarë në të gjitha gjykatat, me qëllim evidentimin e nevojave, boshllëqeve dhe praktikave më të mira ekzistuese në fushën e sigurisë gjyqësore, duke mundësuar një vlerësim të sigurisë për të gjitha nivelet e gjykatave. Është kryer analizë për çdo gjykatë për periudhën 2023-2025, si dhe është përgatitur raporti për sigurinë e tyre. Gjithashtu, Këshilli i është drejtuar me shkresë institucioneve kompetente, si Kryeministrit, Ministrit të Drejtësisë, Ministrit të Brendshëm, Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe Kuvendit, lidhur me nevojën për garantimin e sigurisë në gjykata. Për më tepër, Këshilli ka ngritur Grupin e Punës "Për verifikimin e kushteve të sigurisë në ambientet e gjykatave" dhe Grupin Ndërinstitucional të Punës "Për vlerësimin e masave për sigurinë në sistemin gjyqësor të Republikës së Shqipërisë".

Lidhur me rekomandimin nr. 10 **"Të zbatojë masat për digjitalizimin e plotë të procesit gjyqësor, përfshirë sistemin e regjistrimit elektronik të çështjeve, nënshkrimin elektronik dhe komunikimin elektronik me palët",** gjatë vitit 2025 projekti i digjitalizimit ka vijuar me ritme të përshpejtuara dhe në përputhje të plotë me objektivat e planifikuara. Procesi i digjitalizimit të vendimeve gjyqësore është finalizuar në të gjitha zyrat e shërbimit (ish-gjykatat), si dhe në nëntë gjykata të tjera, duke përmbyllur detyrimin e parashikuar për vitin 2025. Paralelisht me këtë proces, ka vijuar puna për implementimin e sistemit të ri të integruar të menaxhimit të çështjeve gjyqësore, i cili shënon një fazë strategjike të transformimit digjital të sistemit gjyqësor. Gjatë vitit 2025 është parashikuar përmbyllja e tre fazave fillestare të projektit, përkatësisht: ngritja e infrastrukturës fizike hardware, e domosdoshme për funksionimin e sistemit; inicimi dhe dokumentimi i proceseve ekzistuese; si dhe analiza e proceseve, e cila synon identifikimin e ndryshimeve të nevojshme në mënyrën e punës, me qëllim mundësimin e integrimit të nënshkrimit elektronik dhe komunikimit elektronik me palët ndërgjyqëse.

Lidhur me rekomandimin nr. 11, **"Të përgatisë raporte periodike mbi zbatimin e rekomandimeve të Kuvendit, duke e bërë ketë një pjesë integrale të procesit vjetor të raportimit"**, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka përfshirë tashmë si pjesë integrale të raportit vjetor mbi gjendjen e sistemit gjyqësor dhe veprimtarinë e tij, nivelin e zbatimit të rekomandimeve të Kuvendit në rezolutë. Konkretisht, raportet e veprimtarisë së institucionit për vitin 2023 dhe 2024, si edhe në këtë raport të vitit 2025, i kanë dedikuar një kapitull të veçantë këtij aspekti, i cili do të vijojë të reflektohet edhe në raportimet e ardhshme vjetore.

Lidhur me rekomandimin nr. 12, **"Të përgatisë brenda muajit dhjetor 2025 një analizë krahasuese të çështjeve gjyqësore të mbartura (*backlog*) përpara dhe pas reformës në drejtësi, përfshirë krahasimet me vendet e tjera të rajonit dhe me standardet e CEPEJ-**

it, me qëllim vlerësimin objektiv të ecurisë së sistemit gjyqësor dhe identifikimin e nevojave për ndërhyrje të mëtejshme ligjore dhe institucionale", Këshilli i Lartë Gjyqësor, i angazhuar në forcimin e efikasitetit dhe cilësisë së drejtësisë në Shqipëri, monitoron periodikisht performancën e gjykatave në vend. Ky vlerësim bëhet plotësisht në përputhje me standardet e CEPEJ-it. Këshilli, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, kryen vlerësime të organizimit të rretheve dhe kompetencave të gjykatave çdo 5 vjet. Viti 2024 ishte viti i parë pas zbatimit të hartës së re gjyqësore, një reformë e thellë strukturore që kërkon një periudhë të caktuar për të vlerësuar ndikimin e saj real në veprimtarinë dhe efiçencën gjyqësore. Në vlerësimin tërësor të situatës, vihet re një përmirësim i ndjeshëm në indikatorët e efiçencës për gjykatat e shkallës së parë, situata paraqitet disi më ndryshe në gjykatat e apelit. Sikurse është theksuar edhe më parë, stoku i çështjeve të prapambetura është sfida kryesore me të cilën përballen gjykatat. *Backlog-u* i trashëguar vazhdon të ketë peshë të rëndësishme në ngarkesën e punës së gjykatave. Me plotësimin gradual të vakancave në radhët e gjyqtarëve, forcimin e kapaciteteve administrative dhe vazhdimin e zbatimit të strategjisë për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura, pritet që situata të përmirësohet ndjeshëm në vitet në vijim.

Lidhur me rekomandimin nr. 13, **"Të raportojë mbi ecurinë e përgatitjes dhe miratimit të rregulloreve të parashikuara në ligj, duke adresuar pengesat që ndikojnë në përmbylljen e kuadrit nënligjor dhe duke siguruar funksionim të plotë institucional",** Këshilli i Lartë Gjyqësor, gjatë veprimtarisë së tij, ka përmbyllur miratimin e pjesës më të madhe të akteve nënligjore të parashikuara nga ligji, duke bërë prioritizimin e kuadrit nënligjor, duke vendosur përparësi në miratim për aktet me një ndikim të drejtpërdrejtë në funksionalitetin e sistemit gjyqësor. Të tilla akte lidhen me zhvillimin e karrierës, vlerësimin e gjyqtarëve, administrimin e gjykatave apo rritjen e efiçencës së gjyqësorit, me fokus në forcimin dhe konsolidimin e standardeve të profesionalizmit me qëllimin final pasjen e një drejtësie transparente, cilësore dhe efikase. Miratimi i tyre ka kërkuar burime njerëzore, kohë dhe angazhim të vazhdueshëm deri në finalizimin e tyre. Edhe gjatë vitit 2025, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka miratuar një sërë aktesh nënligjore dhe rregullatorë, të cilat synojnë konsolidimin e kuadrit nënligjor dhe rritjen e efiçencës në sistemin gjyqësor.

Lidhur me rekomandimin nr. 14, **"Të hartojë deri në dhjetor 2025 një analizë të plotë të vakancave në sistemin gjyqësor, duke përfshirë gjyqtarët e komanduar dhe nevojat për burime njerëzore, me qëllim hartimin e një plani të unifikuar për rekrutimin, trajnimin dhe sistemimin e gjyqtarëve në të gjitha nivelet e gjyqësorit, si dhe kërkesat për sistemin e rekrutimeve në Shkollën e Magjistraturës, nevojat për staf mbështetës, etj.",** Këshilli i Lartë Gjyqësor i ka përcjellë Kuvendit analizën mbi vakancat dhe planet për plotësimin progresiv të tyre. Në zbatim të detyrimit ligjor, Këshilli përcakton në fillim të çdo viti numrin maksimal të kandidatëve magjistratë (profili gjyqtar), si dhe numrin e kandidatëve për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë që pranohen në formimin fillestar për vitin e ri akademik në Shkollën e Magjistraturës.

Analiza përmban një vlerësim të numrit maksimal të kandidatëve magjistratë/profili gjyqtar, por jo vetëm, që duhet të pranohen në formimin fillestar të Shkollës së Magjistraturës për vitin akademik 2026-2027, bazuar në: (i) nevojat aktuale për gjyqtarë në sistemin gjyqësor, referuar për këtë numrit të vendeve vakante/pozicioneve të lira të përhershme; (ii) nevojat e pritshme për gjyqtarë në sistemin gjyqësor deri në vitin 2029, referuar për këtë numrit të vendeve/pozicioneve në sistemin gjyqësor që pritet të bëhen të lira të përhershme deri në vitin 2029, kur diplomohen kandidatët magjistratë që do të rekrutohen gjatë vitit të ri akademik 2026-2027; (iii) nevojat aktuale dhe në vijimësi për gjyqtarë në institucionet e sistemit të drejtësisë; (iv) mundësitë e plotësimit të nevojave aktuale dhe atyre të pritshme në një të ardhme të afërt, referuar për këtë numrit të kandidatëve magjistratë që pritet të diplomohen në Shkollën e Magjistraturës gjatë viteve 2026, 2027 dhe 2028, pra gjatë viteve pararendëse me vitin 2029; (v) kapacitetet e Shkollës së Magjistraturës.

3. UDHËRRËFYESI PËR EFIKASITETIN E PUSHTETIT GJYQËSOR NË SHQIPËRI 2025-2027

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në përmbushje të kompetencave kushtetuese, si edhe detyrimeve që burojnë nga procesi i integrimit në Bashkimin Evropian, me vendim nr. 407, datë 15.07.2025 miratoi "Udhërrëfyesin për efikasitetin e pushtetit gjyqësor në Shqipëri 2025-2027", si një dokument gjithëpërfshirës, i cili hedh themele në tetë shtylla kryesore, drejt efikasitetit të sistemit gjyqësor. Ndërsa, me qëllim monitorimin e zbatimit të objektivave që burojnë nga Udhërrëfyesi, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur ngritjen e Komisionit Ad Hoc për monitorimin e zbatimit të Udhërrëfyesit për Efikasitetin e Pushtetit Gjyqësor në Shqipëri 2025–2027[34] si dhe ka miratuar Rregulloren për organizimin dhe funksionimin e këtij komisioni.[35]

Udhërrëfyesi për Efikasitetin ka përcaktuar, për secilin objektiv strategjik, masat dhe aktivitetet përkatëse, të shoqëruara me afatet kohore dhe strukturat përgjegjëse për zbatimin e tyre strukturat përgjegjëse të Këshillit të Lartë Gjyqësor janë angazhuar në përmbushjen e këtyre detyrimeve, duke pasur në fokus objektivat e parashikuara për t'u realizuar gjatë vitit 2025.

Niveli i progresit në përmbushjen e synimeve dhe objektivave të Udhërrëfyesit për Efikasitetin, për vitin 2025, paraqitet si më poshtë:

SYNIMI 1: Zgjidhja në kohë e çështjeve dhe vendimmarrja cilësore

Objektivi 1.1: Forcimi i kapaciteteve të gjyqësorit nëpërmjet miradministrimit të burimeve njerëzore: Plotësimi i vakancave në trupën gjyqësore

[34] Vendim nr. 483, datë 28.07.2025.
[35] Vendim nr. 441, datë 23.07.2025.

Në zbatim të treguesit 1.1.1, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, në bashkëpunim me ekspertët e projektit "EU4Justice", në përputhje me afatet e parashikuara në Udhërrëfyes (dhjetor 2025), është angazhuar në hartimin e një plani për hapjen progresive të pozicioneve vakante dhe plotësimin gradual të vakancave ekzistuese për gjyqtarë, për të përshpejtuar funksionalitetin në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, Gjykatën Administrative të Apelit dhe Gjykatën e Apelit për Korrupsion dhe Krimin e Organizuar. Ky plan synon të sigurojë menaxhim transparent dhe të bazuar në meritë të karrierës gjyqësore, si dhe të ofrojë të dhëna në kohë reale mbi vendet e lira, aplikimet, vlerësimet dhe ngritjet në detyrë.

Zbatimi i planit ka si objektiv garantimin e funksionalitetit të gjykatave të apelit, përmes plotësimit të strukturave gjyqësore dhe administrative në përputhje me parashikimet ligjore, në mënyrë që gjykatat të adresojnë në mënyrë më efektive çështjet e prapambetura dhe ato të reja. Gjatë periudhës raportuese, në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm ushtrojnë detyrën 42 gjyqtarë nga 78 të parashikuar në organikë, duke e çuar nivelin e plotësimit të organikës në rreth 54%, nga 42% që ishte treguesi bazë në qershor 2025. Ndërkohë, Gjykata Administrative e Apelit funksionon me 15 gjyqtarë nga 22 në organikë, duke arritur një nivel plotësimi prej rreth 68%, nga 59% që ishte treguesi bazë.

Në zbatim të treguesit 1.1.2, gjatë vitit 2025 janë shpallur 6 pozicione vakante për gjyqtarë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe në Gjykatën Administrative të Apelit, ndërsa brenda vitit 2026 parashikohet shpallja e të gjitha pozicioneve vakante të mbetura në gjykatat e apeleve, pas përfundimit të procesit të rivlerësimit në qershor 2026. Aktualisht, numri i përgjithshëm i vakancave në gjykatat e apelit është 24, nga të cilat 6 lidhen me përfundimin e mandatit të gjyqtarëve të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

Në përmbushje të treguesit 1.1.3, deri në fund të periudhës raportuese është evidentuar një rritje e ndjeshme e nivelit të plotësimit të organikës. Në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, organika është plotësuar në nivelin 91% (213 gjyqtarë nga 235), nga 89% që ishte treguesi bazë. Në gjykatat e apelit, niveli i plotësimit ka arritur në 60% (67 gjyqtarë nga 111), nga 50% që ishte treguesi bazë, me rritje të veçantë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe Gjykatën Administrative të Apelit.

Lidhur me treguesin 1.1.4, gjatë vitit 2025 janë ngritur në detyrë 22 gjyqtarë (duke përfshirë edhe gjyqtarët e caktuar në skemë delegimi), duke tejkaluar objektivin minimal prej 12 gjyqtarësh në vit. Paralelisht, në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm dhe administrativ janë emëruar dhe caktuar në pozicion 42 gjyqtarë të rinj, të diplomuar nga Shkolla e Magjistraturës në vitin akademik 2024–2025. Sipas parashikimeve aktuale, deri në vitin 2028 pritet të diplomohen edhe 72 kandidatë për magjistratë, profili gjyqtar, të cilët do të kontribuojnë në plotësimin e vakancave të përhershme ekzistuese.

Për garantimin e funksionimit të gjykatave, gjatë periudhës raportuese janë aplikuar edhe mekanizmat ligjorë ekzistues, si lëvizjet paralele, transferimet e përkohshme dhe skema e delegimit. Gjatë vitit 2025, 34 gjyqtarë janë transferuar nëpërmjet lëvizjes paralele, 17 gjyqtarë janë transferuar përkohësisht dhe 11 gjyqtarë janë caktuar në skemë delegimi, kryesisht në gjykatat e apelit.

Në kuadër të treguesit 1.1.16, me urdhrin nr. 147, datë 21.10.2025 të Kryetarit të Këshillit, është ngritur një grup pune për vlerësimin e mekanizmave ligjorë ekzistues dhe nevojës për ndryshime ligjore që mundësojnë caktimin e përkohshëm të gjyqtarëve në gjykatat e apelit. Raporti i hartuar nga grupi i punës propozon përdorimin e skemës së delegimit si mekanizmin më të përshtatshëm për plotësimin e përkohshëm të vakancave, si dhe sugjeron ndryshime ligjore për forcimin e incentivave për gjyqtarët e deleguar.

Gjithashtu, ka avancuar puna për krijimin e një sistemi gjurmimi *(tracking tool)* për procedurat e lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, i cili do të implementohet në platformën ekzistuese M-Files *(ProMagistrate)*. Gjatë periudhës raportuese është përfunduar hartëzimi i fazave të procedurave dhe identifikimi i proceseve që do të digjitalizohen.

Në kuadër të përmbushjes së treguesve 1.1.10, 1.1.11, 1.1.12, 1.1.13 dhe 1.1.18 të Objektivit 1.1, janë ndërmarrë masa konkrete për forcimin e kapaciteteve administrative dhe teknike të Këshillit të Lartë Gjyqësor, me qëllim mbështetjen efektive të Komisioneve përkatëse dhe përshpejtimin e proceseve të zhvillimit të karrierës dhe vlerësimit të gjyqtarëve.

Nevojat për shtim të burimeve njerëzore janë evidentuar që në fazën e rishikimit të strukturës organizative të administratës së Këshillit, të miratuar me vendimin nr. 44, datë 05.02.2025, përmes të cilit u shtuan 24 pozicione dhe u krijuan njësi të reja organizative, në funksion të përmirësimit të kapaciteteve mbështetëse. Në lidhje me Komisionet e Përhershme, struktura organizative parashikon gjithsej 14 pozicione *(11 këshilltarë ligjorë dhe 3 këshilltarë ekonomikë)*. Aktualisht, evidentohen 3 pozicione vakante, konkretisht 1 këshilltar ligjor dhe 2 këshilltarë ekonomikë, ndërkohë që një nga pozicionet e këshilltarit ekonomik është shpallur për rekrutim gjatë muajit dhjetor 2025.

Në përmbushje të treguesit 1.1.12 dhe me qëllim përshpejtimin e procedurave të vlerësimit etik dhe profesional, Këshilli ka ndërmarrë masa për rritjen e numrit të burimeve njerëzore në Njësinë e Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve. Përmes vendimeve nr. 672 dhe nr. 673, datë 01.10.2025, si dhe vendimit nr. 872, datë 23.12.2025, është vendosur komandimi i tre gjyqtarëve të tjerë në këtë njësi. Si rezultat, gjatë vitit 2025 janë përfunduar procedurat e vlerësimit për 50 gjyqtarë, ndërsa që nga fillimi i procesit në vitin 2021 janë vlerësuar në total 154 gjyqtarë.

Në zbatim të treguesve 1.1.9 dhe 1.1.13, si pjesë e masave për rritjen e transparencës dhe llogaridhënies institucionale, Këshilli ka parashikuar dhe realizuar publikimin periodik, çdo

tre muaj, të të dhënave të përgjithësuara mbi emërimet, ngritjet në detyrë dhe transferimet në sistemin gjyqësor. Në këtë kuadër, janë përgatitur dhe publikuar tabela statistikore për periudhat korrik–shtator 2025 dhe tetor–dhjetor 2025, të cilat janë të aksesueshme në rubrikën "Publikime" në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Po ashtu, është realizuar publikimi i të dhënave të përgjithësuara mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve të inspektimeve tematike të kryera nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në përputhje me objektivat e përcaktuara në Udhërrëfyes.

Në vijim të treguesit 1.1.18, dhe përtej masave afatshkurtra për plotësimin e vakancave aktuale, Objektivi 1.1 parashikon edhe një qasje strategjike afatgjatë për vlerësimin e nevojës për rishikimin e numrit të përgjithshëm të gjyqtarëve, bazuar në metodologjinë e CEPEJ-it. Për këtë qëllim, me Urdhrin nr. 195, datë 24.12.2025 të Kryetarit të Këshillit, është ngritur grupi i punës "Për rishikimin e numrit të përgjithshëm të gjyqtarëve", i cili gjatë veprimtarisë së tij do të asistohet nga ekspertë të CEPEJ-it, me synim përgatitjen e një analize gjithëpërfshirëse që do të shërbejë si bazë për vendimmarrje strategjike në vijim.

Objektivi 1.2: Forcimi i kapaciteteve të gjyqësorit nëpërmjet miradministrimit të burimeve njerëzore: plotësimi i vakancave në njësitë ligjore dhe stafin administrativ mbështetës

Nga raportimet mujore periodike të gjykatave rezulton se organika faktike e administratës gjyqësore është 1186 punonjës, nga 1307 vende të miratuara sipas strukturës organizative. Gjatë periudhës së raportimit vërehet një përmirësim progresiv i nivelit të plotësimit të vendeve vakante, ku numri i tyre është ulur nga 134 vende të lira në muajin shtator në 102 vende të lira në fund të muajit dhjetor 2025, duke reflektuar një tendencë pozitive drejt arritjes së objektivit për mbulimin rreth 95% të stafit mbështetës sipas strukturave të miratuara.

Në lidhje me forcimin e njësive të shërbimit ligjor në gjykata, Këshilli i Lartë Gjyqësor, me vendimet nr. 713–721, datë 20.10.2025, ka vendosur pranimin në shërbimin civil gjyqësor të 9 ndihmësve ligjorë të diplomuar në Shkollën e Magjistraturës për vitin akademik 2024–2025, konkretisht 8 ndihmës ligjorë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe 1 ndihmës ligjor në Gjykatën Administrative të Apelit. Si rezultat, organika faktike e ndihmësve ligjorë është rritur në 46 punonjës, nga 55 vende të miratuara në strukturën organizative. Ndërkohë, në Gjykatën e Lartë, organika faktike e këshilltarëve ligjorë është 30, nga 35 vende të miratuara. Në zbatim të detyrimeve të përcaktuara në ligjin nr. 98/2016, "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", në muajin janar 2026, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka përcaktuar edhe numrin maksimal të kandidatëve për ndihmës ligjorë që do të pranohen në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës për vitin e ri akademik.

Objektivi parashikon gjithashtu përgatitjen e një raporti vlerësimi për rritjen graduale të numrit të stafit mbështetës jogjyqtar, në përputhje me standardet e CEPEJ-it, të shoqëruar me planin buxhetor përkatës (rezultati 1.2.7). Sipas të dhënave të CEPEJ-it, mesatarja evropiane është 4.12 staf administrativ për gjyqtar. Aktualisht, raporti gjyqtar/staf administrativ sipas strukturës organizative është 3.14, ndërsa sipas organikës faktike rezulton se për 307 gjyqtarë janë 1194 punonjës administrativë, me raportin 3.89. Me miratimin e Ligjit nr. 87/2025 "Për buxhetin e vitit 2026", u miratua shtimi i 100 punonjësve për sistemin gjyqësor. Megjithatë, krahasuar me kërkesën për shtimin e 219 punonjësve të propozuar gjatë fazës së dytë të PBA 2026–2028, rezulton një diferencë prej 119 punonjësish më pak, çka ndikon në një ritëm më të ngadaltë të përmbushjes së standardeve të CEPEJ-it.

Sa i përket krijimit të një sistemi karriere për ndihmësit ligjorë, në përmbushje të rezultateve të pritshme 1.2.1 dhe 1.2.2, është përgatitur një relacion analitik mbi zbatimin e këtij aktiviteti. Relacioni përfshin një vlerësim të nevojave reale të gjykatave për ndihmës ligjorë, analizën e kuadrit ligjor ekzistues dhe praktikës gjyqësore, si dhe propozime për ndryshime ligjore me qëllim garantimin e një karriere profesionale të qëndrueshme. Zhvillimi i karrierës së ndihmësve ligjorë është analizuar në dy drejtime kryesore: (i) zhvillimi i karrierës brenda shërbimit civil gjyqësor dhe (ii) mundësia për të konkurruar në Shkollën e Magjistraturës për profilet gjyqtar ose prokuror.

Propozimet e hartuara parashikohet të pasohen, në rast miratimi, me ndryshime përkatëse në aktet nënligjore të Këshillit të Lartë Gjyqësor, vendimet e Këshillit të Ministrave dhe Rregulloren e Shkollës së Magjistraturës. Relacioni do t'i përcillet Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, si struktura përgjegjëse për koordinimin dhe monitorimin e përmbushjes së këtij objektivi (rezultati 1.2.6).

Objektivi 1.3: Rritja e efikasitetit nëpërmjet zbatimit të standardeve kohore dhe sasiore të miratuara nga KLGJ

Objektivi është realizuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor nëpërmjet miratimit të vendimit nr. 433, datë 22.07.2025, *"Për përcaktimin e afateve standarde minimale kohore dhe standardeve minimale sasiore për gjykimin e çështjeve".* Vendimi përcakton standarde minimale të detyrueshme për gjykimin e çështjeve, si në aspektin kohor ashtu edhe në atë sasior, dhe ngarkon kryetarët e gjykatave me përgjegjësinë për monitorimin dhe raportimin e zbatimit të këtyre standardeve. Në zbatim të këtij detyrimi, duke filluar nga muaji tetor 2025, gjykatat kanë vijuar me raportime periodike mbi nivelin e përmbushjes ose mospërmbushjes së kritereve të miratuara, duke mundësuar krijimin e një baze të dhënash për vlerësimin e performancës dhe identifikimin e problematikave.

Objektivi 1.4 - Rritja e përdorimit të zgjidhjeve alternative të çështjeve si mekanizëm për uljen e *backlog*-ut

Për realizimin e aktiviteteve që parashikon ky objektiv, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka ngritur Grupin e Punës me Urdhrin nr. 175, datë 05.12.2025, "Për hartimin e udhëzuesit për gjykatat për dërgimin e çështjeve për ndërmjetësim", të ndryshuar. Grupi i punës ka si objekt të veprimtarisë së tij hartimin dhe zbatimin e instrumenteve dhe mekanizmave që synojnë nxitjen dhe standardizimin e përdorimit të ndërmjetësimit si formë alternative për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve. Në këtë kuadër, Grupi i punës është ngarkuar me: hartimin e udhëzuesit për gjykatat për dërgimin e çështjeve për ndërmjetësim, si dhe të modelit të ftesës për ndërmjetësim, me qëllim unifikimin e praktikës gjyqësore; hartimin e një marrëveshjeje bashkëpunimi me Dhomën Kombëtare të Ndërmjetësimit dhe Dhomën Kombëtare të Avokatisë, për forcimin e mekanizmave të zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjeve; zhvillimin e tryezave të diskutimit dhe aktiviteteve të përbashkëta mbi problematikat e hasura në zbatimin e ndërmjetësimit, si dhe analizimin e nevojës për ndërhyrje apo ndryshime ligjore.

Paralelisht, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka përcjellë një shkresë udhëzuese pranë të gjitha gjykatave, duke rikujtuar detyrimin për zbatimin e ligjit nr. 10385, datë 24.02.2011, "Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve. Të dhënat lidhur me raportin ndërmjet çështjeve të zgjidhura me ndërmjetësim dhe numrit total të çështjeve të referuara nga gjykatat, si dhe raporti ndërmjet çështjeve të zgjidhura me ndërmjetësim dhe numrit total të çështjeve të filluara me ndërmjetësim, mblidhen nga Ministria e Drejtësisë, bazuar në informacionin e përcjellë nga Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve. Këto të dhëna do të shërbejnë si tregues për vlerësimin e efektivitetit të mekanizmit të ndërmjetësimit dhe për hartimin e politikave të mëtejshme në këtë fushë.

Objektivi 1.5 - Rritja e efiçencës nëpërmjet përdorimit të formateve standarde të vendimit dhe arsyetimit në kohë të vendimeve

Në zbatim të objektivit, Këshilli i Lartë Gjyqësor, me vendimin nr. 434, datë 22.07.2025, *"Për miratimin e modeleve standarde të vendimeve gjyqësore"*, ka miratuar modele standarde të vendimeve gjyqësore për çështje të thjeshta me natyrë jokomplekse. Këto modele synojnë të kontribuojnë në rritjen e efikasitetit të sistemit gjyqësor, përmes reduktimit të kohës së nevojshme për hartimin dhe arsyetimin e vendimeve nga gjyqtarët, ndihmësit ligjorë, sekretarët gjyqësorë dhe stafi tjetër mbështetës jogjyqtar, si dhe në uljen graduale të numrit të çështjeve të prapambetura.

Po ashtu, me Urdhrin nr. 196, datë 24.12.2025, të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, është ngritur Grupi i Punës "Për hartimin e udhëzuesit për arsyetimin e vendimeve gjyqësore, në përputhje me udhëzimet e CEPEJ-it", me synimin për të garantuar vendime gjyqësore të aksesueshme dhe efikase.

Paralelisht, në kuadër të procesit të ngritjes së **sistemit të ri të integruar të menaxhimit të çështjeve (Juronix)**, janë duke u analizuar në mënyrë të strukturuar procedurat aktuale të

punës në të gjitha hallkat e sistemit të drejtësisë. Ky proces synon identifikimin e problematikave ekzistuese, riorganizimin dhe standardizimin e procedurave, si dhe transformimin e tyre në procese digjitale të unifikuara, të cilat do të implementohen në sistemin e ri. Objektivi përfundimtar është krijimi i një platforme të centralizuar dhe të sigurt, e aftë për të mbështetur menaxhimin e plotë të ciklit jetësor të çështjeve gjyqësore, rritjen e transparencës, efikasitetit operacional dhe forcimin e ndërveprimit me institucionet e tjera të drejtësisë.

Objektivi 1.6 - Rritja e efiçencës nëpërmjet miratimit të rregullave të efiçencës gjyqësore sipas kërkesave të nenit 94 të ligjit nr. 115/2016 për organet qeverisëse

Me Urdhrin nr. 176, datë 05.12.2025, të ndryshuar, të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, është ngritur Grupi i Punës "Për hartimin e rregullave të efiçencës për gjykatat". Grupi i Punës përbëhet nga anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, zëvendëskryetarë dhe kancelarë të gjykatave të apelit dhe të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm dhe atij administrativ. Objekti i veprimtarisë së Grupit të Punës përfshin hartimin e rregullave të efiçencës për gjykatat, duke adresuar në mënyrë të strukturuar këto elemente kryesore:

- Vlerësimin e përputhshmërisë së rregullave të brendshme të gjykatave me udhëzimet e CEPEJ-it mbi krijimin e mekanizmave për zgjidhjen e problematikave funksionale dhe shpërndarjen e balancuar të ngarkesës së punës;
- Përcaktimin e veprimeve standarde që duhet të ndërmerren në rastet kur shqyrtimi i çështjeve tejkalon afatet ligjore ose standarde;
- Vendosjen e rregullave standarde për monitorimin e kohëzgjatjes së pezullimeve të çështjeve, përfshirë ato që vijnë si pasojë e mosveprimit nga palët ose gjykatat;
- Hartimin e udhëzimeve për një rol më aktiv të gjyqtarëve në menaxhimin e çështjeve;
- përcaktimin e mekanizmave për monitorimin e shtyrjeve të seancave gjyqësore;
- Dhënien e udhëzimeve për menaxhimin efektiv të procesit gjyqësor *(trial management)*, në përputhje me praktikat më të mira të CEPEJ-it.

Miratimi dhe zbatimi i këtyre rregullave do të kontribuojë në unifikimin e praktikave të menaxhimit të çështjeve gjyqësore, në përmirësimin e shpërndarjes së ngarkesës së punës dhe në rritjen e efikasitetit dhe cilësisë së shërbimit gjyqësor në të gjitha nivelet e sistemit.

Objektivi 1.7 - Rritja e efiçencës nëpërmjet statistikave gjyqësore të qarta, të bazuara në standardet ndërkombëtare dhe harmonizimit të tyre

Në përmbushje të këtij objektivi, me Urdhrin nr. 148, datë 21.10.2025, të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, është ngritur Grupi i Punës *"Për hartimin e udhëzuesit për statistikat gjyqësore"*, i cili ka si objekt të veprimtarisë së tij hartimin e udhëzuesit për harmonizimin dhe standardizimin e statistikave gjyqësore, përfshirë mbajtjen e tyre sipas llojeve të veçanta të çështjeve, si dhe përditësimin e metodologjisë së mbledhjes së të

dhënave të unifikuara. Në këtë kuadër, udhëzuesi do të adresojë edhe integrimin e statistikave relative dhe moduleve të raportimit në sistemin e ri të menaxhimit të çështjeve (Juronix), në përputhje me metodologjinë dhe standardet e CEPEJ-it, duke kontribuar drejtpërdrejt në përmirësimin e cilësisë së të dhënave dhe përdorimin e tyre për qëllime analitike dhe vendimmarrëse.

SYNIMI 2: Reduktimi i numrit të çështjeve të prapambetura për sistemin gjyqësor

Objektivi 2.1 - Ulja strukturore e çështjeve të prapambetura nëpërmjet marrjes së masave konkrete sipas strategjisë kombëtare për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura 2024 – 2027

Objektivi është i harmonizuar me Strategjinë Kombëtare për Uljen e Numrit të Çështjeve të Prapambetura 2024–2027, e cila parashikon një paketë masash konkrete për reduktimin progresiv të stokut të çështjeve të pashqyrtuara në gjykata. Monitorimi i zbatimit të kësaj Strategjie nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, nëpërmjet raportimeve periodike të gjykatave, tregon se masat që përkojnë me këtë objektiv janë në proces zbatimi, me rezultate të matshme dhe hapa konkretë drejt arritjes së objektivave afatmesëm dhe afatgjatë.

Gjykatat kanë vijuar procesin e inventarizimit të çështjeve të prapambetura. Deri në këtë fazë, në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm janë inventarizuar 27,444 çështje, ndërsa në Gjykatën Administrative të Apelit janë inventarizuar 19,444 çështje. Procesi i inventarizimit vijon edhe në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me synimin për të arritur deri në dhjetor 2026 objektivat përkatëse prej 38,000, 23,000, 20,000 dhe 8,000 çështjesh të inventarizuara.

Në funksion të përshpejtimit të shqyrtimit dhe reduktimit të stokut, Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe Gjykata Administrative e Apelit kanë miratuar vendime për krijimin e listave të grup-çështjeve prioritare, të cilat u janë përcjellë gjyqtarëve relatorë për shqyrtim me përparësi. Ndërkohë, edhe gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm dhe administrativ Tiranë ndodhen në procesin e hartimit dhe miratimit të listave të grup-çështjeve.

Gjithashtu, gjykatat kanë ndërmarrë masa organizative për krijimin e ekipeve të posaçme për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura. Konkretisht, Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm ka ngritur një grup pune të përbërë nga 14 sekretarë gjyqësorë të trajnuar, të cilët janë angazhuar në inventarizimin e dosjeve sipas vitit të regjistrimit dhe vijojnë aktualisht punën. Në Gjykatën Administrative të Apelit fillimisht është krijuar një ekip prej 6 nëpunësish civilë gjyqësorë, i cili më pas është reduktuar në 4 nëpunës, për shkak të mungesës së burimeve njerëzore dhe nevojës për përmbushjen e detyrave të tjera administrative thelbësore për funksionimin normal të gjykatës. Procesi i krijimit dhe

funksionimit të ekipeve vijon gjithashtu në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm dhe administrativ Tiranë.

Sa i përket planeve individuale të punës, rezulton se ky proces ka nisur në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm dhe administrativ Tiranë. Në Gjykatën Administrative të Apelit, ky proces nuk është realizuar ende, pasi gjykata raporton se, në kushtet e ekzistencës së çështjeve të regjistruara që nga vitet 2017–2018 dhe në mungesë të burimeve njerëzore të pritshme, por të parealizuara nga institucionet përkatëse, është vlerësuar si zgjidhje më efektive përqendrimi në listat e grup-çështjeve prioritare.

Këshilli i Lartë Gjyqësor po ndjek gjithashtu matjen e indikatorëve bazë të performancës, përfshirë *Disposition Time* (DT), si dhe progresin vjetor në uljen e volumit të çështjeve të prapambetura sipas niveleve të gjykatave dhe llojit të çështjeve. Objektivat përfshijnë, ndër të tjera, uljen me 20–30% në vit të stokut të çështjeve në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, uljen me 25% në vit në Gjykatën Administrative të Apelit, si dhe reduktime progresive në gjykatat e shkallës së parë, në përputhje me përqindjet e parashikuara në Strategji.

Objektivi 2.2 - Përmirësimi i metodave të punës

Në kuadër të këtij objektivi që synon rritjen e efiçencës së sistemit gjyqësor përmes lehtësimit të ngarkesës së gjyqtarëve nga veprime administrative dhe optimizimit të rolit të stafit mbështetës, nga monitorimi i zbatimit të Strategjisë për Uljen e Numrit të Çështjeve të Prapambetura konstatohet progres në disa prej aktiviteteve të planifikuara.

Gjykata Administrative e Apelit ka hartuar dhe ka në përdorim modele standarde për përgatitjen e relacioneve nga ndihmësit ligjorë, si dhe ka ndërmarrë masa për përdorimin e modeleve dhe veprimeve të standardizuara në përpilimin e akteve procedurale dhe kryerjen e veprimeve përgatitore. Bazuar në gjetjet e deritanishme, kjo gjykatë parashikon vijimin e punës për përmirësimin dhe zgjerimin e këtyre modeleve. Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm raporton se ky aktivitet është realizuar, ndërsa Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ndodhet aktualisht në proces zbatimi.

Në lidhje me identifikimin e ndryshimeve të nevojshme ligjore dhe nënligjore me qëllim lehtësimin e gjyqtarëve nga veprime administrative dhe përmirësimin e organizimit efikas të sistemit gjyqësor, konstatohet progres në përputhje me rezultatet e pritshme. Në kuadër të zhvillimit të sistemit të ri të menaxhimit të çështjeve, janë ngritur grupe pune me përfaqësues nga gjykatat dhe institucione të ndryshme, me qëllim identifikimin e akteve ligjore dhe nënligjore që kërkojnë ndërhyrje. Janë zhvilluar takime ndërinstitucionale, të cilat kanë shërbyer si për prezantimin e funksionaliteteve të sistemit të ri, ashtu edhe për evidentimin e problematikave praktike dhe nevojave për ndryshime në legjislacionin në fuqi.

Objektivi 2.3 - Ndryshimet ligjore me fokus uljen dhe parandalimin e çështjeve të prapambetura të miratuara

Në kuadër të këtij objektivi, që synon rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit të përgjithshëm të sistemit gjyqësor, me Urdhrin nr. 177, datë 05.12.2025, të ndryshuar, të Kryetarit të Këshillit, është ngritur Grupi Ndërinstitucional i Punës "Për hartimin e ndryshimeve ligjore". Ky grup ka në përbërje të tij anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Ministrisë së Drejtësisë, si dhe zëvendëskryetarë të Gjykatave të Apelit dhe të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe Administrativ Tiranë. Grupi ka si objekt hartimin e një pakete rekomandimesh ligjore për thjeshtimin e procedurave gjyqësore, duke u fokusuar në rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit të gjykimeve, dhe përmirësimin e menaxhimit të çështjeve gjyqësore. Aktivitetet kryesore të grupit përfshijnë:

1. **Analizën e kuadrit ligjor aktual** të procedurave civile dhe penale, duke identifikuar pengesat dhe proceset që shkaktojnë vonesa ose ngarkesë administrative të panevojshme për gjyqtarët.
2. **Hartimin e një pakete rekomandimesh ligjore**, e cila përfshin ndryshime në:
   - Kodet e procedurave civile dhe penale;
   - Ligjin nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve", i ndryshuar;
   - Ligjin nr. 98/2016 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor", i ndryshuar.
3. **Identifikimin e masave për thjeshtimin e procedurave gjyqësore**, duke përfshirë: disiplinën gjatë shqyrtimit gjyqësor, vonesat e shkaktuara nga mosparaqitja e palëve, përdorimin e mënyrave digjitale të njoftimit të palëve dhe optimizimin e kohës së gjykimeve.

Për të siguruar zbatimin efektiv të këtij objektivi, grupi zhvilloi mbledhjen e parë në dhjetor 2025, dhe parashikohet që brenda muajit mars 2026 të përfundojë analiza e ligjeve procedurale dhe të hartojë një paketë rekomandimesh për thjeshtimin e procedurave gjyqësore të parashikuara në kodet përkatëse. Këto rekomandime do të përfshijnë dispozita për rritjen e efikasitetit dhe përmirësimin e menaxhimit të gjykimeve.

SYNIMI 3: Përmirësimi i menaxhimit të çështjeve nëpërmjet vendosjes/përdorimit të teknologjive me të avancuara

Objektivi 3.1 - Zhvillimi i sistemi elektronik të integruar të menaxhimit të çështjeve gjyqësore, bazuar në praktikat më të mira ndërkombëtare

Në zbatim të Objektivit 3.1, ka vijuar puna për implementimin e sistemit të ri të integruar të menaxhimit të çështjeve gjyqësore (Juronix), që përfaqëson një fazë strategjike të transformimit digjital të sistemit gjyqësor. Gjatë vitit 2025 janë përfunduar fazat e inicimit, analizës dhe planifikimit të projektit, si dhe ngritja e infrastrukturës fizike dhe IT të

domosdoshme për funksionimin e sistemit, ku do të hostohen shërbimet elektronike. Këto përfshijnë pajisje server, pajisje rrjeti, paketa të sigurisë kibernetike dhe sisteme auditimi për bazën e të dhënave. Në kuadër të këtyre fazave, janë identifikuar dhe dokumentuar proceset ekzistuese të punës, me qëllim përcaktimin e ndryshimeve organizative, procedurale dhe teknike që do të implementohen në platformën Juronix. Ky proces përfshin gjithashtu integrimin e nënshkrimit elektronik dhe të komunikimit elektronik me palët ndërgjyqësore, duke mundësuar një menaxhim më efikas dhe të sigurt të çështjeve gjyqësore.

Këshilli i Lartë Gjyqësor ka prezantuar pranë institucioneve të sistemit të drejtësisë dhe gjykatave proceset e evidentuara për digjitalizim dhe automatizim, mbi të cilat do të adresohen ndryshimet e nevojshme ligjore dhe nënligjore, për të mbështetur funksionimin e plotë të sistemit të ri.

Në vijim të zbatimit të projektit, janë kryer përmirësime thelbësore në infrastrukturën e arkivës digjitale, duke mundësuar akses të shpejtë dhe efikas në materialet e digjitalizuara. Procesi i digjitalizimit të vendimeve gjyqësore është përfunduar në të gjitha zyrat e shërbimit dhe në nëntë gjykata të tjera, duke krijuar një bazë dokumentare të digjitalizuar me 12,937,316 fletë të arkivuara elektronikisht, të aksesueshme nga përdoruesit e gjykatave përmes platformës elektronike.

Në kuadër të përmirësimit të infrastrukturës IT, ka filluar procedura për blerjen e pajisjeve kompjuterike, printerëve, pajisjeve rrjeti dhe sistemeve IT për gjykatat, me qëllim standardizimin dhe harmonizimin e infrastrukturës elektronike.

Ky progres dëshmon një avancim të qëndrueshëm drejt digjitalizimit të plotë të ciklit të administrimit gjyqësor, duke kontribuar drejtpërdrejt në: rritjen e efikasitetit, reduktimin e vonesave administrative, përmirësimin e transparencës, forcimin e llogaridhënies së gjykatave. Ky zhvillim afron sistemin gjyqësor shqiptar me standardet e BE-së dhe rekomandimet e CEPEJ-it**,** duke krijuar një mjedis të digjitalizuar, transparent dhe efikas për menaxhimin e çështjeve gjyqësore.

Objektivi 3.2 - Pilotimi i shkëmbimit të akteve elektronike

Në zbatim të objektivit, ka nisur vlerësimi i proceseve të nevojshme për krijimin e dosjes elektronike, duke përfshirë analizën e proceseve të punës që do të digjitalizohen dhe automatizohen, me fokus të veçantë në procesin e njoftimeve elektronike. Gjatë kësaj faze janë zhvilluar takime koordinuese me institucionet që do të ndërveprojnë me sistemin e ri Juronix, duke siguruar përputhshmërinë me protokollet dhe standardet e miratuara nga Qendra e Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë.

Po ashtu, është parashikuar përdorimi i platformave shtetërore të certifikuara dhe regjistrave elektronikë kombëtarë për të garantuar identitetin, autenticitetin dhe legjitimitetin e palëve

ndërgjyqëse, përfaqësuesve ligjorë dhe subjekteve të tjera të përfshira në proceset gjyqësore. Ky sistem siguron gjithashtu verifikimin elektronik të të dhënave përkatëse, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe standardet e sigurisë së informacionit.

Objektivi 3.3: Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve nga gjykata përmes digjitalizimit

Objektivi synon shtrirjen e mekanizmave digjitalë për të gjitha gjykatat dhe publikun, në mënyrë që të mundësohet aksesi në shërbimet e ofruara nga administrata gjyqësore. Në këtë kuadër, janë përgatitur dhe analizuar pyetësorë për publikun dhe palët ndërgjyqësore, të cilët do të shërbejnë si udhërrëfyes për dizenjimin dhe implementimin e funksionaliteteve të reja në sistemin Juronix**.** Qëllimi kryesor është të sigurohet aksesi sa më i lehtë, efektiv dhe në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi**,** duke garantuar që të paktën 10%–40% e shërbimeve *online* të jenë të aksesueshme nga përdoruesit deri në fund të vitit 2027.

Objektivi 3.4 - Forcimi i kapaciteteve të Qendrës së Teknologjisë së Informacionit të sistemit të drejtësisë

Fokusi ka qenë dhe vijon të jetë konsolidimi i rolit të QTI-së si strukturë kyçe për transformimin digjital dhe sigurinë e sistemeve të drejtësisë. Në këtë kuadër, është synuar forcimi i kapaciteteve njerëzore, organizative dhe profesionale të kësaj strukture, si dhe krijimi i një kuadri të qëndrueshëm planifikimi dhe zhvillimi afatmesëm e afatgjatë.

Organigrama e QTI-së përbëhet nga 6 punonjës, ndërkohë që aktualisht struktura funksionon me 5 punonjës, pasi një pozicion mbetet vakant. Plotësimi i kësaj vakance nuk është arritur të realizohet brenda afatit të përcaktuar, për shkak të faktorëve proceduralë dhe organizativë, megjithatë mbetet një prioritet për t'u adresuar sa më parë, me qëllim garantimin e funksionimit të plotë dhe rritjen e kapaciteteve operative të QTI-së.

Paralelisht, janë ndërmarrë dhe vijojnë përpjekjet për rritjen e kapaciteteve profesionale të stafit të QTI-së përmes trajnimeve të specializuara, përfshirë trajnime të financuara nga Bashkimi Evropian dhe të implementuara nga UNOPS-i, si dhe trajnime të mbështetura drejtpërdrejt nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, me fokus në menaxhimin e sistemeve IT, sigurinë e informacionit, sigurinë kibernetike dhe qëndrueshmërinë e infrastrukturës digjitale. Këto masa synojnë, ndër të tjera, përmirësimin e njohurive të stafit mbi udhëzimet e CEPEJ-it për drejtësinë kibernetike dhe përafrimin e praktikave të QTI-së me standardet evropiane.

SYNIMI 4: Përmirësimi i menaxhimit të çështjeve nëpërmjet vendosjes/përdorimit të teknologjive më të avancuara

Objektivi 4.1 - Forcimi i kapaciteteve të gjyqësorit nëpërmjet trajnimit të nëpunësve civilë gjyqësorë

Objektivi synon forcimin e kapaciteteve të administratës gjyqësore përmes zhvillimit të trajnimeve të vazhdueshme, të përputhura me standardet ndërkombëtare dhe evropiane, si dhe funksionalitetin e plotë të Njësisë së Trajnimit pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, duke e fuqizuar atë për trajnimin e nëpunësve civilë gjyqësorë.

Sektori i trajnimeve, i ngritur si njësi organizative në kuadër të ndryshimeve të miratuara me vendimin nr. 44, datë 05.02.2025, përbëhet nga tre pozicione, një shef sektori dhe dy specialistë. Aktualisht është i plotësuar pozicioni i shefit të sektorit, ndërsa procesi për plotësimin e pozicioneve të specialistëve vijon. Brenda këtij kuadri, njësia e trajnimit ka vijuar zhvillimin e moduleve për temat e administrimit gjyqësor, mbrojtjen e të dhënave personale dhe tema të tjera të rëndësishme për përmirësimin e efikasitetit dhe standardeve profesionale. Janë përgatitur aktet dhe materialet për implementimin e programeve të formimit fillestar dhe vazhdues, në mënyrë që ato të jenë funksionale dhe të aplikueshme për gjithë stafin e gjykatave. Po ashtu, janë organizuar trajnime praktike, përfshirë programet ToT, si dhe module *online*, për të mundësuar pjesëmarrjen e të gjithë nëpunësve civilë gjyqësorë në proceset e formimit profesional.

Objektivi 4.2 - Forcimi i kapaciteteve të gjyqësorit nëpërmjet trajnimit të ndihmësve ligjorë në bashkëpunim me SHM-në

Objektivi synon rritjen e kapaciteteve profesionale të këshilltarëve ligjorë dhe ndihmësve ligjorë përmes programeve të trajnimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, duke përfshirë zhvillimin e aftësive në shkrimin, kërkimin dhe arsyetimin ligjor, si dhe njohuri mbi administrimin e gjykatave. Shkolla e Magjistraturës mbetet institucioni përgjegjës për ofrimin e trajnimeve të këtij grupi nëpunësish civilë gjyqësorë, dhe të dhënat e deritanishme tregojnë një nivel të lartë përfshirjeje në programet e formimit vazhdues.

Paralelisht, objektivi përfshin zhvillimin e takimeve periodike ndërmjet njësive të shërbimit ligjor në gjykata, për shkëmbimin e eksperiencave dhe unifikimin e praktikave të punës. Aktualisht, në gjykatat e shkallës së parë, njësitë e shërbimit ligjor janë ngritur në përputhje me vendimin nr. 242, datë 29.04.2025, por procesi i detajimit të funksionimit të tyre vazhdon. Megjithatë, do të organizohen takime periodike me njësitë ekzistuese, duke synuar të paktën dy takime në vit, për të mbështetur shkëmbimin e përvojave dhe konsolidimin e praktikave të standardizuara në të gjithë sistemin gjyqësor.

Ky proces garanton që çdo këshilltar ligjor dhe ndihmës ligjor të trajnohet 100% çdo vit, duke përmbushur objektivat e planifikuara të zhvillimit profesional dhe të rritjes së cilësisë së shërbimit në njësitë ligjore.

Objektivi 4.3 - Forcimi i kapaciteteve të gjyqësorit nëpërmjet vlerësimit të stafit mbështetës jogjyqtar

Objektivi synon forcimin e mekanizmave të vlerësimit të performancës së nëpunësve civilë gjyqësorë, në përputhje me vendimin nr. 205, datë 10.04.2025 të Këshillit të Lartë Gjyqësor "Mbi miratimin e rregullores për vlerësimin e veprimtarisë së nëpunësve civilë gjyqësorë". Sipas kësaj rregulloreje, veprimtaria e nëpunësve civilë gjyqësorë vlerësohet periodikisht çdo vit, duke filluar nga data e ushtrimit të detyrës në vendin përkatës. Rregullorja përcakton gjithashtu organet kompetente për vlerësim: kancelarët vlerësohen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, ndërsa nëpunësit e tjerë civilë gjyqësorë nga Këshilli i Gjykatës.

Në zbatim të këtij objektivi, Këshillat e gjykatave kanë nisur procesin e vlerësimit dhe kanë përcjellë pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor 19 vendime për vlerësimin e nëpunësve civilë gjyqësorë. Për kancelarët, vlerësimi nga KLGJ-ja do të kryhet pas konfirmimit përfundimtar në detyrë. Procesi i vlerësimit ka për qëllim të përfshijë të paktën 19 këshilltarë ligjorë, 38 ndihmës ligjorë dhe 17 kancelarë çdo vit, duke garantuar një monitorim të plotë të performancës së stafit.

Ky proces i integruar i vlerësimit siguron jo vetëm transparencë dhe llogaridhënie, por edhe përmirësim të vazhdueshëm të kapaciteteve profesionale dhe efikasitetit të administratës gjyqësore.

Objektivi 4.4 - Rritja e kapaciteteve drejtuese/menaxhuese të gjyqtarëve

Objektivi fokusohet në zhvillimin e trajnimeve mbi aftësitë menaxheriale të kryetarëve të gjykatave, me qëllim përshtatjen e rolit të tyre me Opinionin e Këshillit Konsultativ të Gjyqtarëve Evropianë (KKGJE) dhe udhëzimet e CEPEJ-it mbi menaxhimin e gjykatave. Ky proces, i planifikuar për të vazhduar gjatë vitit 2026, është paraprirë nga miratimi i rregullave për zgjedhjen e kryetarëve të gjykatave. Në zbatim të këtij objektivi dhe të detyrimit ligjor të parashikuar në ligjin nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", Këshilli i Lartë Gjyqësor, me vendimin nr. 779, datë 31.10.2025, ka miratuar rregullat për kriteret dhe procedurën e emërimit në pozicionin e kryetarit të gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë. Ky vendim ka hyrë në fuqi në janar 2026.

SYNIMI 5: Përmirësimi i infrastrukturës gjyqësore për të përmbushur standardet bashkëkohore

Objektivi 5.1 - Monitorimi i përshtatshmërisë së infrastrukturës gjyqësore pas zbatimit të Hartës së Re Gjyqësore, përmes bashkëpunimit me Ministrinë e Drejtësisë

Në kuadër të këtij objektivi parashikohet për periudhën 2025-2026 përgatitja e një studimi mbi nevojat infrastrukturore të gjyqësorit, me synim sigurimin e hapësirës dhe kapaciteteve të përshtatshme në një periudhë afatgjatë, në përputhje me standardet e CEPEJ-it. Në këtë drejtim, është përgatitur një dokument që evidenton nevojën emergjente për godinë të re për 13 gjykata, të cilat nuk kanë mundësi zgjerimi të ndërtesave ekzistuese. Dokumenti përfshin

gjithashtu një projeksion të investimeve të nevojshme për ndërtimin e këtyre godinave për periudhën 2026-2030, duke siguruar një planifikim strategjik të infrastrukturës gjyqësore sipas standardeve ndërkombëtare. Ky proces synon të garantojë planifikim të qëndrueshëm të hapësirave gjyqësore dhe përmirësimin e kushteve të punës për magjistratët dhe administratën gjyqësore.

Objektivi 5.2 - Përmirësimi i infrastrukturës gjyqësore

Objektivi parashikon hartimin e planeve të investimeve dhe përmirësimin e logjistikës gjyqësore, në përputhje me procesin e digjitalizimit të arkivave dhe përmirësimin e kushteve fizike të godinave të gjykatave. Me miratimin e buxhetit për vitin 2025, sipas ligjit nr. 115/2024, "Për buxhetin e vitit 2025", i ndryshuar, KLGJ[36] ka detajuar fondet për shpenzime kapitale dhe investime, duke alokuar një shumë prej 765,500 mijë lekësh. Realizimi i buxhetit për investime për vitin 2025 ka arritur 18.5%. Sa i përket përmirësimit të logjistikës, në muajin shtator 2025 janë blerë dhe rishpërndarë 31 automjete për nevojat e sistemit gjyqësor, duke arritur një përqindje zbatimi të planit prej 88.4%.

Procesi i digjitalizimit të arkivave, i parashikuar në objektivin 3.1, është përfunduar në të gjitha zyrat e shërbimit (ish-gjykatat) dhe në nëntë gjykata të tjera, duke digjitalizuar një volum prej 12,937,316 fletësh të skanuara dhe të arkivuara elektronikisht[37]. Të dhënat janë të aksesueshme për përdoruesit e gjykatave përmes platformës elektronike, duke garantuar efikasitet dhe transparencë në administrimin e dokumentacionit.

Në përmirësimin e infrastrukturës së godinave të gjykatave, rezulton si më poshtë:

Për Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm ka përfunduar hartimi i detyrës së projektit të zbatimit për ndërtimin e godinës së re. Pas miratimit të buxhetit të vitit 2026, KLGJ ka siguruar fonde për rikonstruksionin e ish-ndërtesës së "Degës së Tatimpaguesve të Mëdhenj", e cila përdoret përkohësisht nga gjykata deri në ndërtimin e objektit të ri. Gjithashtu, është realizuar kontrata me qira për strehimin e 23 ndihmësve ligjorë për një periudhë dyvjeçare (1 tetor 2025 – 1 tetor 2027), duke zgjidhur përkohësisht nevojën për hapësirë pune. Janë hartuar projektet e përforcimit strukturor dhe ndërtimit të ambientit shtesë, duke përfshirë ngritjen e kati shtesë dhe ndërtimin e soletës me konstruksion metalik.

Për Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për vitin 2025 janë akorduar fonde në shumën 13,000 mijë lekë për hartimin e projektit të zbatimit të shtesës anësore të godinës ekzistuese, projekt i cili është përfunduar në dhjetor 2025.

Për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë ka përfunduar hartimi i detyrës së projektit të zbatimit për ndërtimin e godinës së re. Në rastin e Gjykatës

[36] Me vendimin nr. 762, datë 27.12.2024.
[37] Përditësuar deri në muajin janar 2026.

Administrative të Apelit gjatë fazës së paraqitjes së kërkesave buxhetore nuk janë evidentuar kërkesa për përshtatjen e infrastrukturës, sipas masave të parashikuara në këtë objektiv.

Rezulton se buxheti i miratuar për vitin 2025 është 24% më i lartë krahasuar me vitin 2024 dhe përfaqëson 70% të buxhetit të kërkuar nga institucionet për shpenzime kapitale dhe korrente. Fondet buxhetore të miratuara për vitin 2026 për KLGJ, gjykatat dhe QTI-në janë gjithsej 6,827,009 mijë lekë, ndërsa kërkesat buxhetore ishin 9,307,728 mijë lekë, duke lënë një diferencë prej 2,480,719 mijë lekë. Raporti midis buxhetit të miratuar dhe atij të kërkuar është 73.34%.

SYNIMI 6: Përmirësimi i transparencës dhe aksesit në veprimtarinë e sistemit gjyqësor

Objektivi 6.1 "Rritja e transparencës dhe aksesit në veprimtarinë e sistemit gjyqësor"

Në kuadër të këtij objektivi është parashikuar miratimi dhe zbatimi i Planit të Komunikimit të Sistemit Gjyqësor për periudhën 2025-2027, në përputhje me udhëzuesin e CEPEJ-it mbi komunikimin me publikun dhe median.

Në vijim të këtij angazhimi, u ngrit grupi i punës për hartimin e Planit të komunikimit të sistemit gjyqësor 2025-2027,[38] i përbërë nga stafi administrativ i Këshillit dhe përfaqësues të projektit EU4Justice. Veprimtaria e tij u finalizua me miratimin nga mbledhja e KLGJ-së e Planit të Komunikimit për sistemin gjyqësor,[39] i cili është në fazat e para të implementimit të tij nga gjykatat.

Objektivi 6.2 - Përmirësimi i komunikimit dhe marrëdhënieve me publikun dhe me mediat për të siguruar një marrëdhënie *proactive*, transparente e informuese

Objektivi parashikon krijimin e një portali elektronik për regjistrimin e personave të autorizuar për marrjen e njoftimeve, në përputhje me parashikimet e nenit 133 të Kodit të Procedurës Civile, dhe të integruar me sistemin e ri të menaxhimit të çështjeve gjyqësore Juronix.

Në kuadër të zbatimit të këtij objektivi janë përfunduar fazat e inicimit dhe analizës paraprake të projektit, gjatë të cilave është evidentuar nevoja për krijimin e portalit elektronik për njoftimet dhe janë përcaktuar kërkesat kryesore funksionale dhe teknike për modulin përkatës, me qëllim planifikimin e implementimit në platformën e re. Në procesin e zhvillimit është parashikuar përdorimi i portaleve publike qeveritare të certifikuara, përfshirë platformën e-Albania, si dhe integrimi me platforma ekzistuese të zhvilluara me mbështetjen e Këshillit të Evropës, si platforma *E-Notification*, e cila aktualisht përdoret nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Ky integrim siguron autentikimin e

[38] Me urdhrin e Kryetarit nr. 143, datë 16.10.2025.
[39] Vendimi nr. 34, datë 30.01.2026.

përdoruesve, mbrojtjen e të dhënave dhe sigurinë e komunikimit elektronik, në përputhje me kuadrin ligjor dhe standardet ndërkombëtare të sigurisë së informacionit.

Për zbatimin e këtij moduli janë planifikuar dhe zhvilluar trajnime për stafin gjyqësor dhe nëpunësit civilë gjyqësorë, me qëllim përvetësimin e përdorimit të portalit dhe të funksionaliteteve të tij. Të paktën dy trajnime zhvillohen çdo vit, për të garantuar zotërimin e njohurive mbi përdorimin e modulit dhe përputhshmërinë me standardet ligjore dhe teknike.

Rezultatet e pritshme për këtë objektiv përfshijnë zhvillimin dhe hartimin e modulit, zbatimin e tij sipas nenit 133 të Kodit të Procedurës Civile, si dhe realizimin e trajnimeve periodike për përdoruesit e portalit. Ky modul synon të rrisë efikasitetin dhe sigurinë e njoftimeve gjyqësore, duke mundësuar një proces të standardizuar, transparent dhe të integruar me sistemin e menaxhimit të çështjeve gjyqësore.

SYNIMI 7: Rritja e bashkëpunimit me bashkëpunëtorët kryesorë të gjykatave

Objektivi 7.1 -Përmirësimi dhe institucionalizimi i bashkëpunimit të KLGJ me institucione apo organizata të ndryshme, brenda dhe jashtë vendit

Objektivi përcakton hartimin dhe miratimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione të tjera, si dhe organizimi i takimeve dhe negociatave për finalizimin e këtyre marrëveshjeve, me qëllim përmirësimin e funksionimit të sistemit gjyqësor dhe rritjen e efikasitetit të shërbimeve të ofruara nga gjykatat.

Në zbatim të këtij objektivi, është draftuar një marrëveshje bashkëpunimi midis Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Postës Shqiptare sh.a., e cila synon përmirësimin dhe rritjen e efiçencës së shërbimeve postare në të gjitha gjykatat në vend. Një tjetër marrëveshje është planifikuar me Dhomën Kombëtare të Ndërmjetësimit dhe Dhomën Kombëtare të Avokatisë, me qëllim lehtësimin dhe promovimin e zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjeve, në kuadër të objektivit 1.4 dhe veprimtarisë së grupit të punës[40] për hartimin e udhëzuesit për gjykatat mbi dërgimin e çështjeve për ndërmjetësim. Sa më sipër, pritet hartimi dhe miratimi i të paktën tre modele të bashkëpunimit, të cilat do të mundësojnë standardizimin e praktikave dhe unifikimin e procedurave ndërinstitucionale, të cilat do të nënshkruhen në ceremoni zyrtare.

Objektivi 7.2 - Forcimi i bashkëpunimit me organet kolegjiale të gjykatave

Objektivi parashikon forcimin e bashkëpunimit mes Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe gjykatave përmes organizimit të takimeve periodike me lidershipin e gjykatave, si dhe

[40] Ngritur me urdhrin e Kryetarit nr. 175, datë 05.12.2025.

mbledhjeve të përgjithshme të gjyqtarëve, me qëllim përmirësimin e efikasitetit, transparencës dhe sigurisë në gjykata.

Në zbatim të këtij objektivi, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka miratuar me vendimin nr. 868, datë 23.12.2025, aktin nënligjor për themelimin dhe funksionimin e mbledhjes së kryetarëve të gjykatave, duke siguruar kështu bazën formale për organizimin e takimeve periodike të lidershipit të gjykatave. Më datë 13 shkurt 2026 në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor u mbajt mbledhja e parë me kryetarët e gjykatave. Në këtë forum u diskutuan çështje në lidhje me përmirësimin e infrastrukturës së gjykatave dhe forcimin e kapaciteteve administrative, në funksion të garantimit të një shërbimi gjyqësor më cilësor dhe efikas.

Objektivi 7.3 - Përmirësimi dhe institucionalizimi i bashkëpunimit të KLGJ-së dhe gjykatave me Dhomën Kombëtare të Avokatisë

Objektivi parashikon hartimin e një raporti vlerësimi për identifikimin e mangësive që mund të ndikojnë në efikasitetin e gjykimit të çështjeve, si dhe evidentimin e fushave për përmirësimin e marrëdhënieve ndërmjet gjykatave dhe avokatëve. Ky proces zhvillohet në përputhje me praktikat e mira të CEPEJ-it për cilësinë e debatit gjyqësor dhe rritjen e dialogut me Dhomën Kombëtare të Avokatisë, me qëllim evitimin e problematikave që mund të ndikojnë në zvarritjen e çështjeve dhe përmirësimin e kohës së përgjigjes së pretendimeve me shkrim të avokatëve.

Në kuadër të zbatimit të këtij objektivi, Këshilli i Lartë Gjyqësor i është drejtuar zyrtarisht Dhomës Kombëtare të Avokatisë dhe të gjitha gjykatave, duke kërkuar adresimin e çdo problematike të konstatuar në këtë drejtim, me synimin e marrjes së masave të mëtejshme për rritjen e efikasitetit të sistemit gjyqësor. Dhoma Kombëtare e Avokatisë ka shprehur gatishmërinë për bashkëpunim dhe konkretizimin e masave të përcaktuara në Udhërrëfyes. Ndërsa, Këshilli mbetet në pritje të informacionit të përcjellë nga të gjitha gjykatat, i cili do të evidentojë faktorët që ndikojnë në vonesat e çështjeve dhe do të mundësojë forcimin e bashkëpunimit ndërmjet gjyqtarëve dhe avokatëve.

Objektivi 7.4 - Përmirësimi dhe institucionalizimi i bashkëpunimit të KLGJ-së dhe gjykatave me prokuroritë

Ky objektiv parashikon hartimin e një raporti vlerësimi mbi fushat për përmirësim, i cili pritet të miratohet nga mbledhja plenare e Këshillit. Ky raport lejon evidentimin e fushave ku mund të përmirësohen marrëdhëniet ndërmjet gjykatave dhe prokurorive, si dhe identifikimin e mangësive që mund të ndikojnë në efikasitetin e gjykimit të çështjeve.

Në zbatim të këtij objektivi, Këshilli i Lartë Gjyqësor i është drejtuar zyrtarisht Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Prokurorisë së Përgjithshme dhe të gjitha gjykatave, duke kërkuar vlerësimin e tyre mbi mangësitë dhe fushat për përmirësim në marrëdhëniet mes gjykatave

dhe prokurorive. Në përgjigje të kësaj kërkese, Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka shprehur mbështetjen dhe gatishmërinë për të kontribuar në përmbushjen e objektivave të Udhërrëfyesit për Efikasitetin, ndërsa mbetemi në pritje të përgjigjes së Prokurorisë së Përgjithshme dhe të informacionit të kërkuar nga të gjitha gjykatat, i cili do të evidentojë faktorët që ndikojnë në efikasitetin e gjykimit dhe forcimin e bashkëpunimit mes prokurorëve dhe gjyqtarëve.

Ky objektiv synon gjithashtu uljen me 50% të seancave gjyqësore të shtyra për shkak të mungesës së prokurorëve, si dhe zhvillimin e të paktën dy forumeve me Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe dy seminareve ose trajnimeve të përbashkëta me gjyqtarë dhe prokurorë çdo vit, duke forcuar bashkëpunimin dhe koordinimin ndërinstitucional.

SYNIMI 8: Rritja e besimit të publikut

Objektivi 8.1 -Informimi i publikut për masat e marra

Përmes këtij objektivi synohet garantimi e informimi i publikut mbi të gjitha angazhimet dhe objektivat e parashikuara në kuadër të Udhërrëfyesit për Efikasitetin. Për këtë qëllim, Udhërrëfyesi për Efikasitetin e Pushtetit Gjyqësor në Shqipëri 2025-2027 është publikuar në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe në portalin "gjykata.gov.al".

Objektivi 8.2 - Përmirësimi i transparencës dhe llogaridhënies duke publikuar rezultatet e arritura

Objektivi parashikon, ndër të tjera, detyrimin për raportimin mbi zbatimin e Udhërrëfyesit për Efikasitetin. Në zbatim të këtij objektivi janë ndërmarrë hapa konkretë për hartimin e formatit të raportimit, me synim rritjen e efiçencës dhe uljen e *backlog*-ut, duke shënuar një progres të dukshëm të aktivitetit. Projekti i modelit standard të monitorimit i është përcjellë grupit të punës për vlerësim dhe opinione, ndërsa mbetet për t'u finalizuar miratimi i formatit standard të hartuar. Sipas objektivave, pas miratimit të formatit do të publikohet katër herë në vit raportimi tremujor në faqen zyrtare të KLGJ-së, si dhe do të publikohen dy raporte vjetore mbi zbatimin e Udhërrëfyesit.

Objektivi 8.3 - Përmirësimi i shërbimeve ndaj publikut

Këshilli i Lartë Gjyqësor ka ndërmarrë një sërë veprimesh konkrete për vlerësimin e mënyrës se si gjykatat ofrojnë shërbimet e tyre për qytetarët. Në këtë kuadër, janë zhvilluar vizita *onsite* në gjykatat e të gjitha niveleve, me qëllim vëzhgimin nga afër të funksionimit të sporteleve të shërbimit, komunikimit me publikun, aksesit të qytetarëve në informacion dhe procedurat që ndiqen për ofrimin e shërbimeve gjyqësore. Këto vizita kanë shërbyer për evidentimin e praktikave pozitive, si dhe për identifikimin e problematikave dhe nevojave për përmirësim në nivel institucional.

Paralelisht me këtë proces vlerësimi në terren, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka ndërmarrë nisma në drejtim të digjitalizimit dhe modernizimit të shërbimeve gjyqësore, nëpërmjet zhvillimit të sistemit të ri të menaxhimit të çështjeve gjyqësore. Ky sistem synon të garantojë një nivel më të lartë transparence, rritjen e efikasitetit në trajtimin e çështjeve dhe lehtësimin e aksesit të qytetarëve në shërbimet gjyqësore përmes përdorimit të teknologjisë së informacionit.

Në këtë kontekst, për një periudhë dy mujore, në portalin publik "gjykata.gov.al" është publikuar një pyetësor i dedikuar për qytetarët, me qëllim mbledhjen e mendimeve dhe sugjerimeve të tyre mbi përdorimin e portalit të gjykatave dhe shërbimeve digjitale të ofruara nga sistemi gjyqësor. Pyetësori ka pasur në fokus identifikimin e nevojave konkrete të përdoruesve, vështirësitë e hasura gjatë aksesimit të shërbimeve *online*, si dhe propozimet për përmirësimin e mëtejshëm të funksionaliteteve digjitale.

Njëkohësisht, është hartuar edhe një pyetësor i veçantë për stafin e gjykatave, i cili ka synuar të evidentojë mënyrën se si zhvillohen aktualisht proceset e punës në institucionet gjyqësore, qoftë në formë elektronike apo manuale. Përmes këtij instrumenti është synuar të mblidhen vlerësime lidhur me efikasitetin e procedurave ekzistuese, sfidat e përditshme të hasura nga punonjësit, si dhe nevojat për ndërhyrje në drejtim të automatizimit, standardizimit dhe digjitalizimit të mëtejshëm të proceseve.

Të dy pyetësorët janë plotësuar dhe përpunuar në mënyrë elektronike nga stafi pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, duke siguruar analizimin e tyre për qëllime planifikimi dhe hartimi të masave konkrete për përmirësimin e shërbimeve gjyqësore në të ardhmen.

Arritjet, sfidat dhe angazhime:

Gjatë periudhës raportuese, prioritet i veçantë i është kushtuar masave dhe aktiviteteve të planifikuara për t'u realizuar brenda vitit 2025, nga zbatimi i të cilave rezultojnë arritje konkrete në disa drejtime kyçe të funksionimit të sistemit gjyqësor. Në këtë kuadër, është realizuar miratimi i një sërë aktesh nënligjore dhe rregullatore, në përputhje me parashikimet e objektivave të Udhërrëfyesit, si dhe ka vijuar zbatimi i tyre në praktikë. Paralelisht, ka vazhduar procesi i plotësimit të vakancave në sistemin gjyqësor, si me gjyqtarë ashtu edhe me staf mbështetës jo gjyqtar, me qëllim forcimin e kapaciteteve njerëzore të gjykatave. Këshilli ka ndjekur në mënyrë periodike raportimin e gjykatave lidhur me masat e ndërmarra për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura, duke monitoruar progresin dhe nevojat për ndërhyrje të mëtejshme.

Një tjetër drejtim prioritar ka qenë vijimi i punës për implementimin e sistemit të ri të integruar të menaxhimit të çështjeve gjyqësore, si dhe avancimi me ritme të përshpejtuara i procesit të digjitalizimit të vendimeve gjyqësore, në përputhje të plotë me objektivat e planifikuara. Gjithashtu, janë ndërmarrë masa konkrete për përmirësimin e infrastrukturës gjyqësore, si dhe iniciativa për ndryshime ligjore dhe hartimin e akteve nënligjore që

synojnë rritjen e efikasitetit të sistemit gjyqësor, përmes ngritjes së grupeve të posaçme dhe ndërinstitucionale të punës. Në të njëjtën kohë, është intensifikuar bashkëpunimi me aktorë të ndryshëm të sistemit të drejtësisë dhe partnerë institucionalë.

Ndërkohë, disa masa dhe aktivitete të parashikuara për t'u realizuar brenda vitit 2025 nuk kanë nisur ende zbatimin brenda afatit të planifikuar. Këto lidhen, ndër të tjera, me kryerjen e vlerësimit të strukturës aktuale të Këshillit të Lartë Gjyqësor për analizimin e nevojave për burime njerëzore në mbështetje të Komisioneve të Përhershme dhe procesit të ngritjes në detyrë, miratimin e indikatorit bazë lidhur me kohën e shqyrtimit të çështjeve (DT) për reduktimin e çështjeve të prapambetura, forcimin e kapaciteteve të Qendrës së Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë përmes plotësimit të organigramës dhe hartimit të një plani strategjik për zbatimin e sistemit të teknologjisë së informacionit, si dhe vlerësimin e ngarkesës së punës së ndihmësve ligjorë nga gjykatat, sipas rregullores përkatëse.

Për periudhën në vijim, duke filluar nga viti 2026, fokusi i Këshillit të Lartë Gjyqësor do të orientohet drejt përmbushjes së një sërë masash thelbësore që synojnë konsolidimin e reformave të ndërmarra. Këto përfshijnë vendosjen *online* të sistemit të gjurmimit të procesit të ngritjes në detyrë dhe lëvizjes paralele, me qëllim rritjen e transparencës, krijimin e njësisë mbështetëse të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, përfundimin e veprimtarisë së grupeve të punës për hartimin e akteve nënligjore dhe rregullatore dhe miratimin e tyre nga Këshilli, si dhe finalizimin e veprimtarisë së grupit ndërinstitucional për hartimin e paketës së propozimeve për ndryshime ligjore dhe përcjelljen e tyre pranë Kuvendit.

Po ashtu, do të vijojë prezantimi dhe shpërndarja pranë gjykatave e udhëzimeve të CEPEJ-it dhe SATURN-it, si dhe zbatimi i masave për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura, përmes finalizimit të inventarit të *backlog*-ut, hartimit të planeve individuale gjithëpërfshirëse të veprimit për gjykatat e shkallës së parë dhe aplikimit të masave të menaxhimit aktiv të çështjeve. Parashikohet gjithashtu hartimi i një kuadri nënligjor për zhvillimin e seancave gjyqësore në distancë, pilotimi i shkëmbimit elektronik të akteve dhe përgatitja e udhëzuesve dhe mjeteve teknike për funksionimin e sistemit të ri të menaxhimit të çështjeve.

Në këtë kontekst, do të vijojë forcimi i kapaciteteve të njësisë së trajnimit për nëpunësit civilë gjyqësorë dhe zhvillimi i trajnimeve të specializuara në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës. Gjithashtu, parashikohet përgatitja e studimeve të fizibilitetit për sigurimin e infrastrukturës ndërtimore, përshtatja e ambienteve për gjykatat administrative, zbatimi i Planit të Ri të Komunikimit të Gjykatave 2025–2027, hartimi dhe nënshkrimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit ndërinstitucional, si dhe finalizimi i raporteve të vlerësimit mbi marrëdhëniet e gjykatave me avokatët dhe prokurorët. Në vijimësi do të zhvillohen edhe vrojtime për vlerësimin e shërbimeve të gjykatave nga përdoruesit e tyre.

Në përfundim, Këshilli i Lartë Gjyqësor ndodhet në fazat fillestare të konkretizimit të objektivave të parashikuara në Udhërrëfyesin për Efikasitetin, i cili përbën një dokument ambicioz dhe gjithëpërfshirës. Zbatimi i tij kërkon një angazhim të vazhdueshëm dhe të koordinuar jo vetëm nga vetë Këshilli, por edhe nga gjykatat, gjyqtarët, administrata gjyqësore dhe institucionet e tjera partnere, nëpërmjet një bashkëpunimi të ngushtë dhe të qëndrueshëm.

4. MENAXHIMI DHE ZHVILLIMI I BURIMEVE NJERËZORE

Menaxhimi dhe zhvillimi i burimeve njerëzore për institucionin e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe për sistemin gjyqësor është në përputhje me objektivat, strategjinë dhe zbatimin e politikave të Këshillit, me synimin për të krijuar një mjedis pune të përshtatshëm dhe motivues, i cili i shërben rritjes profesionale të punonjësve dhe përmirësimit të vazhdueshëm të proceseve administrative të institucionit, si garanci e mirëqeverisjes së sistemit gjyqësor.

Në funksion të arritjes së objektivave strategjikë të përcaktuar në strategjinë dyvjeçare të Këshillit të Lartë Gjyqësor, gjatë periudhës 1 janar-31 dhjetor 2025, administrimi i kapaciteteve njerëzore është orientuar në drejtim të rritjes profesionale të stafit, forcimit dhe ruajtjes së një mjedisi pune motivues dhe llogaridhënës, si për punonjësit e sferës së shërbimit civil ashtu edhe për punonjësit e shërbimeve administrative.

Ndjekja e politikave dinamike të punësimit, menaxhimit dhe motivimit të stafit administrativ, për një organizim strukturor profesional dhe fleksibël, mbeten në vijimësi prioritet i Këshillit të Lartë Gjyqësor. Racionalizimi i strukturës organizative dhe përmirësimi i efektivitetit të institucionit, në linjë me objektivat strategjikë të tij dhe kuadrin rregullator përkatës, janë qëllimi kryesor i këtyre politikave.

4.1 Burimet njerëzore të Këshillit të Lartë Gjyqësor

Menaxhimi dhe administrimi i duhur i burimeve njerëzore kërkon përshtatjen e infrastrukturës rregullatore të institucionit dhe të shërbimit civil me standardet më të mira, duke krijuar në vazhdimësi mundësi motivimi për punonjësit me eksperiencë profesionale, si dhe duke synuar gjithmonë motivimin e punonjësve dhe rritjen e efektivitetit në punë. Përmes politikave për rritjen e motivimit profesional, është synuar ruajtja e qëndrueshmërisë dhe vazhdimësisë së stafit, e cilësuar si një ndër sfidat kryesore me të cilat përballet sot administrata publike në vendin tonë.

Struktura organizative e Këshillit të Lartë Gjyqësor, e miratuar me vendimin nr. 12, datë 18.01.2019, të KLGJ-së, i ndryshuar, përbëhet nga 162 punonjës nga të cilët 11 janë anëtarët e Këshillit. Në nivel funksional ajo përbëhet nga katër njësi kryesore dhe disa njësi të tjera më të vogla, të cilat mbështesin veprimtarinë dhe funksionet kryesore të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si një organ qendror qeverisës i sistemit gjyqësor. Aktualisht, organika faktike e

KLGJ-së, ka një përbërje prej 109 punonjësish në total. Raporti i femrave ndaj meshkujve në totalin e punonjësve aktual është: femra 58 ose 53.2% dhe meshkuj 51 ose 46.8%.

Sa i përket nivelit të lartë drejtues, aktualisht janë 3 nëpunës në funksion (sekretar i përgjithshëm/drejtor departamenti) dhe 14 nëpunës të nivelit të mesëm drejtues (5 drejtorë drejtorie dhe 9 këshilltarë të komisioneve). Raporti gjinor rezulton se 8 ose 47.05% e nëpunësve të nivelit të lartë dhe të mesëm drejtues janë të gjinisë femërore, si dhe 9 ose 52.94% janë meshkuj. Përqindja e nëpunësve të nivelit të lartë dhe të mesëm drejtues të gjinisë femërore, krahasuar me vitin paraardhës, është ulur me rreth 10.95%.

Menaxhimi i burimeve njerëzore

Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Trajnimeve, si njësi përgjegjëse për burimet njerëzore, në zbatim të ligjit nr.152/2013 "Për nëpunësin civil", si dhe akteve të tjera nënligjore në zbatim të tij mbi proceset e rekrutimit, është angazhuar në zhvillimin e procedurave të rekrutimit për plotësimin e pozicioneve vakante të institucionit, pjesë e shërbimit civil.

Gjatë periudhës 1 janar-31 dhjetor 2025, kanë përfunduar 24 procedura rekrutimi për 25 pozicione vakante, ndër të cilat 21 prej tyre kanë përfunduar me sukses, si më poshtë:

- 1 pozicion i nivelit të mesëm drejtues;
- 9 pozicione të nivelit të ulët drejtues;
- 11 pozicione të nivelit ekzekutiv.

Mbi zhvillimin profesional të stafit administrativ në KLGJ

Një aspekt i rëndësishëm i politikave të menaxhimit të burimeve njerëzore është edhe identifikimi i kapaciteteve profesionale dhe ndërpersonale, si dhe përdorimi i tyre në funksion të zhvillimit të stafit, i cili është bërë i mundur nëpërmjet realizimit të trajnimeve të ndryshme profesionale dhe takimeve periodike nga stafet respektive të drejtorive.

Gjatë periudhës 1 janar – 31 dhjetor 2025, 5 punonjës të KLGJ-së janë trajnuar pranë Shkollës së Administratës Publike, pas identifikimit të nevojave për trajnim. Gjithashtu, gjatë vitit raportues punonjësit kanë marrë pjesë edhe në trajnime të zhvilluara nga aktorë të tjerë; më konkretisht, 61 punonjës janë trajnuar nga KLGJ-ja në fushën e teknologjisë së informacionit dhe 4 punonjës janë trajnuar nga partnerët ndërkombëtarë.

Vlerësimi i rezultateve në punë në Këshillin e Lartë Gjyqësor

Gjatë periudhës 1 janar-31 dhjetor 2025, sikundër edhe në atë pararendës, në KLGJ janë realizuar të gjitha vlerësimet e rezultateve në punë për stafin administrativ, pjesë e shërbimit civil të KLGJ-së. Përkatësisht për aktivitetin e 6-mujorit të parë të vitit 2025, vlerësimet janë kryer në 15-ditorin e parë të muajit pasardhës.

Procesi i vlerësimit është realizuar në zbatim të VKM-së nr. 109, datë 26.02.2014 "Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë", i mbikëqyrur nga njësia përgjegjëse për burimet njerëzore. Ky proces është zhvilluar në konsultim të pandërprerë me të gjithë nëpunësit raportues, në përputhje me strukturën organizative të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

4.2 Burimet njerëzore në gjykatat e të tre nivele

Mbështetur në ligjin nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, Këshilli i Lartë Gjyqësor është përgjegjës për mirëmenaxhimin e burimeve njerëzore (magjistratë/gjyqtarë, administratë civile gjyqësore dhe punonjës të tjerë gjyqësor) në gjykatat e të gjitha niveleve.

Numri i magjistratëve (gjyqtarëve), gjatë periudhës 1 janar-31 dhjetor 2025, pasqyrohet në tabelën e mëposhtme:

		1 Janar 2025			*31 dhjetor 2025*		
Nr.	***Gjykata***	***Struktura organizative***	***Organika në fakt***	***Efektivisht në detyrë***	***Struktura organizative***	***Organika në fakt***	***Efektivisht në detyrë***
1	Gjykata e Lartë	19	18	17	19	17	15
2	Gj.Apelit Juridik.i Përgjithshëm	78	31	28	78	36	40
3	Gj.Posaçme e Apelit K.K.O	11	10	10	11	10	10
4	Gj.Shkalla e Parë e Juridik.të Përgj. Berat	8	8	6	8	10	7
5	Gj.Shkalla e Parë e Juridik.të Përgj. Dibër	7	9	7	7	7	7
6	Gj.Shkalla e Parë e Juridik.të Përgj. Durrës	23	14	16	23	16	14
7	Gj.Shkalla e Parë e Juridik.të Përgj. Elbasan	18	18	13	18	22	16
8	Gj.Shkalla e Parë e Juridik.të Përgj. Fier	21	23	17	21	25	15
9	Gj.Shkalla e Parë e Juridik.të Përgj.Gjirokastër	7	9	4	7	9	7
10	Gj.Shkalla e Parë e Juridik.të Përgj. Korçë	15	18	11	15	14	11
11	Gj.Shkalla e Parë e Juridik.të Përgj. Kukës	7	8	7	7	8	7
12	Gj.Shkalla e Parë e Juridik.të Përgj. Lezhë	11	11	9	11	12	9
13	Gj.Shkalla e Parë e Juridik.të Përgj. Sarandë	7	10	6	7	9	6
14	Gj.Shkalla e Parë e Juridik.të Përgj. Shkodër	15	17	10	15	15	13
15	Gj.Shkalla e Parë e Juridik.të Përgj.Tiranë	80	62	55	80	63	56
16	Gj.Shkalla e Parë e Juridik.të Përgj.Vlorë	16	18	12	16	15	14
17	Gj.Posaçme Shkalla e Parë K.K.O	16	11	11	16	10	14
18	Gj.Apelit Adminstrativ	13	7	13	22	11	15
19	Gj.Adm. Shkalla e Parë Lushnjë	9	10	7	9	10	9
20	Gj.Adm. Shkalla e Parë Tiranë	27	21	13	27	25	21
	Totali	**408**	**333**	**272**	**417**	**344**	**306**

Gjatë vitit referues kanë ushtruar efektivisht funksionin e gjyqtarit në gjykatat e të gjitha niveleve gjithsej 306 gjyqtarë, në të njëjtën periudhë kohore. Kjo nënkupton se sistemi gjyqësor gjatë vitit 2025 ka funksionuar me pothuajse 73.38% të kapacitetit të tij.

Gjatë vitit 2025 janë emëruar dhe caktuar në pozicion 42 magjistratë, të cilët kanë përfunduar programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës në vitin akademik 2022–2025. Referuar të dhënave statistikore, numri i magjistratëve të emëruar në sistem nga viti 2019 deri në vitin 2025 është 186 magjistratë, nga të cilët 4 janë gjyqtarë në Gjykatën e Lartë nga radhët e juristëve të spikatur dhe 182 janë magjistratë të diplomuar nga Shkolla e Magjistraturës.

Sa i përket humbjeve nga sistemi si pasojë e procesit të rivlerësimit kalimtar, vlen të theksohet se nga 27 vendimmarrje të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, gjatë 2025, 21 vendime janë marrë në disfavor të magjistratëve, duke i larguar nga sistemi gjyqësor.

Rezulton se që nga fillimi i procesit të rivlerësimit kalimtar, me vendim të organeve të rivlerësimit kalimtar (KPK-së apo KPA-së) janë shkarkuar nga detyra në **total 144 gjyqtarë (magjistratë).**

Ndërkohë, më 31 dhjetor 2025, rezultojnë 4 gjyqtarë (magjistratë) të shkarkuar nga detyra me vendimmarrje të KPK-së, të cilët do të presin zhvillimin e procesit në KPA përgjatë vitit 2026, si dhe 2 gjyqtarë (magjistratë) të pezulluar/ shkarkuar me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor, duke mbajtur ndërkohë statusin e gjyqtarit për shkak të pezullimit.

Rezulton se numri i vakancave në sistem për magjistratët (gjyqtarë) është 111 vakanca, nga të cilat 73 të përhershme[41] dhe 38 vakanca të përkohshme.[42]

Nëse marrim në shqyrtim një ndër treguesit e menaxhimit të burimeve njerëzore që përdoret nga Komisioni Evropian për Efiçencën në Drejtësi (në vijim CEPEJ), dhe konkretisht *numrin e gjyqtarëve në raport me popullsinë*, sikurse paraqitet në tabelën së mëposhtme:

Nr	***Raporti numër gjyqtarësh / 100 mijë banorë, sipas strukturës organizative (dekreti)***	***Raporti numër gjyqtarësh / 100 mijë banorë, sipas organikës në fakt***	***Raporti numër gjyqtarësh / 100 mijë banorë, sipas organikës efektive në fakt***	***Mesatarja europiane, sipas CEPEJ-it***
1	17.35 gjyqtar/100 mijë	14.32 gjyqtar/100 mijë	12,73 gjyqtar/100 mijë	21.9[43] gjyqtar/100 mijë

[41] Vakancë e përhershme është diferenca e strukturës organizative me organikën në fakt.
[42] Vakancë e përkohshme është diferenca e organikës në fakt me efektivitetin në detyrë.
[43] Mesatarja sipas CEPEJ 2024 me të dhënat e vitit 2022, rezulton 21.9 (fq.43).

Rezulton se mesatarja evropiane, sipas CEPEJ-it, është 21.9gjyqtar/100 mijë banorë,[44] ndërsa aktualisht në Republikën e Shqipërisë raporti, sipas strukturës organizative (dekreti), është 17.35 gjyqtar/100 mijë banorë, çka tregon se Shqipëria pozicionohet ende larg mesatares evropiane.

Ndërkaq, për sa i përket *raportit midis gjyqtarëve dhe administratës gjyqësore*, pra numri mesatar i punonjësve në mbështetje të punës së një gjyqtari, rezulton për sa pasqyruar në tabelën e mëposhtme:

Nr	***Raporti numër gjyqtarësh / staf administrativ sipas strukturës organizative (dekreti)***	***Raporti numër gjyqtarësh / staf administrativ, sipas organikës në fakt***	***Raporti numër gjyqtarësh / staf administrativ, sipas organikës efektive***	***Mesatarja evropiane, sipas CEPEJ-it***
1	3.13 gjyqtar/staf	3.5 gjyqtar/staf	3.9 gjyqtar/staf	4.12[45] gjyqtar/staf

Rezulton se mesatarja evropiane, sipas CEPEJ-it është 4.12gjyqtar/staf,[46] ndërsa aktualisht në Republikën e Shqipërisë raporti i numrit të gjyqtarëve ndaj stafit administrativ, sipas strukturës organizative (dekreti), është 3.13 gjyqtar/staf, çka tregon se Shqipëria pozicionohet ende larg mesatares evropiane.

Numri i stafit jogjyqtar për 100 mijë banorë për Shqipërinë për vitin 2025, sipas organikës në fakt, është ***50.16,*** kundrejt mesatares evropiane për vitin 2022 prej ***55.5***.[47] Këto të dhëna evidentojnë se, pavarësisht shtimit të burimeve njerëzore në administratën gjyqësore, numri i tyre në raport me numrin e popullsisë nuk është në përputhje me standardet e mesatares evropiane.

Numri i punonjësve (gjyqtarë, administratë gjyqësore) në gjykatat e të gjitha niveleve, gjatë periudhës 1 janar-31 dhjetor 2025:

Pasqyra
e numrit të punonjësve (gjyqtarë, administratë gjyqësore) në gjykatat e të gjitha niveleve, deri në 31 dhjetor 2025

[44] Mesatarja sipas CEPEJ 2024 me të dhënat e vitit 2022, rezulton 21.9 (fq.43).
[45] Referuar raportit të CEPEJ-it viti 2024 me të dhënat e vitit 2022 rezulton 4.12, (Fq.51).
[46] Referuar raportit të CEPEJ-it viti 2024 me të dhënat e vitit 2022 rezulton 4.12, (Fq.51).
[47] https://public.tableau.com/app/profile/cepej/viz/OverviewEN/Overview. (Referuar CEPEJ 2024, me të dhënat e vitit 2022, kjo e dhënë nuk është e pasqyruar).

	Totali		Gjyqtarë në total			Administrata Gjyqësore		
Gjykata	***Str. Organizative***	***Organika në fakt***	***Dekreti***	***Organika në fakt***	***Vakancat***	***Str. Organizative***	***Organika në fakt***	***Vakanca***
Gjykata e Lartë	151	132	19	17	2	132	115	17
Gj.Ap. Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë	245	190	78	36	42	167	154	13
Gjykata e Posaçme A.K.K.O	55	39	11	10	1	44	29	15
Gj.Shkallë e Parë Juridiksioni Përgj. Berat	38	36	8	10	+2	30	26	4
Gj.Shkallë e Parë Juridiksioni Përgj Dibër	38	36	7	7	0	31	29	2
Gj.Shkallë e Parë Juridiksioni Përgj. Durrës	83	75	23	16	7	60	59	1
Gj.Shkallë e Parë Juridiksioni Përgj Elbasan	61	62	18	22	+4	43	40	3
Gj.Shkallë e Parë Juridiksioni Përgj Fier	76	76	21	25	+4	55	51	4
Gj.Shkallë e Parë Juridiksioni Përgj Gjirokastër	42	41	7	9	+2	35	32	3
Gj.Shkallë e Parë Juridiksioni Përgj.Korçë	63	59	15	14	1	48	45	3
Gj.Shkallë e Parë Juridiksioni Përgj. Kukës	37	38	7	8	+1	30	30	0
Gj.Shkallë e Parë Juridiksioni Përgj Lezhë	49	45	11	12	+1	38	33	5
Gj.Shkallë e Parë Juridiksioni Përgj Sarandë	31	32	7	9	+2	24	23	1
Gj.Shkallë e Parë Juridiksioni Përgjj Shkodër	79	77	15	15	0	64	62	2
Gj.Shkallë e Parë Juridiksioni Përgj Tiranë	281	255	80	63	17	201	192	9
Gj.Shkallë e Parë Juridiksioni Përgj.Vlorë.	73	72	16	15	1	57	57	0
Gjykata e Posaçme Shk.I.K.K.O	80	67	16	10	6	64	57	7
Gjykata Adm.Ap Tiranë	90	74	22	11	11	68	63	5
Gjykata Adm. Shk.I Lushnje	48	46	9	10	+1	39	36	3
Gjykata Adm. Shk.I Tiranë	104	97	27	25	2	77	72	5
Totali	**1724**	**1549**	**417**	**344**	**73**	**1307**	**1205**	**102**

Sikurse evidentohet në pasqyrën e mësipërme, numri i punonjësve në total, sipas strukturës organizative të gjykatave të të gjitha niveleve, është 1724 punonjës, nga të cilët 417 magjistratë (gjyqtarë) dhe 1307 administratë gjyqësore (nëpunës civilë gjyqësorë dhe punonjës të tjerë gjyqësorë).

Mbi zhvillimin profesional të magjistratëve (gjyqtarë) dhe stafit administrativ gjyqësor në gjykata.

Gjatë vitit 2025, 302 gjyqtarë efektivisht në detyrë kanë marrë pjesë në trajnimet e programit të formimit vazhdues, të zhvilluara nga Shkolla e Magjistraturës. Gjithashtu, rezultojnë edhe

2 magjistratë (gjyqtarë) të trajnuar në kuadër të trajnimeve të ofruara nga ERA - Academy of European Law, për Shkollën e Magjistraturës, si dhe 1 magjistrat (gjyqtar) pjesëmarrës në trajnimet e ofruara nga KLGJ-ja në fushën e teknologjisë së informacionit.

Ndërsa, për nëpunësit civilë gjyqësorë në gjykatat e të gjitha niveleve, duhet përmendur se janë zhvilluar trajnime nga një gamë e larmishme aktorësh për **396** nëpunës civilë gjyqësorë në total, si më poshtë:

- **56** nëpunës civilë gjyqësorë të trajnuar nga ASPA;
- **74** nëpunës civilë gjyqësorë të trajnuar nga Shkolla e Magjistraturës;
  - 18 kancelarë në detyrë, të cilët kanë marrë pjesë në trajnimet e programit të formimit vazhdues të zhvilluara nga Shkolla e Magjistraturës;
  - 16 këshilltarë ligjorë, të cilët kanë marrë pjesë në trajnimet e programit të formimit vazhdues të zhvilluara nga Shkolla e Magjistraturës;
  - 36 ndihmës ligjorë, të cilët kanë marrë pjesë në trajnimet e programit të formimit vazhdues të zhvilluara nga Shkolla e Magjistraturës;
  - 4 nëpunës civilë gjyqësorë.
- **280** nëpunës civilë gjyqësorë të trajnuar nga KLGJ-ja;
- **28** nëpunës civilë gjyqësorë të trajnuar nga partnerët ndërkombëtarë;
- **38** nëpunës civilë gjyqësorë të cilët kanë marrë pjesë në trajnime të tjera.

5. VEPRIMTARIA BUXHETORE DHE FINANCIARE

Me ligjin nr. 115/2024 "Për buxhetin e vitit 2025", është miratuar buxheti i shtetit për vitin 2025, pjesë e të cilit është edhe buxheti për sistemin gjyqësor (grupi buxhetor Këshilli i Lartë Gjyqësor), i ndarë në tre programe buxhetore:

- Programi buxhetor 01110, **"Planifikim, Menaxhim dhe Administrim"**, ku përfshihen fondet buxhetore për funksionimin e veprimtarisë së Këshillit të Lartë Gjyqësor;
- Programi buxhetor 01140, **"Mbështetje për Teknologjinë e Sistemit të Drejtësisë"**, ku përfshihen kërkesat buxhetore për funksionimin e Qendrës së Teknologjisë së Informacionit (QTI);
- Programi buxhetor 03310, **"Buxheti Gjyqësor",** ku përfshihen fondet buxhetore për funksionimin e veprimtarisë së gjykatave në të tre nivelet.


Buxheti i miratuar për vitin 2025 për sistemin gjyqësor, i ndarë sipas programeve, paraqitet sipas pasqyrës së mëposhtme:

000 lekë

Kodi	Emërtimi	Shpenzime Paga	Shpenzime Sig. shoqërore	Shpenzime operative	Shpenzime tranf fam	Shpenzime kapitale	Totali fonde buxhetore
01110	Planifikim, Menaxhim, Administrim	343,600	37,171	73,150	1,500	15,000	**470,421**
01140	QTI	14,578	2,500	2976	24		**20,078**
03310	Buxheti Gjyqësor	3,397,060	500,600	909,900	6,400	855,500	**5,669,460**
29	Këshilli i Lartë Gjyqësor	**3,755,238**	**540,271**	**986,026**	**7,924**	**870,500**	**6,159,959**

Në buxhetin e miratuar peshën më të madhe, sipas programeve për sistemin gjyqësor e zënë fondet buxhetore për gjykatat e të tre niveleve në masën **92.04%,** më pas fondet buxhetore për KLGJ-në në masën rreth **7.64%** dhe peshën më të vogël fondet buxhetore për QTI-në në masën **0.33%.**

Grafikisht pesha specifike që zë buxheti i miratuar për secilin nga programet, paraqitet si më poshtë:



Fondet buxhetore të sistemit gjyqësor, të rishikuara, së bashku me realizimin tyre 12 mujor, sipas grup shpenzimeve, paraqiten në pasqyrën e mëposhtme:


Pasqyra

e buxhetit të miratuar, të rishikuar dhe realizuar për Sistemin Gjyqësor për vitin 2025

000 lekë

Nr.	Emërtimi	Buxheti i miratuar	Ndryshime gjatë vitit	Buxheti i rishikuar	Realizimi	Realizimi %
01	Shpenzime "Paga"	3,755,238	-600,000	3,155,238	3,121,108	99%
02	Shpenzime "Sig. Shoqërore"	540,271	-145,600	394,671	389,022	99%
03	Shp. "Mallra e shërbime të tjera"	986,026	-114,000	872,026	844,133	97%
04	Shp. "Trans për buxh. fam. & ind."	7,924	4,500	12,424	10,335	83%
05	Shpenzime kapitale	870,500	-121,879	748,621	367,207	49%
	Totali	**6,159,959**	**976,979**	**5,182,980**	**4,731,805**	**91%**

Në lidhje me strukturën sipas grup shpenzimeve të fondeve buxhetore për sistemin gjyqësor, vërehet se shpenzimet e personelit zënë peshën kryesore të buxhetit të miratuar, në masën **70%**, ndërsa shpenzimet kapitale (investime) janë, ende më të ulëta se nevojat reale që ka sistemi gjyqësor, në masën **36%** të kërkesave të paraqitura. Grafikisht pesha specifike që zë buxheti i miratuar për secilin nga grup shpenzimesh, paraqitet si më poshtë:



Gjatë vitit buxhetor 2025, buxheti i sistemit gjyqësor është rishikuar disa herë, duke u shtuar dhe pakësuar në shumën absolute prej -976,979 mijë lekë,[48] si më poshtë vijon:

- Akordimi i fondit të veçantë nga Ministria e Financave me Udhëzimin Plotësues nr. 2, datë 24.01.2025 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2025", dhe mbështetur në vendimin nr. 97, datë 19.02.2025 të KLGJ-së për detajimin e fondit të veçantë në shumën 4,500 mijë lekë, respektivisht në programin 01110 - "Planifikim, menaxhim dhe administrim" në shumën 1,200 mijë lekë, programin 01140 - "Mbështetje për Teknologjinë e Sistemit të Drejtësisë", në shumën 100 mijë lekë dhe në programin 03310 - "Buxheti Gjyqësor", në shumën 3,200 mijë lekë.
- Pakësim fondi me Aktin Normativ nr. 6, datë 11.06.2025 në shumën 105,000 mijë lekë në programin 03310 "Buxheti Gjyqësor", në shpenzime kapitale.
- Pakësim fondi me Aktin Normativ nr. 10, datë 08.10.2025 në shumën 360,000 mijë lekë të gjitha në shpenzime korrente nga të cilat, në programin 01110 "Planifikim, menaxhim dhe administrim" në shumën 100,000 mijë lekë dhe në programin 03310 "Buxheti Gjyqësor" në shumën 260,000 mijë lekë.
- Pakësim fondi me Aktin Normativ nr. 11, datë 19.12.2025 në shumën 516,479 mijë lekë nga të cilat, në programin 01110 "Planifikim, menaxhim dhe administrim" në shumën 35,600 mijë lekë (në shpenzime korrente 34,000 mijë lekë dhe në shpenzime

[48] Nga të cilat në shpenzime paga është pakësur në shumën 600,000 mijë lekë, në shpenzime sigurime shoqërore është pakësur në shumën 145,600 mijë lekë, në shpenzime mallra dhe shërbime të tjera është pakësuar në shumën 114,000 mijë lekë, në shpenzime transferta për buxhetet familjare dhe individët është shtuar në shumën 4,500 mijë dhe në shpenzime kapitale është pakësuar në shumën 121,879 mijë lekë.


kapitale 1,600 mijë), në programin 01140 - "Mbështetje për Teknologjinë e Sistemit të Drejtësisë", në shumën 7,700 mijë lekë në shpenzime korrente dhe në programin 03310 "Buxheti Gjyqësor" në shumën 473,179 mijë lekë (në shpenzime korrente 457,900 mijë lekë dhe në shpenzime kapitale 15,279 mijë lekë).

Gjithashtu, janë miratuar rishpërndarje të fondeve buxhetore në shpenzime korrente dhe shpenzime kapitale (investime) në programin 03310 "Buxheti Gjyqësor".[49] Këto rishpërndarje fondesh janë kryer për plotësimin e nevojave sipas kërkesave të gjykatave.

Fondet buxhetore të miratuara për sistemin gjyqësor janë rritur në mënyrë të vazhdueshme nga viti në vit, duke filluar nga viti 2021, sikurse ilustrohet në grafikun më poshtë. Pavarësisht kësaj, pesha që zë ky buxhet si përqindje ndaj PBB-së ka mbetur pothuajse e pandryshuar, me një tendencë të lehtë në rritje, nëse e krahasojmë vitin 2025 me vitet e mëparshme.

Tendeca në rritje në buxhetin e sistemit gjyqësor ka ardhur si rezultat:

- Ndryshimeve ligjore në legjislacionin e pagave për gjyqtarët dhe administratën gjyqësore (zë peshën më të madhe në % të rritjes);
- Implementimi i Hartës së Re Gjyqësore;
- Përmirësimi i Infrastrukturës Ndërtimore;
- Përmirësimin i Infrastrukturës Elektronike;
- Përmirësimi i Infrastrukturës së Teknologjisë së Informacionit dhe Implementimi i Sistemeve të reja Software.



[49] Në zbatim të vendimeve nr. 411, datë 16.07.2025, nr. 644, datë 23.09.2025, nr. 657, datë 01.10.2025 dhe nr. 788, datë 10.11.2025, të Këshillit të Lartë Gjyqësor

Ndërsa në vlerë absolute buxheti i miratuar për vitin 2025 është afërsisht 26.06 euro/banor,[50] ndërkohë që mesatarja e vendeve të Evropës është 28.3 euro/banor,[51] për vende me PBB më të vogël se 10,000 euro/ banor. Kjo do të thotë se pavarësisht rritjes që ka pasur në buxhetin gjyqësor, jemi ende larg mesatares së shpenzimeve për gjyqësorin në vendet e BE-së.

I. Programi buxhetor 01110, **"Planifikim, Menaxhim dhe Administrim"**, ku përfshihen fondet buxhetore për funksionimin e veprimtarisë së Këshillit të Lartë Gjyqësor.


Fondet buxhetore të miratuara për programin "Planifikim, Menaxhimi dhe Administrim", sipas emërtimit të shpenzimeve, paraqiten sipas pasqyrës së mëposhtme:

Pasqyra
e buxhetit të miratuar, rishikuar dhe realizuar për programin 01110 për vitin 2025

000 lekë

Nr	Emërtimi	Buxheti i miratuar	Ndryshime gjatë vitit	Buxheti i rishikuar	Realizimi	Realizimi %
01	Shpenzime "Paga"	343,600	-126,500	217,100	216,759	99.8%
02	Shpenzime "Sig. Shoqërore"	37,171	-7,500	29,671	29,325	98.8%
03	Shp. "Mallra e shërbime të tjera"	73,150	0	37,1500	67,298	92%
04	Shp. "Trans për buxh. fam. & ind."	1,500	1,200	2,700	1,517	56.2%
05	Shpenzime kapitale	15,000	-1,600	13,400	7,991	59.6%
	Totali	**470,421**	**-134,400**	**336,021**	**322,890**	**96.1%**

Sikurse ilustrohet, fondet buxhetore të miratuara në programin "Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi", për vitin 2025, janë në shumën 470,421 mijë lekë. Gjatë këtij viti, ato janë pakësuar në shumën 134,400 mijë lekë, kryesisht në shpenzime personeli dhe janë realizuar në masën **96.1%,** ose në vlerë absolute në shumën **322,890 mijë lekë**, sikurse paraqiten dhe grafikisht më poshtë:



Në mënyrë më të detajuar buxheti dhe realizimi për këtë program, paraqitet si më poshtë:

[50] Popullsia 1 janar 2025, publikuar nga INSTAT, datë 12.06.2025
[51] European judicial systems - CEPEJ Evaluation Report – 2024 Evaluation cycle (2022 data)

Shpenzime personeli

Buxheti i miratuar në shpenzime personeli është **380,771 mijë lekë**, i ndarë përkatësisht në shumën 343,600 mijë lekë në paga dhe në shumën 37,171 mijë lekë në sigurime shoqërore. Ky fond është përllogaritur dhe miratuar për **162 punonjës**. Realizimi i fondeve të rishikuara në shpenzime personeli është **në masën 99.4%,** për shkak të mosplotësimit 100% të strukturës organizative të KLGJ-së.
Numri faktik i punonjësve në KLGJ, në datën 31.12.2025, është 105 punonjës, kundrejt 162 punonjës sipas strukturës organizative. Konstatohet se gjatë vitit 2025 ka 57 punonjës më pak.

Shpenzime operative

Lidhur me shpenzimet për mallra e shërbime të tjera (operative) është miratuar një fond në shumën **73,150 mijë lekë**. Në këtë fond u përfshinë nevojat në shpenzimet operative për aktivitetin e përditshëm të KLGJ-së, referuar kërkesave të përcaktuara në fazën e projektbuxhetit sipas zërave të shpenzimeve, si dhe realizimit të vitit 2024.

Realizimi i fondeve të rishikuara në shpenzimeve operative është në masën **92%**. Në këtë zë të shpenzimeve janë realizuar shpenzimet për aktivitetin e përditshëm të institucionit të KLGJ-së. KLGJ-ja, krahas administrimit dhe menaxhimit të fondeve të programit të saj, ka administruar dhe menaxhuar edhe një pjesë të fondit të programit buxhetor të gjykatave (programi 03310), në shpenzime operative, në vlerën prej **307,300 mijë lekë**, e cila është prokuruar dhe realizuar në vlerën **298,020 mijë lekë**. Objekti i prokurimit është realizuar 100% sipas zërave dhe fondi është realizuar në masën **97%**, për shkak të kursimit të fondeve gjatë procedurave të prokurimit.

Shpenzime për transferta për buxhetet familjare dhe individët

Lidhur me shpenzimet në këtë artikull është miratuar një fond që do të përdoret kryesisht për pagesa të shpenzimeve të telefonisë celulare, për pagesat e interesit të kredisë për blerje apartamenti për qëllim banimi për gjyqtarët, sipas parashikimeve ligjore dhe nënligjore, për raste të dhënies së ndihmës së menjëhershme në raste fatkeqësie, si dhe për raste të tjera (sëmundje dhe pension pleqërie).

Shpenzime kapitale (Investime)

Buxheti i miratuar në shpenzime kapitale (investime) ishte në shumën **15,000 mijë lekë**. Në këtë fond ishin përfshirë kryesisht nevojat për pajisje teknologjike dhe rikonstruksion. Realizimi i shpenzimeve kapitale (investime) është kryer në **masën 59.6%.**

Masa e realizimit në terma sasiorë apo në vlerë absolute të produkteve është e lidhur me vonesën e procedurave për shkak të afateve të ankimimit dhe vendimmarrjes së vonuar (15.01.2026) të KPP-së.

I. Programi buxhetor 01140, **"Mbështetje për Teknologjinë e Sistemit të Drejtësisë"**,[52] ku përfshihen fondet buxhetore për funksionimin e veprimtarisë së Qendrës së Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë.

Fondet buxhetore të miratuara për programin "Mbështetje për Teknologjinë e Sistemit të Drejtësisë", sipas grup shpenzimeve, paraqiten sipas pasqyrës së mëposhtme:

Pasqyra
e buxhetit të miratuar, rishikuar dhe realizuar për programin 01140, viti 2025

000 lekë

Nr	Emërtimi	Buxheti i miratuar	Ndryshime gjatë vitit	Buxheti i rishikuar	Realizimi	Realizimi %
01	Shpenzime "Paga"	14,578	-5,200	9,378	9,271	98.9%
02	Shpenzime "Sig. Shoqërore"	2,500	-1,100	1,400	1,387	99.1%
03	Shp. "Mallra e shërbime të tjera"	2,976	-1,400	1,576	1,065	67.6%
04	Shp. "Trans për buxh. fam. & ind."	24	100	124	40	32.3%
05	Shpenzime kapitale	0	0	0	0	
	Totali	**20,078**	**-7,600**	**12,478**	**11,763**	**94.3%**

Fondet buxhetore për vitin 2025, për QTI-në, janë alokuar vetëm në shpenzime korrente dhe janë realizuar në masën **94.3%**, për shkak të mosplotësimit të strukturës organike të saj.

II. Programi buxhetor 03310, **"Buxheti Gjyqësor"**, ku përfshihen fondet buxhetore, për funksionimin e veprimtarisë së gjykatave në të gjitha nivelet.

Pasqyra
e *buxhetit të miratuar, rishikuar dhe realizuar për programin 03310, viti 2025*


000 lekë

Nr	Emërtimi	Buxheti i miratuar	Ndryshime gjatë vitit	Buxheti i rishikuar	Realizimi	Realizimi %
01	Shpenzime "Paga"	3,397,060	-468,300	2,928,760	2,895,075	98.8%
02	Shpenzime "Sig. Shoqërore"	500,600	-137,000	363,600	358,310	98.5%
03	Shp. "Mallra e shërbime të tjera"	909,900	-122,600	797,300	775,769	97.3%
04	Shp. "Trans për buxh. fam. & ind."	6,400	3,200	9,600	8,777	91.4%
05	Shpenzime kapitale	855,500	-120,279	735,221	359,216	49%
	Totali	**5,669,460**	**-834,979**	**4,834,481**	**4,397,150**	**91%**

Fondet buxhetore të miratuara në programin "Buxheti Gjyqësor", për vitin 2025 kanë qenë në shumën 5,669,460 mijë lekë. Gjatë këtij viti ato janë pakësuar në vlerë absolute në shumën 834,979 mijë, kryesisht në shpenzime personeli dhe janë realizuar në masën **91%,** ose në vlerë absolute në shumën **4,834,481 mijë lekë.**

[52] Në këtë program përfshihen fondet buxhetore, për funksionimin e veprimtarisë së Qendrës së Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë, miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 972, datë 02.12.2020 "Për organizimin, funksionimin e përcaktimin e kompetencave të Qendrës së Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë"

Fondet buxhetore të miratuara, të rishikuara dhe realizimi i tyre, sipas grup shpenzimeve, për programin 03310, grafikisht paraqiten si më poshtë:



Në mënyrë më të detajuar, buxheti dhe realizimi për këtë program paraqitet si më poshtë:

Shpenzime personeli

Buxheti i miratuar në shpenzime personeli është në shumën 3,897,660 mijë lekë, i ndarë në shumën 3,397,060 mijë lekë për paga dhe në shumën 500,600 mijë lekë për sigurime shoqërore.

Buxheti në shpenzime personeli në këtë program është përllogaritur, mbështetur në numrin e plotë të punonjësve sipas strukturave organike për të gjitha gjykatat dhe nivelit të pagave në përputhje me legjislacionin në fuqi për magjistratët dhe për administratën gjyqësore.

Realizimi i fondeve të rishikuara në shpenzime personeli është në masën 98.6%. Numri faktik i punonjësve në gjykatat e të gjitha niveleve, në datën 31.12.2025, është 1,523 punonjës, kundrejt 1,724 punonjës sipas strukturës organizative. Konstatohet se gjatë vitit 2025 ka 201 punonjës më pak në sistem nga të cilët: 99 janë magjistratë, (mungesa të cilat janë për shkak se janë të shkarkuar nga KPA-ja me vendim të formës së prerë, janë të dorëhequr, janë të komanduar, ose janë vende vakante të paplotësuara më parë) dhe 102 të tjerë në administratën gjyqësore. Këto mungesa nuk ka qenë e mundur të plotësohen brenda vitit 2025.

Shpenzime operative

Buxheti i miratuar në shpenzime për mallra e shërbime të tjera (operative) për vitin 2025 është në shumën **909,900 mijë lekë**. Shpenzimet operative përbëjnë ato shpenzime që kanë të bëjnë me aktivitetin e përditshëm të gjykatave. Gjithashtu, në këtë kategori llogariten edhe shpenzime të tjera specifike, të cilat kryhen nga gjykata jo çdo vit, por sipas rrethanave të krijuara, si shpenzimet për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore etj.

Realizimi i fondeve të rishikuara, në shumën **797,300 mijë lekë**, në shpenzime operative është në masën 97.3%. Ky është një tregues i përdorimit me efiçencë dhe ekonomicitet të fondeve nga gjykatat.

Shpenzime për transferta për buxhetet familjare dhe individët

Lidhur me shpenzimet në këtë artikull është miratuar një fond që do të përdoret kryesisht për pagesa të shpenzimeve të telefonisë celulare dhe për raste të dhënies së ndihmës së menjëhershme për raste fatkeqësie, si dhe raste të tjera (sëmundje dhe pension pleqërie).

Shpenzime kapitale (investime)


Buxheti i miratuar në shpenzime kapitale (investime) për këtë program ishte në shumën prej **750,500 mijë lekë.** Këto fonde janë ndarë sipas projekteve të mëposhtme:

Pasqyra
e buxhetit të miratuar, rishikuar dhe realizuar, në shpenzimeve kapitale (investime) sipas projekteve për programin 03310, viti 2025

000 lekë

Kodi i projektit	Emërtimi i projektit	Buxheti i miratuar	Buxheti i rishikuar	Realizimi	Realizimi %
18AD801	Blerje orendi dhe pajisje zyre	55,000	64,895	56,608	87.2%
21AC401	Blerje pajisje elektronike	60,300	115,300	0	0%
21AC501	Blerje software	415,300	359,465	156,460	43.5%
24AI401	Programe software për sigurinë kibernetike	50,000	46,190	46,190	100%
M290066	Studime dhe projektime	41,000	16,155	16,153	100%
M290068	Ndërtim i ri dhe rikonstruksion i plotë	98,900	106,708	57,297	53.7%
M290075	Blerje mjete motorike	30,000	26,508	26,508	100%
	Totali	**750,500**	**735,221**	**359,216**	**49%**

Sikurse ilustrohet, peshën kryesore në fondet buxhetore të miratuara në shpenzime kapitale (investime) e zënë shpenzimet për “Blerje software” dhe “Ndërtim i ri dhe rikonstruksion i plotë”, me rreth 68.5% të fondeve. Pas ndryshimeve të bëra gjatë vitit 2025, peshën kryesore në realizimin e këtyre fondeve në shpenzime kapitale (investime) e zë projekti “Blerje software”, sikurse paraqiten edhe grafikisht më poshtë:



Realizimi i fondeve të rishikuara në shpenzime kapitale (investime) për programin 03310 është në masën **49%**. Në këtë realizim, një ndikim të madh ka mospërmbushja në tre projekte ("Ndërtim i ri dhe rikonstruksion i plotë", "Blerje pajisje elektronike" dhe "Blerje software"), e cila ka ardhur si rezultat i vonesave të procedurave për shkak të afateve të ankimimit dhe vendimmarrjes së vonuar (15.01.2026) të KPP-së dhe vonesave të lejes së ndërtimit nga AZHT-ja.

Për sa më sipër, sikurse evidentohet edhe nga analiza raportuese e detajuar, **realizimi i fondeve buxhetore të rishikuara për vitin 2025 në sistemin gjyqësor rezulton në masën 91%,** i cili sipas grup shpenzimeve paraqitet si vijon:

- Në shpenzime paga, në masën 99%,
- Në shpenzime sigurime shoqërore dhe shëndetësore, në masën 99%,
- Në shpenzime për mallra dhe shërbime të tjera (operative), në masën 97%,
- Në shpenzime për transferta për buxhetet familjare dhe individë, në masën 83%,
- Në shpenzime kapitale (investime), në masën 49%.

Nevojat buxhetore

Buxheti i miratuar për Sistemin Gjyqësor për vitin 2026

Për vitin buxhetor 2026, buxheti i miratuar për sistemin gjyqësor, me ligjin nr. 87/2025 "Për buxhetin e vitit 2026", është në shumën **6,827,009 mijë lekë**.

Nevojat e evidentuara nga KLGJ-ja dhe, për rrjedhojë, të paraqitura prej saj si kërkesa buxhetore për vitin pasardhës, pasqyruar në dokumentin e projekt-buxhetit afatmesëm PBA-së 2026–2028, kanë qenë rreth **36.3%** më të larta se buxheti i miratuar dhe akorduar, ose në

vlerë absolute **2,480,719 mijë lekë**, si për shpenzimet korrente ashtu edhe për shpenzimet kapitale.

Ndërkohë, për sa i përket kërkesave për burime njerëzore shtesë nga Këshilli, pavarësisht se është kërkuar akordimi i 219 punonjësve shtesë, janë miratuar 100 punonjës shtesë për vitin 2026.

Në vlerësim të situatës buxhetore për vitin e ardhshëm evidentojmë se:

Shpenzimet korrente - Për vitin 2026, fondet e miratuara në shpenzime korrente janë më të ulëta krahasuar me kërkesat buxhetore të paraqitura. KLGJ-ja do të monitorojë në mënyrë të vazhdueshme situatën në sistem, me qëllim plotësimin e nevojave të të gjitha gjykatave, si dhe për të mundësuar mirëfunksionimin e tyre. Ky monitorim do të kryhet duke marrë parasysh të gjithë faktorët që ndikojnë në rritjen apo uljen e këtyre shpenzimeve dhe, më veçanërisht, atyre të lidhura me mungesën e burimeve njerëzore në gjykata, si në gjyqtarë ashtu edhe në staf administrativ, mungesa të cilat kanë ndikim të drejtpërdrejtë në masën e realizimit të shpenzimeve korrente. Megjithatë, për të plotësuar të gjitha detyrimet ligjore, është e domosdoshme akordimi i fondeve shtesë nga ana e Ministrisë së Financave, sipas kërkesave të paraqitura nga KLGJ-ja, sidomos në shpenzime personeli.

Shpenzimet kapitale (investime) - Fondet e miratuara për shpenzime kapitale, për vitin 2026, janë më të larta se viti i mëparshëm.

Fokusi i KLGJ-së në investimet e parashikuara për vitin 2026 do të jetë në vazhdimësinë e projekteve ekzistuese, ruajtjen e standardeve të arritura, si dhe në përmbushjen e objektivave të përcaktuara në planin strategjik të KLGJ-së, me qëllim përmirësimin e infrastrukturës ndërtimore, teknologjisë së informacionit dhe situatës së transportit në gjykatat e vendit.

Gjatë vitit 2026, prioritet u është dhënë edhe investimeve për zhvillimin e projekteve ekzistuese në fushën e teknologjisë së informacionit, me qëllim digjitalizimin e shërbimeve në gjykatat e të gjitha niveleve. Disa nga projektet e parashikuara për t'u realizuar gjatë vitit 2026 janë:

- *Projekti për rikonstruksionin e plotë të ish - godinës* "Dega e Tatimpaguesve të Mëdhenj", kaluar në përdorim për Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, në zbatim të VKM-së nr.173, datë 20.03.2025.
- *Projekti për zhvillimin e një sistemi të ri të menaxhimit të çështjeve gjyqësore,* i cili është planifikuar për një kohëzgjatje 5-vjeçare, sipas vlerësimit në udhërrëfyesin e Këshillit të Evropës,[53] KLGJ-ja, në bashkëpunim me partnerët, kërkon të ngrejë një sistem të ri, modern dhe funksional të menaxhimit të çështjeve, i cili do të kapërcejë pengesat e sistemeve ekzistuese dhe do jetë një hap i madh drejt transformimit digjital

[53] Udhërrëfyes i miratuar me vendimin nr.6, datë 17.12.2021, të Bordit Drejtues të Qendrës së Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë

në shërbimet e sektorit të drejtësisë. Implementimi i projektit ka filluar zbatimin e tij gjatë vitit 2025.

- *Projekti Enterprise Service BUS (ESB)* është parashikuar të realizohet në një periudhë 3-vjeçare. Implementimi i një ESB-je do të ndihmojë KLGJ-në, me qëllim për të ofruar një qasje të unifikuar për komunikimin midis shërbimeve. ESB-ja do të veprojë si një pikë qendrore e identifikimit dhe autorizimit, duke ofruar një qasje të sigurt dhe të standardizuar për komunikimin midis shërbimeve. Me një APGË, shërbimet do të zhvillohen, shpërndahen dhe integrohen me lehtësi, duke kursyer kohë të konsiderueshme zhvillimi dhe integrimi.

  Projekti ishte parashikuar të fillonte zbatimin e tij gjatë vitit 2025, por procesi ka pësuar zgjatje për shkak të natyrës së procedurës dhe pritjes së detyrueshme të afateve të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi për prokurimin publik, të cilat duhet të respektohen në çdo fazë të procesit.
- *Projekti "Rritja e kapaciteteve të sigurisë kibernetike* është parashikuar të realizohet në një periudhë 3-vjeçare. Ky investim lidhet me rritjen e kapaciteteve të infrastrukturës IT, lidhur me menaxhimin e rrezikut të sigurisë kibernetike, duke identifikuar dhe adresuar rreziqet potenciale, si dhe duke pasur një plan të përgatitur për rikuperim dhe marrjen e masave për identifikimin dhe përballimin e incidenteve të mundshme kibernetike. Implementimi i projektit ka filluar zbatimin e tij gjatë vitit 2025.

Duke qenë se implementimi i Hartës së Re Gjyqësore, e cila solli ndryshime në vendndodhjen dhe kompetencat territoriale të gjykatave në vend, ka përfunduar në korrik 2023, kërkesat buxhetore për shpenzime kapitale (investime) të KLGJ-së pasqyrojnë vetëm nevojat për investime qartësisht të domosdoshme, të cilat garantojnë vijimisht mirëfunksionimin e gjykatave dhe ofrimin e shërbimeve gjyqësore për publikun.

Sikurse është theksuar në mënyrë të vazhdueshme, vit pas viti, mbetet emergjente përmirësimi i infrastrukturës ndërtimore nëpërmjet ndërtimit të godinave të reja për Gjykatën e Lartë, Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, si dhe gjykatat e shkallës së parë të jurdiksionit të përgjithshëm në Tiranë, Fier, Lezhë dhe Durrës. Këto investime do të mundësonin standarde bashkëkohore në përmbushjen e detyrave kushtetuese dhe ofrimin dinjitoz të shërbimeve për publikun. Kërkesat për realizimin e këtyre projekteve janë përfshirë edhe në dokumentin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028.

KLGJ-ja, pasi ka përmbushur objektivat në drejtim të rritjes së numrit të punonjësve në sistemin gjyqësor, si dhe rritjen e fondeve në shpenzime korrente për përmirësimin e shërbimeve ndaj publikut, është fokusuar në rritjen e nivelit të investimeve në sistem, kryesisht për përmirësimin e infrastrukturës ndërtimore të gjykatave dhe infrastrukturës së sistemeve të teknologjisë së informacionit.

Politikat në drejtim të reformimit dhe përmirësimit të efikasitetit të shërbimit gjyqësor duhet të reflektohen në buxhete më të larta, veçanërisht në investime. Një rritje e qëndrueshme e fondeve buxhetore në shpenzime kapitale (investime) në vitet në vijim është thelbësore për përmbushjen e objektivave për përmirësimin infrastrukturor të gjykatave, me ndikim të rëndësishëm në funksionimin efikas të sistemit gjyqësor.

6. DIGJITALIZIMI

Digjitalizimi i gjykatave është një proces transformues që ka për qëllim përmirësimin e efikasitetit, transparencës dhe aksesit në drejtësi. Integrimi i mjeteve digjitale në sistemin gjyqësor ofron një sërë përfitimesh thelbësore që ndikojnë në cilësinë dhe shpejtësinë e shërbimeve gjyqësore.

- Së pari, digjitalizimi mundëson një menaxhim më efikas të çështjeve dhe dokumenteve gjyqësore. Përdorimi i sistemeve të automatizuara dhe platformave elektronike lehtëson ruajtjen, organizimin dhe qasjen në dosjet gjyqësore, duke ulur ndjeshëm kohën e nevojshme për përpunimin e tyre. Kjo, nga ana tjetër, redukton vonesat dhe rrit efikasitetin e përgjithshëm të gjykatave.
- Së dyti, transparenca është një aspekt kyç i drejtësisë, dhe digjitalizimi ndihmon në përmirësimin e saj. Me ndihmën e sistemeve digjitale, qytetarët mund të kenë qasje më të lehtë dhe të shpejtë në informacionet e lidhura me proceset gjyqësore, duke përfshirë kalendarët e seancave, listën e shortit, vendimet gjyqësore dhe çdo informacion tjetër që lidhet me veprimtarinë e gjykatave. Kjo rrit besimin e publikut në sistemin e drejtësisë dhe ndihmon në uljen e korrupsionit.
- Së treti, digjitalizimi zgjeron aksesin në drejtësi. Platformat *online* dhe teknologjitë e fundit të aplikuara garantojnë integritetin dhe ruajtjen e sigurt të të dhënave gjyqësore që përpunohen nga gjykatat.

Digjitalizimi i sistemit gjyqësor nuk është vetëm një kërkesë e kohës moderne, por edhe një mundësi për të forcuar themelet e një sistemi drejtësie të drejtë, të shpejtë dhe të besueshëm. Ai ndihmon jo vetëm në përmirësimin e shërbimeve të drejtësisë, por edhe në ndërtimin e një shoqërie më të drejtë dhe më të përparuar.

6.1 Qendra e Teknologjisë së Informacionit

Qendra e Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë, [54] me mision përcaktimin e standardeve dhe politikave për sistemet e teknologjisë së informacionit në sistemin e drejtësisë, edhe gjatë vitit 2025 ka vijuar veprimtarinë e saj, duke ndërmarrë dhe miratuar një sërë vendimesh të rëndësishme me qëllim përmirësimin, zhvillimin, fuqizimin dhe standardizimin e sistemeve TIK në Sistemin e Drejtësisë.

[54] E cila ushtron aktivitetin e saj në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 972, datë 02.12.2020 "Për organizimin, funksionimin e përcaktimin e kompetencave të Qendrës së Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë".

QTI-ja, në përmbushje të veprimtarisë së saj, edhe gjatë vitit raportues është angazhuar në hartimin e akteve të tjera rregullatore, me qëllim garantimin e zbatimit të standardeve dhe politikave të Bashkimit Evropian për teknologjinë e informacionit dhe komunikimit në sistemin e drejtësisë.

Vendimmarrje të rëndësishme dhe pasurimi i kuadrit rregullator

Gjatë vitit 2025, QTI-ja ka vijuar forcimin e rolit të saj rregullator dhe koordinues, përmes miratimit të një sërë vendimesh me rëndësi strategjike për funksionimin, sigurinë dhe zhvillimin e qëndrueshëm të sistemeve TIK në sistemin e drejtësisë. Në këtë kuadër, Bordi Drejtues i QTI-së ka miratuar këto vendime kryesore:

- Vendimi nr. 3, datë 28.02.2025, "Për miratimin e rregullave dhe procedurave për aksesin në sistemet e menaxhimit të çështjeve gjyqësore nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë". Ky vendim garanton akses të plotë të ILD-së në sistemet ekzistuese të gjykatave (ARKIT dhe ICMIS), pa të drejtë ndërhyrjeje ose modifikimi, në përputhje me parashikimet ligjore, duke siguruar respektimin e parimeve të ligjshmërisë, transparencës dhe sigurisë së informacionit.
- Vendimi nr. 5, datë 25.04.2025, "Për miratimin e Dokumentit të Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2026-2028, Faza e Parë, të Qendrës së Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë". Ky vendim shënon fillimin e procesit të planifikimit buxhetor afatmesëm, duke përcaktuar prioritetet strategjike financiare për QTI-në.
- Vendimi nr. 8, datë 30.06.2025, "Për miratimin e Standardit 'Mbi specifikimet minimale teknike për përdorimin e pajisjeve të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në institucionet e sistemit të drejtësisë'", së bashku me Aneksin nr. 1 – Standardet TIK. Ky standard përbën një hap thelbësor drejt standardizimit të pajisjeve hardware dhe garantimit të interoperabilitetit, sigurisë dhe efiçencës teknologjike në të gjitha institucionet e sistemit të drejtësisë.
- Vendimi nr. 10, datë 30.07.2025, "Për miratimin e Dokumentit të Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2026–2028, Faza e Dytë, të Qendrës së Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë". Me këtë vendim përmbyllet procesi i hartimit të PBA-së, duke konsoliduar planifikimin financiar dhe duke siguruar koherencë ndërmjet objektivave strategjike, nevojave teknike dhe burimeve buxhetore të QTI-së.
- Vendimi nr. 12, datë 28.12.2025, "Miratimin e detajimit të fondeve buxhetore, për Qendrën e Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë, për vitin buxhetor 2026, vitin 2027 dhe vitin 2028", i fundit për vitin 2025.

Një tjetër dokument me rëndësi strategjike është *"Udhërrëfyesi për digjitalizimin e sistemit të drejtësisë"*. Gjatë vitit 2025 ka vijuar puna për finalizimin dhe përditësimin e draftit përfundimtar të Udhërrëfyesit, i cili është konsultuar në mënyrë të vazhdueshme me ekspertët

e huaj të delegacionit të BE-së, si dhe Ekipin Këshillimor të Ekspertëve të Qendrës, nëpërmjet takimeve të punës, me qëllim diskutimin dhe reflektimin e çdo ndryshimi të propozuar.

Vlen të theksohet se GNP-ja ka përditësuar draftin paraprak të Udhërrëfyesit në tetor 2025, duke përfshirë arkitekturën e nyjës ESB, si dhe shërbimin ETL. Në fazat e hershme të hartimit të udhërrëfyesit ishte parashikuar fond buxhetor vetëm për komponentin BI. Duke qenë se nuk ekzistonte një projekt i plotë për komponentët e përbashkët dhe sistemet mbështetëse, u vendos që vlerësimi i kostove për sistemin IBIS të realizohet në një fazë të mëvonshme, pasi të jenë funksionale sistemet ICMIS dhe CAMS dhe të jenë të qarta kërkesat e biznesit dhe ato teknike.

Të gjitha këto kërkonin konsultim dhe dakordësim me Ekipin Këshillimor të Ekspertëve të Qendrës, si dhe ekspertëve të huaj të BE-së.

Në fazat e hershme të hartimit të Udhërrëfyesit ishte parashikuar gjithashtu një fond buxhetor për institucionet e sistemit të drejtësisë, për të mundësuar elementet e nevojshme sipas kornizës së ndërveprimit. Në vijim të bisedimeve dhe bashkëpunimit, UNOPS-i, me shkresën nr. 5671/2 prot., datë 09.05.2025, drejtuar KLGJ-së, propozon që kostot e parashikuara në këtë Udhërrëfyes të mos pasqyrohen më në planin financiar, pasi fondet përkatëse do të alokohen në projekte të tjera të sistemit të drejtësisë.

Periudha e konsultimit ka qenë relativisht e gjatë, për shkak të qartësimit të funksioneve teknike të projektit me të gjithë aktorët, ndryshimit të vazhdueshëm të ekspertëve të huaj, koordinimit me institucionet e sistemit të drejtësisë për të përcaktuar një plan veprimi me masa dhe afate konkrete, si dhe përcaktimit të buxhetit për digjitalizimin e institucioneve të KLGJ-së, PP-së dhe ILD-së, me qëllim përfitimin e donacioneve të huaja (fondet IPA III), me ndihmën e UNOPS-it.

Këto takime kanë rezultuar në pasurimin dhe konfirmimin e Udhërrëfyesit me zhvillimet e reja teknologjike në rajon dhe kornizën ligjore, lidhur si me pjesën procedurale, ashtu edhe atë teknike (hardware dhe software). Të gjitha këto etapa do të minimizojnë kohën e përpunimit dhe ruajtjes së dokumentacionit në formë digjitale, duke shtyrë drejt transformimit të plotë digjital të shërbimeve në Sistemin e Drejtësisë.

Bashkëpunime ndërinstitucionale

Është ngritur Komiteti Drejtues për Projektin “Mbështetje për Sundimin e Ligjit përmes transformimit digjital: Avancimi i aftësive të menaxhimit të çështjeve dhe inteligjencës së biznesit në Shqipëri” (EU4DJ), si dhe Steering Committee (PSC) lidhur me Sistemin e Menaxhimit të Çështjeve (Case Management System) për Prokuroritë e Përgjithshme, sistemin e Statistikave dhe Inteligjencës së Biznesit.

Gjithashtu, është ngritur një grup pune me qëllim sigurimin dhe bashkëpunimin e ngushtë ndërinstitucional për zhvillimin dhe zbatimin e Sistemit të Ri të Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore, duke krijuar një strukturë koordinimi dhe përfaqësimi të institucioneve të drejtësisë dhe të sistemit qeveritar. Grupi synon të garantojë funksionimin e integruar të sistemit, standardizimin dhe shkëmbimin e të dhënave, adresimin e kërkesave funksionale dhe prioriteteve të institucioneve pjesëmarrëse, si dhe planifikimin e fazave të testimit, pilotimit dhe trajnimit të përdoruesve, përfshirë edhe vizitën studimore në Suedi për të njëjtin qëllim.

Përmes këtij bashkëpunimi synohet ngritja e një rrjeti kontakti ndërmjet koordinatorëve të emëruar nga çdo institucion, me qëllim përmirësimin e koordinimit dhe monitorimin e nevojave dhe kërkesave përkatëse.

Ndjekja e strategjive ndërsektoriale, në kuadër të aderimit në BE

Në kuadër të hartimit të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë (SND) 2024-2030, si një dokument politik i qeverisë shqiptare me objektivin madhor "Konsolidimi i arritjeve të reformës në drejtësi në përputhje me standardet më të mira evropiane", Qendra, në bashkëpunim me Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe Ministrinë e Drejtësisë, ka dhënë kontributin e saj për evidentimin në këtë dokument të aktiviteteve dhe afateve të objektivave specifikë, ku QTI-ja identifikohet si institucion përgjegjës. Gjithashtu, gjatë vitit raportues, ka bashkëpunuar ngushtësisht me KLGJ-në lidhur me raportimet periodike të SND-së dhe strategjive të tjera, si monitorimi dhe raportimi i Strategjisë Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit 2024-2030.

Duke marrë shkas nga detyrimet që lindin në Strategjinë Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit 2024-2030, QTI-ja ka vijuar hulumtimin mbi standardet për përdorimin e sistemit të videokonferencave, referuar praktikave më të mira, si dhe rekomandimeve të CEPEJ-it dhe organizatave të tjera në sektorin e drejtësisë, duke përgatitur një draft përkatës.

Gjithashtu, QTI-ja ka zhvilluar takime me partnerë ndërkombëtarë me axhendë prezantimin e eksperiencave të tyre dhe njohjen më të mirë me procesin e transformimit digjital në sistemin e drejtësisë.

Struktura e QTI-së

QTI vijon veprimtarinë e saj që nga krijimi pranë KLGJ-së, e cila i mundëson funksionet horizontale administrative, financiare dhe logjistike, të përcaktuara në pikën 2 të VKM-së nr. 972, datë 02.12.2020 "Për organizimin, funksionimin e përcaktimin e kompetencave të Qendrës së Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë".[55] Qendra ushtron

[55] Qendra është institucion publik buxhetor, që gëzon personalitet juridik, me seli në Tiranë. Qendra ngrihet dhe funksionon pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, i cili siguron ambientet e përshtatshme të punës për të. Funksionet mbështetëse horizontale administrative, financiare e logjistike kryhen për qendrën nga Këshilli i Lartë Gjyqësor.

funksionet e saj nëpërmjet dy organeve kryesore: Bordi Drejtues (organ kolegjial vendimmarrës) dhe Drejtori Ekzekutiv (organ administrativ). Për çështje specifike në lidhje me problematika të fushës TIK dhe sigurisë kibernetike, Bordi ndihmohet nga Ekipi Këshillimor i Ekspertëve, i cili përbëhet nga nëpunësit më të lartë për çështjet e teknologjisë së informacionit në institucionet e drejtësisë.

Procedurat e rekrutimit të stafit të QTI-së kryhen nga KLGJ-ja, në zbatim të pikës 2 të VKM-së nr. 972, datë 02.12.2020 "Për organizimin, funksionimin e përcaktimin e kompetencave të Qendrës së Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë", si dhe legjislacionit përkatës "Për nëpunësin civil". Struktura organizative e QTI-së përbëhet nga 1 (një) pozicion Drejtor Ekzekutiv dhe 5 (pesë) pozicione specialistësh. Aktualisht, struktura është e mbuluar pjesërisht, me 1 (një) Drejtor Ekzekutiv dhe 3 (tre) specialistë në detyrë, ndërkohë që 2 (dy) pozicione specialistësh rezultojnë ende vakante.

Ngritja e kapaciteteve njerëzore dhe teknike mbështetur nga UNOPS

Në kuadër të ndihmës financiare të ofruar nga UNOPS-i për Qendrën e Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë, si dhe në vijim të takimeve të zhvilluara ndërmjet përfaqësuesve të KLGJ-së, QTI-së dhe UNOPS-it, u dakordësua detajimi i nevojave prioritare të Qendrës për pajisje elektronike (hardware dhe software), si dhe për trajnimin e stafit, me qëllim forcimin e kapaciteteve teknike dhe njerëzore të QTI-së. Në këtë kuadër, u mundësua sigurimi i pajisjeve teknologjike dhe zhvillimi i aftësive profesionale të stafit, ku QTI ka qenë pjesëmarrëse në dy trajnime ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes kibernetike dhe digjitalizimit të sistemeve qeveritare. Gjithashtu, stafi ka përfunduar kurset certifikuese dhe është në proces pajisjeje me certifikatat përkatëse me karakter teknik dhe manaxherial, si ISO, ITIL, PRINCE2 dhe CGEIT, tepër të vlefshme për rolin e tij në veprimtarinë e institucionit. E gjitha kjo është realizuar në funksion të përmbushjes së misionit institucional dhe mbështetjes së procesit të digjitalizimit të sistemit të drejtësisë.

6.2 Përmirësimet në infrastrukturën teknologjike ekzistuese

Procesi i digjitalizimit të sistemit gjyqësor përbën një nga prioritetet strategjike për modernizimin e administrimit gjyqësor, me synim rritjen e efikasitetit, transparencës dhe aksesit në shërbimet gjyqësore. Integrimi i teknologjive bashkëkohore në veprimtarinë e gjykatave ka krijuar mundësi të reja për përmirësimin e menaxhimit të çështjeve, automatizimin e procedurave, forcimin e sigurisë së informacionit dhe garantimin e një shërbimi më të shpejtë dhe të besueshëm për publikun. Në këtë kuadër, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vijuar të investojnë në infrastrukturë teknologjike, zhvillimin e platformave digjitale dhe harmonizimin e proceseve të punës me standardet më të avancuara evropiane.

Gjatë vitit 2025, përmirësimet janë intensifikuar më tej, duke u përqendruar në ndërtimin e bazave të qëndrueshme për një transformim afatgjatë të sistemit gjyqësor. Veprimet konkrete kanë përfshirë përfundimin e projekteve infrastrukturore kritike, avancimin e sistemeve të reja të menaxhimit të çështjeve, rritjen e kapaciteteve të sigurisë kibernetike, si dhe zgjerimin

e shërbimeve elektronike për qytetarët dhe subjektet e interesuara. Këto zhvillime dëshmojnë angazhimin e vazhdueshëm të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe institucioneve partnere për ndërtimin e një sistemi gjyqësor modern, të integruar dhe orientuar drejt nevojave të shoqërisë.

- Në fushën e sigurisë kibernetike janë realizuar ndërhyrje të rëndësishme, në zbatim të kuadrit ligjor përkatës dhe rekomandimeve të institucioneve përgjegjëse, me qëllim forcimin e mbrojtjes së infrastrukturave kritike të informacionit dhe garantimin e vazhdimësisë së shërbimeve digjitale në sistemin gjyqësor.
- Janë zhvilluar programe të strukturuara trajnimi për specialistët e teknologjisë së informacionit në gjykata dhe për administratën gjyqësore. Në fokus të këtyre trajnimeve ka qenë ngritja e kapaciteteve profesionale në fushën e sigurisë kibernetike, auditimit të sistemeve, hakerimit etik, mbrojtjes së aplikacioneve web, si dhe përgatitja për certifikime ndërkombëtare të njohura në këtë fushë, përfshirë CEH, CySA+, CISSP, CCSP dhe CISM. Këto trajnime kanë kontribuar në forcimin e kompetencave teknike të personelit, rritjen e ndërgjegjësimit institucional për menaxhimin e riskut kibernetik dhe përmirësimin e aftësive për parandalimin dhe reagimin ndaj incidenteve të sigurisë.
- Në kuadër të zhvillimit të Regjistrit Elektronik të Organizatave Jo-Fitimprurëse, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka bashkëpunuar me institucionet partnere për ndërtimin dhe testimin e shërbimeve digjitale përkatëse, si dhe për adresimin e çështjeve teknike të evidentuara gjatë procesit të integrimit në platformën kombëtare të shërbimeve elektronike.
- Në të njëjtën kohë, në kontekstin e modernizimit të sistemit gjyqësor, janë ndërmarrë masa për avancimin e digjitalizimit të arkivës gjyqësore, përmes implementimit të zgjidhjeve teknologjike që mundësojnë menaxhimin elektronik të dokumentacionit dhe përmirësojnë aksesin e strukturave gjyqësore dhe të publikut në të dhënat arkivore.

Përpos iniciativave për përmirësimin e infrastrukturës ekzistuese, nga Këshilli i Lartë Gjyqësor është realizuar vlerësimi i kapaciteteve ekzistuese, proces përmes të cilit janë evidentuar nevojat për përmirësimin e infrastrukturës bazë për përdoruesit fundorë në gjykata. Nevojat konsistojnë në pajisje kompjuterike moderne, printerë, fotokopje, pajisje rezervë të furnizimit me energji (UPS), si dhe mjete të tjera mbështetëse të domosdoshme për funksionimin efektiv të sistemeve digjitale dhe ofrimin e shërbimeve cilësore ndaj publikut.

- Deri në momentin e përfundimit dhe vënies në funksion të sistemit të ri të menaxhimit të çështjeve gjyqësore **Juronix**, është vijuar pa ndërprerje garantimi i shërbimit të mirëmbajtjes për sistemet ekzistuese **ICMIS** dhe **ARKIT**, si dhe për të gjithë infrastrukturën mbështetëse të gjykatave të të gjitha niveleve.

  Janë realizuar një sërë zhvillimesh funksionale dhe raportuese në këto sisteme, me qëllim përmirësimin e proceseve të menaxhimit të çështjeve gjyqësore, rritjen e transparencës, efiçencës operative dhe përmbushjen e kërkesave ligjore dhe institucionale.

Për sistemin **ICMIS** në Gjykatën e Lartë dhe në gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm, apel dhe administrative, janë zbatuar zhvillime që lidhen me proceset e shortimit dhe rishortimit të çështjeve, gjenerimin e statistikave për çështje urgjente, përmirësimin e ndërfaqeve funksionale, filtrat dinamikë për përdoruesit drejtues, si dhe pasurimin e portalit publik gjyqësor me rubrika të reja informuese dhe vizualizime institucionale.

Në të njëjtën kohë, për sistemin **ARKIT** janë realizuar zhvillime të shumta që lidhen me automatizimin e arsyes së rishortimit, raportimin statistikor, përmirësimin e gjurmimit të çështjeve dhe dosjeve, optimizimin e ndërfaqeve të përdoruesve, forcimin e kontrollit për caktimet manuale të gjyqtarëve dhe dokumentimin e vendimeve përkatëse, duke garantuar përputhshmëri me aktet rregullatore dhe praktikat gjyqësore në fuqi.

Këto ndërhyrje teknike dhe funksionale kanë siguruar vazhdimësinë e shërbimit dhe stabilitetin e sistemeve ekzistuese, duke mbështetur punën e përditshme të gjykatave dhe organeve drejtuese, deri në përfundimin e implementimit të sistemit të ri **Juronix**.

- Vijon procesi i mirëmbajtjes dhe përditësimit të sistemit audio RDA dhe të pajisjeve audio-video në 20 gjykata.

  Këto ndërhyrje kanë pasur si qëllim përmirësimin e cilësisë së regjistrimit të seancave gjyqësore, sigurimin e ruajtjes së qëndrueshme të materialeve audio-vizuale, rritjen e besueshmërisë teknike të pajisjeve, si dhe garantimin e përputhshmërisë me standardet teknologjike dhe të sigurisë së informacionit në fuqi.

  Nëpërmjet këtyre veprimeve është synuar gjithashtu reduktimi i ndërprerjeve teknike, rritja e disponueshmërisë së sistemeve në sallat e gjyqit dhe mbështetja efektive e veprimtarisë gjyqësore, në funksion të transparencës dhe cilësisë së shërbimit ndaj qytetarëve.

Sa i përket realizimit të rekomandimeve të lëna nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, janë ndërmarrë masa konkrete për përmirësimin e mekanizmave të monitorimit dhe raportimit në sistemin e administrimit të çështjeve gjyqësore. Në këtë kuadër, është mundësuar gjenerimi i raporteve periodike të gjurmimit, si dhe përgatitja e raporteve të posaçme sipas kërkesave të ILD-së, lidhur me shortet elektronike, caktimet manuale dhe rishortimet për të gjitha gjykatat. Këto masa synojnë rritjen e transparencës, forcimin e kontrollit institucional dhe garantimin e zbatimit korrekt të procedurave në procesin e shpërndarjes së çështjeve.

Implementimi i projekteve të reja dhe vijimi i mbështetjes së projekteve ekzistuese

- Këshilli i Lartë Gjyqësor ka planifikuar projektin për krijimin dhe zbatimin e Sistemit Enterprise Service Bus (ESB), si një komponent strategjik për standardizimin e ndërveprimit ndërmjet sistemeve ekzistuese dhe të reja të administrimit gjyqësor. Projekti synon ngritjen e një shtrese të centralizuar integrimi, rritjen e sigurisë së shkëmbimit të të

dhënave, përmirësimin e kontrollit dhe auditimit të proceseve, si dhe krijimin e bazës teknologjike për zhvillimin e shërbimeve elektronike dhe sistemeve analitike në nivel kombëtar, në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator përkatës.

- Procesi i digjitalizimit të arkivave vijon të mbështetet dhe të zgjerohet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, në përputhje me objektivat strategjikë të përcaktuar. Deri më tani, në kuadër të këtij projekti janë digjitalizuar gjithsej 12,937,316 fletë, ndërkohë që janë rritur ndjeshëm kapacitetet harduerike me qëllim përshpejtimin e përpunimit dhe digjitalizimit të dokumenteve të skanuara, duke përmirësuar efikasitetin operacional dhe shërbimin ndaj përdoruesve institucionalë dhe qytetarëve.
- Në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit dhe në zbatim të ligjit nr. 80/2021 "Për regjistrimin e organizatave jo-fitimprurëse", vijon mbështetja e projektit për zhvillimin e shërbimeve elektronike për OJF-të në portalin e-Albania. Në këtë kuadër, janë ndërtuar tetë shërbime digjitale që mbulojnë proceset e regjistrimit, përditësimit, çregjistrimit dhe administrimit të veprimtarisë së OJF-ve, ndërkohë që zhvillimet teknike të realizuara nga AKSHI po shoqërohen me fazat përkatëse të testimit dhe integrimit në platformën elektronike të OJF-ve pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
- Në kuadër të zbatimit të ligjit nr. 25/2024 "Për sigurinë kibernetike" dhe rekomandimeve të Agjencisë Kombëtare të Sigurisë Kibernetike, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka ndërmarrë masa të strukturuara për forcimin e mbrojtjes së infrastrukturave kritike të informacionit, duke iniciuar procedura për furnizimin me softuerë dhe pajisje të avancuara sigurie. Këto masa përfshijnë zëvendësimin e sistemeve "end of life", azhurnimin dhe licencimin e platformave operative, implementimin e zgjidhjeve për mbrojtjen e pajisjeve fundore (EDR/XDR/DLP), vendosjen e firewall-eve të gjeneratës së re (NGFW), rinovimin e shërbimeve WAF, forcimin e konfigurimeve të rrjetit, si dhe realizimin e testimeve periodike të sigurisë (vulnerability assessment dhe penetration test).

  Paralelisht, është vijuar me rishikimin dhe përditësimin e dokumentacionit institucional në fushën e sigurisë së informacionit, përfshirë politikat dhe procedurat për menaxhimin e identiteteve dhe aksesit, planin e vazhdimësisë së punës dhe rimëkëmbjes nga fatkeqësitë, dokumentet për klasifikimin dhe inventarizimin e aseteve kritike, procedurat për monitorimin e sistemeve dhe menaxhimin e ndryshimeve, si dhe planet për identifikimin dhe menaxhimin e riskut kibernetik, me synim harmonizimin e tyre me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të sigurisë dhe forcimin e kuadrit qeverisës të mbrojtjes së informacionit në sistemin gjyqësor.
- Ka vijuar mbështetja për garantimin e funksionimit të pandërprerë të platformës "Promagistrate", duke siguruar akses të vazhdueshëm dhe efikas në arkivimin dhe menaxhimin elektronik të dokumentacionit të gjyqtarëve.

Sistemi i Ri i Integruar i Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore Juronix

Këshilli i Lartë Gjyqësor gjatë vitit 2025, ka vijuar me zbatimin e projektit për implementimin e Sistemit të Ri të Integruar të Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore, Juronix, i cili përbën një nga investimet më të rëndësishme në kuadër të transformimit digjital të sistemit gjyqësor shqiptar. Ky sistem synon unifikimin dhe standardizimin e proceseve të menaxhimit të çështjeve në të gjitha nivelet e gjykatave, duke rritur efikasitetin, transparencën dhe sigurinë e të dhënave gjyqësore.

Në fazën fillestare të projektit u realizua analiza e thelluar e sistemeve ekzistuese dhe proceseve aktuale të punës në gjykata, me qëllim identifikimin e mangësive funksionale dhe teknike. U evidentuan kufizime në arkitekturën e decentralizuar, procese manuale dhe mungesë standardizimi, të cilat përforcuan domosdoshmërinë për zhvillimin e një platforme të re të centralizuar dhe të integruar.

Gjatë fazës së analizës dhe planifikimit, u hartuan proceset e ardhshme (TO-BE), u unifikuan workflow-t procedurale dhe u përcaktuan kërkesat funksionale dhe jofunksionale të sistemit. Në këtë kuadër, u konceptuan funksionalitetet kryesore që lidhen me auditimin e sistemit, regjistrat elektronikë të unifikuar, njoftimet elektronike për palët dhe mekanizmat e raportimit statistikor dinamik, duke garantuar përputhshmëri me kuadrin ligjor në fuqi dhe standardet e sigurisë.

Parësore në këto faza ka qenë garantimi i disponueshmërisë së lartë, auditimit të plotë të veprimeve (*audit trail*), kontrollit të roleve dhe integrimit me sistemet e tjera të drejtësisë dhe ato publike, duke krijuar një infrastrukturë të qëndrueshme dhe të shkallëzueshme.

Paralelisht, u ngrit infrastruktura qendrore teknologjike, e përbërë nga *data center primar* dhe site rezervë (DR), me arkitekturë aktive–aktive dhe mekanizma të avancuar *backup*-i dhe mbrojtjeje kibernetike. Implementimi i sistemeve të firewall-it të avancuar, WAF-it dhe platformës SIEM për monitorimin e sigurisë ka garantuar mbrojtjen e sistemit dhe të të dhënave nga kërcënimet kibernetike. Në vijim, parashikohet zhvillimi i fazës së dizajnimit të sistemit, ndërtimi i arkitekturës së aplikacionit dhe modeli i ri i bazës së të dhënave, si dhe zhvillimi i moduleve kryesore funksionale të sistemit.

Një komponent thelbësor i projektit është procesi i migrimit të të dhënave nga sistemet ekzistuese drejt platformës së re. Ky proces është planifikuar për tu zbatuar me kujdes, duke përfshirë verifikimin e integritetit të të dhënave, testime paraprake dhe validim funksional, me qëllim ruajtjen e saktësisë dhe vazhdimësisë së informacionit gjyqësor.

Për të garantuar integritetin dhe sigurinë maksimale të të dhënave gjatë dhe pas migrimit, është implementuar gjithashtu platforma e monitorimit dhe auditimit të databazës (Database Activity Monitoring – DAM), e cila siguron gjurmueshmëri të plotë të çdo veprimi që lidhet me aksesimin, ndryshimin, ekstraktimin apo përpunimin e të dhënave. Kjo platformë

mundëson regjistrimin në kohë reale të aktiviteteve, identifikimin e aksesimeve të paautorizuara dhe krijimin e një historiku të plotë auditimi, duke forcuar transparencën.

Këshilli i Lartë Gjyqësor mbetet maksimalisht i angazhuar për realizimin e plotë, të sigurt dhe cilësor të këtij projekti, si një hap vendimtar drejt modernizimit dhe forcimit të sistemit gjyqësor, me qëllim zbatimin në përputhje me planifikimin strategjik dhe afatet e përcaktuara.

7. STRATEGJIA KOMBËTARE E ULJES SË NUMRIT TË ÇËSHTJEVE TË PRAPAMBETURA NË GJYKATA

Drejtësia nuk matet vetëm me përmbajtjen e vendimeve gjyqësore, por në mënyrë thelbësore me kohën e arsyeshme brenda së cilës qytetarët arrijnë t'i marrin ato. Në këtë kuptim, dimensioni kohor përbën një komponent kritik të efektivitetit të sistemit gjyqësor dhe të besimit publik ndaj tij. Vonesat e zgjatura në shqyrtimin dhe përfundimin e çështjeve nuk përfaqësojnë thjesht një problem procedural, por reflektojnë kufizime strukturore në aftësinë e sistemit për të garantuar akses real dhe në kohë në drejtësi.

Për një periudhë të konsiderueshme kohore, sistemi gjyqësor shqiptar është përballur me këtë sfidë në mënyrë të vazhdueshme, duke krijuar situata ku qytetarët presin për vite të tëra për marrjen e një vendimi përfundimtar. Një pritje e tillë tejkalon dimensionin administrativ të vonesës dhe përbën një indikator të drejtpërdrejtë të presionit mbi kapacitetet operacionale të sistemit.

Backlog-u i çështjeve gjyqësore nuk është një fenomen i ri dhe as një zhvillim i rastësishëm, por është rezultat i një procesi të akumuluar ndër vite, ku rritja progresive e volumit të çështjeve nuk ishte parashikuar për tu shoqëruar në mënyrë proporcionale me zhvillimin e kapaciteteve institucionale, burimeve njerëzore dhe mekanizmave të menaxhimit të ngarkesës.

Historikisht, ky fenomen është perceptuar dhe trajtuar kryesisht si një pasojë e pashmangshme e kompleksitetit të sistemit gjyqësor, duke çuar në një qasje kryesisht pasive, të orientuar drejt menaxhimit të situatës ekzistuese dhe jo drejt zgjidhjes së saj strukturore. Kjo qasje ka kontribuar në konsolidimin e *backlog*-ut si një gjendje e qëndrueshme, në vend që të trajtohej si një devijim që kërkon ndërhyrje të synuara.

Analiza e performancës së sistemit gjyqësor evidenton qartë se *backlog*-u nuk përbën një fenomen të pashmangshëm, por një tregues të drejtpërdrejtë të funksionimit të sistemit dhe të efikasitetit të mekanizmave të tij të brendshëm. Si i tillë, ai kërkon një qasje të re, të bazuar në ndërhyrje të drejtpërdrejta, të qëndrueshme dhe të mirëstrukturuara.

Adresimi efektiv i *backlog*-ut nënkupton kalimin nga një model reaktiv në një model proaktiv, i cili përfshin forcimin e kapaciteteve njerëzore dhe organizative, përmirësimin e proceseve të menaxhimit të çështjeve, përdorimin e instrumenteve të monitorimit dhe analizës së performancës sipas indikatorëve të CEPEJ-it, si dhe ndërhyrje të targetuara në nivelet me ngarkesë më të lartë.

Viti 2025 shënon një moment thelbësor në trajtimin e *backlog*-ut në sistemin gjyqësor shqiptar, duke përfaqësuar kalimin nga një fazë e identifikimit të problemit në një fazë të ndërhyrjes së strukturuar mbi të. Qasja institucionale është orientuar drejt ndërtimit të një baze të dhënash të plotë, të saktë dhe të matshme mbi çështjet e prapambetura, si parakusht për çdo ndërhyrje efektive.

Procesi i inventarizimit të *backlog*-ut ka mundësuar identifikimin, klasifikimin dhe strukturimin e dhjetëra mijëra çështjeve, duke krijuar një panoramë të konsoliduar të situatës në nivel sistemi. Ky zhvillim përbën një hap cilësor përtej një ushtrimi statistikor, pasi çdo njësi e identifikuar përfaqëson një çështje konkrete dhe një kërkesë reale të qytetarëve për drejtësi në kohë. Në këtë kuptim, të dhënat e gjeneruara nuk janë thjesht tregues numerikë, por një reflektim i drejtpërdrejtë i nevojës për ndërhyrje institucionale.

Ndryshimi qëndron në faktin se sistemi tashmë operon mbi një njohje të plotë dhe të verifikuar të fenomenit të *backlog*-ut. Pa një identifikim të saktë dhe të standardizuar të problemit, çdo përpjekje për zgjidhje do të ishte e fragmentuar dhe me efekt të kufizuar. Në këtë drejtim, procesi i inventarizimit përbën themelin mbi të cilin ndërtohen politikat dhe ndërhyrjet e mëtejshme.

Kjo fazë, megjithëse shpesh e nënvlerësuar në diskursin publik, ka një rëndësi, pasi krijon kushtet për matjen e saktë të performancës së sistemit, identifikimin e pikave kritike të ngarkesës dhe ndërtimin e mekanizmave të targetuar të ndërhyrjes.

Si rezultat, sistemi gjyqësor ka kaluar nga një situatë ku *backlog*-u trajtohej në mënyrë të përgjithshme dhe pa parametra të qartë, në një fazë ku ai njihet, matet dhe monitorohet në mënyrë sistematike.

Në këtë kuadër, janë ndërmarrë masa konkrete për grupimin e çështjeve sipas natyrës dhe kompleksitetit, vendosjen e prioriteteve në trajtimin e tyre, krijimin e listave të strukturuara të grup-çështjeve, si dhe aplikimin e mekanizmave për trajtimin me përparësi të kategorive të caktuara.

Kjo qasje synon të rrisë ndjeshëm shpejtësinë e trajtimit dhe efiçencën operacionale të gjykatave, duke optimizuar përdorimin e burimeve ekzistuese. Në thelb, bëhet fjalë për një ndryshim të modelit të funksionimit, i cili kalon nga trajtimi individual dhe i fragmentuar i çështjeve, drejt një menaxhimi të integruar.

Ky zhvillim përfaqëson jo vetëm një përmirësim teknik, por një transformim të kulturës organizative të sistemit gjyqësor, duke vendosur në qendër të tij parimet e efikasitetit, planifikimit dhe përgjegjshmërisë institucionale.

Paralelisht me ndërhyrjet në menaxhimin e *backlog*-ut, gjatë vitit 2025 është zhvilluar një proces i rëndësishëm standardizimi dhe profesionalizimi i funksionimit të brendshëm të gjykatave. Ky proces ka përfshirë implementimin e modeleve standarde për aktet procedurale, rritjen e rolit të ndihmësve ligjorë përmes delegimit të detyrave, forcimin e kapaciteteve përmes trajnimeve të stafit mbështetës, si dhe zgjerimin e përdorimit të dokumentacionit elektronik.

Në tërësi, këto masa kontribuojnë në ndërtimin e një sistemi më të organizuar, më të parashikueshëm dhe më efikas, duke reduktuar variabilitetin procedural dhe duke rritur koherencën në praktikën gjyqësore. Praktika të tilla përbëjnë standard në sistemet gjyqësore të konsoliduara dhe, në kontekstin shqiptar, përfaqësojnë një hap të rëndësishëm drejt modernizimit funksional dhe institucional të drejtësisë.

Megjithatë, procesi i transformimit nuk paraqitet linear dhe mbetet i shoqëruar me sfida të konsiderueshme. Të dhënat e raportuara evidentojnë qartë se përpjekjet për uljen e *backlog*-ut përballen me kufizime të forta strukturore, ku ndër më të theksuarat mbetet mungesa e burimeve njerëzore.

Në disa raste, reduktimi i kapaciteteve operative përfshirë tkurrjen e ekipeve të dedikuara për trajtimin e *backlog*-ut, si dhe ndërprerja e mbështetjes nga projekte specifike, kanë ndikuar drejtpërdrejt në ritmin dhe qëndrueshmërinë e ndërhyrjeve. Këto zhvillime tregojnë se, pavarësisht përmirësimeve në organizim dhe metodologji, kapacitetet institucionale mbeten faktor përcaktues për arritjen e rezultateve konkrete.

Në këtë kuptim, *backlog*-u nuk mund të trajtohet thjesht si një problem i brendshëm i gjykatave, por si një çështje që lidhet ngushtësisht me mënyrën e financimit, mbështetjes dhe organizimit të sistemit në tërësi. Mungesa e burimeve të mjaftueshme njerëzore dhe financiare, si dhe e një mbështetjeje të qëndrueshme institucionale, rrezikon të kufizojë efektin e ndërhyrjeve të ndërmarra.

Në këtë kontekst, viti 2025 duhet konceptuar si një vit themelimi, në të cilin nuk pritet eliminimi i menjëhershëm i *backlog*-ut, por krijimi i kushteve reale për uljen e tij të qëndrueshme në periudhën afatmesme dhe afatgjatë.

Ky vit karakterizohet nga ndërtimi i instrumenteve kryesore operacionale dhe analitike, të cilat do të shërbejnë si bazë për prodhimin e rezultateve konkrete në vitet në vijim. Pikërisht për këtë arsye, ai përbën edhe fazën më kritike të procesit, ku përcaktohet nëse reformat e ndërmarra do të konsolidohen apo do të mbeten të pjesshme.

Faza aktuale përfaqëson një moment vendimtar për sistemin gjyqësor shqiptar. Konsolidimi i mekanizmave të krijuar kërkon sigurimin e burimeve të mjaftueshme njerëzore dhe financiare, institucionalizimin e standardeve të reja të punës, si dhe forcimin e koordinimit ndërinstitucional.

Nëse këto kushte plotësohen, ekziston një mundësi reale për të adresuar në mënyrë të qëndrueshme një nga problematikat më të hershme dhe më komplekse të sistemit të drejtësisë. Në të kundërt, ekziston rreziku që ndërhyrjet e ndërmarra të mbeten në një fazë tranzitore, pa arritur të prodhojnë efektin e plotë të synuar.

Në përfundim, adresimi i *backlog*-ut tejkalon dimensionin e një reforme administrative apo teknike. Ai lidhet drejtpërdrejt me një nga elementët themelorë të shtetit të së drejtës që është besimin e qytetarëve në funksionimin efektiv dhe në kohë të drejtësisë.

Vonesat në dhënien e drejtësisë cenojnë vlerën e saj, ndërsa përmirësimi i ritmit, organizimit dhe përgjegjshmërisë institucionale kontribuon në rikthimin e besimit publik dhe në rritjen e legjitimitetit të sistemit gjyqësor.

Në këtë kuadër, zhvillimet e vitit 2025 tregojnë se procesi i transformimit ka hyrë në një fazë konkrete implementimi. Pas një periudhe të gjatë, mund të konstatohet se adresimi i *backlog*-ut nuk mbetet në nivel deklarativ, por po materializohet si një realitet në ndërtim, i cili kërkon vijimësi, konsolidim dhe mbështetje të qëndrueshme për të arritur rezultatet e pritshme.

8. ANALIZA MBI SITUATËN E GJYKATAVE

Metodologjia

Analiza statistikore e sistemit gjyqësor e realizuar në mënyrë vjetore nga KLGJ-ja në bazë të metodologjisë së CEPEJ-it, përpunon dhe analizon 5 indikatorë apo tregues të funksionimit të gjykatës, të tillë si: ngarkesa mesatare për gjyqtar (treguesi WR), rendimenti mesatar për gjyqtar (treguesi ER), norma e zgjidhjes së çështjeve (treguesi CR), raporti i qarkullimit të çështjeve (treguesi RQC) dhe koha e nevojshme për evadimin e çështjeve (treguesi DT).

Analiza e këtyre treguesve për secilën gjykatë dhe përpunimi i tyre për grupet e gjykatave ofron informacion të vlefshëm për performancën e tyre.

Në përgjithësi, analiza statistikore e sistemit gjyqësor në bazë të metodologjisë së CEPEJ-it, sjell një qasje më të përpiktë dhe të bazuar në fakt për të vlerësuar dhe përmirësuar performancën e sistemit gjyqësor në Shqipëri.

KATEGORIA	TREGUESI	ÇFARË TREGON
BURIMET NJERËZORE	Burimet njerëzore ***efektive***	Llogaritur mbi bazën e kontributit real dhe konkret të çdo gjyqtari.
MENAXHIMI I ÇËSHTJEVE	*Backlog*-u i mbartur nga një vit më parë	Përcaktohet nga numri i çështjeve në pritje të gjykimit në fillim të periudhës së raportimit. Sa më i madh të jetë *backlog*-u aq më pak efiçent ka qenë sistemi gjyqësor / gjykata në menaxhimin e fluksit të çështjeve në vite dhe aq më shumë kohë do t'i duhet për të gjykuar çështjet.
	Çështjet e reja të regjistruara	Numri i çështjeve që regjistrohen në gjykatë gjatë periudhës së raportimit. Tregon trendin e çështjeve që pritet të regjistrohen në gjykatë përcaktuar nga ndryshime ligjore, demografike, ekonomike, sociale, etj.
	Ngarkesa e punës në gjykatë	Shuma e *backlog*-ut dhe çështjet e reja të regjistruara
	Ngarkesa mesatare e punës për gjyqtar **(treguesi WR)**	Ngarkesa e punës në gjykatë në raport me numrin efektiv të gjyqtarëve. Shërben si element krahasues mes të njëjtit juridiksion dhe nivel gjykimi për të përcaktuar ngarkesën e gjyqtarëve në kushte të ngjashme.
	Backlog-u i mbartur në fund të periudhës së raportimit	Numri i çështjeve në pritje të gjykimit në fund të periudhës së raportimit. Krahasuar me atë të llogaritur në fillim të periudhës së raportimit tregon ecurinë gjatë vitit të gjykatës / juridiksionit.
EFIÇENCA	Rendimenti mesatar i punës për gjyqtar **(Treguesi ER)**	Raporti ndërmjet numrit të çështjeve të zgjidhura dhe numrit të gjyqtarëve efektivë gjatë periudhës së raportimit. Shërben si element krahasues mes të njëjtit juridiksion dhe nivel gjykimi për të vlerësuar rendimentin e gjyqtarëve në kushte të ngjashme.
	Koha e nevojshme për evadimin e çështjes (**treguesi DT**) shprehur në ditë	Raporti i numrit të çështjeve të pazgjidhura me numrin e çështjeve të zgjidhura gjatë periudhës së monitoruar shumëzuar me 365. Raporti mat se sa shpejt sistemi gjyqësor punon mbi çështjet e marra, që do të thotë sa kohë duhet për një lloj të caktuar çështjeje për t'u zgjidhur. Ky tregues jep një perceptim se si sistemi gjyqësor menaxhon sasinë apo fluksin e çështjeve të ardhura.
	Norma e likuidimit të çështjeve (**treguesi CR**)	Përcaktohet nga raporti ndërmjet çështjeve të përfunduara brenda një periudhe dhe çështjeve të reja, dhënë në përqindje.


8.1 GJYKATA E LARTË E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Çështje në pritje të gjykimit (*Backlog*)

(Pending Cases – Gjykata e Lartë)

Në fillim të vitit 2025, Gjykata e Lartë ka hyrë me një *backlog* prej 20,888 çështjesh në pritje të gjykimit, duke reflektuar një stok të konsiderueshëm të trashëguar nga vitet e mëparshme. Ky volum mbetet një nga sfidat më të rëndësishme strukturore për funksionimin e gjykatës dhe për garantimin e standardit të drejtësisë në kohë, në përputhje me metodologjinë e CEPE-it.

Megjithatë, krahasuar me vitin 2024, *backlog*-u ka pësuar një ulje të ndjeshme prej 5,170 çështjesh (-20%), duke përbërë një nga zhvillimet më domethënëse pozitive në nivel sistemi. Ky reduktim pasqyron rritjen e ritmit të shqyrtimit të çështjeve, përmirësimin e organizimit të brendshëm të gjykatës dhe zbatimin e masave të dedikuara për trajtimin e stokut të prapambetur.



Grafiku nr.1

Struktura e *backlog*-ut sipas natyrës së çështjeve evidenton një dominim të qartë të juridiksionit civil:

- 64% e *backlog*-ut përbëhet nga çështje civile, duke konfirmuar këtë kategori si më të mbingarkuarën;
- 28% përbëhet nga çështje administrative, të cilat vijojnë të kenë një peshë të konsiderueshme në stok;
- vetëm 8% përbëhet nga çështje penale, që mbeten relativisht të kufizuara në raport me kategoritë e tjera.

Kjo shpërndarje reflekton jo vetëm volumin e çështjeve në shkallët më të ulëta, por edhe kompleksitetin më të lartë të çështjeve civile dhe administrative në nivel kasacioni.

Reduktimi prej 20% i *backlog*-ut përbën një indikator të qartë se Gjykata e Lartë ka hyrë në fazë aktive të reduktimit të stokut, ndryshe nga nivelet e tjera të sistemit që ndodhen ende në fazë stabilizimi. Në metodologjinë CEPEJ, kjo nënkupton se gjykata po arrin një CR efektivisht mbi 100% (në trend), ritmi i përfundimit të çështjeve po tejkalon fluksin hyrës dhe gjykata ka kaluar nga faza e akumulimit në fazën e de-akumulimit të *backlog*-ut.

Gjykata e Lartë për vitin 2025 shënon një kthesë të rëndësishme drejt reduktimit të *backlog*-ut, duke kaluar nga një fazë akumulimi historik në një fazë aktive të përmirësimit të efiçencës dhe administrimit gjyqësor.

Çështje të reja të regjistruara
(*Incoming Cases – Gjykata e Lartë*)


Gjatë vitit 2025, në Gjykatën e Lartë janë regjistruar gjithsej 2,433 çështje të reja, duke shënuar një rënie të lehtë prej 1.5% krahasuar me vitin 2024 (−36 çështje). Ky ndryshim minimal tregon një qëndrueshmëri të fluksit hyrës, duke konfirmuar se presioni mbi këtë gjykatë mbetet i lartë dhe i vazhdueshëm.

Në kontekstin e analizës shumëvjeçare, ky stabilitet i *incoming* nënkupton se Gjykata e Lartë operon në një mjedis me fluks të konsoliduar çështjesh, ku reduktimi i *backlog*-ut nuk mund të vijë si rezultat i uljes së hyrjeve, por vetëm përmes rritjes së kapaciteteve dhe përmirësimit të performancës.

Shpërndarja sipas juridiksioneve tregon një balancë relativisht të shpërndarë, me dominim të juridiksionit administrativ:

- 42% (1,012 çështje) i përkasin juridiksionit administrativ, duke konfirmuar rolin e rëndësishëm të këtij segmenti në volumet e përgjithshme të Gjykatës së Lartë;
- 32% (778 çështje) i përkasin juridiksionit penal, që vijon të ketë një peshë të konsiderueshme në ngarkesën e punës;
- 26% (643 çështje) i përkasin juridiksionit civil, duke ruajtur një kontribut të qëndrueshëm në totalin e çështjeve.

Kjo strukturë tregon një shpërndarje më të balancuar krahasuar me *backlog*-un, i cili dominohet nga çështjet civile, duke reflektuar diferencat në kompleksitet dhe kohëzgjatje ndërmjet juridiksioneve.



Grafiku nr.2


Qëndrueshmëria e *incoming* është një element kyç në vlerësimin e efiçencës. Mungesa e rritjes së ndjeshme të çështjeve të reja krijon kushte më të favorshme për reduktimin e *backlog*-ut. Një fluks i qëndrueshëm lejon planifikim më të mirë të burimeve dhe të kapaciteteve gjyqësore. Qëndrueshmëria e fluksit të çështjeve të reja krijon kushte të favorshme për Gjykatën e Lartë që të konsolidojë trendin e reduktimit të *backlog*-ut, duke e bërë performancën e brendshme faktor vendimtar për efiçencën.

Ngarkesa totale e Gjykatës së Lartë
(*Total Caseload – 2025*)

Në vitin 2025, ngarkesa e përgjithshme e Gjykatës së Lartë ka shënuar një ulje të konsiderueshme prej 5,206 çështjesh, që përkthehet në një reduktim prej 18% krahasuar me vitin 2024. Ky zhvillim përfaqëson një nga treguesit më domethënës të përmirësimit të efiçencës në këtë nivel gjyqësor.

Ulja e ngarkesës totale është rezultat i drejtpërdrejtë i reduktimit të *backlog*-ut (-20%), rritjes së ritmit të shqyrtimit të çështjeve dhe zbatimit të qëndrueshëm të masave për përmirësimin e administrimit gjyqësor.

Si rrjedhojë, viti 2025 paraqet nivelin më të ulët të ngarkesës së punës në pesë vitet e fundit, duke reflektuar një kthesë të rëndësishme në trajektoren e performancës së Gjykatës së Lartë.



Grafiku nr.3

Në metodologjinë CEPEJ, ulja e ngarkesës totale konsiderohet një tregues i drejtpërdrejtë i përmirësimit të balancës ndërmjet hyrjeve dhe daljeve, reduktimit të presionit operacional mbi gjykatën dhe rritjes së kapacitetit për menaxhimin efektiv të çështjeve.

Në rastin konkret, kombinimi i uljes së *backlog*-ut dhe stabilitetit të *incoming*, tregon se Gjykata e Lartë ka arritur një balancë funksionale më të qëndrueshme, duke kaluar në një fazë më të avancuar të efiçencës krahasuar me nivelet e tjera të sistemit.

Viti 2025 shënon një ulje të ndjeshme të ngarkesës totale në Gjykatën e Lartë, duke reflektuar një fazë reale përmirësimi të efiçencës dhe krijuar bazën për reduktimin e qëndrueshëm të *backlog*-ut.

Ngarkesa mesatare e punës për gjyqtar (Treguesi WR)
(*Workload Ratio – Gjykata e Lartë*)

Në vitin 2025, treguesi i ngarkesës mesatare për gjyqtar (treguesi WR) në Gjykatën e Lartë ka shënuar një ulje prej 12%, duke rënë nga 1,602.6 çështje për gjyqtar në vitin 2024, në 1,405 çështje për gjyqtar.

Ky përmirësim vjen në një kontekst ku numri efektiv i gjyqtarëve është ulur me 7% (nga 17.8 në 16.6), ndërkohë, ngarkesa totale e gjykatës është reduktuar ndjeshëm (-18%).

Kjo tregon se ulja e treguesit WR nuk është rezultat i rritjes së kapaciteteve njerëzore, por kryesisht i reduktimit të *backlog*-ut dhe ngarkesës totale të sistemit.

Ngarkesa mesatare e punës për gjyqtar për Gjykatën e Lartë

Numri efektiv i gjyqtarëve 2024	Numri efektiv i gjyqtarëve 2025	# në %	Treguesi WR 2024	Treguesi WR 2025	# në %
17.8	16.6	-7%	1602.6	1405	-12%

Në metodologjinë CEPEJ, treguesi WR është një indikator kyç për vlerësimin e presionit mbi gjyqtarët dhe kapacitetin e sistemit për të përpunuar çështjet. Ulja e treguesit WR në Gjykatën e Lartë tregon një lehtësim të presionit operacional mbi gjyqtarët, një përmirësim të balancës ndërmjet volumit të çështjeve dhe kapaciteteve ekzistuese dhe krijimin e kushteve më të favorshme për rritjen e cilësisë së vendimmarrjes. Megjithatë, niveli prej 1,405 çështjesh për gjyqtar mbetet ende relativisht i lartë, duke reflektuar faktin se gjykata vijon të operojë në kushte të një ngarkese të konsiderueshme.

Reduktimi i ngarkesës për gjyqtar në Gjykatën e Lartë tregon një përmirësim real të efiçencës, duke krijuar kushte për një administrim më cilësor dhe më efektiv të drejtësisë në nivelin më të lartë gjyqësor.

TREGUESIT E EFIÇENCËS

Rendimenti mesatar i punës për gjyqtar (Treguesi ER)

(*Efficiency Rate – Gjykata e Lartë*)

Në vitin 2025, treguesi i rendimentit mesatar për gjyqtar (ER) në Gjykatën e Lartë ka shënuar një rënie të lehtë prej 3.5%, duke arritur në 414 çështje për gjyqtar, nga 429.2 çështje për gjyqtar në vitin 2024. Në terma absolute çdo gjyqtar ka përfunduar mesatarisht 15 çështje më pak, numri total i çështjeve të gjykuara ka rënë me 10%, nga 7,639 në 6,876 çështje.

Kjo rënie lidhet drejtpërdrejt me uljen e numrit të gjyqtarëve efektivë me 7% (nga 17.8 në 16.6) dhe ndryshimin e fokusit të gjykatës drejt trajtimit të *backlog*-ut historik.

Përqendrimi i fokusit në uljen e *backlog*-ut, si edhe respektimi i shqyrtimit të çështjeve nga ana e gjykatës sipas rendit kronologjik të kohës së paraqitjes së kërkesë/padisë në gjykatë, ka ndikuar në ritmin e shqyrtimit të çështjeve të reja.

Rendimenti mesatar i punës për gjyqtar për Gjykatën e Lartë

Gjykata e Lartë	Çështje të gjykuara 2024	Çështje të gjykuara 2025	# në %	Gjyqtarë 2024	Gjyqtarë 2025	# në %	ER 2024	ER 2025	# në % i ER
	7639	6876	-10%	17.8	16.6	-7%	429.2	414	-3.5%

Në metodologjinë CEPEJ, ER është një tregues që mat produktivitetin e gjyqtarëve, por ai duhet analizuar gjithmonë në kontekstin e kompleksitetit të çështjeve, strukturës së *backlog*-ut dhe politikave të menaxhimit të gjykatës.

Në rastin e Gjykatës së Lartë, rënia e ER nuk përbën domosdoshmërisht një përkeqësim të efiçencës, por reflekton një zhvendosje të fokusit drejt shqyrtimit të çështjeve më të vjetra dhe më komplekse, respektimin e parimit kronologjik të shqyrtimit dhe një proces më të thelluar vendimmarrjeje, që kërkon më shumë kohë.

Norma e likuidimit të çështjeve (Treguesi CR)
(*Clearance Rate – Gjykata e Lartë*)

Në vitin 2025, Gjykata e Lartë ka arritur një zhvillim thelbësor në efiçencën e saj, duke tejkaluar pragun 100% të treguesit CR në të tre juridiksionet (civil, administrativ dhe penal). Ky rezultat konfirmon se gjykata jo vetëm ka përballuar plotësisht fluksin e çështjeve të reja, por ka hyrë në një fazë aktive të reduktimit të *backlog*-ut historik.

Në metodologjinë CEPEJ, një CR > 100% përfaqëson kushtin themelor për:

- ndalimin e akumulimit të çështjeve;
- dhe fillimin e reduktimit progresiv të stokut të trashëguar.

Performanca e Gjykatës së Lartë paraqitet në nivele shumë të larta në të gjitha juridiksionet:

- Çështjet civile – CR 373% (+15.4%)


  Ky është treguesi më i lartë dhe ka ndikimin më të madh në reduktimin e *backlog*-ut, duke qenë se juridiksioni civil përbën peshën kryesore të stokut. Niveli shumë i lartë i CR në këtë kategori tregon një fokus të qartë strategjik në trajtimin e *backlog*-ut civil.

- Çështjet administrative – CR 248% (−47%)

  Megjithëse ka rënie krahasuar me vitin 2024, niveli mbetet shumë mbi pragun 100%, duke garantuar vijimin e reduktimit të *backlog*-ut edhe në këtë juridiksion.

- Çështjet penale – CR 254% (−22%)

  Edhe në këtë kategori, pavarësisht rënies relative, treguesi mbetet në nivele shumë të larta, duke reflektuar një ritëm të qëndrueshëm dhe respektim të prioriteteve procedurale për çështjet penale.




Grafiku nr.4


Në vitin 2025 janë përfunduar gjithsej 6,876 çështje, një rënie prej 10% krahasuar me vitin 2024. Megjithatë, në një perspektivë afatmesme, numri i çështjeve të gjykuara është dyfishuar krahasuar me vitin 2021 (nga 3,325 në 6,876), ndërkohë, numri i gjyqtarëve është rritur ndjeshëm në të njëjtën periudhë.

Kjo tregon një rritje strukturore të kapacitetit të Gjykatës së Lartë, e cila ka mundësuar përballimin dhe reduktimin e *backlog*-ut historik.

Shpërndarja e çështjeve të evaduara në vitin 2025 reflekton një qasje të balancuar dhe strategjike:

- 35% çështje civile – me prioritet për shkak të peshës së tyre në *backlog*;
- 36% çështje administrative – duke konfirmuar përpjekjet për reduktimin e stokut në këtë juridiksion;
- 29% çështje penale – duke ruajtur një ritëm të qëndrueshëm dhe në përputhje me standardet procedurale.





Grafiku nr.5 dhe **Grafiku nr.6**

Treguesi CR në Gjykatën e Lartë për vitin 2025 përbën një nga rezultatet më të rëndësishme në nivel sistemi. Nga analiza dalin disa përfundime thelbësore:

1. Gjykata ka kaluar në mënyrë të qartë në fazën e reduktimit aktiv të *backlog*-ut;
2. Performanca është rezultat i kombinimit të rritjes së kapaciteteve dhe përmirësimit të menaxhimit të çështjeve;
3. Edhe pse disa juridiksione kanë shënuar rënie relative, niveli i CR mbetet shumë i lartë dhe i qëndrueshëm.

Megjithatë, për të garantuar që ky progres të jetë i qëndrueshëm, është e domosdoshme që ky nivel i CR të ruhet në mënyrë të vazhdueshme dhe të shoqërohet me përmirësim të mëtejshëm të treguesve të tjerë, veçanërisht DT.


Gjykata e Lartë në vitin 2025 ka arritur një nivel të lartë të normës së likuidimit, duke kaluar qartazi në fazën e reduktimit të *backlog*-ut dhe duke u pozicionuar si institucioni me performancën më të avancuar në sistemin gjyqësor.

Koha e nevojshme për evadimin e çështjeve (Treguesi DT)
(Disposition Time – Gjykata e Lartë)

Në vitin 2025, treguesi i kohës së nevojshme për evadimin e çështjeve (DT) në Gjykatën e Lartë ka vijuar trendin e përmirësimit, duke arritur 873 ditë mesatarisht, ose 12.5% më pak krahasuar me vitin 2024. Ky është niveli më i ulët i DT në katër vitet e fundit dhe përbën një zhvillim të rëndësishëm në drejtim të rritjes së efiçencës dhe reduktimit të kohës së pritjes për palët.

Ecuria e treguesit DT paraqet dinamika të ndryshme ndërmjet juridiksioneve:

- Çështjet civile – 1762 ditë (+4%)
  Ndryshe nga trendi i përgjithshëm pozitiv, kjo kategori ka shënuar një rritje të lehtë të kohës së shqyrtimit. Ky zhvillim lidhet drejtpërdrejt me:
  - kompleksitetin më të lartë të çështjeve civile në nivel gjykatë e lartë;
  - peshën dominuese të tyre në *backlog*;
  - dhe fokusin në trajtimin e çështjeve të vjetra.
    Për rrjedhojë, juridiksioni civil vijon të mbetet segmenti më problematik në aspektin e kohëzgjatjes.
- Çështjet administrative – 641 ditë (−23%)
  Kjo kategori ka shënuar një përmirësim të ndjeshëm, me 189 ditë më pak kohë për evadim. Ky zhvillim tregon një rritje të qartë të efiçencës në trajtimin e çështjeve administrative, edhe pse niveli mbetet ende relativisht i lartë.
- Çështjet penale – 89 ditë (−68.4%)
  Përmirësimi në këtë kategori është shumë i theksuar, me një reduktim prej 193 ditësh. Ky është një nga rezultatet më të forta të vitit 2025 dhe reflekton:
  - prioritetin procedural të çështjeve penale;
  - dhe angazhimin për respektimin e të drejtave themelore të palëve në proces.



Grafiku nr.7

Në metodologjinë CEPEJ, treguesi DT është një indikator thelbësor për vlerësimin e efikasitetit real të sistemit dhe respektimit të standardit të "gjykimit brenda një afati të arsyeshëm".

Përmirësimi i përgjithshëm i DT në Gjykatën e Lartë tregon se reduktimi i *backlog*-ut ka filluar të reflektohet në kohën e shqyrtimit dhe se sistemi po lëviz drejt standardeve më të pranueshme të efiçencës. Diferencat ndërmjet juridiksioneve mbeten të theksuara.

Veçanërisht, niveli i lartë i DT për çështjet civile vijon të jetë një indikator kritik që kërkon ndërhyrje të mëtejshme.

Gjykata e Lartë ka arritur një përmirësim të ndjeshëm të kohës së shqyrtimit në vitin 2025, duke reflektuar efektet e reduktimit të *backlog*-ut, por mbetet nevoja për ndërhyrje të mëtejshme, veçanërisht në juridiksionin civil.

Backlog-u në fund të vitit
(Gjykata e Lartë – 2025)

Në fund të vitit 2025, Gjykata e Lartë rezulton me një *backlog* prej 16,445 çështjesh në pritje të gjykimit, duke shënuar një ulje të ndjeshme prej 4,443 çështjesh (-21%) krahasuar me fillimin e vitit (20,888 çështje).

Ky reduktim përfaqëson një nga rezultatet më domethënëse të vitit 2025 dhe konfirmon në mënyrë të qartë se gjykata ka hyrë në një fazë të konsoliduar të reduktimit aktiv të *backlog*-ut historik.

Struktura e *backlog*-ut vijon të dominohet nga juridiksioni civil:

- 70% çështje civile – duke mbetur kategoria më problematike për shkak të volumit dhe kompleksitetit të lartë;
- 27% çështje administrative – që vijojnë të përbëjnë një peshë të konsiderueshme në stok;
- vetëm 3% çështje penale – një nivel shumë i ulët, që reflekton trajtimin prioritar dhe efikas të kësaj kategorie.

Kjo shpërndarje konfirmon se sfida kryesore strukturore e Gjykatës së Lartë mbetet *backlog*-u civil, i cili kërkon ndërhyrje të vazhdueshme dhe të targetuara.

Në kuadër të metodologjisë së CEPEJ-it, reduktimi i *backlog*-ut me mbi 20% brenda një viti përbën një indikator shumë të fortë të përmirësimit të efiçencës së sistemit, balancimit efektiv ndërmjet hyrjeve dhe daljeve (CR > 100%) dhe funksionimit të qëndrueshëm të mekanizmave të menaxhimit të çështjeve.

Ky rezultat e pozicionon Gjykatën e Lartë në një nivel të avancuar krahasuar me pjesën tjetër të sistemit gjyqësor.

Nëse ruhet ky ritëm reduktimi (rreth 20% në vit), është realiste të parashikohet që, *backlog*-u i Gjykatës së Lartë mund të reduktohet në nivele minimale brenda 2–3 viteve dhe gjykata të kalojë në një fazë normalizimi funksional, ku shqyrtimi i çështjeve zhvillohet brenda afateve të arsyeshme.

Megjithatë, ky skenar mbetet i kushtëzuar nga ruajtja e treguesit CR mbi 100%, stabiliteti i fluksit të çështjeve të reja dhe vazhdimësia e kapaciteteve njerëzore dhe organizative.

Viti 2025 shënon një reduktim të ndjeshëm të *backlog*-ut në Gjykatën e Lartë, duke konfirmuar hyrjen e saj në një fazë të qëndrueshme përmirësimi dhe duke krijuar premisa reale për eliminimin gradual të stokut të çështjeve të prapambetura në periudhën afatmesme.

Gjetjet kryesore!

Gjykata e Lartë (2025)

Analiza e treguesve të efiçencës për vitin 2025 evidenton një transformim të qartë pozitiv të Gjykatës së Lartë, e cila ka kaluar nga një fazë e mbingarkesës kronike në një fazë të konsoliduar të reduktimit aktiv të *backlog*-ut dhe përmirësimit të performancës.

1. Reduktim i ndjeshëm dhe i qëndrueshëm i *backlog*-ut

Backlog-u është ulur me 21% brenda një viti (−4,443 çështje), duke konfirmuar një progres real dhe të matshëm në trajtimin e stokut historik. Ky është treguesi më i fortë i përmirësimit të performancës në nivel sistemi.

2. Norma e likuidimit shumë mbi standardin (CR > 100%)

Gjykata ka arritur CR mbi 100% në të gjitha juridiksionet, duke hyrë në fazën e ndalimit të akumulimit të çështjeve dhe reduktimit aktiv të *backlog*-ut.

Veçanërisht CR civil 373%, tregues ndikimi kryesor në uljen e *backlog*-ut dhe CR administrativ dhe penal mbi 200%, që tregon performancë shumë të lartë dhe të qëndrueshme.

3. Ulje e ndjeshme e ngarkesës totale dhe për gjyqtar (treguesi WR)

- Ngarkesa totale është ulur me 18%;
- Ngarkesa për gjyqtar (treguesi WR) është ulur me 12%, pavarësisht rënies së numrit të gjyqtarëve.

Kjo tregon një rritje reale të efiçencës, jo të varur nga shtimi i burimeve.

4. Stabilitet i fluksit të çështjeve të reja (*incoming*)

Numri i çështjeve të reja ka mbetur pothuajse i pandryshuar (−1.5%), duke krijuar kushte të favorshme për planifikim dhe mundësi reale për reduktim të *backlog*-ut përmes performancës së brendshme.

5. Përmirësim i ndjeshëm i kohës së evadimit (DT)

DT mesatar është ulur në 873 ditë (−12.5%), niveli më i mirë në 4 vite. Përmirësim shumë i fortë në penale (−68%) dhe administrative (−23%). Megjithatë, çështjet civile mbeten problematike (DT 1762 ditë), për shkak të kompleksitetit dhe stokut të lartë.

6. Rënie e lehtë e rendimentit (ER), por pa ndikim negativ

ER është ulur me vetëm 3.5%, rënia lidhet kryesisht me uljen e numrit të gjyqtarëve dhe fokusin në çështje të vjetra dhe më komplekse. Pavarësisht kësaj, rezultati neto është pozitiv, pasi *backlog*-u është reduktuar ndjeshëm.

7. Dominim i *backlog*-ut nga çështjet civile

70% e *backlog*-ut është civil, ndaj kjo kategori mbetet sfida kryesore strukturore e Gjykatës së Lartë dhe përcakton ritmin e përmirësimit në vijim.

8. Konsolidim i kapaciteteve dhe rritje strukturore e performancës


Në krahasim me vitin 2021, numri i çështjeve të gjykuara është dyfishuar dhe kapacitetet e gjykatës janë rritur ndjeshëm. Kjo tregon një transformim strukturor të funksionimit të Gjykatës së Lartë.

Gjykata e Lartë ka hyrë në një fazë reale të normalizimit të funksionimit të saj, ku për herë të parë në vite, sistemi prodhon reduktim të qëndrueshëm të *backlog*-ut, duke krijuar premisa konkrete për arritjen e standardeve të drejtësisë në kohë në periudhën afatmesme (2–3 vite).

8.2 GJYKATA E POSAÇME E APELIT PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

Menaxhimi i çështjeve në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar

Çështje në pritje të gjykimit (*Backlog*)
(Pending Cases – Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar)
Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për shkak të kompetencës në gjykimin e një rrethi të posaçëm të veprave penale, karakterizohet nga një numër i vogël i çështjeve të prapambetura edhe për vitin 2025. Viti referues ka nisur për këtë gjykatë me një numër prej 16 çështjesh në pritje të gjykimit (backlog), 9 çështje (rreth 36%) më pak se një vit më parë.
Sikurse ilustrohet grafikisht, evidentohet se në:




Grafiku nr.1

- Vitet 2021- 2022, *backlog*-u paraqitet relativisht i qëndrueshëm, midis 23-24 çështje.
- Vitin 2023 ka një rritje të ndjeshme të *backlog*-ut duke arritur në 34 çështje, kjo si pasojë e ngadalësimit të shqyrtimit të tyre.
- Vitin 2024- 2025 ka rënie të qëndrueshme të *backlog*-ut me nga 9 çështje më pak në secilin vit.

Çështje të reja të regjistruara

(Incoming Cases – Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar)

Gjatë vitit 2025 janë regjistruar gjithsej 445 çështje të reja, ose 13% më shumë se vitin e kaluar. Njëkohësisht viti 2025 shënon vlerën më të lartë të çështjeve të reja të regjistruara në 5 vitet e fundit në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Prirja në rritje e regjistrimeve të reja vihet re që nga viti 2023 e në vijim.



Grafiku nr.2


Çështjet penale administrative përbëjnë pjesën më të madhe të regjistrimeve të reja, si një tendencë e vazhduar përgjatë gjithë periudhës 5-vjeçare të marrë në analizë. Sa i përket çështjeve të regjistruara me natyrë të veprës penale krim, vihet re një rritje prej 17% ose 10

çështje më shumë krahasuar me vitin e kaluar; për këtë kategori çështjesh gjithashtu vihet re një prirje në rritje që prej vitit 2023. Për çështjet e ligjit antimafia, pas rritjes së ndjeshme në vitin 2024, gjatë këtij viti raportues janë regjistruar 9 çështje ose 50% më pak se vitin e kaluar; megjithatë regjistrimet e reja në këtë kategori vijojnë të jenë disa herë më të larta se gjatë periudhës 2021-2023 kur ishin në nivelin e 2-3 çështjeve në vit.

Ngarkesa totale e gjykatës

(Total Caseload – 2025)

Ngarkesa e përgjithshme e gjykatës për vitin 2025 ka arritur nivelet më të larta të pesë viteve të fundit. Sipas të dhënave statistikore, ngarkesa totale për vitin 2025 është rritur me rreth 10% krahasuar me një vit më parë, si pasojë e numrit të lartë të çështjeve të reja të regjistruara. Pavarësisht kësaj rritjeje, Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar mbetet ndër gjykata e apelit me ngarkesën më të ulët në rang republike. Grafikisht ngarkesa e gjykatës në 5 vite paraqitet si vijon.



Grafiku nr.3

Ngarkesa mesatare e punës për gjyqtar (Treguesi WR)

(Workload Ratio – Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar)

Ngarkesa mesatare e punës për gjyqtar në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar për vitin 2025, ka arritur në 46 çështje për gjyqtar. Ky tregues qëndron në nivel gati të njëjtë me vitin 2024 kur secili gjyqtar mesatarisht kishte 45 çështje në ngarkim.

Gjatë vitit 2025, Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ka përfunduar 437 çështje, ose 9% më shumë se vitin e kaluar. Sa i përket natyrës së çështjeve të gjykuara, sikundër pasqyrohet grafikisht në grafikun nr.4, ato paraqiten si më poshtë:


- 83% çështje penale administrative;
- 15% e çështjeve me natyrë krim;
- 2% çështje të ligjit antimafia.



Grafiku nr. 4

Vendimmarrja e Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar

Në vitin 2025, 75% e vendimeve të shkallës së parë janë lënë në fuqi nga gjykata e apelit. Ndërkohë, për pjesën tjetër të vendimeve rezulton se:



Grafiku nr.5

- 8% e çështjeve kanë përfunduar me prishjen e vendimit dhe kthimin e çështjeve për rigjykim, ose ndryshimin e vendimit të shkallës së parë;
- 17% e çështjeve rezultojnë në vendimmarrje të tjera.

TREGUESIT E EFIÇENCËS

Rendimenti mesatar i punës për gjyqtar (Treguesi ER)
(Efficiency Rate – Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar)

Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ka ruajtur pothuajse të njëjtin rendiment mesatar për gjyqtar sikurse dhe në vitin 2024. Gjatë këtij viti, një gjyqtar ka gjykuar mesatarisht 44 çështje, ndërsa në vitin 2024 ky tregues ishte 43 çështje për gjyqtar. Një ndryshim i lehtë i treguesit ka ardhur si rezultat i numrit të gjyqtarëve efektivisht në detyrë.

Rendimenti mesatar i punës për gjyqtar në Gjykatën e Posaçme të Apelit për KKO

Rendimenti mesatar i punës për gjyqtar në Gjykatën e Posaçme të Apelit për KKO	Çështje të gjykuara 2024	Çështje të gjykuara 2025	# në %	Gjyqtarë 2024	Gjyqtarë 2025	ER 2024	ER 2025	# i ER në %
	402	437	+9%	9.3	10	43	44	+2%

Pavarësisht se numri i gjyqtarëve ka një rritje minimale, krahasuar me vitin e kaluar ata kanë arritur të përfundojnë bashkërisht 437 çështje, që përbën një rritje prej 9% krahasuar me vitin 2024. Ky fakt tregon një përmirësim të lehtë të ritmit të përpunimit të çështjeve në këtë gjykatë.

Norma e likuidimit të çështjeve (Treguesi CR)


(*Clearance Rate – Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar*)

Norma e likuidimit të çështjeve në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar për vitin 2025 është 98%, duke pësuar një ulje 4% krahasuar me vitin 2024. Ky tregues edhe pse jo larg pragut prej 100%, vë në dukje se gjykata nuk ka arritur të përfundojë tërësinë e çështjeve të reja të regjistruara gjatë vitit, duke rritur *backlog*-un për vitin pasardhës.

Norma e likuidimit rezulton të jetë ulur në të tre kategoritë e çështjeve:

- Norma më e ulët e likuidimit është regjistruar në kategorinë e çështjeve të ligjit antimafia, me 89%, një rënie prej 16.6% krahasuar me vitin 2024.
- Norma më e lartë e likuidimit është regjistruar për çështjet penale administrative, duke arritur 99%, një rënie prej 4% krahasuar me vitin e kaluar. Kjo tregon një fokus më të madh në shqyrtimin e kësaj kategorie çështjesh që ka peshën kryesore të ngarkesës së punës në gjykatë.
- Norma e likuidimit në kategorinë e krimeve është 93%, ose 3.7% më e ulët krahasuar me vitin 2024. Nga 70 çështje të reja të kësaj kategorie, 5 çështje janë mbartur për vitin pasardhës.


Treguesi CR tregon, pavarësisht përpjekjeve të bëra dhe rritjes së numrit të çështjeve të zgjidhura, se gjykata nuk ka mundur të përballojë fluksin e prurjeve të reja që në vitin 2025 kishte nivelin më të lartë të pesë viteve të fundit. Rritja e numrit të gjyqtarëve do të ndikonte pozitivisht në rritjen e normës së likuidimit të çështjeve.



Grafiku nr.6

Koha e nevojshme për evadimin e çështjeve (Treguesi DT)
(Disposition Time – Gjykata e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar)

Gjatë vitit 2025, përdoruesve të gjykatës iu është dashur të presin mesatarisht 20 ditë për përfundimin e një çështjeje. Ky indikator ka pësuar një rritje të lehtë krahasuar me vitin 2024, kur koha mesatare e evadimit të çështjeve ishte 14.5 ditë. Nga analiza e të dhënave për katër vitet e fundit rezulton se në vitin 2025, edhe pse ky tregues ka pësuar një rritje të lehtë, paraqitet ndjeshëm më i ulët në raport me dy-tre vite më parë.




Grafiku nr.7

Treguesi i kohës së nevojshme për evadimin e çështjeve gjyqësore është një ndër indikatorët cilësorë më të rëndësishëm të sistemit gjyqësor, pasi lidhet drejtpërdrejt me parimin e drejtësisë pa vonesa. Afatet e gjykimit në këtë gjykatë mbeten më të shpejtat në të gjithë sistemin gjyqësor, duke treguar një menaxhim më efektiv të çështjeve dhe një përkushtim të vazhduar për reduktimin e vonesave gjyqësore.

***Backlog*-u në fund të vitit**
(Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar – 2025)

Në fund të vitit 2025, *backlog*-u në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar është 24 çështje, një tregues i përpjekjeve për qëndrueshmëri në menaxhimin e fluksit të çështjeve.



Grafiku nr.8

Ky nivel rezulton më i lartë, 8 çështje më shumë, krahasuar me *backlog*-un në fillim të vitit. Rritja e numrit të çështjeve të reja të regjistruara gjatë vitit 2025, ndjeshëm më e madhe sesa rritja e numrit të gjyqtarëve efektivë, ka qenë faktori dominant që ka ndikuar në rritjen e *backlog*-ut. Përmirësimi i rendimentit dhe rritja e numrit të çështjeve të përfunduara kanë qenë të pamjaftueshëm për të shmangur rritjen e *backlog*-ut.

Vjetërsia e çështjeve në pritje të gjykimit

(Mosha e backlog-ut – Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar)

Shpërndarja e çështjeve sipas kohëzgjatjes së shqyrtimit, sikundër është pasqyruar edhe në grafik, rezulton:



Grafiku nr.9

- 433 çështje (ose 99% e çështjeve të gjykuara) janë përfunduar brenda 6 muajve, duke treguar një ritëm të shpejtë të procesit gjyqësor.
- 4 çështje (ose 1%) janë shqyrtuar brenda një periudhe 6-12 muaj.

- Asnjë çështje nuk ka kaluar 1 vit në shqyrtim, një tregues pozitiv për proceset gjyqësore në këtë gjykatë.

Analiza e tendencës dhe e ndikimit në sistemin gjyqësor nxjerr në pah përqindjen e lartë të çështjeve të përfunduara brenda 6 muajve, çka tregon efikasitet në menaxhimin e proceseve gjyqësore dhe një angazhim për të dhënë drejtësi brenda afateve të arsyeshme.

Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar mbetet një ndër gjykatat më efikase në sistemin gjyqësor. Mospasja e çështjeve që zgjasin mbi 2 vjet tregon respektim të standardeve ndërkombëtare të kohëzgjatjes së proceseve gjyqësore, aspekt thelbësor ky, për ruajtjen e besimit të publikut në sistemin e drejtësisë.

Gjetjet kryesore!

Nga analiza e indikatorëve të performancës së Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar për vitin 2025, rezulton se:

1. Ngarkesa e Gjykatës dhe Evolucioni i *Backlog*-ut

- Në fillim të vitit 2025, *backlog*-u ishte 16 çështje, një rënie prej rreth 36% krahasuar me vitin 2024.
- Në fund të vitit, *backlog*-u ka arritur në 24 çështje, duke pësuar një rritje të lehtë me 8 çështje krahasuar me fillimin e vitit.
- Gjatë vitit 2025 janë gjykuar 437 çështje ose 9% më shumë se vitin e kaluar.

2. Rritja e Ngarkesës dhe Efikasiteti i Gjyqtarëve

- 445 çështje të reja u regjistruan në vitin 2025, 13% më shumë se në vitin 2024, duke shënuar numrin më të lartë të regjistrimeve në 5 vitet e fundit.
- Rendimenti mesatar për gjyqtar (ER) u rrit me vetëm 2%, krahasuar me vitin 2024 dhe çdo gjyqtar trajtoi mesatarisht 44 çështje.
- Norma e likuidimit të çështjeve (CR) ishte 98%, ose 4% më e ulët krahasuar me vitin e kaluar duke treguar se gjykata nuk arriti të përfundonte të gjitha çështjet e reja.

3. Përshpejtimi i Gjykimeve dhe Përmirësimi i Cilësisë së Vendimmarrjes

- Koha mesatare për evadimin e një çështjeje (Treguesi DT) u rrit nga 14.5 ditë në vitin 2024 në 20 ditë në vitin 2025.
- 99% e çështjeve u përfunduan brenda 6 muajve, duke treguar një ritëm të shpejtë të procesit gjyqësor.
- 75% e vendimeve të shkallës së parë u lanë në fuqi, 8% janë kthyer për rigjykim ose ndryshim të vendimit të shkallës së parë dhe 17% vendimmarrje të tjera.

4. Përfundim: Një Gjykatë me Efiçencë të Lartë

- Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar është ndër gjykatat më efikase në sistemin gjyqësor.


- Shqyrtimi i shpejtë i çështjeve dhe rritja e saktësisë së vendimmarrjeve kanë kontribuar në forcimin e besueshmërisë së kësaj gjykate.
- Mosprania e çështjeve që zgjasin mbi 2 vjet është tregues i zbatimit të parimit të drejtësisë pa vonesa.

8.3 GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

Menaxhimi i çështjeve në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar

Çështje në pritje të gjykimit *(Backlog*-u)
(Pending Cases – Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar)

Në janar 2025, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ka nisur punën me 169 çështje në pritje të gjykimit. Ky numër është më i lartë krahasuar me vitin 2024, kur ky *backlog* ishte 126 çështje, duke reflektuar një rritje prej 34%.




Grafiku nr.1

Në krahasim me vitin 2024, *backlog*-u paraqitet më i lartë në të tre kategoritë e çështjeve në shqyrtim prej saj, ku peshën kryesore e kanë çështjet penale administrative me 27 çështje dhe në kategorinë e krimeve me 11 çështje më shumë se një vit më parë.

Aktualisht, *backlog*-u vlerësohet si i pranueshëm dhe i justifikueshëm, pasi përfaqëson çështje që janë efektivisht në proces shqyrtimi dhe nuk ka një mbingarkesë kritike në stokun e çështjeve të pashqyrtuara.

Natyra e *Backlog*-ut

Në analizën e *backlog*-ut për vitin 2025, vërehet një ndryshim në shpërndarjen e kategorive të çështjeve në pritje të gjykimit krahasuar me vitin 2024, specifikisht:



Grafiku nr.2


- 57% e *backlog*-ut përbëhet nga çështje penale administrative, krahasuar me 55% në vitin 2024. Kjo tregon një shtim të *backlog*-ut të kësaj kategorie çështjesh, duke pasqyruar një rritje të ndjeshme të regjistrimeve në këtë kategori.
- 34% e *backlog*-ut përbëhet nga çështje për krime, një shifër më e ulët nga viti i kaluar kur ishte 36%, duke treguar përmirësim në shqyrtimin e kësaj kategorie.
- 9% e *backlog*-ut përbëhet nga çështje të ligjit antimafia, një shifër që ka mbetur e pandryshuar nga viti i kaluar.

Rritja e *backlog*-ut për çështjet penale administrative tregon një ngarkesë më të madhe për këtë natyrë çështjesh. Ulja e *backlog*-ut për çështjet e krimeve është një tregues pozitiv që tregon një ritëm më të mirë të shqyrtimit të këtyre çështjeve.


Çështje të reja të regjistruara
(Incoming Cases – Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar)

Përgjatë vitit 2025, në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar janë regjistruar 3,076 çështje të reja. Në vështrim krahasues me vitin 2024, kjo vlerë është 11% më e ulët ose 383 çështje më pak.

Shpërndarja e çështjeve të regjistruara sipas natyrës për vitin referues, rezulton në 96% çështje penale administrative duke mbizotëruar si kategori çështjesh; 3% çështje me natyrë krim, një përqindje kjo e ulët krahasuar me totalin e çështjeve të regjistruara; dhe vetëm 1% janë çështje të ligjit antimafia, duke përfaqësuar pakicë në shifra, por rëndësi të veçantë në kuadër të luftës kundër krimit të organizuar dhe pastrimit të parave.



Grafiku nr.3




Grafiku nr.4

Ngarkesa totale e gjykatës

(Total Caseload – 2025)

Ngarkesa totale e Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar për vitin 2025, rezulton në 3,245 çështje, sikurse pasqyrohet në grafikun përbri. Në përbërje të saj rezultojnë konkretisht:



Grafiku nr.5

- 94% çështje penale administrative, duke konfirmuar se kjo kategori mbizotëron në punën e gjykatës;
- 4% e çështjeve i përkasin kategorisë krime, një përqindje e vogël në raport me totalin e ngarkesës;
- 2% e ngarkesës përbëhet nga çështje të ligjit antimafia, një kategori që ka mbetur e qëndrueshme krahasuar me vitet e mëparshme.

Dominimi i çështjeve penale administrative tregon një tendencë të vazhdueshme për rritjen e ndjekjeve dhe hetimeve në këtë fushë, duke ndikuar drejtpërdrejt në ngarkesën e gjykatës.

Ngarkesa totale prej 3,245 çështjesh tregon një rënie të fluksit të punës me rreth 9.5% krahasuar me vitin e mëparshëm. Përqindja e ulët e çështjeve për krime dhe ligjin antimafia sugjeron se këto kategori kanë një ndikim më të vogël në volumin e përgjithshëm të punës, por të një rëndësie thelbësore në aspekt të luftës kundër krimit të organizuar.

Ngarkesa mesatare e punës për gjyqtar (Treguesi WR)
(Workload Ratio – Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar)

Ngarkesa mesatare e punës për gjyqtar në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar gjatë viteve 2024-2025, paraqitur në formë tabelare më poshtë, na jep të dhëna duke na mundësuar ballafaqimin mes viteve. Në vitin 2025, ngarkesa mesatare e punës për gjyqtar është 309 çështje, ose 11% më e ulët krahasuar me vitin e mëparshëm. Nga analiza e të dhënave për këtë vit raportues rezulton se numri i gjyqtarëve efektiv ka një ndryshim minimal që vlerësohet pa ndikim në ngarkesën mesatare. Faktori që ka diktuar uljen e ngarkesës është numri i çështjeve të regjistruara të reja, që në vitin 2025 gjithashtu ka rënë me 11% krahasuar me vitin e kaluar.

Ngarkesa mesatare e punës për gjyqtar në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar

Numri i gjyqtarëve efektiv 2024	Numri i gjyqtarëve efektiv 2025	Treguesi WR 2024	Treguesi WR 2025	# në %
10.3	10.5	348	309	-11%

Pavarësisht rënies së ngarkesës mesatare për gjyqtar, nevojitet menaxhim i mirë i burimeve ekzistuese, për të garantuar një ritëm optimal të shqyrtimit të çështjeve.

TREGUESIT E EFIÇENCËS

Rendimenti mesatar i punës për gjyqtar (Treguesi ER)
(Efficiency Rate – Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar)

Treguesit statistikorë sjellin në pah rënien e rendimentit mesatar të punës për gjyqtar në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar gjatë viteve 2024-2025. Treguesi ER për vitin 2025 është 290 çështje për gjyqtar, një rënie prej 13% krahasuar me vitin 2024, kur ky tregues ishte 331.7 çështje për gjyqtar.

Rendimenti mesatar i punës për gjyqtar në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar


Gjyqtarë 2024	Gjyqtarë 2025	ER 2024	ER 2025	# në % i ER
10.3	10.5	331.7	290	-13 %

Këto rezultate tregojnë për rënien e produktivitetit të gjyqtarëve, edhe pse numri i çështjeve të regjistruara është ulur ndjeshëm gjatë vitit 2025. Në këtë situatë, nevojitet marrja e masave nga gjykata për përballimin e volumit të çështjeve dhe përmirësimin e ritmeve të gjykimit.

Norma e likuidimit të çështjeve (Treguesi CR)
(*Clearance Rate – Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar*)

Për sa i përket normës së likuidimit në vitin 2025, ajo paraqitet në të njëjtin nivel prej 99% sikurse vitin e kaluar. Edhe pse gjykata nuk ka arritur të përfundojë të gjitha çështjet e reja të regjistruara, duke bërë që një pjesë e tyre të mbarten në vitin pasardhës, kjo vlerë e treguesit CR nuk vlerësohet problematike sepse është shumë afër pragut prej 100%.

Duke iu referuar grafikut përbri, grafiku nr.6, vihet re se nga kategoria e çështjeve që shqyrton Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, CR për çështjet krim i organizuar është 103%, për çështjet e ligjit antimafia 88% dhe për korrupsionin 86%. Kjo tregon se gjykata i ka dhënë përparësi gjykimit të çështjeve të krimit të organizuar, duke shqyrtuar të gjitha çështjet e reja si dhe disa të mbartura nga viti i kaluar. Më i ulët është niveli për çështjet e ligjit antimafia dhe korrupsionit për shkak edhe të kompleksitetit të tyre.




Grafiku nr.6

Pavarësisht normës së likuidimit prej 99%, CR mbetet në nivele të larta, duke treguar një menaxhim të mirë të ngarkesës. Shtimi i çështjeve të ndërlikuara ka ndikuar në kohën e shqyrtimit, por nuk paraqitet si problematikë serioze. Nëse kjo prirje vazhdon, rritja e *backlog*-ut në vitet e ardhshme mund të kërkojë masa për përshpejtimin e proceseve, si rritja e kapacitetit të gjyqtarëve ose përdorimi i teknologjisë për të përmirësuar menaxhimin e çështjeve.

Koha e nevojshme për evadimin e çështjeve (Treguesi DT)


(*Disposition Time – Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar*)

Koha e nevojshme për evadimin e çështjeve në vitin 2025 rezulton të jetë mesatarisht 24 ditë ose 6 ditë më shumë se vitin e kaluar. Vërehet kështu një rritje e lehtë e kohës së nevojshme për evadimin e çështjeve, që është tregues i ngadalësimit në shqyrtimin e tyre. Niveli i treguesit DT për periudhën 2024-2025 paraqitet në grafik.



Grafiku nr.7


Çështjet me ndjeshmëri të lartë kanë pasur rritje të kohëzgjatjes së shqyrtimit, siç tregohet në grafik:



Grafiku nr.8

- Korrupsioni: Nga 169 ditë në vitin 2024, në 240 ditë në vitin 2025 (+71 ditë).
- Krimi i Organizuar: Nga 426 ditë në vitin 2024, në 376 ditë në vitin 2025 (-50 ditë).
- Ligji Antimafia: Nga 119 ditë në vitin 2024 në 252 ditë në vitin 2025 (+133 ditë).

Sa i takon shpërndarjes së çështjeve sipas kohëzgjatjes së shqyrtimit, ajo paraqitet në raportin më poshtë:



Grafiku nr.9

- 98% e çështjeve (2.979 çështje) janë përfunduar brenda 6 muajve, duke treguar një ritëm të shpejtë për shumicën e rasteve.
- 35 çështje janë shqyrtuar nga 6-12 muaj.
- 23 çështje nga 1-2 vjet.
- 9 çështje kanë kaluar mbi 2 vjet në pritje.

Për shumicën e çështjeve, koha mesatare e shqyrtimit është e arsyeshme, duke respektuar parimin e drejtësisë pa vonesa. Çështjet me natyrë komplekse (korrupsioni, antimafia dhe krimi i organizuar) kërkojnë më shumë kohë për shqyrtim, siç shihet në rritjen e treguesit DT në këto kategori. Koha mesatare e shqyrtimit të çështjeve mbi 2 vjet mbetet shumë e ulët, duke treguar që gjykata po parandalon krijimin e stokut afatgjatë të çështjeve të pashqyrtuara.

***Backlog*-u në fund të vitit**

(Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar – 2025)

Në fund të vitit 2025, *backlog*-u në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar është 199 çështje, ose 30 çështje më shumë se në fillim të vitit. Pavarësisht kësaj, me marrjen e masave të duhura dhe plotësimin me gjyqtarë, ky *backlog* vlerësohet i menaxhueshëm.

Vjetërsia e çështjeve në pritje të gjykimit

(Mosha e backlog-ut – Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar)

Nga analiza e vjetërsisë së çështjeve në pritje të gjykimit rezulton se 80% e stokut përbëhet nga çështje të reja të regjistruara gjatë vitit 2025, duke treguar që pjesa më e madhe e

backlog-ut vjen si pasojë e regjistrimeve të reja, që janë në proces shqyrtimi. Ndërkohë, 18% e çështjeve janë regjistruar në gjysmën e dytë të vitit 2025, që nënkupton se ato janë ende brenda një periudhe të arsyeshme pritjeje.

Nisur nga struktura e çështjeve të prapambetura sipas vjetërsisë, rezulton se:

- 26 çështje (13% e *backlog*-ut) kanë mbi një vit që presin gjykim, një përqindje relativisht e ulët në raport me totalin e çështjeve në stok.
- 9 çështje janë në pritje prej 2-3 vitesh, duke treguar se gjykata ka një numër minimal çështjesh të mbartura në afatgjatë.
- Vetëm 5 çështje kanë vjetërsi më shumë se 3 vjet, një tregues pozitiv që dëshmon se gjykata ka shmangur akumulimin e çështjeve të vjetra.

Vjetërsia e çështjeve në pritje të gjykimit								
Lloji i çështjes		**Numri i çështjeve në pritje të gjykimit**						
		Në pritje të gjykimit në fund të periudhës	**< 6 muaj**	**6-12 muaj**	**1-2 vjet**	**2-3 vjet**	**3-5 vjet**	**> 5 vjet**
A.	Krime	**63**	32	16	8	5	2	
B.	Kundërvajtje penale	**0**						
C.	Çështje penale administrative	**116**	90	12	11	2	1	
D.	Çështje të ligjit antimafia	**20**	1	8	7	2	2	
E.	Çështje penale gjithsej (A+B+C+D)	**199**	**123**	**36**	**26**	**9**	**5**	**0**

Ky vlerësim tregon se, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar po arrin të përpunojë çështjet brenda afateve optimale. Megjithatë, vlen të theksohet se shtimi i numrit të gjyqtarëve dhe përmirësimi i procedurave do të kontribuojnë në rritjen e efikasitetit dhe përmirësimin e vazhdueshëm/mëtejshëm të performancës së Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Gjetjet kryesore!

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ka treguar efiçencë dhe kapacitet të mirë menaxhues gjatë vitit 2025, pavarësisht sfidave të lidhura me çështjet gjyqësore, natyrën dhe kompleksitetin e tyre. Më poshtë paraqiten gjetjet kryesore të analizës:

1. **Ngarkesa e Gjykatës dhe Evolucioni i *Backlog*-ut**
    - Ngarkesa totale për vitin 2025 ishte 3,245 çështje, që përfshin çështjet e mbartura nga viti 2024 dhe ato të regjistruara të reja.

- *Backlog*-u në fillim të vitit 2025 ishte 169 çështje, një rritje prej 34% nga viti 2024.
- Në fund të vitit 2025, *backlog*-u ishte 199 çështje, një rritje prej 18% nga fillimi i vitit, por me masat e duhura do të jetë i menaxhueshëm.

2. **Rritja e Ngarkesës dhe Efikasiteti i Gjyqtarëve**
    - 3,076 çështje të reja u regjistruan në vitin 2025, një rënie me 11% krahasuar me vitin 2024.
    - Rendimenti mesatar për gjyqtar (ER) ishte 290 çështje, një rënie me 13% krahasuar me vitin 2024.
    - Norma e likuidimit të çështjeve (CR) ka mbetur e qëndrueshme në nivelin 99% sikurse dhe në vitin 2024, duke treguar se pothuajse të gjitha çështjet e reja u shqyrtuan.
3. **Përshpejtimi i Gjykimeve dhe Përmirësimi i Cilësisë së Vendimmarrjes**
    - Koha mesatare për përfundimin e një çështjeje (DT) u rrit nga 18 ditë në vitin 2024 në 24 ditë në vitin 2025.
    - 98% e çështjeve u përfunduan brenda 6 muajve, një ritëm i mirë që tregon se gjykata arrin të përpunojë çështjet brenda afateve të arsyeshme.
    - Çështjet komplekse kishin kohëzgjatje më të madhe, si:
        a. Korrupsioni: 240 ditë në vitin 2025 (+71 ditë krahasuar me vitin 2024).
        b. Krimi i organizuar: 376 ditë (ulje nga 426 ditë në vitin 2024).
        c. Ligji antimafia: 252 ditë (+133 ditë krahasuar me vitin 2024).
    - Vetëm 14 çështje kanë kaluar mbi 2 vjet në pritje duke treguar se gjykata ka shmangur akumulimin e çështjeve të vjetra.
4. **Përfundim: Një Gjykatë me Efiçencë të Lartë**
    - Gjykata ka ruajtur një nivel të lartë efiçence duke shqyrtuar pothuajse të gjitha çështjet e reja.
    - Koha e zgjidhjes së çështjeve është rritur sidomos për çështjet komplekse, por gjykata ka arritur të përpunojë 98% të çështjeve brenda 6 muajve.
    - Nëse rritja e *backlog*-ut vazhdon, mund të kërkohet një rritje e mëtejshme e numrit të gjyqtarëve dhe përmirësim i proceseve të punës për të shmangur vonesat në vitet e ardhshme.

8.4 GJYKATA E APELIT TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM

Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, gjatë vitit 2025, ka vijuar të përballet me problematika të vazhdueshme strukturore dhe organizative, të cilat kanë ndikuar drejtpërdrejt në treguesit e efiçencës gjyqësore. Ndryshe nga gjykatat e shkallës së parë, ku vihet re një stabilizim gradual i fluksit dhe reduktim i moderuar i *backlog*-ut, niveli i apelit paraqet një situatë më komplekse dhe më të ndjeshme ndaj faktorëve strukturorë.

Problematikat kryesore që kanë karakterizuar funksionimin e Gjykatës së Apelit gjatë vitit 2025 lidhen me vakancat e zgjatura në trupën gjyqësore, ngarkesën disproporcionale për gjyqtar, stokun e lartë të trashëguar dhe kompleksitetin më të lartë juridik të çështjeve në këtë nivel gjykimi. Si rezultat, treguesit e efiçencës në nivel apeli paraqesin luhatje më të theksuara krahasuar me shkallën e parë, veçanërisht në raport me kohëzgjatjen e gjykimeve dhe normën e likuidimit.


Gjatë vitit 2025, Gjykata e Apelit është përballur me presion të vazhdueshëm të stokut të mbartur, rritje të kohëzgjatjes mesatare të shqyrtimit në disa kategori çështjesh, vështirësi në balancimin e hyrjeve dhe përfundimeve në periudha të caktuara. Ndryshe nga gjykatat e shkallës së parë, ku fokusi kryesor është stabilizimi i fluksit, në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm prioritet strategjik mbetet reduktimi i *backlog*-ut historik, rritja e kapacitetit efektiv për gjykim dhe përmirësimi i kohëzgjatjes së gjykimeve.

Menaxhimi i çështjeve në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm

Çështje në pritje të gjykimit (*Backlog*-u)

(Pending Cases – Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm)

Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm ka hyrë në vitin 2025 me një stok prej 41,700 çështjesh në pritje të gjykimit, duke reflektuar një nivel të lartë të *backlog*-ut strukturor. Ky volum përfaqëson një nga sfidat më serioze të nivelit të dytë të gjykimit dhe dëshmon për akumulim të zgjatur të çështjeve ndër vite. Sipas metodologjisë së CEPEJ-it, ky stok përbën bazën për vlerësimin e kapacitetit të sistemit për të ruajtur balancën ndërmjet hyrjeve dhe përfundimeve dhe ndikon drejtpërdrejt në kohën e evadimit të çështjeve (DT), i cili në nivel apeli është tradicionalisht më i lartë për shkak të kompleksitetit të çështjeve.



Grafiku nr.1

Analiza e shpërndarjes së stokut sipas kategorive tregon një dominim të qartë të çështjeve civile në raport me çështjet penale, 67% çështje civile dhe 33% çështje penale. Ky raport konfirmon një prirje të konsoliduar në nivel apeli, ku çështjet civile përbëjnë peshën kryesore të *backlog*-ut. Shkaku kryesor lidhet me numrin e lartë të ankimeve në çështjet civile dhe me natyrën komplekse që kjo kategori çështjesh gëzon në nivel apeli. Në kontrast, përqindja më

e ulët e çështjeve penale në stok reflekton natyrën më të përshpejtuar të gjykimeve penale dhe respektimin e afateve procedurale të përcaktuara në legjislacionin në fuqi

Rritja dhe konsolidimi i *backlog*-ut në Gjykatën e Apelit janë rezultat i një kombinimi faktorësh strukturorë:

1. Numri i pamjaftueshëm i gjyqtarëve efektivë, krahasuar me volumin e çështjeve të regjistruara.
2. Ngarkesa e lartë për gjyqtar, e cila ka kufizuar kapacitetin për përshpejtim të likuidimit.
3. Stoku historik i mbartur ndër vite, veçanërisht në çështjet civile.
4. Kompleksiteti më i lartë juridik i çështjeve në apel, që kërkon analizë më të thelluar dhe kohë më të gjatë shqyrtimi.


Gjykata e Apelit ka qenë në mënyrë të vazhdueshme në fokus të Këshillit të Lartë Gjyqësor, në këtë kuadër, është përfshirë si prioritet në Strategjinë Kombëtare për Uljen e Numrit të Çështjeve të Prapambetura 2024-2027, e cila synon vendosjen e objektivave të matshëm për reduktimin e stokut, monitorim periodik të treguesve të performancës, rishpërndarje të burimeve njerëzore sipas ngarkesës reale dhe përmirësim të menaxhimit të kalendarëve gjyqësorë. Megjithatë, duke qenë se *backlog*-u në apel është rezultat i akumulimit shumëvjeçar, efektet e strategjisë pritet të jenë të dukshme në periudhë afatmesme dhe jo të menjëhershme.

Ndryshe nga shkalla e parë, ku progresi i vitit 2025 tregon stabilizim dhe reduktim gradual të stokut, Gjykata e Apelit mbetet në një fazë kritike tranzicioni, ku konsolidimi i kapaciteteve njerëzore dhe menaxheriale është kusht i domosdoshëm për përmirësimin e treguesve të efiçencës. *Backlog*-u prej 41,700 çështjesh në fillim të vitit 2025 dëshmon se Gjykata e Apelit përballet me një sfidë strukturore të thellë, veçanërisht në seksionin civil. Përmirësimi i situatës kërkon rritje të kapaciteteve efektive, vazhdimësi në zbatimin e strategjisë kombëtare dhe monitorim të rreptë të treguesve CR dhe DT në nivel apeli. Gjykata e Apelit përfaqëson hallkën më të ndjeshme të sistemit në aspektin e kohëzgjatjes dhe stokut. Stabilizimi i saj do të ketë ndikim të drejtpërdrejtë në performancën e përgjithshme të sistemit gjyqësor.

Çështje të reja të regjistruara

(Incoming Cases – Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm)

Gjatë vitit 2025, në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm janë regjistruar **15,290 çështje të reja**, duke shënuar një **rritje prej 10%** krahasuar me vitin 2024 (1,402 çështje më shumë). Ky zhvillim përfaqëson një rritje domethënëse të presionit hyrës në nivelin e dytë të gjykimit dhe përbën një faktor kritik në analizën e efiçencës, pasi ndikon drejtpërdrejt në balancën ndërmjet hyrjeve dhe përfundimeve (CR), si dhe në dinamikën e *backlog*-ut.



Grafiku nr.2

Shpërndarja e çështjeve të reja sipas natyrës së tyre paraqitet, 60% (9,122 çështje) çështje penale dhe 40% (6,168 çështje) çështje civile. Dominimi i çështjeve penale në hyrjet vjetore është një karakteristikë e veçantë e nivelit të apelit. Kjo situatë lidhet me frekuencën më të lartë të ankimeve në çështjet penale.

Megjithëse përqindja e çështjeve civile është më e ulët, volumi prej mbi 6 mijë çështjesh përbën një ngarkesë të konsiderueshme, veçanërisht duke marrë në konsideratë faktin se gjykimi në një shkallë më të lartë karakterizohet nga një natyrë më komplekse e çështjeve civile të cilat kërkojnë të marrin zgjidhje.

Rritja prej 10% e hyrjeve në një gjykatë që ka hyrë në vit me 41,700 çështje në pritje përforcon presionin strukturor mbi sistemin. Nëse ritmi i përfundimeve nuk rritet në mënyrë proporcionale, rritja e hyrjeve do të ndikojë në përkeqësimin e treguesit CR, do të prodhojë rritje të *backlog*-ut, do të shtojë kohën e nevojshme për evadimin e çështjeve (DT) dhe do të rrisë ngarkesën mesatare për gjyqtar. Në nivel apeli, ky efekt është më i ndjeshëm se në shkallën e parë, pasi çështjet kërkojnë analizë më të thelluar juridike dhe vendimmarrje më komplekse.


Rritja e fluksit hyrës në Gjykatën e Apelit gjatë vitit 2025 përbën një sinjal paralajmërues për nevojën e rritjes së kapaciteteve efektive gjyqësore, përmirësimit të menaxhimit të kalendarëve, prioritizimit të çështjeve me vjetërsi të lartë dhe monitorimit të vazhdueshëm të treguesit CR në nivel apeli. Në mungesë të ndërhyrjeve të mjaftueshme, rritja e vazhdueshme e hyrjeve rrezikon të neutralizojë efektet e strategjisë për reduktimin e *backlog*-ut.

Regjistrimi i 15,290 çështjeve të reja në vitin 2025 konfirmon se Gjykata e Apelit përballet me një presion të shtuar hyrës, veçanërisht në seksionin penal. Ky zhvillim e bën të domosdoshëm përshpejtimin e ritmeve të gjykimit dhe forcimin e kapaciteteve organizative, në mënyrë që rritja e fluksit të mos përkthehet në thellim të *backlog*-ut dhe përkeqësim të treguesve të efiçencës.

Ngarkesa totale e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm

(*Total Caseload – 2025*)

Ngarkesa e përgjithshme e Gjykatës së Apelit për vitin 2025 ka arritur në 56,990 çështje, duke shënuar një rritje prej 5,440 çështjesh krahasuar me vitin 2024. Kjo përfaqëson një rritje vjetore prej rreth 11-12%, duke konfirmuar një trend të qëndrueshëm rritës gjatë tre viteve të fundit.



Grafiku nr.3

Rritja ngarkesës totale për disa vite radhazi sinjalizon një presion të vazhdueshëm strukturor mbi kapacitetin e gjykatës për të ruajtur ekuilibrin midis hyrjeve dhe përfundimeve. Analiza sipas natyrës së çështjeve tregon se 34,283 çështje (60%) i përkasin juridiksionit civil (+2,343 çështje krahasuar me vitin 2024) dhe 22,707 çështje (40%) i përkasin juridiksionit penal (+3,097 çështje krahasuar me vitin 2024). Megjithëse çështjet penale përbëjnë shumicën e hyrjeve të reja, ngarkesa totale dominohet nga çështjet civile, të cilat përbëjnë segmentin më të madh të stokut dhe të volumit total. Kjo diferencë konfirmon se çështjet civile kanë tendencë të qëndrojnë më gjatë në sistem, *Disposition Time* në seksionin civil është më i lartë dhe *backlog*-u civil ka karakter më strukturor dhe më të vështirë për reduktim të shpejtë.

Rritja e ngarkesës totale me 11-12% çdo vit për tre vite radhazi përbën një tregues të qartë të mosbalancimit të plotë ndërmjet hyrjeve dhe përfundimeve, kapaciteteve efektive që nuk janë rritur në të njëjtin ritëm me fluksin, si dhe akumulimit progresiv të stokut, veçanërisht në juridiksionin civil. Në terma praktikë, kjo do të thotë se edhe nëse norma e likuidimit afrohet me 100%, ritmi aktual nuk është i mjaftueshëm për të frenuar rritjen progresive të ngarkesës.

Rritja e vazhdueshme e ngarkesës totale ndikon drejtpërdrejt në rritjen e ngarkesës mesatare për gjyqtar (treguesi WR), përkeqësimin potencial të normës së likuidimit të çështjeve (treguesi CR), rritjen e kohës së nevojshme për evadimin e çështjes (treguesi DT) dhe rrezikun e konsolidimit të *backlog*-ut shumëvjeçar. Nëse trendi aktual nuk shoqërohet me masa strukturore, ekziston rreziku që gjykata të hyjë në një cikël të akumulimit të çështjeve.


Ngarkesa totale prej 56,990 çështjesh për vitin 2025 e pozicionon Gjykatën e Apelit si hallkën më të ndjeshme të sistemit në aspektin e presionit volumor dhe kompleksitetit juridik. Ndryshe nga shkalla e parë, ku vihet re stabilizim dhe reduktim i *backlog*-ut, niveli i apelit karakterizohet nga rritje progresive e volumit, dominim i çështjeve civile në stok, presion i lartë i çështjeve penale në hyrje dhe trend rritës i ngarkesës për disa vite radhazi.

Rritja e ngarkesës totale në Gjykatën e Apelit gjatë vitit 2025, konfirmon se gjykata po përballet me një sfidë strukturore afatgjatë. Stabilizimi i situatës kërkon forcim të burimeve njerëzore, përmirësim të menaxhimit të kalendarëve, përdorimi më efektiv i instrumenteve procedurale për filtrimin dhe menaxhimin e ankimeve; monitorim të vazhdueshëm të normës së likuidimit të çështjeve (treguesi CR) dhe të kohës së nevojshme për evadimin e çështjeve (treguesi DT), si edhe ndërhyrje të targetuara në juridiksionin civil. Ritmi i rritjes prej 11-12% në vit, në mungesë të masave strukturore që adresojnë trendin aktual, me fokus në rritjen proporcionale të kapaciteteve efektive, rrezikon të përkeqësojë treguesit e efiçencës në vitet pasuese. Duke thelluar më tej ngarkesën ekzistuese, me efekt të drejtpërdrejtë në përkeqësimin e vonesave në administrimin e drejtësisë.

Ngarkesa mesatare e punës për gjyqtar (Treguesi WR)

(*Workload Ratio – Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm*)

Në vitin 2025, treguesi i ngarkesës mesatare për gjyqtar (Treguesi WR) në Gjykatën e Apelit ka shënuar një ulje prej 7.3%, duke zbritur nga 1,945.3 çështje për gjyqtar në vitin 2024 në 1,804 çështje për gjyqtar në vitin 2025.



Grafiku nr.4

Kjo ulje ndodh në një kontekst ku ngarkesa totale e gjykatës është rritur me rreth 11-12%, çka tregon se përmirësimi i treguesit WR nuk është rezultat i reduktimit të volumit, por i rritjes së kapacitetit efektiv gjyqësor. Numri efektiv i gjyqtarëve është rritur nga 26.5 në 31.6, ose +19% krahasuar me vitin 2024. Ky shtim ka pasur ndikim të drejtpërdrejtë në shpërndarjen më të balancuar të ngarkesës, uljen e presionit individual për gjyqtar dhe frenimin e përshkallëzimit të mbingarkesës që karakterizonte vitet e mëparshme. Në terma të analizës së kapaciteteve, rritja e trupës gjyqësore ka kompensuar pjesërisht rritjen e hyrjeve dhe të ngarkesës totale, duke shmangur një përkeqësim të mëtejshëm të treguesit WR. Megjithëse ulja prej 7.3% është zhvillim pozitiv, niveli i treguesit WR prej 1,804 çështjesh

për gjyqtar mbetet shumë i lartë në terma krahasues dhe dëshmon për presion të vazhdueshëm në nivel apeli.

Për krahasim konceptual, në shkallën e parë treguesi WR është rreth 607 çështje për gjyqtar ndërsa në apel, ky tregues është pothuajse trefishi. Kjo diferencë nuk është vetëm sasiore, por edhe cilësore, pasi çështjet në apel janë më komplekse dhe kërkojnë analizë më të thelluar juridike.

Rritja e numrit të gjyqtarëve ka prodhuar efekt të menjëhershëm pozitiv, por vetëm shtimi i trupës gjyqësore nuk mjafton për të përmbysur trendin rritës të ngarkesës totale. Rritja e vazhdueshme e hyrjeve (10%) dhe e ngarkesës (11-12%) rrezikon të neutralizojë efektin e kësaj mase nëse nuk shoqërohet me ndërhyrje të tjera. Nëse hyrjet vijojnë të rriten me këtë ritëm, treguesi WR mund të stabilizohet, por jo domosdoshmërisht të reduktohet ndjeshëm.

Ngarkesa mesatare e punës për gjyqtar për Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm

Treguesi	2024	2025	Ndryshimi
Numri efektiv i gjyqtarëve	26.5	31.6	+19%
Treguesi WR (çështje/gjyqtar)	1945.3	1804	-7.3%

Viti 2025 shënon një kthesë të rëndësishme për herë të parë, pas disa viteve rritjeje të vazhdueshme të presionit individual, ngarkesa mesatare për gjyqtar ka pësuar ulje. Megjithatë, niveli absolut i ngarkesës mesatare të punës për gjyqtar, mbetet i lartë dhe kërkon ndërhyrje të vazhdueshme për të shmangur rikthimin e mbingarkesës. Rritja e trupës gjyqësore në vitin 2025 ka prodhuar një efekt stabilizues në ngarkesën mesatare për gjyqtar në Gjykatën e Apelit. Megjithatë, përballë një trendi rritës të çështjeve të reja dhe të ngarkesës totale, ruajtja e këtij përmirësimi do të kërkojë masa të integruara organizative dhe strukturore, përtej shtimit numerik të kapaciteteve.

TREGUESIT E EFIÇENCËS

Rendimenti mesatar i punës për gjyqtar (Treguesi ER)

(*Efficiency Rate – Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm*)

Në vitin 2025, Gjykata e Apelit ka regjistruar një rendiment mesatar prej 352 çështjesh të përfunduara për gjyqtar, kundrejt 371.7 çështjeve në vitin 2024, duke shënuar një rënie prej rreth 5%. Në një lexim të parë numerik, kjo ulje mund të interpretohet si dobësim i performancës individuale. Megjithatë, analiza kontekstuale tregon se rënia e lehtë e treguesit ER nuk përbën domosdoshmërisht përkeqësim të efiçencës.

Treguesi	2024	2025	Ndryshimi
ER (çështje/gjyqtar)	371.7	352	-5%

Ngarkesa e përgjithshme e gjykatës është rritur me rreth 11% krahasuar me vitin 2024. Një volum më i lartë çështjesh zakonisht sjell rritje të presionit administrativ, nevojë për riorganizim të kalendarëve dhe kohë shtesë për menaxhim procedural. Në këtë kontekst, ruajtja e një niveli ER relativisht të qëndrueshëm përbën tregues stabiliteti.

Numri i gjyqtarëve është rritur nga 26.5 në 31.6, por kjo rritje është realizuar gjatë gjithë vitit. Kjo do të thotë se efekti i plotë i shtimit të trupës gjyqësore nuk është reflektuar proporcionalisht në rezultatin vjetor, treguesi ER është llogaritur mbi një mesatare vjetore që përfshin periudhë të gjatë me numër më të ulët gjyqtarësh.


Pavarësisht uljes së lehtë të rendimentit mesatar të punës për gjyqtar (treguesi ER), numri absolut i çështjeve të përfunduara është rritur me rreth 13% krahasuar me vitin 2024. Kjo do të thotë se produktiviteti total i gjykatës është rritur, dhe se ulja e treguesit ER lidhet me rritjen e numrit të gjyqtarëve dhe jo me ulje reale të performancës operative. Efekti i plotë i rritjes së kapaciteteve pritet të reflektohet më qartë gjatë vitit 2026, me potencial për stabilizim ose rritje të rendimentit të punës për gjyqtar (ER), përmirësim të normës së likuidimit (CR), dhe reduktim të kohës së nevojshme për evadimin e çështjes (DT).

Rënia prej 5% e treguesit ER në vitin 2025 nuk përbën tregues të përkeqësimit të efiçencës së Gjykatës së Apelit, por pasqyron një situatë tranzitore të karakterizuar nga rritje e volumit total të çështjeve, shtim i trupës gjyqësore në fund të vitit dhe rritje e numrit të çështjeve të përfunduara. Në terma strategjikë, sistemi në nivel apeli është në fazë stabilizimi operacional, ndërsa konsolidimi i plotë i performancës pritet të materializohet në periudhën pasuese.

Norma e likuidimit të çështjeve (Treguesi CR)

(*Clearance Rate – Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm*)

Treguesi i normës së likuidimit (CR), i cili mat raportin ndërmjet çështjeve të përfunduara dhe çështjeve të reja të regjistruara gjatë vitit, përbën një indikator thelbësor për vlerësimin e balancës së sistemit. Në vitin 2025, pavarësisht përmirësimit krahasuar me vitin 2024, Gjykata e Apelit nuk ka arritur ende pragun optimal prej 100%, çka do të nënkuptonte përballimin e plotë të hyrjeve të reja pa shtuar stokun ekzistues.



Grafiku nr.5

Pamundësia për të arritur një normë likuidimi 100% lidhet drejtpërdrejt me dy faktorë kryesorë si **funksionimi me vetëm 41% të organikës së miratuar**, sipas vendimit nr. 553, datë 29.12.2022, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe **rritja e ndjeshme e çështjeve të reja të regjistruara gjatë vitit 2025**, veçanërisht penal. Këta faktorë kanë kufizuar kapacitetin efektiv të gjykatës për të përballuar plotësisht fluksin hyrës.

Norma e likuidimit për çështjet civile në vitin 2025 ka arritur në **76%**, duke shënuar një përmirësim të dukshëm krahasuar me **64% në vitin 2024**. Ky zhvillim është veçanërisht i rëndësishëm sepse çështjet civile përbëjnë **67% të *backlog*-ut** dhe çështjet civile kanë qenë historikisht burimi kryesor i akumulimit të stokut.

Rritja e CR në këtë kategori dëshmon angazhim më të lartë në trajtimin e çështjeve civile, orientim të politikave të brendshme drejt reduktimit të *backlog*-ut civil. Megjithatë, një normë prej 76% nënkupton se për çdo 100 çështje të reja civile, 24 mbeten të pashqyrtuara, duke kontribuar në vazhdimësinë e problemit strukturor të stokut.

Për çështjet penale, norma e likuidimit ka rënë në **71%**, nga **76% në vitin 2024**. Kjo rënie lidhet kryesisht me rritjen prej rreth 15% të regjistrimeve të reja penale gjatë vitit 2025, presionin shtesë të krijuar nga kjo rritje në një gjykatë që funksionon me kapacitet të kufizuar. Megjithëse seksioni penal ka traditë më të shpejtë procedurale, rritja e hyrjeve ka tejkaluar ritmin e përfundimeve, duke ulur CR në këtë kategori.

Në tërësi, norma e likuidimit për vitin 2025 paraqet **përmirësim në aspektin civil**, por mbetet nën pragun e balancës sistemike (100%). Nga këndvështrimi i CEPEJ-it, një CR nën 100% për disa vite radhazi prodhon rritje progresive të *backlog*-ut, rrit kohën e nevojshme për evadimin e çështjes (DT), duke përforcuar presionin mbi trupën gjyqësore.

Norma e likuidimit në vitin 2025 dëshmon përpjekje reale në përmirësim të performancës, por Gjykata e Apelit ende operon në kushte strukturore të kufizuara, me vetëm 41% të organikës së miratuar. Nëse organika do të plotësohet dhe nëse ruhet ritmi i përfundimeve, arritja e një CR afër ose mbi 100% mund të bëhet objektiv realist në periudhë afatmesme. Stabilizimi i CR dhe arritja e pragut 100% mbetet kusht thelbësor për frenimin e rritjes së *backlog*-ut, përmirësimin e kohëzgjatjes së çështjeve, konsolidimin e efiçencës në nivel apeli.

Koha e nevojshme për evadimin e çështjeve (Treguesi DT)

(*Disposition Time – Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm*)

Treguesi i kohës së nevojshme për evadimin e çështjeve (DT), i cili sipas metodologjisë së CEPEJ llogaritet si raporti ndërmjet çështjeve në pritje dhe çështjeve të përfunduara gjatë vitit, përfaqëson indikatorin më të ndjeshëm të presionit strukturor mbi një gjykatë.

<u>DT për çështjet civile</u>

Në vitin 2025, koha mesatare për evadimin e çështjeve civile në Gjykatën e Apelit ka arritur në 2318 ditë, duke shënuar një përmirësim të ndjeshëm krahasuar me vitin 2024. Reduktimi i kohës mesatare është rreth 1 vit, ose 14% më pak se një vit më parë. Ky përmirësim është i rëndësishëm për disa arsye: Çështjet civile përbëjnë **67% të *backlog*-ut**; Çështjet civile kanë qenë tradicionalisht burimi kryesor i kohëzgjatjeve shumëvjeçare; Ulja e DT në këtë kategori reflekton përpjekjet të targetuara për adresimin e stokut civil. Megjithatë, një kohë mesatare prej mbi **6 vite** (2318 ditë) mbetet shumë e lartë dhe tregon se *backlog*-u historik vazhdon të ndikojë në treguesin.

DT për çështjet penale

Për çështjet penale, koha mesatare e evadimit është rritur me rreth 3 muaj (11.8%), duke arritur në 920 ditë. Faktori kryesor që ka ndikuar në këtë rritje është rritja prej rreth 15% e regjistrimeve të reja në çështjet penale gjatë vitit 2025. Rritja e hyrjeve ka tejkaluar ritmin e përfundimeve, duke prodhuar ndikim të drejtpërdrejtë në DT penal. Megjithatë, edhe me këtë rritje, DT penal mbetet ndjeshëm më i ulët se ai civil, për shkak të natyrës më të përshpejtuar të gjykimit penal.

DT mesatar për të gjitha çështjet


Mesatarisht, për të gjitha kategoritë e çështjeve, treguesi DT në vitin 2025 ka arritur në 1507 ditë, duke shënuar një përmirësim modest prej 2.5% krahasuar me vitin e kaluar. Ky përmirësim i përgjithshëm është rezultat i uljes së ndjeshme të DT civil, rritjes së numrit të gjyqtarëve në fund të vitit, rritjes së numrit absolut të çështjeve të përfunduara. Pavarësisht përmirësimeve, DT në Gjykatën e Apelit mbetet shumë i lartë në terma absolutë. Kjo tregon se gjykata vijon të operojë nën presion të madh strukturor, *backlog*-u shumëvjeçar vazhdon të ndikojë në tregues, norma e likuidimit nën 100% nuk ka lejuar përmbysjen e trendit në mënyrë më të theksuar. Në standardet e CEPEJ-it, një DT i lartë për disa vite radhazi sinjalizon nevojë për ndërhyrje sistemike dhe jo vetëm operacionale.

Viti 2025 shënon përmirësim të rëndësishëm në seksionin civil, përkeqësim të moderuar në seksionin penal, stabilizim të përgjithshëm në nivel gjykate. Megjithatë, niveli aktual i DT dëshmon se Gjykata e Apelit mbetet hallka më e brishtë e sistemit në aspektin e kohëzgjatjes së gjykimeve. Reduktimi real dhe i qëndrueshëm i DT do të kërkojë arritjen e një CR të paktën 100% për disa vite radhazi, plotësimin gradual të organikës, menaxhim të strukturuar të çështjeve me vjetërsi të lartë, masa organizative për filtrimin dhe trajtimin e çështjeve me prioritet. Situata konfirmon se gjykata ndodhet në një fazë stabilizimi fillestar, por reduktimi i *backlog*-ut historik dhe arritja e standardeve optimale të kohëzgjatjes kërkojnë ndërhyrje të vazhdueshme dhe të strukturuara në periudhë afatmesme.

***Backlog*-u në fund të vitit 2025**

(*Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm – 2025*)

Analiza e *backlog*-ut në fund të vitit përbën treguesin më të drejtpërdrejtë të raportit ndërmjet hyrjeve dhe përfundimeve dhe është indikator kyç për vlerësimin e efiçencës strukturore të gjykatës. Në fund të vitit 2025, *backlog*-u i Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm ka arritur në 45,876 çështje, duke shënuar një rritje prej 4,176 çështjesh, ose 10% më shumë krahasuar me fillimin e vitit.



Grafiku nr.6

Kjo rritje konfirmon se gjatë vitit 2025 çështjet e reja të regjistruara kanë tejkaluar përfundimet, duke prodhuar një akumulim shtesë të stokut. Në terma të metodologjisë CEPEJ, një normë likuidimi nën 100% për një periudhë të zgjatur çon në rritje progresive të *backlog*-ut dhe në përkeqësim të treguesit DT (*Disposition Time*).

Volumi prej 45,876 çështjesh përfaqëson nivelin më të lartë të *backlog*-ut të regjistruar në këtë gjykatë, duke reflektuar problematika të akumuluara ndër vite, periudha të gjata funksionimi me organikë të paplotësuar, rritje të vazhdueshme të çështjeve të reja, presion të shtuar pas përqendrimit të juridiksionit në nivel kombëtar.

Struktura e stokut vijon të dominohet nga çështjet civile 65% çështje civile dhe 35% çështje penale. Ky konfigurim është në koherencë me analizën e mëparshme mbi treguesin DT, ku seksioni civil paraqitet si kategoria me kohëzgjatjen më të lartë të gjykimeve dhe me kontributin më të madh në akumulimin e stokut. Edhe pse hyrjet penale janë më të shumta në numër, çështjet civile kanë tendencë të qëndrojnë më gjatë në sistem dhe të ndikojnë në rritjen e *backlog*-ut shumëvjeçar.

Rritja e *backlog*-ut lidhet drejtpërdrejt me funksionimin me vetëm 41% të organikës së miratuar të gjyqtarëve, me rritjen e çështjeve të reja të regjistruara gjatë vitit 2025, veçanërisht në seksionin penal si dhe kapacitetet e kufizuara operative, që nuk kanë lejuar përfundimin e një numri më të madh çështjesh sesa ato të regjistruara rishtazi. Në nivel apeli, mungesa e filtrave proceduralë më efektivë për pranueshmërinë dhe menaxhimin e ankimeve shton presionin mbi trupën gjyqësore. Përdorimi i mekanizmave alternativë të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve (ndërmjetësimi, arbitrazhi, marrëveshje konsensuale) mbetet i kufizuar në praktikë. Si rrjedhojë, një volum i konsiderueshëm çështjesh që potencialisht mund të

zgjidheshin jashtë gjykatës vijon të kanalizohet në sistemin gjyqësor, duke kontribuar në mbingarkesë.


Backlog-u prej 45,876 çështjesh në fund të vitit tregon qartazi sfidën strukturore me të cilën përballet Gjykata e Apelit. Përmirësimet e shënuara në disa tregues gjatë vitit 2025 nuk kanë qenë të mjaftueshme për të përmbysur trendin rritës të stokut. Stabilizimi dhe më pas reduktimi i *backlog*-ut në nivel apeli përbën kusht thelbësor për përmirësimin e përgjithshëm të efiçencës së sistemit gjyqësor dhe për rritjen e besimit publik në drejtësi.

Vjetërsia e çështjeve në pritje të gjykimit

(*Mosha e backlog*-ut – *Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm*)

Analiza e moshës së *backlog*-ut përbën një element thelbësor për vlerësimin e efiçencës reale të sistemit, pasi ajo nuk mat vetëm sasinë e çështjeve në pritje, por edhe thellësinë e akumulimit. Sipas të dhënave për vitin 2025, struktura e *backlog*-ut paraqitet si vijon:

- 3-5 vite në pritje: 12,947 çështje (28%)
  - 9,509 civile
  - 3,438 penale
- 2-3 vite në pritje: 8,597 çështje (19%)
- 1-2 vite në pritje: 8,246 çështje (18%)
- Mbi 5 vite në pritje: 6,211 çështje (14%)
  - 4,260 civile
  - 1,951 penale





Grafiku nr.7

Përqendrimi i 28% të *backlog*-ut në segmentin 3-5 vite dhe 14% në segmentin mbi 5 vite tregon për një akumulim të konsiderueshëm shumëvjeçar. Në terma praktikë, kjo do të thotë se më shumë se 40% e stokut është mbi 3 vite i vjetër, segmenti i çështjeve shumëvjeçare mbetet i konsoliduar, çështjet civile kontribuojnë në mënyrë disproporcionale në këtë akumulim. Dominimi i çështjeve civile në segmentet më të vjetra konfirmon analizën e mëparshme mbi kohën e evadimit (DT) dhe normën e likuidimit (CR), duke e identifikuar

juridiksionin civil si hallkën më problematike në nivel apeli. Mosha e *backlog*-ut është tregues i drejtpërdrejtë i rrezikut për cenimin e standardit të "gjykimit brenda një afati të arsyeshëm", rritjes së presionit mbi sistemin, perceptimit publik mbi zgjatjen e gjykimeve. Një stok me 14% çështje mbi 5 vite përbën një sinjal të fortë për nevojën e ndërhyrjes prioritare në trajtimin e dosjeve më të vjetra.

Kohëzgjatja e çështjeve të gjykuara gjatë vitit 2025





Grafiku nr. 8 dhe Grafiku nr. 9

Analiza e çështjeve të përfunduara gjatë vitit 2025 konfirmon dallime të qarta ndërmjet juridiksionit civil dhe penal. Kështu sa i përket çështjeve civile të përfunduara, 69% e tyre rezultojnë të kanë zgjatur mbi 2 vite; Vetëm 22% janë përfunduar brenda një viti. Sa i përket çështjeve penale të përfunduara rezulton se, 57% e tyre janë gjykuar brenda 6 muajve; 15% e tyre kanë zgjatur mbi 2 vite. Këto të dhëna tregojnë se, edhe pse ka përmirësim në DT civil, ritmet e shqyrtimit mbeten të ngadalta për një pjesë të konsiderueshme të dosjeve.

Mosha e *backlog*-ut në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për vitin 2025 konfirmon se problematika nuk është vetëm volumore, por edhe kronologjike. Pjesa e konsiderueshme e çështjeve "mbi 3" dhe "mbi 5 vite", kërkon prioritizim të posaçëm, mekanizma për trajtimin, ruajtje të normës së likuidimit mbi 100% për disa vite radhazi, plotësim gradual të organikës. Pa adresim sistematik të segmentit të çështjeve shumëvjeçare, përmirësimi në treguesit vjetorë do të mbetet i kufizuar dhe jo ti qëndrueshëm.

Gjetjet kryesore!

Analiza e treguesve të efiçencës për vitin 2025 tregon se Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm ndodhet në një fazë tranzicioni, me përmirësime të pjesshme operative, por me sfida të theksuara strukturore.

1. Rritje e ndjeshme e ngarkesës totale (+11–12%)
   Ngarkesa ka arritur në 56,990 çështje, duke konfirmuar një trend rritës trevjeçar.

2. Rritje e *backlog*-ut (+10%)
   Backlog-u ka arritur në 45,876 çështje – niveli më i lartë i regjistruar në vitet e fundit.
3. Organikë e paplotësuar (41% e miratuar)
   Funksionimi me kapacitete të reduktuara mbetet faktori kryesor strukturor.
4. Norma e likuidimit nën 100%

- Civil: 76% (përmirësim nga 64%)
- Penal: 71% (ulje nga 76%)
  CR nën 100% për disa vite radhazi ka prodhuar akumulim progresiv të stokut.

5. *Disposition Time* shumë i lartë

- Civil: 2318 ditë (~6 vite)
- Penal: 920 ditë
- Mesatar total: 1507 ditë

6. Rritje e numrit të gjyqtarëve (+19%)
   Ka prodhuar ulje të treguesit WR (-7.3%), por efekti i plotë pritet të reflektohet në 2026.
7. Mosha e *backlog*-ut alarmante

- 42% e stokut është mbi 3 vite
- 14% mbi 5 vite

8.5 GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT


Çështje në pritje të gjykimit (*Backlog*)

Në fillim të vitit 2025, Gjykata Administrative e Apelit ka hyrë me një stok të akumuluar prej 23,862 çështjesh në pritje, duke konfirmuar një prirje rritëse të *backlog*-ut që prej vitit 2021. Megjithatë, dinamika e rritjes së këtij stoku ka pësuar një ngadalësim të ndjeshëm gjatë viteve të fundit.

Konkretisht, ritmi i rritjes së *backlog*-ut në vitin 2025 rezulton 57% më i ulët krahasuar me vitin 2024**,** 71% më i ulët krahasuar me vitin 2023**.**

Ky zhvillim tregon se masat e ndërmarra kanë filluar të prodhojnë efekt në frenimin e rritjes së stokut, megjithatë niveli absolut i *backlog*-ut mbetet shumë i lartë dhe përbën një sfidë për funksionimin e gjykatës**.**

Për këtë arsye, Gjykata Administrative e Apelit është përfshirë si një nga prioritetet kryesore në kuadër të Strategjisë Kombëtare për Uljen e Çështjeve të Prapambetura 2024–2027, me objektiv kryesor përshpejtimin e shqyrtimit të çështjeve dhe reduktimin progresiv të stokut të trashëguar.



Grafiku nr.1


Struktura e *backlog*-ut sipas burimit të çështjeve evidenton një varësi të fortë nga juridiksioni i shkallës së parë:

- 57% e *backlog*-ut (13,707 çështje) vjen nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, duke reflektuar si volumin e lartë të çështjeve në këtë gjykatë, ashtu edhe shkallën e lartë të ankimeve;
- 12% (2,762 çështje) vjen nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë, e cila përbën një burim të rëndësishëm shtesë të stokut;
- 6% (1,440 çështje) janë çështje të paraqitura drejtpërdrejt në Gjykatën Administrative të Apelit në cilësinë e juridiksionit fillestar.
- Rreth 25% e *backlog*-ut shpërndahet ndërmjet gjykatave të tjera administrative të cilat janë mbyllur.


Kjo strukturë tregon qartë se *backlog*-u në apel është në një masë të konsiderueshme produkt i fluksit të lartë dhe përqendrimit të çështjeve në Gjykatën Administrative të Tiranës, duke krijuar një zinxhir presioni nga shkalla e parë drejt apelit

Backlog-u dominohet nga çështje administrative të përgjithshme, të cilat karakterizohen nga kompleksitet më i lartë juridik, nevojë për shqyrtim më të detajuar të provave dhe akteve administrative dhe kohëzgjatje më e madhe procedurale.

Kjo përbërje strukturore e stokut ndikon drejtpërdrejt në treguesit DT (*Disposition Time*) dhe CR (*Clearance Rate*), duke e bërë më të vështirë reduktimin e shpejtë të *backlog*-ut.



Grafiku nr.2



Grafiku nr.3


Backlog-u prej 23,862 çështjesh e vendos Gjykatën Administrative të Apelit ndër nyjat më kritike të sistemit gjyqësor në aspektin e efiçencës. Megjithëse ngadalësimi i ritmit të rritjes përbën një zhvillim pozitiv, situata aktuale tregon se sistemi nuk ka hyrë ende në fazë reduktimi të *backlog*-ut, por vetëm në fazë stabilizimi të rritjes

Nëse nuk ndërmerren masa të mëtejshme për rritjen e kapaciteteve gjyqësore, përmirësimin e menaxhimit të çështjeve dhe kontrollin e fluksit nga shkalla e parë, atëherë *backlog*-u rrezikon të mbetet në nivele të larta edhe në periudhën afatmesme.

Gjykata Administrative e Apelit nuk është më vetëm një problem i stokut të lartë, por një nyjë sistemike që reflekton drejtpërdrejt performancën e gjithë juridiksionit administrativ.

Çështje të reja të regjistruara (Incoming Cases)

Gjatë vitit 2025, në Gjykatën Administrative të Apelit janë regjistruar gjithsej 4,067 çështje të reja, duke shënuar një rritje prej 17% krahasuar me vitin 2024 (602 çështje më shumë). Kjo rritje përbën një zhvillim të rëndësishëm, pasi ndikon drejtpërdrejt në ngarkesën totale të gjykatës dhe në aftësinë e saj për të reduktuar *backlog*-un ekzistues.



Grafiku nr.4


Në kontekstin e analizës shumëvjeçare (2019–2025), fluksi i çështjeve të reja paraqet luhatje të ndjeshme, të lidhura kryesisht me ndryshimet në kuadrin ligjor dhe procedural, ritmet e shqyrtimit dhe prodhimit të vendimeve në gjykatat e shkallës së parë si dhe shkallën e ankimeve të vendimeve administrative.

Pas një periudhe relativisht të qëndrueshme dyvjeçare, viti 2025 shënon një rikthim në trajektore rritëse të *incoming*, duke rritur presionin mbi Gjykatën Administrative të Apelit.

Shpërndarja sipas natyrës së çështjeve mbetet e qëndrueshme dhe reflekton kompleksitetin e juridiksionit administrativ në apel:

- 68% (2,762 çështje) janë çështje administrative të përgjithshme (me palë kundërshtare), të cilat karakterizohen nga kompleksitet i lartë juridik dhe kohëzgjatje më e gjatë shqyrtimi;
- 28% (1,135 çështje) janë çështje pa palë kundërshtare, që zakonisht kanë procedura më të thjeshta dhe mund të trajtohen më shpejt;
- 4% (170 çështje) lidhen me mosmarrëveshje të marrëdhënieve të punës.

Kjo përbërje strukturore tregon se pjesa dominuese e *incoming* përbëhet nga çështje me ndikim të drejtpërdrejtë në rritjen e *Disposition Time* (DT) dhe në vështirësinë e reduktimit të *backlog*-ut.




Grafiku nr.5

Analiza e burimit të çështjeve të reja evidenton një përqendrim të theksuar institucional:

- 84% e çështjeve të reja vijnë nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, duke konfirmuar rolin dominues të kësaj gjykate në gjenerimin e fluksit të ankimeve;
- 15% vijnë nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Lushnjë;
- pjesa tjetër është minimale dhe lidhet me gjykatat e tjera administrative.

Ky përqendrim tregon se Gjykata Administrative e Apelit është në një masë të konsiderueshme e varur nga performanca dhe volumi i prodhimit të vendimeve në Tiranë, duke krijuar një lidhje të drejtpërdrejtë ndërmjet dy niveleve të juridiksionit.



Grafiku nr.6

Rritja prej 17% e *incoming* në vitin 2025 përbën një faktor presioni për Gjykatën Administrative të Apelit dhe ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në treguesit kryesorë të efiçencës.

Nga analiza rezulton se rritja e hyrjeve të reja, e kombinuar me një *backlog* të lartë ekzistues, e bën më të vështirë arritjen e një CR ≥ 100%, përqendrimi i fluksit në Tiranë krijon një varësi strukturore ndërmjet niveleve të gjykimit si dhe dominimi i çështjeve me kompleksitet të lartë rrit presionin mbi DT dhe kufizon shpejtësinë e reduktimit të stokut.

Nëse trendi rritës i incoming vijon, pa një rritje proporcionale të kapaciteteve dhe pa përmirësim të rendimentit, Gjykata Administrative e Apelit rrezikon të mbetet në një cikël të vazhdueshëm akumulimi të *backlog*-ut.

Fluksi i çështjeve të reja në Gjykatën Administrative të Apelit nuk është thjesht tregues volumesh, por një reflektim i drejtpërdrejtë i presionit që gjenerohet në shkallën e parë, veçanërisht në Tiranë, duke e bërë këtë gjykatë një hallkë kritike në zinxhirin e efiçencës së drejtësisë administrative.

Ngarkesa mesatare e punës për gjyqtar (Treguesi WR)

Në vitin 2025, ngarkesa mesatare e punës për gjyqtar (treguesi WR) në Gjykatën Administrative të Apelit ka arritur në 2,116 çështje për gjyqtar, duke shënuar një ulje prej 8% krahasuar me vitin 2024 (2,306.2 çështje për gjyqtar).

Ky përmirësim lidhet drejtpërdrejt me rritjen e numrit të gjyqtarëve efektivë, nga 11.5 në 13.2 gjyqtarë (+15%), duke kontribuar në një shpërndarje më të balancuar të ngarkesës së punës. Megjithëse ulja e treguesit WR është një zhvillim pozitiv, niveli prej 2,116 çështjesh për gjyqtar mbetet jashtëzakonisht i lartë dhe sinjalizon një mbingarkesë strukturore të gjykatës.

Gjykata Administrative e Apelit paraqet një ngarkesë disproporcionale, që ndikon drejtpërdrejt në uljen e rendimentit (ER), pamundësinë për të arritur CR ≥ 100% dhe rritjen e *Disposition Time* (DT). Ulja prej 8% e treguesit WR nuk përfaqëson një lehtësim real të presionit operacional, por më tepër një zbutje të moderuar të mbingarkesës.

Kjo për shkak se *backlog*-u fillestar mbetet shumë i lartë (23,862 çështje), *incoming* ka shënuar rritje (+17%) dhe struktura e çështjeve është e dominuar nga raste komplekse. Rrjedhimisht, edhe pas rritjes së numrit të gjyqtarëve, niveli i ngarkesës vazhdon të jetë në kufij që ndikojnë negativisht në performancën e përgjithshme të gjykatës.

Rritja e numrit të gjyqtarëve dhe ulja e moderuar e treguesit WR përbëjnë një hap në drejtimin e duhur, por nuk janë të mjaftueshme për të përmbysur trendin e *backlog*-ut, nuk kanë prodhuar ende efekt të dukshëm në stabilizimin e treguesve të tjerë (ER, CR, DT) dhe nuk adresojnë në mënyrë të plotë disproporcionin midis volumit të çështjeve dhe kapaciteteve të gjykatës.

Nëse prirja e rritjes së kapaciteteve vijon dhe shoqërohet me masa organizative dhe procedurale, mund të krijohen kushtet për një ekuilibër gradual midis ngarkesës dhe kapaciteteve në periudhën 2026–2027.

Edhe pas rritjes së kapaciteteve, Gjykata Administrative e Apelit mbetet një nga strukturat më të mbingarkuara të sistemit gjyqësor, duke kërkuar ndërhyrje të mëtejshme për të arritur standarde të qëndrueshme të efiçencës.

Ngarkesa mesatare e punës për gjyqtar për Gjykatën Administrative të Apelit

Gjykata Administrative e Apelit	Nr. efektiv i gjyqtarëve 2024	Nr. efektiv i gjyqtarëve 2025	# ne %	Treguesi WR 2024	Treguesi WR 2025	# në %
	11.5	13.2	15%	2306.2	2116	-8%

TREGUESIT E EFIÇENCËS

Rendimenti mesatar i punës për gjyqtar (Treguesi ER)

Në vitin 2025, Gjykata Administrative e Apelit ka shënuar një përmirësim të treguesit ER, duke arritur në 258 çështje për gjyqtar, nga 231.2 çështje për gjyqtar në vitin 2024, që përfaqëson një rritje prej 11.4%. Në terma absolutë, kjo përkthehet në +26 çështje më shumë

për gjyqtar krahasuar me vitin paraardhës dhe një rritje prej 28% të numrit total të çështjeve të përfunduara, nga 2,659 në 3,399 çështje.

Ky përmirësim lidhet drejtpërdrejt me rritjen e numrit të gjyqtarëve efektivë me 15% (nga 11.5 në 13.2), një shpërndarje më të balancuar të ngarkesës së punës dhe uljen relative të presionit individual mbi gjyqtarët. Rritja e ER përbën një zhvillim pozitiv dhe sinjalizon përmirësim të kapaciteteve operative të gjykatës. Në metodologjinë CEPEJ, ky është një tregues kyç që reflekton aftësinë e sistemit për të përpunuar çështjet në mënyrë më efikase.

Megjithatë, ky përmirësim duhet analizuar në raport me nivelin shumë të lartë të WR (2,116 çështje/gjyqtar), rritjen e *incoming* (+17%) dhe *backlog*-un e lartë ekzistues. Në këtë kontekst, rritja e ER përfaqëson më shumë një përmirësim relativ të kapaciteteve, sesa një ndryshim struktural të efiçencës së sistemit.

Rritja e ER ka prodhuar disa efekte pozitive, ka kontribuar në përballimin më të mirë të fluksit të çështjeve, ka ndikuar në frenimin e ritmit të rritjes së *backlog*-ut dhe ka përmirësuar kapacitetin e gjykatës për të trajtuar volum më të madh çështjesh. Megjithatë, duke qenë se *incoming* është rritur ndjeshëm dhe CR mbetet nën pragun optimal (siç pritet të analizohet), rritja e ER nuk ka qenë e mjaftueshme për të kaluar në fazë reduktimi të *backlog*-ut.

Përmirësimi i treguesit ER në vitin 2025 përbën një nga zhvillimet më pozitive në Gjykatën Administrative të Apelit. Megjithatë ky përmirësim duhet të konsolidohet dhe të mos mbetet episodik, rritja e kapaciteteve duhet të vazhdojë për të përballuar presionin e lartë të çështjeve dhe ER duhet të rritet më tej për të mundësuar arritjen e një CR ≥ 100%, që është kusht thelbësor për reduktimin e *backlog*-ut.

Nëse trendi rritës i ER vijon dhe shoqërohet me stabilizim të fluksit të çështjeve, Gjykata Administrative e Apelit mund të hyjë gradualisht në fazë stabilizimi gjatë viteve 2026–2027. Rritja e rendimentit është një sinjal pozitiv, por në kushtet e një *backlog*-u të lartë dhe fluksi në rritje, ajo mbetet e pamjaftueshme për të përmbysur trendin e akumulimit të çështjeve.

Rendimenti mesatar për gjyqtar në Gjykatën Administrative të Apelit

Gjykata Administrative e Apelit	Çështje të gjykuara 2024	Çështje të gjykuara 2025	# në %	Gjyqtarë 2024	Gjyqtarë 2025	# në %	ER 2024	ER 2025	# në % i ER
	2659	3399	28%	11.5	13.2	15%	231.2	258	11.4%


Norma e likuidimit të çështjeve (Treguesi CR)

Në vitin 2025, Gjykata Administrative e Apelit ka arritur një normë likuidimi (CR) prej 84%, duke shënuar nivelin më të lartë në katër vitet e fundit. Ky përmirësim reflekton një rritje të

kapacitetit të gjykatës për të përfunduar çështje dhe përbën një zhvillim pozitiv në drejtim të rritjes së efiçencës operative.

Megjithatë, pavarësisht këtij progresi, treguesi mbetet ndjeshëm nën pragun kritik prej 100%, i cili në metodologjinë CEPEJ përfaqëson kufirin minimal për stabilizimin e *backlog*-ut. Një CR prej 84% nënkupton se për çdo 100 çështje të reja të regjistruara, gjykata ka përfunduar vetëm 84 dhe diferenca prej 16 çështjesh për çdo 100 çështje të reja kontribuon drejtpërdrejt në rritjen e *backlog*-ut.

Në këtë kontekst, edhe pse gjykata ka rritur numrin e çështjeve të përfunduara, ritmi i përfundimit mbetet i pamjaftueshëm për të përballuar fluksin hyrës, duke prodhuar një akumulim të vazhdueshëm të stokut.



Grafiku nr.7

Arritja e nivelit 84% për CR përbën një përmirësim të rëndësishëm, por jo të mjaftueshëm për të adresuar problemin strukturor të *backlog*-ut.

Gjykata ka hyrë në një fazë përmirësimi të kapaciteteve, por jo ende në fazë stabilizimi. Diferenca nga pragu 100% është ende e konsiderueshme dhe prodhon rritje progresive të stokut. Rritja e *incoming* ka neutralizuar pjesërisht përmirësimin e performancës. Për të kaluar nga faza e përmirësimit në fazën e stabilizimit, është e domosdoshme rritja e mëtejshme e kapaciteteve gjyqësore, përmirësimi i mëtejshëm i rendimentit (ER) dhe ndërhyrje në menaxhimin e fluksit nga shkalla e parë.


Pavarësisht përmirësimit të normës së likuidimit, Gjykata Administrative e Apelit mbetet në një situatë ku përfundon më pak çështje sesa regjistrohen, duke e bërë të pamundur reduktimin e *backlog*-ut pa ndërhyrje strukturore.

Koha e nevojshme për evadimin e çështjeve (Treguesi DT)

Në vitin 2025, treguesi DT (*Disposition Time*) në Gjykatën Administrative të Apelit ka shënuar një përmirësim të ndjeshëm, duke arritur në 2,634 ditë (rreth 7.2 vite). Kjo

përfaqëson një ulje prej rreth 20% krahasuar me vitin 2024 (−642 ditë) dhe një përmirësim të ndjeshëm krahasuar me dy vite më parë, ku koha mesatare e pritjes rezulton e përgjysmuar.

Ky zhvillim reflekton përpjekjet për përshpejtimin e proceseve gjyqësore dhe për përmirësimin e aksesit në drejtësi për palët.



Grafiku nr.8

Pavarësisht përmirësimit të dukshëm, niveli i DT mbetet jashtëzakonisht i lartë dhe sinjalizon një problem strukturor të akumulimit të çështjeve. Një DT prej mbi 2,600 ditësh nënkupton se sistemi ka një stok shumë të lartë në raport me numrin e çështjeve të përfunduara, ritmi i përpunimit të çështjeve është ende i pamjaftueshëm për të ulur ndjeshëm *backlog*-un dhe koha e pritjes për palët mbetet larg standardeve të arsyeshme të drejtësisë në kohë.

Në metodologjinë CEPEJ, DT është tregues sintetik që reflekton drejtpërdrejt raportin midis *backlog*-ut dhe *output*-it (resolved cases). Edhe pas përmirësimit, niveli aktual tregon se gjykata ndodhet ende në fazë presioni të lartë operacional.

Përmirësimi i treguesit DT është një nga zhvillimet më pozitive në Gjykatën Administrative të Apelit në vitin 2025. Megjithatë, niveli absolut i këtij treguesi mbetet kritik.

Nga analiza dalin tre përfundime: gjykata ka hyrë në fazë përmirësimi të performancës, por jo ende në fazë normalizimi, DT mbi 7 vite përbën një indikator të fortë të mbingarkesës strukturore; dhe pa arritjen e një CR ≥ 100%, reduktimi i mëtejshëm i DT do të jetë i kufizuar.

Për të ulur ndjeshëm kohëzgjatjen e shqyrtimit, kërkohen masa të kombinuara që përfshijnë rritje të mëtejshme të kapaciteteve gjyqësore, përmirësim të organizimit të punës, prioritizim të *backlog*-ut të vjetër dhe kontroll të fluksit të çështjeve nga shkalla e parë. Pavarësisht përmirësimit të ndjeshëm, koha e evadimit në Gjykatën Administrative të Apelit mbetet në nivele shumë të larta, duke e pozicionuar këtë gjykatë si një nga sfidat më kritike për garantimin e drejtësisë në kohë.

Backlog-u në fund të vitit

Në fund të vitit 2025, *backlog*-u i Gjykatës Administrative të Apelit ka arritur në 24,530 çështje në pritje, duke shënuar një rritje prej 2.8% krahasuar me fillimin e vitit (+668 çështje).

Megjithëse *backlog*-u vijon të rritet, viti 2025 përfaqëson një zhvillim relativisht pozitiv në krahasim me periudhën e mëparshme, pasi është regjistruar rritja më e ulët e *backlog*-ut në periudhën 2021–2025 dhe ritmi i rritjes ka pësuar një ngadalësim progresiv (nga 3.5% në vitin 2024 në 2.8% në vitin 2025).

Ky zhvillim tregon se masat e ndërmarra kanë filluar të japin efekt në frenimin e akumulimit të stokut, por jo ende në reduktimin e tij.

Rritja e *backlog*-ut, edhe pse e moderuar, konfirmon se CR (84%) mbetet nën pragun 100%, duke prodhuar akumulim neto të çështjeve dhe se për çdo vit sistemi vijon të shtojë stok të ri, edhe në kushte përmirësimi të performancës.

Në metodologjinë CEPEJ, kjo situatë përkufizohet si fazë stabilizimi e rritjes, por jo fazë reduktimi e *backlog*-ut.

Ngadalësimi i ritmit të rritjes së *backlog*-ut përbën një zhvillim pozitiv dhe një sinjal që sistemi ka hyrë në një fazë më të kontrolluar operacionale. Megjithatë, niveli absolut prej 24,530 çështjesh mbetet shumë i lartë dhe përfaqëson një barrë të rëndësishme për funksionimin e gjykatës.

Nëse trendi aktual vijon pa ndërhyrje shtesë, *backlog*-u do të vazhdojë të rritet, edhe pse me ritme më të ulëta, duke shtyrë në kohë zgjidhjen e problemit strukturor.

Viti 2025 shënon frenimin e rritjes së *backlog*-ut në Gjykatën Administrative të Apelit, por jo reduktimin e tij, një tregues i qartë se sistemi ndodhet ende në fazë tranzitore drejt stabilizimit.

Vjetërsia e çështjeve në pritje të gjykimit (Mosha e *backlog*-ut)


Analiza e strukturës së *backlog*-ut sipas vjetërsisë së çështjeve evidenton një akumulim të konsiderueshëm të çështjeve të vjetra, duke përbërë një nga problematikat më të theksuara të Gjykatës Administrative të Apelit dhe një tregues të qartë të sfidave strukturore në funksionimin e saj.

Nga totali prej 24,530 çështjesh në pritje, shpërndarja sipas vjetërsisë paraqitet si vijon:

- 16% (3,925 çështje) janë në pritje prej më pak se 1 vit;
- 25% (6,122 çështje) janë në pritje prej 1–3 vitesh;


- 28.5% (6,989 çështje) janë në pritje prej 3–5 vitesh;
- 30.5% (7,494 çështje) janë në pritje për më shumë se 5 vite.

Në total, 59% e *backlog*-ut përbëhet nga çështje me vjetërsi mbi 3 vite, ndërsa një pjesë shumë e konsiderueshme, mbi 30%, ka tejkaluar kufirin e 5 viteve, duke kapërcyer qartazi standardin e "afatit të arsyeshëm".



Grafiku nr.9

Struktura e moshës së *backlog*-ut është një tregues thelbësor për vlerësimin e cilësisë së drejtësisë në kohë. Në rastin e Gjykatës Administrative të Apelit, të dhënat tregojnë se sistemi përballet me një stok të rëndë historik, i akumuluar ndër vite, pjesa dominuese e çështjeve të vjetra ndikon drejtpërdrejt në rritjen e *Disposition Time* (DT) dhe ekziston një risk i lartë për cenimin e standardeve të drejtësisë në kohë, sipas praktikave të CEPEJ-it dhe jurisprudencës së GJEDNJ-së.



Grafiku nr.10

Gjatë vitit 2025 janë përfunduar gjithsej 3,399 çështje, ku struktura e kohëzgjatjes së tyre reflekton qartë fokusin e gjykatës në trajtimin e *backlog*-ut të vjetër:

- 87% (2,940 çështje) kanë zgjatur mbi 2 vite, duke treguar respektimin e rendit kronologjik të shqyrtimit;
- 3% (110 çështje) janë përfunduar brenda 1–2 viteve;
- rreth 3% (96 çështje) janë përfunduar në 6–12 muaj;
- vetëm 7% (253 çështje) janë përfunduar në më pak se 6 muaj.

Kjo shpërndarje tregon se gjykata ka ndjekur një politikë të qartë të prioritizimit të çështjeve më të vjetra, në përpjekje për të reduktuar stokun historik dhe për të rikthyer balancën në sistem.

Gjetjet kryesore!

Gjykata Administrative e Apelit (2025)

Analiza e treguesve të efiçencës për vitin 2025 evidenton një situatë në përmirësim operacional, por ende kritike në aspektin strukturor, ku *backlog*-u dhe kohëzgjatja e proceseve mbeten sfidat kryesore.

1. ***Backlog* shumë i lartë dhe ende në rritje**
   Gjykata ka përfunduar vitin 2025 me 24,530 çështje në pritje, duke shënuar një rritje prej 2.8%. Megjithëse kjo është rritja më e ulët në vitet e fundit, sistemi vijon të prodhojë akumulim neto të çështjeve, duke mos arritur ende fazën e reduktimit të *backlog*-ut.
2. **Ngadalësim i ritmit të rritjes së *backlog*-ut**
   Rënia e ritmit të rritjes (nga 3.5% në 2.8%) tregon se gjykata ka hyrë në një fazë stabilizimi të rritjes, si rezultat i përmirësimit të treguesve të performancës. Megjithatë, ky zhvillim nuk është ende i mjaftueshëm për të përmbysur trendin.
3. **Fluks hyrës në rritje dhe i përqendruar në Tiranë**
   Çështjet e reja janë rritur me 17%, duke arritur në 4,067.
   - 84% e tyre vijnë nga Gjykata Administrative e Tiranës, duke krijuar një varësi strukturore të apelit nga shkalla e parë dhe duke gjeneruar presion të vazhdueshëm mbi sistemin.
4. **Ngarkesë shumë e lartë për gjyqtar (treguesi WR)**
   Edhe pse treguesi WR është ulur me 8%, niveli prej 2,116 çështjesh për gjyqtar mbetet ndër më të lartët në sistemin gjyqësor, duke reflektuar një mbingarkesë të theksuar strukturore.
5. **Përmirësim i rendimentit (ER), por ende i pamjaftueshëm**

Treguesi ER është rritur me 11.4%, dhe numri total i çështjeve të përfunduara është rritur me 28%. Ky është një zhvillim pozitiv, por nuk ka qenë i mjaftueshëm për të kompensuar rritjen e *incoming* dhe për të arritur stabilizimin e sistemit.

6. **Norma e likuidimit (CR) nën pragun kritik**
   CR ka arritur në 84%, niveli më i lartë në 4 vitet e fundit, por ende nën pragun 100%. Kjo nënkupton se gjykata përfundon më pak çështje sesa regjistrohen, duke prodhuar rritje të vazhdueshme të *backlog*-ut.
7. **Përmirësim i ndjeshëm i kohës së evadimit (DT), por ende shumë i lartë**
   DT është ulur në 2,634 ditë (~7 vite), me përmirësim rreth 20%. Megjithatë, niveli mbetet jashtëzakonisht i lartë, duke e bërë këtë një nga treguesit më problematikë në sistem.
8. ***Backlog*-u me strukturë shumë të rëndë historike**
   - 59% e çështjeve janë mbi 3 vite në pritje
   - 30.5% janë mbi 5 vite

   Kjo tregon një stok të thellë historik, që ndikon drejtpërdrejt në DT dhe në perceptimin e drejtësisë në kohë.
9. **Fokus në shqyrtimin e çështjeve të vjetra**
   87% e çështjeve të përfunduara kanë zgjatur mbi 2 vite, duke treguar se gjykata ka ndjekur një qasje të drejtë në prioritizimin kronologjik të *backlog*-ut.

Gjykata Administrative e Apelit ndodhet në një fazë tranzicioni nga përkeqësimi drejt stabilizimit, ku performanca operative është përmirësuar (ER, DT dhe treguesi WR), por treguesit strukturorë (CR, *backlog*, mosha e çështjeve) mbeten kritikë.

Sfida kryesore mbetet kalimi nga stabilizimi i rritjes së *backlog*-ut në reduktimin real të tij, çka kërkon rritje të mëtejshme të kapaciteteve, përmirësim të rendimentit dhe ndërhyrje në fluksin e çështjeve nga shkalla e parë.

Gjykata Administrative e Apelit mbetet hallka më kritike e sistemit të drejtësisë administrative, ku përmirësimet janë evidente, por ende të pamjaftueshme për të zgjidhur problemin strukturor të *backlog*-ut dhe vonesave shumëvjeçare.

8.6 GJYKATAT ADMINISTRATIVE TË SHKALLËS SË PARË


Menaxhimi i çështjeve në Gjykatat Administrative të Shkallës së Parë

Çështje në pritje të gjykimit (*Backlog*)

(Pending Cases – gjykatat administrative të shkallës së parë)

Në fillim të vitit 2025, gjykatat administrative të shkallës së parë kanë hyrë me një stok prej 8,396 çështjesh në pritje, duke shënuar një rënie prej 4.5% krahasuar me vitin 2024. Ky

reduktim, megjithëse modest, përbën një sinjal pozitiv në drejtim të stabilizimit gradual të *backlog*-ut.




Grafiku nr.1

Megjithatë, struktura e shpërndarjes së këtij *backlog*-u evidenton një përqendrim të theksuar institucional, pasi 79% e stokut total mbahet nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë. Kjo situatë e vendos këtë gjykatë në pozicion kritik për performancën e përgjithshme të juridiksionit administrativ. Për këtë arsye, Këshilli i Lartë Gjyqësor e ka konsideruar reduktimin e *backlog*-ut në Gjykatën Administrative Tiranë si prioritet, duke e përfshirë atë në kuadër të Strategjisë Kombëtare për Uljen e Çështjeve të Prapambetura 2024–2027.

Shqyrtimi i natyrës së çështjeve të mbartura evidenton karakteristika të qarta strukturore:

- 97.5% e stokut përbëhet nga çështje administrative me palë kundërshtare, të cilat për shkak të kontradiktoritetit në gjykim dhe kompleksitetit procedural kërkojnë kohë më të gjatë shqyrtimi;
- 2.5% janë çështje pa palë kundërshtare, të cilat zakonisht trajtohen me procedura më të përshpejtuara. Ky tregues ka rënë ndjeshëm krahasuar me vitin 2024 (17%), duke reflektuar reduktimin e segmentit më pak kompleks të stokut;
- Brenda çështjeve me palë kundërshtare, vetëm 2.4% lidhen me marrëdhëniet e punës, çka tregon se juridiksioni administrativ mbetet i dominuar nga çështje të tjera të natyrës administrative (tatimore, pronësore, vendime administrative, etj.).



Grafiku nr.2

Reduktimi prej 4.5% i *backlog* tregon përpjekje reale në menaxhimin e stokut, por:


- Përqendrimi i 79% të çështjeve në një gjykatë të vetme krijon rrezik strukturor për balancën e sistemit;
- Dominimi i çështjeve me palë kundërshtare sinjalizon se reduktimi i *backlog*-ut kërkon masa të synuara mbi menaxhimin procedural dhe kapacitetet gjyqësore;
- Ulja drastike e çështjeve pa palë kundërshtare tregon se segmenti "më i lehtë" i stokut është pothuajse ezauruar, duke lënë si prioritet çështjet me kompleksitet më të lartë.

Në terma CEPEJ, kjo situatë do të ndikojë drejtpërdrejt në treguesit CR (*Clearance Rate*) dhe DT (*Disposition Time*) nëse nuk shoqërohet me rritje të kapaciteteve dhe masa organizative shtesë.

Çështje të reja të regjistruara

(Incoming Cases - gjykatat administrative të shkallës së parë)


Gjatë vitit 2025, gjykatat administrative të shkallës së parë kanë regjistruar 13,225 çështje të reja, duke shënuar një rënie prej 8% krahasuar me vitin 2024 (1,145 çështje më pak). Ky reduktim i hyrjeve përbën një zhvillim pozitiv në aspektin e presionit mbi sistemin dhe krijon kushte më të favorshme për stabilizimin e *backlog*-ut, nëse shoqërohet me norma likuidimi mbi 100%. Shpërndarja e çështjeve të reja evidenton një përqendrim edhe më të lartë sesa në *backlog*, ku 85% e çështjeve të reja janë regjistruar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, duke e bërë këtë gjykatë faktorin përcaktues të performancës së gjithë juridiksionit administrativ. Ky nivel përqendrimi tregon se çdo devijim në performancën e kësaj gjykate reflektohet drejtpërdrejt në treguesit kombëtarë të efiçencës (CR, DT dhe treguesi WR).



Grafiku nr.3

Analiza sipas natyrës së çështjeve të regjistruara tregon një shpërndarje relativisht të balancuar:

- 50.6% (6,687 çështje) janë çështje administrative të përgjithshme (me palë kundërshtare);
- 48.7% (6,640 çështje) janë çështje administrative pa palë kundërshtare;
- Vetëm 0.7% (98 çështje) lidhen me mosmarrëveshje të marrëdhënieve të punës.



Grafiku nr.4

Krahasuar me strukturën e *backlog*-ut (ku 97.5% janë çështje me palë kundërshtare), rezulton një diferencë e rëndësishme: Çështjet e reja (*Incoming*) janë më të balancuara, ndërsa *backlog*-u dominohet nga çështje me natyrë më komplekse. Segmenti pa palë kundërshtare ka potencial më të lartë për likuidim të shpejtë, ndërsa segmenti me palë kundërshtare kërkon kapacitete më të mëdha gjyqësore dhe ndikon më shumë në treguesin DT (*Disposition Time*). Rënia prej 8% e hyrjeve në vitin 2025 është një faktor lehtësues për juridiksionin administrativ, por përqendrimi 85% në Tiranë krijon varësi strukturore nga performanca e një gjykate të vetme. Struktura e *backlog*-ut tregon se segmenti më kompleks i çështjeve mbetet i akumuluar. Nëse norma e likuidimit nuk kalon pragun 100%, reduktimi i hyrjeve nuk do të jetë i mjaftueshëm për ulje domethënëse të stokut. Në terma CEPEJ, ky moment paraqet një dritare stabilizimi, me kusht që treguesi CR të mbetet mbi 100% dhe që kapacitetet në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, të mos pësojnë rënie.

Ngarkesa totale e gjykatave administrative të shkallës së parë

(Total Caseload – gjykatat administrative të shkallës së parë)

Në vitin 2025, ngarkesa totale e punës në gjykatat administrative të shkallës së parë ka arritur në 21,621 çështje, duke përfshirë si *backlog*-un e trashëguar, ashtu edhe çështjet e reja të regjistruara gjatë vitit. Krahasuar me vitin 2024, ngarkesa totale ka shënuar një rënie prej rreth 7%, kryesisht si rezultat i uljes së hyrjeve të reja (*Incoming*). Ky zhvillim përbën një faktor lehtësues në aspektin e presionit vjetor mbi sistemin.

Megjithatë, analiza e shpërndarjes së kësaj ngarkese evidenton një përqendrim edhe më të lartë sesa në rastin e *backlog*-ut, ku 83% e ngarkesës totale (17,852 çështje) mbahen nga

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë. Kjo do të thotë se performanca e juridiksionit administrativ në nivel kombëtar varet në mënyrë disproporcionale nga kapaciteti organizativ dhe produktiviteti i një gjykate të vetme.

Edhe pse ka rënie të ngarkesës totale, niveli prej 21,621 çështjesh mbetet i lartë për një juridiksion me numër të kufizuar gjyqtarësh. Pesha e lartë e *backlog*-ut brenda kësaj ngarkese tregon se segmenti i çështjeve të vjetra vazhdon të ndikojë në performancën operative dhe ulja e hyrjeve të reja nuk është ende e mjaftueshme për të krijuar një trajektore të fortë rënëse të stokut.


Rënia prej 7% e ngarkesës totale përbën një zhvillim pozitiv, por përqendrimi 83% në Tiranë krijon rrezik të centralizimit të presionit. Pa rritje të kapaciteteve ose përmirësim të dukshëm të normës së likuidimit, ngarkesa mbetet në nivel që mund të ndikojë negativisht në treguesin DT (*Disposition Time*). Sistemi administrativ ndodhet në një fazë tranzitore mes stabilizimit dhe presionit strukturor, me Tiranën si hallkë kritike.

Ngarkesa mesatare për gjyqtar (Treguesi WR)

(Workload Ratio - gjykatat administrative të shkallës së parë)

Në vitin 2025, ngarkesa mesatare e punës për gjyqtar (treguesi WR) në gjykatat administrative të shkallës së parë ka arritur në 818 çështje për gjyqtar, duke shënuar një rënie prej 24% krahasuar me vitin 2024. Ky përmirësim është rezultat i dy faktorëve kryesorë, si rritja e numrit mesatar të gjyqtarëve efektivë, nga 19 në vitin 2024, në 23 në vitin 2025 (+21%), si edhe ulja e ngarkesës totale të punës si pasojë e rënies së hyrjeve të reja.

Megjithëse mesatarja kombëtare është 818 çështje për gjyqtar, ky tregues nuk reflekton në mënyrë të njëtrajtshme realitetin e brendshëm të juridiksionit administrativ, për shkak të përqendrimit disproporcional të ngarkesës në Gjykatën Administrative Tiranë. Kjo do të thotë se në Tiranë, ngarkesa reale për gjyqtar është dukshëm më e lartë se mesatarja, ndërsa në Gjykatën e Lushnjës, presioni është më i moderuar. Rrjedhimisht, mesatarja kombëtare mbart një pabarazi të brendshme në shpërndarjen e ngarkesës. Rënia prej 24% e treguesit WR përbën një nga treguesit më pozitivë të vitit 2025 në juridiksionin administrativ.



Grafiku nr.5

TREGUESIT E EFIÇENCËS

Rendimenti mesatar i punës për gjyqtar (Treguesi ER)

(Efficiency Rate - gjykatat administrative të shkallës së parë)

Në vitin 2025, treguesi ER (*Efficiency Rate*) në gjykatat administrative të shkallës së parë ka shënuar rënie në të dy gjykatat. Kjo rënie lidhet kryesisht me rritjen e numrit të gjyqtarëve efektivë, e cila ka sjellë shpërndarje më të gjerë të çështjeve dhe, për rrjedhojë, ulje të mesatares individuale të çështjeve të përfunduara për gjyqtar.


Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë

- ER 2024: 937 çështje/gjyqtar
- ER 2025: 691 çështje/gjyqtar
- Ulje: 246 çështje/gjyqtar
- Ndryshimi: -26%

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Lushnjë

- ER 2025: 276 çështje/gjyqtar
- Ulje prej 141 çështjesh për gjyqtar
- Ndryshimi: -34%

Rënia e ER në këtë kontekst nuk duhet lexuar automatikisht si rënie e efiçencës strukturore. Në praktikën CEPEJ, një rritje e numrit të gjyqtarëve zakonisht prodhon ulje të përkohshme të ER për shkak të efektit të integrimit dhe shpërndarjes së re të dosjeve dhe rritje të stabilitetit afatmesëm të sistemit përmes uljes së ngarkesës individuale (WR). Në rastin konkret WR ka rënë me 24%, ER ka rënë 26% dhe 34% respektivisht ndërsa çështjet e reja (*Incoming*) kanë pësuar rënie 8%. Kjo sugjeron se sistemi ndodhet në fazë tranzitore riorganizimi, ku rritja e kapaciteteve ende nuk është reflektuar plotësisht në rritje të produktivitetit të agreguar.




Grafiku nr.6

Gjykatat administrative duhet të fokusohen në planifikim më rigoroz të kalendarëve, standardizim të praktikave procedurale dhe monitorim tremujor të ER për të shmangur stagnim operacional. Nëse rritja e kapaciteteve shoqërohet me përmirësim organizativ, ER pritet të stabilizohet gjatë viteve 2026–2027.

Norma e likuidimit të çështjeve (Treguesi CR)

(Clerance Rate - gjykatat administrative të shkallës së parë)

Norma mesatare e likuidimit (CR) në juridiksionin administrativ në vitin 2025, paraqitet në nivel të qëndrueshëm krahasuar me vitin paraardhës, duke treguar se fluksi i çështjeve të reja është përballuar në mënyrë relativisht të kontrolluar. Megjithatë, analiza e detajuar evidenton diferenca të ndjeshme ndërmjet dy gjykatave administrative të shkallës së parë.



Grafiku nr.7

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, CR 2025: 95%, duke shënuar ulje prej 8% krahasuar me vitin 2024. Një normë likuidimi prej 95% do të thotë se gjykata nuk ka arritur të përfundojë të gjitha çështjet e reja të regjistruara gjatë vitit, duke sjellë rritje të *backlog*-ut. Edhe pse diferenca nga pragu 100% është relativisht e vogël, efekti akumulativ është domethënës, veçanërisht duke pasur parasysh se 83% e ngarkesës totale të juridiksionit administrativ është e përqendruar në këtë gjykatë.

Analiza tregon se, nëse do të ishte ruajtur i njëjti rendiment mesatar i vitit 2024, përveç përballimit të hyrjeve të reja, *backlog*-u do të kishte pësuar reduktim të konsiderueshëm (rreth 30%). Kjo thekson ndikimin e drejtpërdrejtë që ka rënia e ER në normën e likuidimit dhe në dinamikën e stokut. Pavarësisht rënies së ngarkesës totale në vitin 2025, niveli i saj mbetet i lartë dhe kërkon përmirësim të organizimit të proceseve të shqyrtimit dhe monitorim më të afërt të performancës operative.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Lushnjë, CR 2025: 103%, dhe ka një përmirësim prej 7% krahasuar me vitin 2024. Ky tregues tregon se gjykata ka arritur jo vetëm të përballojë plotësisht fluksin e ri, por edhe të reduktojë *backlog*-un ekzistues. Në terma CEPEJ, kjo gjykatë ndodhet në trajektore stabilizimi dhe reduktimi të stokut. Edhe pse norma mesatare e likuidimit në juridiksionin administrativ paraqitet e qëndrueshme, situata në Tiranë mbetet faktori kritik për performancën kombëtare.

Tre elementë dalin në pah:


1. CR nën 100% në Tiranë do të prodhojë rritje progresive të *backlog*-ut nëse nuk ndërhyhet;
2. Rritja e numrit të gjyqtarëve duhet të shoqërohet me stabilizim të ER për të prodhuar efekt real në stok;
3. Pa ndërhyrje strukturore, përqendrimi 83% i ngarkesës në një gjykatë të vetme krijon rrezik sistemik për juridiksionin administrativ.

Reduktimi i *backlog*-ut në juridiksionin administrativ varet drejtpërdrejt nga arritja e një norme likuidimi në nivel ose mbi 100% (CR ≥ 100%) në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë gjatë viteve 2026–2027.

<u>Koha e nevojshme për evadimin e çështjeve (Treguesi DT)</u>

(*Disposition Time - gjykatat administrative të shkallës së parë*)

Në vitin 2025, juridiksioni administrativ ka shënuar përkeqësim të treguesit DT (*Disposition Time*), duke reflektuar një zgjatje mesatare të kohëzgjatjes së gjykimeve me rreth një muaj krahasuar me vitin 2024. Ky zhvillim tregon se, pavarësisht rritjes së numrit të gjyqtarëve dhe uljes së ngarkesës mesatare (treguesi WR), koha reale e shqyrtimit të çështjeve nuk ka ndjekur të njëjtin trend përmirësues. Megjithatë, situata paraqitet e diferencuar ndërmjet dy gjykatave.



Grafiku nr.8

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, DT 2025: 247 ditë, +48 ditë krahasuar me vitin 2024, duke reflektuar përkeqësim prej 24%. Zgjatja me 48 ditë e kohës mesatare për evadim përbën një përkeqësim domethënës. Duke qenë se kjo gjykatë mban 83% të ngarkesës totale të juridiksionit administrativ, ndikimi i saj në mesataren kombëtare është përcaktues.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Lushnjë, DT 2025: 266 ditë, +18 ditë krahasuar me vitin 2024, duke reflektuar përkeqësim prej 7%. Edhe pse kjo gjykatë ka arritur likuidim (CR) mbi 100%, zgjatja e kohëzgjatjes mesatare tregon se reduktimi i stokut është realizuar në një kontekst me ritëm më të moderuar gjykimi për dosje individuale.


Përkeqësimi i DT është rezultat i drejtpërdrejtë i uljes së ER (më pak çështje të përfunduara për gjyqtar), mosarritjes së pragut 100% të CR (normës së likuidimit) në Tiranë si dhe strukturës së *backlog*-ut të dominuar nga çështje me palë kundërshtare. Në metodologjinë CEPEJ, DT është tregues sintetik që reflekton kombinimin e *incoming*, *resolved cases* dhe *pending cases*. Rritja e tij tregon se juridiksioni administrativ ndodhet në fazë presioni operacional, veçanërisht në Tiranë.

Megjithëse DT prej 247-266 ditësh mbetet më i ulët sesa në disa juridiksione të tjera, trendi rritës është sinjal paralajmërues. Nëse CR në Tiranë nuk kalon mbi 100%, ER nuk stabilizohet dhe kapacitetet nuk rriten më tej, atëherë DT do të vijojë të rritet në vitet 2026–2027. Reduktimi i *Disposition Time* në juridiksionin administrativ është i lidhur drejtpërdrejt me stabilizimin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

***Backlog* në fund të vitit 2025**

(*Gjykatat Administrative të Shkallës së Parë – 2025*)

Gjykatat administrative të shkallës së parë, në fund të vitit 2025, raportojnë një total prej 8,796 çështjesh në pritje të gjykimit, duke shënuar një rritje prej 4.8% krahasuar me fundin e vitit 2024 (400 çështje më shumë). Kjo rritje tregon se, pavarësisht rënies së hyrjeve të reja dhe shtimit të numrit të gjyqtarëve, juridiksioni administrativ nuk ka arritur të stabilizojë stokun në nivel kombëtar.



Grafiku nr.9

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, ka *backlog* në fund të vitit 2025: 7,209 çështje, +8% krahasuar me fillimin e vitit (+563 çështje). Rritja e *backlog*-ut në Tiranë konfirmon se norma e likuidimit prej 95% nuk ka qenë e mjaftueshme për të përballuar fluksin e çështjeve të reja. Duke qenë se kjo gjykatë mban rreth 85% të ngarkesës totale të juridiksionit administrativ, çdo devijim nga pragu 100% i CR ka efekt të menjëhershëm në rritjen e stokut kombëtar. Kjo situatë tregon se shtimi i gjyqtarëve në vitin 2025 ka qenë i pamjaftueshëm për të prodhuar reduktim real të *backlog*-ut, rënia e ER ka ndikuar drejtpërdrejt në dinamikën e stokut.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Lushnjë, ka *backlog* në fund të vitit 2025: 1,587 çështje, -9% krahasuar me fillimin e vitit (-163 çështje). Në këtë gjykatë, kombinimi i CR mbi 100%, rritjes së kapaciteteve dhe një ngarkese më të moderuar ka prodhuar reduktim të *backlog*-ut. Kjo tregon se, nëse pragu 100% i normës së likuidimit ruhet, reduktimi i stokut është i arritshëm.

Rritja e *backlog*-ut në nivel kombëtar, megjithëse e moderuar (+4.8%), është sinjal që juridiksioni administrativ nuk ka hyrë ende në fazë stabilizimi të plotë. Tre elementë dalin në pah:


1. Tirana mbetet hallka kritike dhe përcaktuese e performancës;
2. CR nën 100% prodhon rritje progresive të stokut;
3. Rritja e kapaciteteve duhet të shoqërohet me stabilizim të ER për të prodhuar efekt real.

Zbatimi i plotë dhe intensiv i masave të parashikuara në Strategjinë Kombëtare për Uljen e Çështjeve të Prapambetura 2024-2027 është i domosdoshëm për të përmbysur këtë trend. Për sa kohë *backlog*-u mbetet në rritje, nevoja për masa të qëndrueshme dhe afatgjata, përfshirë rritje të mëtejshme të kapaciteteve gjyqësore dhe përmirësim organizativ, mbeten prioritete strategjik.

Vjetërsia e çështjeve në pritje të gjykimit

(Mosha e backlog-ut - gjykatat administrative të shkallës së parë)

Analiza e strukturës së *backlog*-ut sipas vjetërsisë së çështjeve tregon se pjesa më e madhe e stokut përbëhet nga çështje relativisht të reja, të regjistruara brenda një viti. Kjo strukturë sugjeron se gjykatat administrative kanë fokusuar përpjekjet në trajtimin e çështjeve më të vjetra, duke reduktuar gradualisht akumulimin shumëvjeçar të dosjeve në pritje.



Grafiku nr.10

Në fund të vitit 2025 rezulton se 61% e *backlog*-ut (5,332 çështje) përbëhet nga çështje të regjistruara gjatë vitit të fundit. Brenda kësaj kategorie, 2,892 çështje kanë një vjetërsi më të vogël se 6 muaj, ndërsa pjesa tjetër përbëhet nga çështje me vjetërsi midis 6 dhe 12 muajsh.

Një pjesë tjetër e konsiderueshme e *backlog*-ut, 24% (2,104 çështje), përbëhet nga çështje të regjistruara 1-2 vite më parë, ndërsa 652 çështje kanë një vjetërsi 2-3 vite. Në kategori më të vjetra rezultojnë 416 çështje që kanë mbi 3 vite në pritje të shqyrtimit.

Çështjet me vjetërsi mbi 5 vite përbëjnë vetëm 3% të *backlog*-ut (292 çështje). Ky nivel relativisht i ulët i çështjeve shumë të vjetra tregon se gjykatat administrative kanë ndërmarrë masa për të reduktuar stokun historik të dosjeve në pritje dhe për të shmangur krijimin e një *backlog*-u shumëvjeçar.

Nga këndvështrimi i efiçencës së sistemit, kjo strukturë e *backlog*-ut tregon se juridiksioni administrativ përballet më shumë me një presion të fluksit të çështjeve të reja, sesa me një problem të akumulimit historik të dosjeve. Megjithatë, përqendrimi i një numri të konsiderueshëm çështjesh brenda vitit të parë sugjeron se kapacitetet aktuale të gjykatave janë të angazhuara kryesisht në përballimin e hyrjeve të reja, duke kufizuar mundësinë për reduktim më të shpejtë të stokut total.

Në këtë kontekst, përmirësimi i mëtejshëm i treguesve të performances, veçanërisht normës së likuidimit (CR) dhe rendimentit mesatar për gjyqtar (ER**)**, mbetet thelbësor për të siguruar që *backlog*-u të mos vijojë të rritet dhe që kohëzgjatja e shqyrtimit të çështjeve të mbahet brenda standardeve të arsyeshme të efiçencës.

Kohëzgjatja e çështjeve të gjykuara në vitin 2025

Gjatë vitit 2025, gjykatat administrative të shkallës së parë kanë përfunduar 12,825 çështje, duke reflektuar një kapacitet të qëndrueshëm të sistemit për të përballuar fluksin e çështjeve të paraqitura. Analiza e kohëzgjatjes së gjykimit tregon se shumica e çështjeve janë shqyrtuar dhe përfunduar brenda afateve relativisht të shkurtra, çka përbën një tregues pozitiv për funksionimin e juridiksionit administrativ. Megjithatë, prania e një *backlog*-u të konsiderueshëm vazhdon të ndikojë në kohëzgjatjen e shqyrtimit për një pjesë të çështjeve.

Nga analiza e shpërndarjes së kohëzgjatjes së gjykimit rezulton se:

- 62% e çështjeve të përfunduara (7,948 raste) janë zgjidhur brenda 6 muajve, duke treguar një ritëm të përshpejtuar të shqyrtimit për një pjesë të madhe të çështjeve administrative;
- 15% e çështjeve (1,978 raste) janë përfunduar brenda një periudhe 6-12 muaj, duke ruajtur një kohëzgjatje relativisht të arsyeshme të procesit gjyqësor;
- 15% e çështjeve (1,945 raste) kanë kërkuar 1-2 vite për t'u përfunduar, e cila lidhet kryesisht me kompleksitetin e disa kategorive të çështjeve ose me ngarkesën e lartë të punës në disa gjykata;
- 8% e çështjeve kanë pasur një kohëzgjatje mbi 2 vite, duke treguar se një segment i kufizuar i çështjeve vijon të përballet me afate më të gjata të shqyrtimit.

Këto të dhëna tregojnë se shumica e çështjeve administrative përfundohen brenda një periudhe relativisht të shkurtër, ndërsa vetëm një pjesë e vogël e tyre shkon përtej dy viteve të shqyrtimit.

Nga pikëpamja e shpërndarjes institucionale të ngarkesës së punës, 83% e çështjeve të përfunduara i përkasin Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, e cila mbetet gjykata me fluksin më të madh të çështjeve në juridiksionin administrativ. Kjo gjykatë përballet njëkohësisht me numrin më të lartë të regjistrimeve të reja dhe me pjesën më të madhe të *backlog*-ut, duke e bërë performancën e saj një faktor përcaktues për efiçencën e përgjithshme të juridiksionit administrativ.

Në tërësi, të dhënat tregojnë se, pavarësisht përpjekjeve për të përshpejtuar ritmin e gjykimit dhe për të trajtuar çështjet brenda afateve të arsyeshme, juridiksioni administrativ vijon të përballet me sfida që lidhen kryesisht me përqendrimin e ngarkesës së punës në Gjykatën Administrative të Tiranës dhe me nevojën për rritje të mëtejshme të kapaciteteve për të reduktuar *backlog*-un dhe për të përmirësuar kohëzgjatjen mesatare të shqyrtimit të çështjeve.

Gjetjet kryesore!

Analiza e të dhënave statistikore për vitin 2025 në juridiksionin administrativ nxjerr në pah disa gjetje kryesore që lidhen me ngarkesën e punës, performancën e gjykatave dhe sfidat strukturore të këtij niveli gjyqësor.

1. **Përqendrimi i ngarkesës në Gjykatën Administrative të Tiranës**

- Kjo gjykatë përballon rreth 85% të çështjeve të reja, 83% të ngarkesës totale dhe 83% të çështjeve të përfunduara, duke e bërë performancën e saj përcaktuese për efiçencën e gjithë juridiksionit administrativ.

2. Ulje e regjistrimeve të reja, por *backlog*-u në rritje

- Gjatë vitit 2025 është vërejtur rënia e çështjeve të reja me rreth 8%,
- *Backlog*-u në fund të vitit është rritur me 4.8%, duke arritur në 8,796 çështje

3. Rritje e kapaciteteve njerëzore dhe ulje e ngarkesës mesatare për gjyqtar

- Numri mesatar i gjyqtarëve është rritur nga 19 në 23 gjyqtarë, duke ulur ngarkesën mesatare për gjyqtar (treguesi WR) në 818 çështje, ose 24% më pak krahasuar me vitin 2024.

4. Rënie e rendimentit mesatar për gjyqtar (ER)

- Pavarësisht rritjes së numrit të gjyqtarëve dhe uljes së ngarkesës mesatare, rendimenti mesatar për gjyqtar ka shënuar rënie, si në Gjykatën Administrative të Tiranës ashtu edhe në atë të Lushnjës.

5. Norma e likuidimit e qëndrueshme, por e pamjaftueshme për reduktimin e *backlog*-ut

Norma mesatare e likuidimit (CR) mbetet relativisht e qëndrueshme.

- Në Tiranë, CR është 95%, duke mos arritur pragun 100% dhe duke kontribuar në rritjen e *backlog*-ut.
- Në Lushnjë, CR ka arritur 103%, duke mundësuar reduktimin e stokut të çështjeve.

6. Përkeqësim i treguesit të kohës së evadimit të çështjeve (DT)

Koha mesatare për evadimin e çështjeve është rritur në të dy gjykatat:

- 247 ditë në Tiranë (+24%)
- 266 ditë në Lushnjë (+7%)

Ky përkeqësim lidhet drejtpërdrejt me rënien e rendimentit mesatar dhe ritmin më të ulët të përfundimit të çështjeve.

7. Strukturë relativisht e shëndetshme e *backlog*-ut sipas vjetërsisë

Shumica e *backlog*-ut përbëhet nga çështje relativisht të reja:

- 61% janë çështje më pak se 1 vit të vjetra
- vetëm 3% janë mbi 5 vite

Kjo tregon se juridiksioni administrativ nuk përballet me një stok të rëndë historik, por kryesisht me presion të vazhdueshëm nga fluksi i çështjeve të reja.

8. Shumica e çështjeve përfundojnë brenda një periudhe të arsyeshme

Nga 12,825 çështje të përfunduara gjatë vitit 2025:

- 62% janë përfunduar brenda 6 muajve
- vetëm 8% kanë zgjatur mbi 2 vite

Ky tregues reflekton një ritëm relativisht të mirë të shqyrtimit për shumicën e çështjeve administrative.


8.7 GJYKATAT E SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM

Menaxhimi i çështjeve në Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm

Çështje në pritje të gjykimit (*Backlog*)

(Pending Cases - gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm)

Gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm në fillim të vitit 2025, kanë regjistruar një stok total prej 42,070 çështjesh të mbartura nga periudha e mëparshme raportuese. Ky stok përbëhet nga 29,824 çështje civile dhe 12,246 çështje penale. Në kontekst krahasimor me fillimin e vitit 2024, vërehet një ulje prej 1,783 çështjesh, që korrespondon me një reduktim prej 4% të stokut total. Ky është reduktimi i parë i evidentuar në pesë vitet e fundit në këtë nivel gjyqësor, çka sinjalizon një përmirësim potencial të balancës midis çështjeve të reja dhe atyre të përfunduara.




Grafiku nr.1

Në kuptim të metodologjisë CEPEJ, ky tregues përfaqëson numrin e çështjeve të pazgjidhura në fund të periudhës së mëparshme, i cili përbën bazën për llogaritjen e indikatorëve të efiçencës, veçanërisht të kohës së nevojshme për evadimin e çështjeve (*Disposition Time*) dhe analizën e kapacitetit për reduktimin e *backlog*-ut.

Nga këndvështrimi i standardeve CEPEJ, një ulje e stokut tregon se gjatë periudhës së mëparshme sistemi ka operuar me një normë likuidimi (*Clearance Rate*) efektive mbi 100%, duke arritur të zgjidhë më shumë çështje sesa janë regjistruar rishtazi. Ky zhvillim përbën një premisë pozitive për përmirësimin e mëtejshëm të kohëzgjatjes së çështjeve gjatë vitit 2025.

Analiza e shpërndarjes së stokut të çështjeve midis gjykatave evidenton një përqendrim të theksuar të ngarkesës në një numër të caktuar gjykatash, duke reflektuar pabarazi në shpërndarjen e fluksit dhe kapaciteteve. Në terma konkretë rezulton se, Gjykata e Tiranës mban peshën kryesore me 18,485 çështje, që përfaqëson rreth 44% të *backlog*-ut total të këtij niveli; Gjykata e Elbasanit përfaqëson rreth 12.5% të *backlog*-ut; dhe Gjykata e Durrësit rreth 10.5% të *backlog*-ut total. Së bashku, këto tre gjykata përqendrojnë 67% të stokut total, duke konfirmuar një polarizim të ngarkesës gjyqësore në zonat me dendësi demografike dhe aktivitet ekonomik më të lartë. Ndërkohë, gjykatat e tjera paraqesin nivele më të moderuara, dhe konkretisht Korçë, Vlorë dhe Fier: nga 4.8% – 5.4%; Shkodër: rreth 4%; Berat, Gjirokastër, Lezhë: rreth 3% secila; Sarandë: 2.3%; Dibër dhe Kukës: rreth 1.3% secila.



Grafiku nr.2

Struktura e shpërndarjes territoriale mbetet relativisht e pandryshuar në pesë vitet e fundit, duke reflektuar vazhdimësi të faktorëve si përqendrimi i popullsisë, volumi i aktivitetit ekonomik, burimet njerëzore në dispozicion si dhe kompleksiteti i çështjeve.

Nga perspektiva CEPEJ, përqendrimi i lartë i *backlog*-ut në disa gjykata kyçe ndikon drejtpërdrejt në kohën e nevojshme për evadim (treguesi DT), në kapacitetin për të ruajtur një normë likuidimi më të lartë ose të barabartë me numrin e çështjeve të reja të regjistruara në gjykatë (*Clearance Rate* ≥ 100%) në mënyrë të qëndrueshme si dhe në rrezikun e krijimit

të "*backlog*-ut strukturor". Reduktimi i përgjithshëm prej 4% përbën një tregues pozitiv në nivel sistemi, por përqendrimi disproporcional i stokut në tre gjykata kërkon masa të targetuara organizative dhe menaxheriale për të shmangur rikrijimin e *backlog*-ut në periudhën pasuese.


Çështjet e reja të regjistruara

(Incoming Cases - gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm)

Sipas metodologjisë së CEPEJ-it, treguesi i çështjeve të reja të regjistruara (*Incoming Cases*) përbën një komponent thelbësor në analizën e fluksit gjyqësor i cili përdoret drejtpërdrejt për llogaritjen e normës së likuidimit të çështjeve (*Clearance Rate*), si dhe në vlerësimin e kapacitetit të sistemit për të përballuar ngarkesën hyrëse.

Gjatë vitit 2025, në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm janë regjistruar gjithsej 81,842 çështje të reja (*incoming cases*). Në krahasim me vitin 2024, ky volum paraqet një ulje prej 2,878 çështjesh, ose rreth 3% më pak. Nga totali i çështjeve të reja të regjistruara në vitin 2025, është 32,408 çështje civile (40%) dhe 49,434 çështje penale (60%)

Struktura e çështjeve të reja mbetet e qëndrueshme në raport me vitet e mëparshme, me dominimin e çështjeve penale në shkallën e parë të juridiksionit të përgjithshëm. Ky konfigurim strukturor ka ndikim të drejtpërdrejtë në organizimin e burimeve njerëzore, kohëzgjatjen mesatare gjykimeve si dhe ngarkesën specifike sipas natyrës së çështjes.



Grafiku nr.3

Për sa është pasqyruar edhe në Grafikun nr.3, gjykata me ngarkesë më të lartë hyrëse është Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, e cila ka regjistruar 34,415

çështje të reja, që përfaqësojnë 42% të totalit kombëtar në këtë nivel gjyqësor. Nga perspektiva e efiçencës gjyqësore, një peshë kaq e lartë e hyrjeve kërkon një kapacitet proporcional për evadimin e çështjeve, në mënyrë që të ruhet një normë likuidimi në nivel 100% ose më e lartë, në mënyrë të tillë që të shmanget rritja e *backlog*-ut strukturor.


Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier renditet e dyta me 8,493 çështje të reja (10%). Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës zë vendin e tretë me 7,525 çështje (9%), duke ruajtur një nivel të ngjashëm me vitin paraardhës. Gjykatat e tjera si Elbasani, Korça, Shkodra dhe Vlora paraqesin volume më të moderuara individualisht, por së bashku përbëjnë rreth 22% të totalit të çështjeve të reja, duke kontribuar ndjeshëm në ngarkesën e përgjithshme të sistemit gjyqësor të shkallës së parë.

Nga këndvështrimi i CEPEJ-it: Ulja prej 3% e hyrjeve përbën një faktor lehtësues për menaxhimin e stokut ekzistues; Përqendrimi territorial i 61% të hyrjeve në tre gjykata (Tiranë, Fier, Durrës) rrit rrezikun e krijimit të presionit disproporcional mbi këto gjykata; Struktura 60% penale - 40% civile duhet të merret në konsideratë në analizën e mëtejshme të kohëzgjatjes (*Disposition Time*) dhe normës së përfundimit.

Ngarkesa totale e gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm

(Total Caseload - 2025)

Treguesi i "ngarkesës totale" paraqet presionin real operacional mbi sistemin gjyqësor gjatë periudhës raportuese dhe përbën bazën për vlerësimin e kapaciteteve organizative dhe menaxheriale të gjykatave. Gjatë vitit 2025, ngarkesa totale e punës *(total caseload)* në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm ka arritur në 123,912 çështje. Në përputhje me metodologjinë e CEPEJ-it, ky volum përfshin stokun e mbartur nga viti 2024 (42,070 çështje) dhe çështjet e reja të regjistruara gjatë vitit 2025 (81,842 çështje).



Grafiku nr.4

Analiza territoriale e ngarkesës totale konfirmon përqendrimin e konsiderueshëm të volumit të çështjeve në disa gjykata kryesore. Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë mban 52,900 çështje, që përfaqësojnë 43% të ngarkesës totale kombëtare në këtë nivel gjyqësor. Gjykatat e Durrësit, Elbasanit dhe Fierit, së bashku, përfaqësojnë rreth 26% të ngarkesës totale, duke konfirmuar modelin strukturor të përqendrimit të fluksit në qendrat urbane më të mëdha.

Krahasuar me vitin 2024, ngarkesa totale gjatë vitit 2025 ka shënuar një ulje prej 3.6%. Ky reduktim është rezultat i dy faktorëve kryesorë, *backlog* fillestar më i ulët, si pasojë e përmirësimit të normës së likuidimit gjatë vitit paraardhës si dhe ulja e çështjeve të reja të regjistruara gjatë vitit 2025 (-3%). Nga këndvështrimi i analizës CEPEJ, kjo situatë tregon një stabilizim të fluksit hyrës, reduktim gradual të presionit mbi sistemin dhe përmirësim të balancës midis hyrjeve dhe përfundimeve.

Në logjikën e CEPEJ-it, ngarkesa totale përfaqëson dimensionin e presionit mbi sistemin. Reduktimi i saj krijon kushte më të favorshme për përmirësimin e treguesit CR (*Clearance Rate*), të treguesit DT (*Disposition Time*) dhe reduktimin progresiv të *backlog*-ut. Megjithatë, nëse ulja e ngarkesës totale nuk shoqërohet me rritje proporcionale të çështjeve të përfunduara, efekti pozitiv mund të jetë i përkohshëm.

Ngarkesa mesatare e punës për gjyqtar (Treguesi WR)

(Workload Ratio - gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm)

Në vitin 2025, ngarkesa mesatare e punës për gjyqtar (*Workload Ratio* – treguesi WR) në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm rezulton 607 çështje për gjyqtar, krahasuar me 750 çështje për gjyqtar në vitin 2024, duke shënuar një ulje prej 143 çështjesh ose 19%. Ky tregues përbën një tregues të kapacitetit operacional dhe ndikon drejtpërdrejt në aftësinë e sistemit për të ruajtur nivele të qëndrueshme të efiçencës.

Përmirësimi i treguesit WR në vitin 2025 është rezultat i rritjes së numrit të gjyqtarëve efektivë në detyrë dhe uljes së ngarkesës totale të punës me rreth 4% krahasuar me vitin e kaluar. Reduktimi i presionit mesatar për gjyqtar krijon kushte më të favorshme për rritjen e normës së përfundimit të çështjeve, uljen e kohëzgjatjes së gjykimeve dhe reduktimin gradual të *backlog*.

Të dhënat tregojnë përmirësime të ndjeshme në disa gjykata, Berat: -39%, Gjirokastër: -35%, Lezhë: -29%, Elbasan: -26% dhe Dibër: -25% Këto ulje reflektojnë ose rritje të numrit të gjyqtarëve efektivë, ose stabilizim të fluksit të çështjeve. Rritje e vetme e evidentuar është gjykata Fier: +8% (727 çështje për gjyqtar në 2025 kundrejt 674.5 në 2024). Në këtë rast, nuk ka pasur rritje të numrit të gjyqtarëve, ndërkohë që çështjet e reja kanë qenë më të larta, duke prodhuar presion shtesë mbi kapacitetin ekzistues.

Gjykata e Tiranës vijon të paraqesë ngarkesën mesatare më të lartë në nivel kombëtar, e cila për vitin 2024 rezulton të jetë në 1006 çështje për gjyqtar, ndërsa në vitin 2025 rezulton të jetë në 917 çështje për gjyqtar, e cila në kontekst krahasimor reflekton një ulje në 9%. Megjithëse është evident një përmirësim, kjo gjykatë mbetet strukturalisht më e ngarkuara për shkak të volumit disproporcional të hyrjeve, stokut të trashëguar dhe kompleksitetit të çështjeve. Nga perspektiva e menaxhimit të efiçencës, Tirana përbën pikën kritike të sistemit, pasi çdo devijim në kapacitetin e saj ndikon ndjeshëm në indikatorët kombëtarë.

Analiza krahasimore tregon se treguesi WR mbetet i pabarabartë midis gjykatave. Megjithatë, krahasimi 2024-2025 evidenton një zbutje të diferencave ndërmjet gjykatave, veçanërisht midis Beratit dhe Gjirokastrës; Kukësit dhe Dibrës; si edhe midis Elbasanit dhe Fierit. Kjo tregon një lëvizje drejt balancimit relativ të kapaciteteve, por ende jo një ekuilibër optimal.

Rënia mesatare prej 19% e treguesit WR përfaqëson një zhvillim pozitiv strukturor, që mund të përkthehet në përmirësim të treguesit CR (*Clearance Rate*), reduktim të treguesit DT (*Disposition Time*) dhe ulje të *backlog*-ut në periudhat pasuese. Megjithatë, përqendrimi i lartë i ngarkesës në disa gjykata kërkon rishpërndarje më të ekuilibruar të burimeve njerëzore, forcim të strukturave administrative mbështetëse dhe mekanizma fleksibël të alokimit të gjyqtarëve në rast presioni disproporcional.

Gjykata	**Treguesi WR 2024**	**Treguesi WR 2025**	**Ndryshimi në %**
Berat	961.2	582	-39%
Dibër	418.4	315	-25%
Durrës	991.5	813	-18%
Elbasan	1001.4	741	-26%
Fier	674.5	727	+8%
Gjirokastër	1010	653	-35%
Korçë	613.3	605	-1%
Kukës	396	348	-12%
Lezhë	735	524	-29%
Sarandë	614.6	518	-16%
Shkodër	722.7	621	-14%
Tiranë	1005.9	917	-9%
Vlorë	603.9	527	-13%
Mesatar	**750**	**607**	**-19%**

TREGUESIT E EFIÇENCËS

Rendimenti mesatar i punës për gjyqtar (Treguesi ER)

(Efficiency Rate - gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm)

Ky tregues mat kapacitetin individual të përfundimit të çështjeve dhe përbën një indikator operacional të produktivitetit gjyqësor. Megjithëse CEPEJ nuk e përdor ER si indikator standard ndërkombëtar (si *Clearance Rate* ose *Disposition Time*), ai përbën një instrument të rëndësishëm të menaxhimit të brendshëm për vlerësimin e performancës së burimeve njerëzore. Në vitin 2025, rendimenti mesatar i punës për gjyqtar (*Efficiency Rate* – ER) në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm rezulton 420 çështje të përfunduara për gjyqtar, krahasuar me 516 çështje për gjyqtar në vitin 2024, duke shënuar një ulje prej 96 çështjesh ose 19%. Rënia mesatare prej 19% e treguesit ER reflekton një reduktim të volumit të çështjeve të përfunduara për gjyqtar në raport me vitin paraardhës.

Gjykata me përmirësim është vetëm Fier, +3%, e cila ka përfunduar 537 çështje për gjyqtar në vitin 2025 kundrejt 521.1 në vitin 2024. Kjo rritje sugjeron një stabilizim të kapacitetit operacional në këtë gjykatë, pavarësisht rritjes së fluksit hyrës. Gjykata me rënie të ndjeshme janë Gjirokastër: -38%, Berat: -36%, Lezhë: -30%, Dibër: -25%, Durrës dhe Elbasan: -20%. Në disa prej këtyre rasteve, rritja e numrit të gjyqtarëve efektivë ka ndikuar në uljen e treguesit mesatar, pasi vëllimi i çështjeve të përfunduara nuk është rritur në mënyrë proporcionale me rritjen e burimeve njerëzore.


Rasti i Gjykatës së Tiranës është i tillë, në vitin 2024: 655.8 çështje për gjyqtar dhe në vitin 2025: 614 çështje për gjyqtar, duke reflektuar një ulje prej -6%. Megjithëse Tirana ka shënuar rënie të lehtë, ajo mbetet ndër gjykatat me rendimentin më të lartë absolut, për shkak të volumit të madh të çështjeve të përfunduara. Megjithatë, kombinimi i *backlog*-ut të lartë, hyrjeve të konsiderueshme dhe presionit strukturor, kërkon një analizë të ndërlidhur me indikatorët e efiçencës së CEPEJ-it për të vlerësuar nëse produktiviteti aktual është i mjaftueshëm për reduktimin e stokut.

Treguesi ER për vitin 2025 sinjalizon nevojën për optimizim të organizimit të brendshëm të punës, përmirësim të menaxhimit të çështjeve komplekse dhe harmonizim më të mirë midis shpërndarjes së gjyqtarëve dhe volumit real të punës. Megjithatë, fakti që sistemi ka ulur ngarkesën mesatare (treguesiWR -19%) ndërkohë që ER gjithashtu ka rënë, tregon se rritja e burimeve njerëzore nuk është përkthyer proporcionalisht në rritje të produktivitetit.

Rendimenti mesatar i punës për gjyqtar në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm

Gjykata	ER 2024	ER 2025	Ndryshimi %
Berat	676.5	434	-36%
Dibër	323.8	243	-25%
Durrës	637	509	-20%

Elbasan	533	425	-20%
Fier	521.1	537	+3%
Gjirokastër	657.6	406	-38%
Korçë	426.9	403	-6%
Kukës	297.4	274	-8%
Lezhë	560.7	394	-30%
Sarandë	448.3	373	-17%
Shkodër	543	462	-15%
Tiranë	655.8	614	-6%
Vlorë	421.9	381	-10%
Mesatar	**516**	**420**	**-19%**



Grafiku nr. 5

Norma e Likuidimit të Çështjeve (Treguesi CR)


(Clearance Rate - gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm)

Norma e likuidimit të çështjeve (*Clearance Rate*) përbën indikatorin qendror të efiçencës gjyqësore sipas metodologjisë së CEPEJ-it, pasi mat në mënyrë të drejtpërdrejtë aftësinë e gjykatave për të përballuar fluksin vjetor të çështjeve dhe për të parandaluar krijimin ose thellimin e *backlog*-ut. Në interpretimin standard të CEPEJ-it, CR mbi 100% nënkupton reduktim të stokut të trashëguar, CR në nivelin 100% tregon balancim të plotë të fluksit si dhe CR nën 100% sinjalizon rritje të *backlog*-ut. Në këtë kuptim, CR është treguesi më i drejtpërdrejtë i qëndrueshmërisë strukturore të sistemit gjyqësor.

Treguesi CR për çështjet civile

Në vitin 2025, mesatarja e treguesit CR për çështjet civile në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm ka arritur në 111%, duke shënuar një rritje të ndjeshme krahasuar me vitin 2024 (103%). Ky rezultat përfaqëson një zhvillim thelbësor në drejtim të reduktimit të *backlog*-ut civil. Praktikisht, gjykatat kanë përfunduar më shumë çështje civile sesa janë regjistruar gjatë vitit 2025, duke kontribuar në mënyrë aktive në uljen e stokut të trashëguar. Duke qenë se çështjet civile përbëjnë peshën kryesore të *backlog*-ut historik, përmirësimi i CR në këtë kategori ka rëndësi të veçantë sistemike. Ai tregon se është arritur një përmirësim në organizimin e punës, është rritur kapaciteti për trajtimin paralel të stokut dhe fluksit të ri dhe janë krijuar kushte për reduktim gradual të kohëzgjatjes së gjykimeve.

Njëmbëdhjetë gjykata kanë kaluar pragun 100% për çështjet civile si Berat, Dibër, Durrës, Elbasan, Gjirokastër, Kukës, Lezhë, Sarandë, Shkodër, Tiranë dhe Vlorë. Gjykata e Dibrës, me një CR prej 101%, paraqet një situatë balancimi të qëndrueshëm, duke ruajtur ekuilibrin midis hyrjeve dhe përfundimeve. Gjykatat e tjera mbi 100% kanë arritur jo vetëm të përballojnë fluksin e ri, por edhe të reduktojnë stokun ekzistues. Nga ana tjetër, Gjykata e Fierit (91%) dhe Gjykata e Korçës (99%) kanë mbetur nën pragun optimal. Në rastin e Fierit, diferenca është domethënëse dhe tregon rritje të *backlog*-ut civil. Korça ndodhet shumë pranë balancimit, por kërkon monitorim për të shmangur një tendencë negative në vitet pasuese.



Grafiku nr.6

Treguesi CR për çështjet penale


Në vitin 2025, mesatarja e CR për çështjet penale është 102%, duke ruajtur të njëjtin nivel me vitin 2024. Ky rezultat dëshmon stabilitet në menaxhimin e fluksit penal dhe aftësi për të ruajtur një balancë pozitive midis hyrjeve dhe përfundimeve. Duke pasur parasysh natyrën specifike të gjykimeve penale që shpesh përfshijnë afate ligjore strikte dhe masa sigurimi, ruajtja e CR mbi 100% është një tregues i rëndësishëm i disiplinës procedurale dhe organizimit efektiv të brendshëm.

Tetë gjykata kanë kaluar pragun 100% për çështjet penale si Berat, Dibër, Elbasan, Kukës, Lezhë, Shkodër, Tiranë dhe Vlorë. Këto gjykata kanë arritur të përballojnë plotësisht fluksin penal dhe të kontribuojnë në reduktimin e stokut. Gjykata e Sarandës me 100% paraqet balancim të plotë të fluksit penal. Ndërkohë, Durrësi, Fieri, Gjirokastra dhe Korça kanë CR nën 100% për çështjet penale, duke shtuar stokun penal gjatë vitit 2025. Këto diferenca tregojnë se përmirësimi në sistem nuk është homogjen dhe kërkon masa të diferencuara.

Rezultatet e vitit 2025 tregojnë një përmirësim të qëndrueshëm të normës së likuidimit në të dy kategoritë kryesore të çështjeve CR Civil: 111% dhe CR Penal: 102%. Ky kombinim përfaqëson një nga treguesit më pozitivë të performancës për vitin raportues, pasi sinjalizon kalimin nga një fazë stabilizimi drejt një faze reduktimi aktiv të *backlog*-ut. Fakti që 11 gjykata kanë kaluar pragun 100% për çështjet civile dhe 8 gjykata për çështjet penale, përbën një progres konkret drejt objektivave të Strategjisë Kombëtare për Uljen e Çështjeve të Prapambetura 2024–2027 dhe përputhet me qasjen e rekomanduar nga CEPEJ për reduktim sistematik të stokut.

Megjithatë, prania e gjykatave me CR nën 100% tregon se sistemi mbetet i ndjeshëm ndaj pabarazive territoriale dhe shpërndarjes së ngarkesës së punës. Për këtë arsye, ruajtja e këtij progresi kërkon monitorim të vazhdueshëm të treguesve në nivel gjykate, rishpërndarje më fleksibile të burimeve njerëzore dhe optimizim të proceseve të brendshme administrative.

Norma e likuidimit për vitin 2025 dëshmon se gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm kanë arritur një nivel të konsoliduar të efiçencës në përballimin e fluksit të çështjeve, veçanërisht në juridiksionin civil. Për herë të parë pas disa viteve, reduktimi i *backlog*-ut nuk është episodik, por i mbështetur në një normë sistemike likuidimi mbi 100%. Për të garantuar që ky përmirësim të jetë i qëndrueshëm, kërkohet vazhdimësi në ruajtjen e CR mbi pragun 100% dhe adresim të diferencave mes gjykatave, në mënyrë që progresi i arritur të konsolidohet në periudhat e ardhshme raportuese.



Grafiku nr.7

Koha e nevojshme për evadimin e çështjeve (Treguesi DT)


(Disposition Time - gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm)

Treguesi DT (*Disposition Time*) përfaqëson një nga indikatorët më të rëndësishëm të efiçencës gjyqësore sipas metodologjisë së CEPEJ-it, pasi mat kohën teorike të nevojshme për përfundimin e çështjeve në pritje të gjykimit, nëse ruhet ritmi aktual i likuidimit. Ndryshe nga CR (*Clerance Rate*), i cili mat balancën mes hyrjeve dhe përfundimeve, DT jep një vlerësim të drejtpërdrejtë të kohëzgjatjes së gjykimeve dhe përbën indikatorin më të afërt me perceptimin e qytetarëve mbi "drejtësinë në kohë".

Treguesi DT për çështjet civile

Në vitin 2025, vlera mesatare e treguesit DT për çështjet civile është 270 ditë, krahasuar me 256 ditë në vitin 2024, duke reflektuar një zgjatje prej 14 ditësh ose rreth 5%. Ky përkeqësim i lehtë duhet analizuar në kontekstin e *backlog*-ut të lartë civil të trashëguar, kompleksitetit të çështjeve civile dhe përqendrimit të ngarkesës në disa gjykata me volum të madh. Megjithëse CR civil ka qenë 111%, ndikimi i stokut historik vazhdon të reflektohet në kohëzgjatjen mesatare të gjykimeve.

Disa gjykata kanë arritur përmirësime domethënëse si Berat: -65 ditë, Vlorë: -19 ditë, Kukës: -14 ditë, Lezhë dhe Shkodër: përmirësime të moderuara. Këto rezultate tregojnë një kombinim të reduktimit të *backlog*-ut, menaxhimit më efektiv të kalendarëve gjyqësorë, optimizimit të proceseve të brendshme. Gjykatat me përkeqësim të DT (çështje civile) si Fier dhe Korçë: +79 ditë, Tiranë: +47 ditë, Shkodër: +43 ditë, Durrës: +31 ditë dhe Gjirokastër: +15 ditë. Në këto gjykata, përkeqësimi i DT lidhet kryesisht me kapacitetet organizative të kufizuara. Në Dibër dhe Sarandë rritja ka qenë minimale (më pak se 10 ditë), duke mos prodhuar devijime të ndjeshme strukturore.




Grafiku nr.8

Treguesi DT për çështjet penale

Në vitin 2025, vlera mesatare e DT për çështjet penale është 92 ditë, krahasuar me 97 ditë në vitin 2024, duke reflektuar një përmirësim prej rreth 5%. Ky zhvillim është veçanërisht i rëndësishëm, duke pasur parasysh natyrën e gjykimit penal. Reduktimi i DT penal tregon disiplinë procedurale, përparësi në trajtimin e çështjeve me ndjeshmëri të lartë, menaxhim më të qëndrueshëm të stokut penal.

Gjykatat me përmirësim të ndjeshëm (çështje penale) janë Elbasan: -71 ditë, Tiranë: -33 ditë, Kukës: -23 ditë, Berat: -20 ditë, Vlorë: -14 ditë dhe Dibër: -7 ditë. Këto rezultate tregojnë rritje të efiçencës në trajtimin e çështjeve penale dhe përmirësim të organizimit procedural. Gjykatat me përkeqësim (çështje penale) janë Gjirokastër: +29 ditë, Fier: +19 ditë, Korçë: +17 ditë dhe Durrës: +15 ditë. Ndërsa në Lezhë, Sarandë dhe Shkodër rritja ka qenë minimale (më pak se 10 ditë), pa ndikim të konsiderueshëm sistemik.



Grafiku nr. 9

Në tërësi, duke kombinuar çështjet civile dhe penale, treguesi DT ka shënuar një reduktim të përgjithshëm prej rreth 2% krahasuar me vitin 2024. Kjo tregon stabilitet të përgjithshëm në kohëzgjatjen e gjykimeve, ndikim pozitiv të CR mbi 100% dhe përmirësim të menaxhimit të procesit penal që kompenson zgjatjen në atë civil. Megjithatë, rritja e DT në disa gjykata të mëdha (sidomos Fier dhe Korçë për çështjet civile) tregon se përmirësimi sistemik nuk është i shpërndarë në mënyrë homogjene.

Nga perspektiva e CEPEJ-it, kombinimi i CR civil 111%, CR penal 102%, DT penal në ulje si dhe DT civil me rritje të moderuar, tregon se sistemi ndodhet në një fazë tranzitore midis stabilizimit dhe konsolidimit të reduktimit të *backlog*-ut. Treguesi DT për vitin 2025 dëshmon se sistemi gjyqësor i shkallës së parë ruan një nivel të qëndrueshëm efiçence, me përmirësim të dukshëm në juridiksionin penal dhe me sfida të moderuara në juridiksionin

civil. Reduktimi i kohëzgjatjes për çështjet penale përbën një arritje të rëndësishme në drejtim të garantimit të drejtësisë në kohë. Ndërkohë, për juridiksionin civil, mbetet e nevojshme një qasje e vazhdueshme dhe e koordinuar për të konsoliduar progresin e arritur në normën e likuidimit dhe për ta reflektuar atë në reduktim të qëndrueshëm të kohëzgjatjes mesatare të gjykimeve.

***Backlog* në fund të vitit 2025**

(*Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm – 2025*)

Në përfundim të vitit 2025, gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm raportojnë një total prej 39,767 çështjesh të mbetura në pritje të shqyrtimit (*pending cases*). Krahasuar me stokun fillestar të vitit (42,070 çështje), kjo përfaqëson një reduktim prej rreth 5.5%, ose 2,303 çështje më pak në pritje. Në kuptim të metodologjisë së CEPEJ-it, ky tregues është indikator thelbësor për vlerësimin e qëndrueshmërisë së sistemit. Ulja e stokut në fund të periudhës raportuese konfirmon se gjatë vitit 2025 sistemi ka funksionuar me një normë likuidimi (*Clearance Rate*) mbi 100%, duke arritur jo vetëm të përballojë çështjet e reja të regjistruara në gjykata, por edhe të reduktojë *backlog*-un e trashëguar. Megjithëse reduktimi është relativisht modest në terma përqindjeje, ai përfaqëson një zhvillim pozitiv dhe të qëndrueshëm, sidomos duke pasur parasysh volumin e lartë të çështjeve në fillim të vitit, përqendrimin disproporcional të ngarkesës në disa gjykata dhe kompleksitetin e çështjeve civile të mbartura ndër vite. Ky rezultat dëshmon përpjekjet e vazhdueshme institucionale për adresimin sistematik të çështjeve të prapambetura dhe për stabilizimin e fluksit gjyqësor.

Në fund të vitit 2025, struktura e stokut paraqitet si vijon 70% çështje civile dhe 30% çështje penale. Kjo shpërndarje konfirmon një prirje të konsoliduar ndër vite, ku çështjet civile përbëjnë peshën kryesore të *backlog*-ut strukturor.

Dominimi i çështjeve civile në stokun përfundimtar lidhet me disa faktorë objektivë:

1. Natyrën dhe kompleksitetin procedural të çështjeve civile, të cilat shpesh kërkojnë administrim të provave, ekspertiza dhe seanca të shumta.
2. Volumin historik të trashëguar, i akumuluar në periudha me CR nën 100%.
3. Prioritetin procedural të çështjeve penale, për shkak të:
    - afateve të detyrueshme të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale,
    - nevojës për garantimin e të drejtave themelore të palëve,
    - standardeve ndërkombëtare për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, veçanërisht në rastet me masa sigurimi.

Për rrjedhojë, sistemi gjyqësor ka ndjekur një qasje të balancuar për ruajtjen e disiplinës së fortë në juridiksionin penal dhe reduktimin progresiv të *backlog*-ut civil.

Backlog-u prej 39,767 çështjesh në fund të vitit 2025 përfaqëson një nivel më të ulët se fillimi i vitit, tregues i stabilizimit të fluksit dhe një bazë më të favorshme për planifikimin e vitit pasardhës. Reduktimi prej 5.5% konfirmon se sistemi ka kaluar nga faza e stabilizimit në

fazën e reduktimit gradual të *backlog*-ut. Megjithatë, përqendrimi territorial i stokut në disa gjykata të mëdha, mbetet faktor për rikrijimin e presionit disproporcional në sistem. Për të arritur një transformim strukturor afatgjatë, është thelbësore ruajtja e ritmit të likuidimit dhe adresimi i pabarazive territoriale që vazhdojnë të ndikojnë në shpërndarjen e stokut.

Kohëzgjatja e çështjeve të gjykuara

Analiza e kohëzgjatjes së çështjeve të përfunduara gjatë vitit 2025 përbën një element thelbësor në vlerësimin e cilësisë dhe efiçencës së sistemit gjyqësor, pasi plotëson treguesin DT (*Disposition Time*) me të dhëna reale mbi shpërndarjen e kohës së gjykimit. Ndryshe nga DT, i cili jep një vlerësim teorik të kohës së nevojshme për evadimin e stokut, analiza e kohëzgjatjes së çështjeve të përfunduara jep një pasqyrë konkrete mbi kohën reale të shqyrtimit.

Kohëzgjatja e çështjeve civile

Gjatë vitit 2025 janë përfunduar 34,327 çështje civile, të shpërndara sipas intervaleve kohore si më poshtë 57% (19,595 çështje) janë përfunduar brenda 6 muajve, 33% (11,189 çështje) janë përfunduar brenda 6-12 muajve, 7% (2,575 çështje) kanë zgjatur 1-2 vjet dhe 3% (968 çështje) kanë pasur kohëzgjatje mbi 2 vjet. Fakti që 90% e çështjeve civile janë përfunduar brenda 12 muajve përbën një tregues pozitiv të përshpejtimit të proceseve gjyqësore për shumicën e çështjeve.

Megjithatë, segmenti prej 10% që tejkalon një vit dhe veçanërisht 3% mbi dy vite, mbetet një zonë me risk për perceptimin e drejtësisë në kohë. Këto çështje zakonisht lidhen me kompleksitet të lartë faktik ose juridik, nevojë për ekspertiza, shtyrje të përsëritura procedurale si dhe ngarkesë disproporcionale në disa gjykata.


Nga perspektiva e CEPEJ-it dhe standardeve të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut mbi “afatin e arsyeshëm”, segmenti mbi 2 vite kërkon monitorim të posaçëm dhe masa të targetuara për reduktim të mëtejshëm.


Kohëzgjatja e çështjeve penale

Gjatë vitit 2025 janë përfunduar 49,818 çështje penale, me shpërndarje 89% (44,248 çështje) janë përfunduar brenda 6 muajve, 8.7% (4,345 çështje) janë përfunduar brenda 6–12 muajve, 1.8% (925 çështje) kanë zgjatur 1-2 vjet dhe 0.5% (300 çështje) kanë zgjatur mbi 2 vjet. Këto të dhëna tregojnë një performancë të lartë në juridiksionin penal, ku pothuajse 98% e çështjeve janë përfunduar brenda një viti. Segmenti prej 0.5% mbi 2 vite përfaqëson një nivel të ulët të vonesave, duke reflektuar stabilitet procedural dhe kontroll efektiv të stokut penal.

Në fund të vitit 2025, rezultojnë 39,767 çështje të pazgjidhura, të shpërndara sipas vjetërsisë, 83% me vjetërsi deri në 2 vite, 9% me vjetërsi 2-3 vite, 4.5% me vjetërsi 3-5 vite dhe 3.5% me vjetërsi mbi 5 vite. Kjo shpërndarje tregon se pjesa dërrmuese e stokut ndodhet brenda një intervali relativisht të kontrollueshëm kohor (deri në 2 vite), çka sugjeron se sistemi po arrin të kufizojë krijimin e *backlog*-ut të thellë kronik.

Segmenti prej rreth 8% të çështjeve mbi 3 vite, dhe veçanërisht 3.5% mbi 5 vite, përbën një indikator kritik për monitorim të vazhdueshëm, pasi çështjet shumëvjeçare janë ato që ndikojnë më shumë në perceptimin publik dhe në vlerësimet ndërkombëtare të efiçencës.





Grafiku nr. 10 dhe Grafiku nr. 11

Të dhënat e vitit 2025 tregojnë performancë shumë të mirë në trajtimin e çështjeve penale, përmirësim të ndjeshëm në shumicën e çështjeve civile, reduktim të *backlog*-ut me rreth 5.5% dhe kufizim të stokut shumëvjeçar në nivele të kontrolluara. Nga perspektiva e menaxhimit të kohës gjyqësore (SATURN – CEPEJ), sistemi ndodhet në një fazë konsolidimi, ku fluksi i ri përballohet në kohë, *backlog*-u po reduktohet gradualisht, segmentet me kohëzgjatje të lartë mbeten sfida prioritare.

Analiza e kohëzgjatjes së çështjeve të përfunduara dhe e strukturës së stokut në fund të vitit 2025 dëshmon një përmirësim të përgjithshëm të efiçencës gjyqësore në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm. Ruajtja e normës së likuidimit mbi 100% dhe përqendrimi në trajtimin prioritar të çështjeve shumëvjeçare, janë elementë kyç për konsolidimin e progresit në vitet pasuese dhe për arritjen e objektivave të Strategjisë Kombëtare për Uljen e Çështjeve të Prapambetura 2024-2027.

Gjetjet kryesore!

1. **Reduktim i *backlog*–ut dhe balancim i fluksit**

- *Backlog*-u është reduktuar me 5.5% krahasuar me vitin 2024.
- CR Civil: 111%
- CR Penal: 102%

Këta tregues konfirmojnë se sistemi ka arritur të përballojë hyrjet e reja dhe njëkohësisht të reduktojë stokun e trashëguar.

2. **Stabilitet i lartë në juridiksionin penal**

- 89% e çështjeve penale janë përfunduar brenda 6 muajve.

- DT penal ka shënuar përmirësim (92 ditë mesatarisht).

Juridiksionin penal paraqet performancë të qëndrueshme dhe respektim të standardeve për drejtësi në kohë.

3. **Përmirësim strukturor në ngarkesën për gjyqtar**

- Ngarkesa mesatare për gjyqtar është ulur me 19%.

Rritja e numrit të gjyqtarëve efektivë ka ndikuar pozitivisht në stabilizimin e sistemit.

4. **Sfida në juridiksionin civil**

- DT civil është rritur me 5% (270 ditë).
- 70% e *backlog*-ut përbëhet nga çështje civile.

Megjithëse norma e likuidimit është e lartë, kompleksiteti dhe stoku historik vazhdojnë të ndikojnë në kohëzgjatjen e proceseve civile.

Diferencat territoriale – Çështje prioritare

Performanca nuk është homogjene.

- Gjykatat me stabilitet të konsoliduar: Berat, Kukës, Lezhë, Vlorë.
- Gjykata me presion të lartë strukturor: Tiranë, Durrës, Elbasan.
- Gjykata me sfida të theksuara në 2025: Fier (CR civil nën 100% dhe rritje e DT), si dhe në disa tregues Korça.

Tirana, megjithëse mban 43% të ngarkesës kombëtare, ka ruajtur performancë relativisht të qëndrueshme në raport me volumin që administron, por mbetet pika më kritike sistemike.

Vlerësim strategjik

Sistemi ka kaluar nga faza e stabilizimit në fazën e reduktimit gradual të *backlog*-ut. Megjithatë:

- Përqendrimi territorial i ngarkesës mbetet faktor rreziku.
- *Backlog*-u civil kërkon ndërhyrje të vazhdueshme.
- Segmenti i çështjeve shumëvjeçare duhet monitoruar në mënyrë të posaçme.

Progresi i vitit 2025 përputhet me objektivat e Strategjisë Kombëtare për Uljen e Çështjeve të Prapambetura 2024–2027, por kërkon konsolidim të mëtejshëm.

1. **Prioritete për vitin 2026**

- Ruajtja e CR mbi 100% në mënyrë të qëndrueshme.
- Reduktimi i DT civil përmes ndërhyrjeve të targetuara.
- Rishpërndarje fleksibile e burimeve në gjykatat me presion disproporcional.
- Fokus specifik në reduktimin e çështjeve mbi 3 vite.

9. BASHKËPUNIMI NDËRINSTITUCIONAL DHE TRANSPARENCA

9.1 Bashkëpunimi i Brendshëm

Gjatë rrugëtimit të tij, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vijuar me efektivitet të plotë bashkëpunimet me shumë aktorë, të cilët jo vetëm kanë besuar në misionin e tij, por kanë shumëfishuar dhe amplifikuar përpjekjet e përbashkëta në përmbushjen e tij. Qasja e Këshillit ka qenë sa institucionale aq dhe proaktive, duke konsoliduar tashmë urat e bashkëpunimit me aktorë të rëndësishëm që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në fushën e drejtësisë, ndër të cilat përmendim:

Bashkëpunimi me Kuvendin e Shqipërisë – Këshilli ka vijuar edhe këtë vit bashkëpunimin e ngushtë me Kuvendin e Republikës së Shqipërisë në përmbushje të detyrimeve të tij kushtetuese dhe ligjore për të raportuar mbi veprimtarinë e institucionit, si dhe gjendjen e sistemit gjyqësor. Vlen të theksojmë se gjatë vitit 2025 janë intensifikuar komunikimet ndërinstitucionale me Kuvendin.

Bashkëpunimi me Ministrinë e Drejtësisë – i cili vijon të mbetet një bashkudhëtar i pandashëm i Këshillit në misionin e tij për krijimin dhe zhvillimin e një gjyqësori në përputhje me standardet më të larta ndërkombëtare.

Bashkëpunimi me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë – si një ndër bashkëpunëtorët më të ngushtë të Këshillit në funksion të garantimit të përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies së gjyqtarëve ndaj publikut dhe rritjes së besimit të tij në sistemin gjyqësor. Këshilli ka vijuar me shqyrtimin e kërkesave për procedimet disiplinore të paraqitura nga ILD-ja ndaj gjyqtarëve, duke vlerësuar këto kërkesa me korrektësi dhe brenda afateve ligjore në përputhje me ligjin "Për Statusin" dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi.

Bashkëpunimi me Këshillin e Lartë të Prokurorisë – Këshilli ka vijuar bashkëpunimin me KLP-në në përmbushje të nenit 170 të Ligjit për Qeverisjen. Një tregues i bashkëpunimit të suksesshëm mes dy Këshillave është dhe miratimi i Rregullores “Për mbledhjet e përbashkëta dhe bashkëpunimin ndërinstitucional ndërmjet Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë”. Ndër të tjera, në këtë akt parashikohen bashkërendim dhe përafrim në interpretimin dhe zbatimin e dispozitave ligjore, shkëmbim të jurisprudencës dhe praktikave institucionale, harmonizimi i procedurave dhe politikave në çështjet që lidhen me zhvillimin e karrierës, vlerësimin, transferimin dhe disiplinën e magjistratëve. Gjithashtu, gjatë vitit 2025 këshillat kanë intensifikuar takimet e përbashkëta duke zhvilluar 3 të tilla. Në këtë drejtim, evidentojmë se ky intensifikim përbën një rritje të rëndësishme të bashkëpunimit institucional duke i konsideruar këto takime si forume për të adresuar çështje me rëndësi.

Bashkëpunimi me Shkollën e Magjistraturës – i cili ka efekte të drejtpërdrejta në rritjen efiçencës së sistemit gjyqësor dhe përmirësimit të kapaciteteve të gjyqtarëve, këshilltarëve dhe ndihmësve ligjorë. Në këtë kontekst, vlen të përmendet se bashkëpunimi ndërinstitucional vijon jo vetëm në drejtim të përcaktimit të kuotave për kandidatët për formimin fillestar dhe të vazhdueshëm të profilit magjistrat dhe ndihmës ligjor por edhe në kuadër të formimit fillestar dhe vazhdues të aktorëve më të rëndësishëm të sistemit gjyqësor.

Bashkëpunimi me Inspektorin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave– i cili vijon të mbetet një bashkëpunëtor i rëndësishëm i Këshillit të Lartë Gjyqësor në drejtim të ushtrimit të kompetencave të tij për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë si dhe zhvillimi të karrierës së tyre. Në sajë të këtij bashkëpunimi të frytshëm Këshilli ka arritur të përmbyllë me sukses procedurat e verifikimit të pasurisë dhe figurës për kandidatët për në formimin fillestar për magjistratë në SHM, kandidatët për magjistratë të diplomuar nga SHM-ja, për kancelarët në detyrë, për kandidatët për në formimin fillestar për ndihmës ligjorë, si dhe për gjyqtarët që kandidojnë për ngritje në detyrë në gjykatat më të larta dhe ato të specializuara.

Bashkëpunimi me institucione të tjera

Në kuadër të përmbushjes së kompetencave të tij për garantimin e integritetit në sistemin gjyqësor, Këshilli bashkëpunon ngushtësisht edhe me institucione të tjera, ku mund të përmendim Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile, Prokurorinë e Përgjithshme si dhe Autoritetin për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit, Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe të Dhënat Personale, etj.

9.2 Bashkëpunimi me grupet e interesit

Bashkëpunimi me Shoqërinë Civile – të cilët janë bashkëpunëtorë të ngushtë të Këshillit në përmbushjen e misionit të tij për një sistem gjyqësor të pavarur, profesional dhe me integritet të lartë, që meriton besimin e publikut.

9.3 Bashkëpunimi me Gjykatat

Komunikimi dhe ndërveprimi mes Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe gjykatave mbetet thelbësor për rritjen e cilësisë së drejtësisë. Në këtë drejtim, Këshilli edhe këtë vit ka pasur bashkëpunime intensive me gjykatat, veçanërisht në kuadër të hartimit të Strategjisë për Uljen e Numrit të Çështjeve të Prapambetura në Gjykata dhe vijimit të zbatimit të saj, si dhe nëpërmjet nënshtrimit të procesit të konsultimit të projekt-akteve të tij, me të gjitha gjykatat në vend. Një tjetër dimension i bashkëpunimit me gjykatat është angazhimi i përbashkët në procesin e planifikimit strategjik për identifikimin qartësisht të vizionit dhe objektivave strategjikë të Këshillit dhe sistemit gjyqësor për periudhën 2025 -2027.

9.4 Aktivitete dhe marrëdhënie ndërkombëtare

Gjatë vitit 2025, në përputhje me objektivat e Strategjisë Institucionale, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka zhvilluar një sërë aktivitetesh dhe bashkëpunimesh ndërinstitucionale dhe ndërkombëtare për forcimin e pavarësisë, profesionalizmit dhe efikasitetit të sistemit gjyqësor. Ndër to vlejnë të përmenden bashkëpunimet me Asamblenë e Përgjithshme të Rrjetit Evropian të Këshillave për Gjyqësorin (ENCJ), Komisionin Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ), Shoqatën Ndërkombëtare për Administrimin Gjyqësor (IACA), Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) dhe Operacionin Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM).

Në kuadër të forcimit të bashkëpunimit me partnerët ndërkombëtarë dhe asistencës së tyre, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor janë zhvilluar takime me përfaqësues të diplomacisë dhe ekspertë ndërkombëtarë. Ndër to përmenden: takimi me Ambasadorin e Gjermanisë, z. Karl Bergner; Zëvendësambasadorin e Italisë, z. Luigi Mattirolo; Ambasadorin e Spanjës, z. Gabriel Cremades Ventura; Ambasadorin e Mbretërisë së Bashkuar, z. Nicholas Abbott; si dhe Kryetaren e Gjykatës së Lartë të Holandës, së bashku me delegacionin shoqërues të Ambasadës së Mbretërisë së Vendeve të Ulëta. Gjithashtu, Kryetari dhe anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor kanë pritur Drejtoreshën për Ballkanin Perëndimor në DG NEAR, znj. Valentina Superti.

Po ashtu, gjatë këtij viti janë zhvilluar takime edhe me delegacione nga Komisioni Evropian, me delegacione gjyqtarësh nga Austria dhe Azerbajxhani, etj.

Një aspekt i rëndësishëm është shkëmbimi i eksperiencave dhe ndarja e praktikave më të mira me institucionet homologe. Për këtë arsye, përfaqësues të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të sistemit gjyqësor kanë marrë pjesë në vizita studimore, si:

- Kongresi i 29-të Botëror i Ligjit në Santo Domingo, Republika Domenikane, me fokus pavarësinë, sigurinë dhe integritetin e gjyqtarëve. Pjesëmarrja mundësoi shkëmbimin e përvojave me homologë ndërkombëtarë dhe theksoi angazhimin e vazhdueshëm për forcimin e besimit të publikut te sistemi gjyqësor, në prag të organizimit të Kongresit Botëror të Ligjit në Shqipëri në vitin 2027.

- Konferenca Ndërkombëtare “Sfidat Globale në Administrimin Gjyqësor”, në Baku, me rastin e 20-vjetorit të Këshillit Gjyqësor-Ligjor të Azerbajxhanit, ku u prezantuan masat e ndërmarra për rritjen e efikasitetit, forcimin e pavarësisë dhe digjitalizimin e sistemit gjyqësor. Në përfundim u nënshkrua një memorandum mirëkuptimi ndërinstitucional dhe u zhvillua një takim me z. Ramin Garagurbanli për shkëmbimin e përvojave në administrimin gjyqësor.

- Vizita në Ministrinë e Drejtësisë së Francës dhe në Këshillin e Lartë të Magjistraturës në Paris, për shkëmbimin e praktikave më të mira në administrimin gjyqësor. Gjatë vizitës u trajtuan menaxhimi i burimeve njerëzore, organizimi dhe kompetencat institucionale, si dhe sfidat e përbashkëta, në funksion të përmirësimit të administrimit gjyqësor në kuadër të integrimit evropian.

9.5 Bashkëpunimi në kuadër të procesit të negociatave për anëtarësim në BE

Integrimi në Bashkimin Evropian vijon të mbetet një objektiv themelor për Shqipërinë, e cila gjatë këtij viti shënoi një hap të rëndësishëm për progresin e negociatave për grup-kapitullin e parë "Themeloret". Në këtë kuadër, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka kontribuar në mënyrë të vazhdueshme duke raportuar zhvillimet kryesore dhe rezultatet e arritura, si edhe duke përditësuar masat e kërkuara nga Bashkimi Evropian dhe Kuvendi i Shqipërisë, në funksion të përmbushjes së rekomandimeve për Kapitullin 23 "Gjyqësori dhe të drejtat themelore", Kapitullin 24 "Drejtësia, liria dhe siguria", si dhe Kriterin Politik.

Angazhimi i Këshillit në përmbushjen efektive të detyrimeve që burojnë nga procesi i integrimit është materializuar në disa drejtime, ndër të cilat përfshihen raportimet periodike tremujore, gjashtëmujore dhe vjetore, të dorëzuara pranë Ministrisë së Drejtësisë në cilësinë e negociatorit të kapitullit. Për më tej, Këshilli vijon të kontribuojë në raportime thelbësore për progresin në procesin e integrimit, si: Raporti i Progresit, Raporti për Sundimin e Ligjit, Agjenda Kombëtare e Reformave, si dhe në pjesëmarrjen në takime në kuadër të procesit të integrimit, si Nënkomiteti "Drejtësi, Liri dhe Siguri", takimi në kuadër të vizitës zyrtare të Grupit të Këshillit të Bashkimit Evropian për Zgjerimin dhe Vendet që Negociojnë Anëtarësimin në Union (COELA).

Një tjetër hap i mëtejshëm në kuadër të procesit të integrimit ishin edhe raportimet mujore pranë shërbimeve të Komisionit Evropian në lidhje me Piketat e Ndërmjetme, sipas dokumentit "Pozicion i përbashkët midis BE-së dhe Shqipërisë" për grup-kapitullin e Themeloreve, takime të cilat janë zhvilluar përgjatë gjithë vitit 2025.

9.6 Transparenca dhe marrëdhëniet me publikun

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në përmbushje të misionit të tij për të qeverisur një sistem gjyqësor me standarde të larta dhe të denjë për besimin e qytetarëve, është angazhuar plotësisht në garantimin e funksionimit të rregullt dhe transparent të marrëdhënieve të gjyqësorit me publikun dhe median.

Prej tre vitesh, KLGJ-ja ka vijuar ndjekjen dhe zbatimin e Planit të Komunikimit për Gjykatat, nëpërmjet raportimeve periodike të gjykatave lidhur me zbatimin e objektivave strategjike që përmbante ky plan. Në zbatim të këtij plani ka pasur arritje të rëndësishme, si përditësimi i faqes zyrtare të institucionit, përdorimi i platformës sociale Facebook për

shpërndarjen në kohë të informacionit për publikun, organizimi i takimeve me gazetarë, përfaqësues të medias dhe grupeve të tjera të interesit, si dhe publikimi i materialeve informuese mbi riorganizimin e gjykatave, vendimmarrjen, veprimtarinë dhe fuksionimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Për vitin 2025, Këshilli, në bashkëpunim me projektin "EU4Justice", nisi draftimin e Planit të ri të Komunikimit për Gjykatat, duke marrë në konsideratë praktikat dhe përvojat më të mira ndërkombëtare, si dhe duke u konsultuar me gjykatat mbi elementet që duhet të përmirësohen në krahasim me planin e mëparshëm të komunikimit.

Gjatë vitit 2025, KLGJ-ja ka publikuar 114 njoftime për shtyp, nga të cilat 78 kanë pasur si qëllim informimin e publikut mbi vendimmarrje të rëndësishme të Këshillit, ndërsa 40 njoftime të tjera kanë pasqyruar aktivitete dhe veprimtari të ndryshme institucionale. Gjithashtu, në përgjigje të sulmeve mediatike ndaj figurës së gjyqtarit, KLGJ-ja ka publikuar në faqen zyrtare të internetit dhe në platformën "Facebook", katër deklarata për shtyp, në mbrojtje të dinjitetit, integritetit dhe figurës së gjyqtarit.

Në zbatim të objektivave të përcaktuara, Këshilli ka vijuar publikimin e Buletinit periodik 3-mujor në faqen zyrtare www.klgj.al, i cili përmban informacion mbi vendimmarrjen dhe veprimtarinë e KLGJ-së, si dhe të dhëna statistikore relevante. Paralelisht, në kuadër të zbatimit të Udhërrëfyesit për Efikasitetin e Pushtetit Gjyqësor në Shqipëri 2025–2027, ka nisur edhe publikimi i të dhënave të hapura mbi emërimet, ngritjet në detyrë dhe transferimet e magjistratëve gjyqtarë në faqen zyrtare të Këshillit.

Programi i Transparencës:

Gjatë vitit 2025, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka trajtuar në total 53 kërkesa për informacion, të paraqitura në bazë të ligjit "Për të drejtën e informimit". Nga këto, 42 kërkesa janë trajtuar me përgjigje të plotë, 4 kanë marrë përgjigje të pjesshme (të kufizuar sipas nenit 17 të këtij ligji), 4 kërkesa janë deleguar pranë autoriteteve kompetente, ndërsa 3 kërkesa janë refuzuar, pasi u vlerësua se dhënia e informacionit do të cenonte të dhënat personale të të tretëve.

Në funksion garantimit të transparencës së plotë dhe informimin e publikut dhe medias, si dhe në zbatim të legjislacionit për të drejtën e informimit, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka publikuar në faqen e tij zyrtare Programin e Transparencës, sipas formatit të miratuar nga Komisineri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. KLGJ-ja ka vijuar përditësimin e vazhdueshëm të këtij programi, duke pasqyruar veprimtarinë e tij në funksion të rritjes së transparencës dhe garantimit të aksesit të publikut në informacion.

10. KONKLUZIONE DHE ANGAZHIME

1. Forcimi i qeverisjes gjyqësore

Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vijuar të konsolidojë rolin e tij si institucion qendror dhe i pavarur në qeverisjen e sistemit gjyqësor. Procesi i ripërtëritjes së anëtarësisë dhe drejtimit është shoqëruar me ruajtjen e vazhdimësisë institucionale dhe me intensifikimin e aktivitetit vendimmarrës. Zhvillimi i 69 mbledhjeve plenare dhe miratimi i 882 vendimeve dëshmojnë një nivel të lartë funksionaliteti dhe një vijueshmëri të qëndrueshme institucionale. Kjo veprimtari reflekton një angazhim të qëndrueshëm për garantimin e funksionimit efikas të sistemit gjyqësor, si dhe për përmbushjen e përgjegjësive kushtetuese dhe ligjore të Këshillit.

2. Përmirësimi i menaxhimit të çështjeve të prapambetura

Gjatë vitit 2025 vihet re një prirje e qartë drejt stabilizimit dhe reduktimit të çështjeve të prapambetura në disa nivele të sistemit gjyqësor. Gjykata e Lartë ka shënuar një ulje prej 21% të *backlog*-ut, ndërsa në gjykatat e shkallës së parë është regjistruar një reduktim prej 5.5%. Këto zhvillime tregojnë se masat e ndërmarra për menaxhimin aktiv të stokut të çështjeve kanë filluar të japin rezultate konkrete, duke përmirësuar gradualisht efikasitetin e sistemit. Megjithatë, pavarësisht këtij progresi, sfidat mbeten të pranishme në disa nivele, veçanërisht në gjykatat e apelit, ku presioni i *backlog*-ut vijon të jetë i lartë dhe kërkon ndërhyrje të mëtejshme strukturore dhe organizative.

3. Rritja e efikasitetit operacional dhe standardizimi

Miratimi dhe zbatimi i standardeve minimale kohore dhe sasiore, si dhe i modeleve të unifikuara të vendimmarrjes, kanë kontribuar në forcimin e koherencës procedurale dhe rritjen e efikasitetit institucional. Normat e likuidimit mbi 100% në gjykatat e shkallës së parë, si për çështjet civile ashtu edhe penale, dëshmojnë një kapacitet të qëndrueshëm për përballimin e ngarkesës së re gjyqësore. Kjo tregon se sistemi, në këto nivele, ka hyrë në një fazë stabilizimi dhe në disa raste edhe reduktimi gradual të *backlog*-ut.

4. Avancimi i transformimit digjital

Ndërtimi i sistemit Juronix dhe procesi i digjitalizimit të një vëllimi të konsiderueshëm dokumentacioni përfaqësojnë një hap të rëndësishëm në modernizimin strukturor të sistemit gjyqësor. Ky zhvillim kontribuon në përmirësimin e aksesit, rritjen e transparencës dhe efikasitetit administrativ, duke hedhur bazat e një sistemi më të integruar dhe bashkëkohor.

5. Zhvillimi i burimeve njerëzore

Proceset e vlerësimit etik dhe profesional, emërimi i magjistratëve të rinj dhe zhvillimi i programeve të trajnimit të vazhdueshëm reflektojnë një qasje gjithnjë e më të strukturuar dhe

sistematike ndaj zhvillimit të kapaciteteve njerëzore. Vëmendja institucionale është zhvendosur në mënyrë progresive drejt forcimit cilësor të trupës gjyqësore.

Sfidat Strukturore të Identifikuara

1. Pabarazitë në shpërndarjen e ngarkesës

Analizat tregojnë një përqendrim të konsiderueshëm të ngarkesës gjyqësore në disa juridiksione kryesore, veçanërisht në Tiranë, çka vijon të krijojë presion të lartë operacional dhe disbalanca në shpërndarjen e çështjeve.

2. Vakancat dhe kufizimet në kapacitetet njerëzore

Mungesat në organikë në disa nivele të sistemit, përfshirë gjykatat e apelit, mbeten një faktor kufizues për rritjen e mëtejshme të efikasitetit institucional dhe përshpejtimin e proceseve gjyqësore.

3. Kohëzgjatja e procedurave në juridiksione të caktuara

Pavarësisht përmirësimeve të arritura, kohëzgjatja e procedurave në disa segmente, veçanërisht në gjykatat administrative të apelit dhe në çështjet civile në apel, vijon të mbetet mbi nivelet e dëshiruara të efiçencës, duke kërkuar ndërhyrje të mëtejshme strukturore.

Angazhimet Strategjike për periudhën 2026–2028

1. Konsolidimi i reformave dhe standardizimi i performancës

Institucioni mbetet i angazhuar për forcimin e standardizimit të praktikave gjyqësore, përmirësimin e cilësisë së vendimmarrjes dhe zbatimin e plotë të instrumenteve të efiçencës, përfshirë monitorimin periodik të treguesve të performancës.

2. Reduktimi progresiv i çështjeve të prapambetura

Synohet vijimi i reduktimit të *backlog*-ut përmes zbatimit të planeve të dedikuara institucionale, rritjes së kapaciteteve menaxhuese dhe prioritizimit të çështjeve mbi bazën e kritereve të qarta funksionale, me qëllim përmirësimin e kohëzgjatjes së procedurave.

3. Forcimi i kapaciteteve njerëzore

Parashikohet vijimi i plotësimit gradual të vakancave dhe forcimi i trupës gjyqësore dhe administrative, në funksion të rritjes së qëndrueshme të kapaciteteve të sistemit.

4. Përmbyllja e transformimit digjital

Do të vijojë implementimi i plotë i sistemit të menaxhimit të çështjeve, zgjerimi i shërbimeve digjitale dhe forcimi i infrastrukturës teknologjike, me synim rritjen e aksesit dhe transparencës për qytetarët.

5. Përmirësimi i infrastrukturës gjyqësore

Do të vazhdojnë kërkesat buxhetore për përmirësimin e infrastrukturës ekzistuese si dhe kërkesa për godina të tjera.

6. Forcimi i transparencës dhe komunikimit institucional

Institucioni mbetet i angazhuar për rritjen e transparencës publike, publikimin periodik të të dhënave dhe forcimin e komunikimit me publikun, mediat dhe aktorët e shoqërisë civile.

7. Integrimi evropian dhe përafrimi me standardet ndërkombëtare

Do të vijojë harmonizimi me standardet evropiane të drejtësisë, zbatimi i rekomandimeve ndërkombëtare dhe forcimi i bashkëpunimit me institucionet homologe.

Kërkesa për mbështetje institucionale

Institucioni vlerëson rëndësinë e vijimit të mbështetjes ndërinstitucionale në drejtim të:

- përmirësimeve legjislative për rritjen e efikasitetit gjyqësor,
- mbështetjes financiare për projektet prioritare infrastrukturore dhe teknologjike,
- forcimit të koordinimit institucional në nivel ekzekutiv dhe vendor,
- infrastrukturës në asete fizike,
- si dhe mbështetjes nga partnerët ndërkombëtarë në fushën e trajnimeve dhe shkëmbimit të praktikave më të mira.

VIZIONI

Në perspektivën afatmesme, synohet ndërtimi i një sistemi gjyqësor të konsoliduar dhe efikas, me reduktim të ndjeshëm të çështjeve të prapambetura, kapacitete institucionale të forcuara, infrastrukturë moderne dhe shërbime digjitale të zgjeruara, i cili garanton transparencë të lartë dhe besim të qëndrueshëm publik.

Ky vizion mbështetet në parimin se drejtësia është një shtyllë themelore e shtetit të së drejtës dhe zhvillimit demokratik, dhe se përmirësimi i saj përbën një proces të vazhdueshëm, të përbashkët dhe të qëndrueshëm institucional.